

POLITIKAT FISKALE, KONKURUESHMËRIA DHE ZHVILLIMI I BISNESEVE NË KOSOVË

Skender Hasani

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës doktrale

Në përmbushje të detyrimeve të Programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, profili Financa, për marrjen e gradës shkencore
’’ Doktor’’

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Flutura Kalemi

Numri i fjalëve: 61,901

Tiranë, Prill 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Me anë të kësaj deklarate deklaroj se punimin tim të doktoratës, dorëzuar te udhëheqësi im shkencor dhe te Këshilli i Profesorëve pranë Universitetit Europian të Tiranës e kam shkruar në mënyrë të pavarur dhe si i tillë është punim imi autorial.

Ky punim i doktoratës deri tani nuk ka qenë i publikuar në asnjë institucion tjetër dhe nuk është përdorur për qëllime akademike apo qëllime të tjera mësimore dhe nuk e kam shfrytëzuar asnjëherë për marrjen e ndonjë kredie akademike apo përfitime të tjera.

Gjatë punimit të këtij punimi të doktoratës në tërësi iu jam përmbajtur dhe kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të kërkuara sipas udhërrëfyesit të Doktoratës të Universitetit Europian të Tiranës.

ABSTRAKT

“Të ardhurat vjetore njëzet paund; shpenzimet vjetore nëntëmbëdhjetë; rezultati, lumturi. Të ardhurat vjetore njëzet paund; shpenzimet vjetore njëzet e gjashtë paund; rezultati, mjerim”

Charles Dickens

Politikat fiskale së bashku me ato monetare janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin ekonomik të një vendi. Kosova deri në pavarësinë e saj më 2008 asnjëherë nuk ka aplikuar politika fiskale të pavarura. Për shkak të diskutimeve të shumta se politikat e fiskale të aplikuara në Kosovë kanë qenë jo stimuluese për bizneset Kosovare ky studim ka për qëllim të përcaktojë sa kanë ndikuar politikat e aplikuara veçanërisht pas vitit 2009 në rritjen ekonomike, rritjen e aftësisë konkurruese dhe zhvillimin e bizneseve Kosovare.

Kampioni i studimit ka përfshirë 425 biznese, pjesa dërmuese të mëdha, sipas kategorizimit që bëhet në Kosovë nga KKRF dhe të dhënat janë mbledhur nga drejtorët financiarë, menaxherët e financave dhe shefat e kontabilitetit në këto shoqëri. Të dhënat e marra nga analizat e regresionit kanë dhëna disa rezultate. Rezultatet e dhëna tregojnë se Kosova nuk ka mundur të ndikojë në politikat monetare Ajo të vetmin opsion ka pasur politikat fiskale të cilat nuk kanë pasur efekt në stimulimin e shoqërive vendore veçanërisht prodhuese. Si rezultat ajo nuk ka arritur të zvogëlojë deficitin e madh tregtar, të krijojnë kushte të volitshme për investime të huaja dhe të zvogëlojë nivelin e papunësisë dhe të varfërisë.

ABSTRACT

“Annual income twenty pounds, annual expenditure nineteen six, result happiness. Annual income twenty pounds, annual expenditure twenty pound ought and six, result misery”

Charles Dickens

Fiscal and monetary policies are of specific importance for the economic development of a country. Until its independence in 2008, Kosovo never applied independent fiscal policies. Due to numerous discussions that fiscal policies applied in Kosovo were not an incentive to Kosovo businesses, the aim of this study is to provide an answer to research question whether policies applied especially after 2009 influenced economic growth and by that enhancement of competitive ability and development of Kosovo businesses.

The sample of the study covered 425 companies in whose majority is based on the classification done in Kosovo by KKRF and the data collected from financial directors, finance managers and heads of accounting of said associations. Data collected from regression analysis gave some results. The results show that unable to influence its monetary policies, the only option for Kosovo were fiscal policies that did not incentivize local companies especially those in production thus failing to minimize great trade deficit, it also failed in establishing favourable conditions for foreign investments in Kosovo and reduce the unemployment and the poverty existing in Kosovo.

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj prindërve të mi të cilët sakrifikuan shumë për mua dhe familjen për të na shkolluar duke u privuar nga shumë mundësi të tyre vetëm që unë dhe fëmijët e tjerë të kishim një jetë më të mirë. Ja dedikoj bashkëshortes dhe fëmijëve të mi të cilët më përkrahën dhe më motivuan për punë, vëllezërve dhe motrave, nipave dhe mbesave dhe tërë atyre që më përkrahën në të gjitha aspektet atëherë kur kisha më shumë nevojë dhe më dhanë shtytje për punën time shkencore dhe profesionale.

FALENDERIME

Së pari dëshiroj të falënderoj udhëheqësen time shkencore Prof. Dr. Flutura Kalemi e cila më mbështeti dhe me këshillat e saj më ndihmoi në realizimin e këtij punimi doktoral. Gjithashtu falënderoj kolegët dhe familjen të cilët më mbështetën dhe me dhanë shtytje në angazhimet dhe punën time kërkimore pa të cilët do ta kisha shumë më të vështirë përfundimin e këtij punimi doktoral. Falënderoj edhe kolegët e mi të studimeve Bahri Hyseni dhe Fatmir Mehmeti për bashkëpunimin që kemi pasur gjatë viteve të studimeve. Gjithashtu falënderoj kolegët e punës Alban Idrizi, Suad Gosalci dhe Arben Qerimi të cilët më ndihmuan në përgatitjen teknike të punimit.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

MF – Ministria e Financave e Kosovës

KKRF – Këshilli Kosovar për Raportim Financiar

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

BE – Bashkimi European

BB – Banka Botërore

BERZH – Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

ESK – Enti Statistikor i Kosovës

EFTA - Zvicra, Irlanda, Norvegjia, Lihtenshtajni

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

INSTAT – Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë

ICO – Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PBB – Prodhimi i Brendshëm Bruto

KB – Kombet e Bashkuara

NATO – Aleanca Veri Atlantike

SHKACK – Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës

OJQ – Organizata Joqeveritare

USADI – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për zhvillim

PTK – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

CEFTA – Vendet e Evropës Lindore dhe Jugore që aspirojnë anëtarësimin në BE

IQP – Institucionet e Qeverisjes së përkohshme

PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

TAK – Tatimi në të ardhura të korporatave

TAP – Tatimi në të ardhura personale

TKP – Trusti i Kursimit të pensioneve

TVSH – Tatimi në vlerën e shtuar

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

OSBE – Organizata Europiane për Siguri dhe Bashkëpunim

AQF – Autoriteti Qendror Fiskal

Përmbajtja

KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1 Parathënie	1
1.2 Shtrimi i problemit	4
1.3 Qëllimi i studimit dhe objektivat.....	4
1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat	6
1.5 Metodologjia e kërkimit	7
1.6 Rëndësia e studimit	7
1.7 Mundësitë dhe kufizimet	8
1.8 Shpjegimi i strukturës së punimit.....	10
1.9 Përmbledhja e kapitullit të parë.....	11
KAPITULLI II:	12
VËSHTRIMI TEORIK - RISHIKIMI I LITERATURËS	12
2.1 Aspekti teorik mbi politikat fiskale dhe sistemet fiskale.....	12
2.2 Teoritë ekonomike të lidhura me problemin	20
2.3 Qasja rreth politikave dhe sistemeve fiskale nga autorët e tjerë pas Keynesit	22
2.4 Ndikimi i shtetit në ekonomi sipas qasjeve të ndryshme	25
2.5 Rishikimi i literaturës së kohëve të fundit mbi politikat fiskale.....	29
2.6 Vlerësimi i politikave fiskale të zbatuara në Kosovë në frymën e teorive ekzistuese në këtë fushë.....	44
2.7 Politikat fiskale dhe zhvillimi i bizneseve.....	45
2.8 Përmbledhja e kapitullit.....	51
KAPITULLI III :	52
POLITIKAT FISKALE, SISTEMI FISKAL DHE KONKURUESHMËRIA E BISNESEVE NË KOSOVË	52
3.1 Kosova dhe politikat fiskale të ndjekura gjatë periudhës kur ishte pjesë e RSFJ	52
3.1.1 Diferencat zhvillimore në Kosovës krahasura me vendet e tjera	54
3.1.2 Diferencat në punësim të Kosovës me viset e tjera	56
3.1.4 Politikat fiskale të udhëhequra nga UNMIK- u nëpërmjet Autoritetit Qendror Fiskal pas vitit 1999 deri në vitin 2008	60
3.1.5 Ndryshimet e politikave fiskale nga viti 2005 deri në vitin 2008.....	65
3.1.7 Sistemet fiskale të ndjekura nga vendet e Ballkanit deri në vitin 2008	72

3.1.8 Ndryshimet dhe politikat fiskale të ndjekura nga Qeveria e Kosovës pas vitit 2009	74
3.1.9 Reforma fiskale e vitit 2015 dhe ndryshimet tjera që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve.....	89
3.1.10 A duhet të eliminohet pragu për regjistrim në tvsh në Kosovë ?	90
3.1.11 Barra tatimore në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit	93
3.2 Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve totale në Buxhetin e Kosovës dhe krahasimi me PBB	95
3.2.1 Prodhimi i brendshëm bruto në Kosovë.....	104
3.2.2 PBB në Kosovë nga viti 2013 deri në vitin 2016 nëpër sektor ekonomik	108
3.2.3 Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB në vendet e Bashkimit Europian nga viti 2009 dhe deficitit buxhetor	110
3.2.4 Pjesëmarrja e të hyrave dhe shpenzimeve totale në PBB e Kosovës dhe krahasimi me vendet e BE.....	114
3.2.5 Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB në vendet e Rajonit dhe krahasimi me Kosovën	116
3.2.6 PBB në Kosovë nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas sektorëve ekonomik.....	121
3.2.7 Borxhi Publik i Kosovës dhe krahasimi me vendet e rajonit	123
3.3 Zhvillimi i bizneseve në Kosovë	126
3.3.1 Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme	133
3.4 Konkureshmëria, dhe krahasimet me vendet e ndryshme	137
3.4.1 Qasja makroekonomike në konkurrencë	143
3.4.2 Qasja mikroekonomike në konkurrencë	146
3.4.3 Konkureshmëria e bizneseve Kosovare.....	150
3.5 Përmbledhja e kapitullit.....	161
KAPITULLI IV: MBLEDHJA E TË DHËNAVE NË TERREN	162
4.1 Puna kërkimore në terren	162
4.2 Popullata dhe kampioni i studimit.....	164
4.3 Metodologjia e përdorur	166
4.4 Mbledhja e të dhënave si dhe përpunimi i tyre.....	167
4.4.1 Pyetësori.....	167
4.4.2 Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave primare	167
KAPITULLI V: INTERPRETIMI I TË DHËNAVE.....	169

5.1 Bizneset e përfshira në studim.....	169
5.2 Politikat fiskale sipas personave të përfshirë në hulumtim për të gjitha bizneset	171
5.2.1 Politikat fiskale sipas personave të përfshirë në hulumtim, pjesa vetëm për bizneset prodhuese.....	176
5.3 Aftësitë konkurruese të bizneseve të përfshira në hulumtim.....	177
5.4 Informata mbi të punësuarit	183
5.5 Informata mbi rezultatin financiar.....	184
5.6 Rezultatet nga hulumtimi i bërë me institucionet qeveritare dhe organizatat e tjera joqeveritare.....	184
5.7 Analiza statistikore dhe interpretimi i të dhënave primare.....	186
Mbledhja e të dhënave.....	186
Futja e të dhënave në data bazë dhe kodimi i tyre.....	186
Përpunimi i të dhënave	187
5.8 TESTIMI I HIPOTEZAVE – KOEFICIENTET E KORRELACIONIT	192
KAPITULLI VI : KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	222
6.1 Konkluzione	222
6.2 Rekomandime.....	231
BIBLIOGRAFIA	237
ANEKSE	243

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKONEVE

Lista e Tabelave

Tabela Nr. 1 – Decentralizimi Fiskal – Pjesëmarrja e niveleve të ndryshme të qeverisjes në të dalat publike	54
Tabela Nr. 2 – Prodhimi Brendshëm Bruto për çdo banor në ish jugosllavi në periudha të ndryshme vlerat në dollar amerikan ndaj vlerave mesatare	56
Tabela Nr. 3 – Niveli i papunësisë tek njësitë federale të ish Jugosllavisë	58
Tabela Nr. 4 – Buxheti i Konsoliduari Kosovës 2000–2004.....	63
Tabela Nr. 5 – Të ardhurat buxhetore në Kosovë viti fiskal 2004.....	64
Tabela Nr. 6 – Krahasimi i obligimeve tatimore në mes të shoqërive tregtare me status të ndryshëm	68
Tabela Nr. 7 – Të hyrat e realizuara nga viti 2005 deri në vitin 2008	71
Tabela Nr. 8 – Normat tatimore në vende të ndryshme të regjionit nëpër periudha të ndryshme duke përfshirë periudhën 1992 deri në vitin 2009.....	73
Tabela Nr. 9 – Norma Tatimore në vendet ndryshme të CEFTA-s pas vitit 2009	77
Tabela Nr. 10 – Të hyrat e realizuara nga tatimet brenda vendit.....	82
Tabela Nr. 11 – Krahasimi i të hyrave tatimore me të hyrat totale.....	83
Tabela Nr. 12 – Të hyrat e realizuara nga pikat kufitare	85
Tabela Nr. 13 – Krahasimi i tvsh- së të mbledhur brenda vendit në krahasim me tvsh –në e mbledhur në kufi nga viti 2009 deri në vitin 2016	86
Tabela Nr. 14 – TVSH totale të mbledhura në kufi dhe brenda vendit	88
Tabela Nr. 15 – Të hyrat tatimore për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2016	90
Tabela Nr. 16 – Qarkullimi dhe pagesat e deklaruesve të TVSH-së	91
Tabela Nr. 17 – Krahasimi i qarkullimit total dhe qarkullimi të deklaruesve të tvsh-së të deklaruar në tvsh dhe pagesat e tatimeve	91
Tabela Nr. 18 – Normat mesatare tatimore në Ballkan	94
Tabela Nr. 19 – Dallimet në mes të normave tatimore dhe ngarkesave fiskale në vendet e Ballkanit në vitin 2016.....	95
Tabela Nr. 20 – Prodhimi i brendshëm bruto nga viti 2001 - 2004.....	96
Tabela Nr. 21 – Pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në PBB në Kosovë nga viti 2001 deri në vitin 2004	97
Tabela Nr. 22 – Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore nga viti 2007 deri në vitin 2013.....	100

Tabela Nr. 23 – Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore nga viti 2014 deri në vitin 2016,.....	103
Tabela Nr. 24 – Raporti i shpenzimeve buxhetore për vitet 2014 – 2016	104
Tabela Nr. 25 – PBB nga viti 2001 deri në vitin 2004	106
Tabela Nr. 26 – PBB nga viti 2005 deri në vitin 2008 me çmime konstante	107
Tabela Nr. 27 – PBB nga viti 2009 deri në vitin 2013 në Kosovë	107
Tabela Nr. 28 – PBB Sipas sektorëve ekonomik 2013 – 2016, çmimi konstant	109
Tabela Nr. 29 – PBB sipas metodës së shpenzimeve 2013 – 2016, çmimet konstante	110
Tabela Nr. 30 – Krahasimet e të hyrave tatimore të mbledhura në kufi dhe brenda vendit me PBB në Kosovë	114
Tabela Nr. 31 – Pjesëmarrja totale e shpenzimeve buxhetore në PBB në Kosovë.....	115
Tabela Nr. 32 – PBB në vendet e Ballkanit sipas Bankës Botërore	118
Tabela Nr. 33 – Të ardhurat për çdo banor në rajon.....	119
Tabela Nr. 34 – Përqindja e rritjes së PBB në vendet e rajonit 2012 – 2015	120
Tabela Nr. 35 – Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB tek vendet e rajonit shprehur në përqindje	120
Tabela Nr. 36 – Pjesëmarrja e shpenzimeve totale në PBB, shprehur në përqindje.....	121
Tabela Nr. 37 – PBB sipas sektorëve ekonomik 2013 – 2016, çmimi konstant.....	122
Tabela Nr. 38 – Sipas metodës së shpenzimeve 2013 – 2016, çmimet konstante,	123
Tabela Nr. 39 – Borxhi Publik i Kosovës.....	124
Tabela Nr. 40 – Pjesëmarrja e borxhit publik të vendeve fqinje të Kosovës ndaj PBB shprehur në %	124
Table Nr. 41 – Borxhi Publik i Kosovës 2014 - 2016	126
Tabela Nr. 42 – Numri i bizneseve të regjistruara në fund të vitit 2004 në Kosovë.....	127
Tabela Nr. 43 – Numri i bizneseve të regjistruara në fund të vitit 2008 në Kosovë.....	128
Tabela Nr. 44 – Numri bizneseve sipas Entit Statistikor të Kosovës	129
Tabela Nr. 45 – Ndarja e bizneseve sipas madhësisë së tyre.....	130
Tabela Nr. 46 – Renditja e të bërit biznes sipas Bankës Botërore.....	133
Tabela Nr. 47 – Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme të Kosovës.....	135
Tabela Nr. 48 – Struktura e importit sipas vendeve në përqindje në periudhën 2005 – 2013.....	136
Tabela Nr. 49 – Partnerët kryesor tregtar të Kosovës në vitin 2013.....	136
Tabela Nr. 50 – Renditja e konkurrueshmërisë sipas Forumit Ekonomik Botëror prej vitit 2014 deri në vitin 2016 për disa vende	159
Tabela Nr. 51 – Rezultatet e Pyetësorit për politikat fiskale për Biznese	179

Tabela Nr 52 – Rezultatet e anketës tek Institucionet qeveritare dhe OJQ	185
--	-----

LISTA E GRAFIKAVE

Grafika Nr. 1 – Ndarjet buxhetore për hulumtim dhe zhvillimi në krahasim me PBB për vitin 2010	160
Grafiku Nr. 2 – Paraqitja grafike e të hyrave të realizuara nga ATK nga viti 2009 deri në vitin 2016	82
Grafiku Nr. 3 – Paraqitja grafike e të hyrave të mbledhura nga pikat doganore	85
Grafiku Nr. 4 - Paraqitja grafike e tvsh-së të mbledhur në kufi me tvsh-në e mbledhur brenda vendit	87
Grafika Nr. 5 – Paraqitja grafike e përqindjes së rritjes së PBB nga viti 2009 deri në vitin 2013 ..	108
Grafika Nr. 6 – Numri i bizneseve të përfshira në hulumtim	169
Grafika Nr. 7 – Pozita e personave të anketuar në ndërmarrje	170
Grafika Nr. 8 - Bizneset e përfshira në anketim sipas llojit të pronësisë.....	171

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Parathënie

Politika fiskale dhe ajo monetare janë dy komponentë themelore të politikës ekonomike shtetërore, të cilat shfrytëzohen për qëllime makroekonomike: me influencë në produktin e përgjithshëm bruto, nivelin e punësimit, të ardhurën dhe nivelin e çmimeve. Politika fiskale lidhet me veprimet e qeverisë në ndryshimin e kompozicionit të të hyrave dhe shpenzimeve publike, me qëllim menaxhimin e kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike, me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave. Duke njohur faktin se Kosova nuk ka mundësinë për aplikim të politikës monetare, duke mos qenë pjesë e Eurozonës, mundësia e ndërhyrjes në ekonomi është duke u koncentruar në politika fiskale gjë që e bën edhe më të rëndësishme dhe njëkohësisht si instrument të vetëm në krijimin e politikave zhvillimore në Kosovë.

Shkalla e lartë e papunësisë, varfëria e madhe, mungesa e prodhimitarisë vendore dhe deficit i ekstrem tregtar ndërmjet importit dhe eksportit, bën që Kosova sot të mbetet vendi që shpenzon më shumë produkte të huaja për konsum, kurse prodhimtaria vendore mbetet tejtejet e dobët dhe jo konkurrense. Kosova është vendi me shkallën më të ulët të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Evropë, prandaj ndryshimi i këtij kursi aktual me një reformë strukturore, duke nxitur forcimin e bizneseve, zgjerimin dhe transformimin e tyre në kontekst të strukturës ekonomike, përmes stimuljeve makro fiskale, ndërhyrjeve të drejtpërdrejta me subvencione, mbështetje organizative, proteksionizëm, dhe lehtësime të

tjera, janë disa nga politikat të cilat duhen ndërmarrë, me qëllim krijimin e kushteve për rritjen e konkurrencës së bizneseve kosovare jo vetëm në regjion por edhe më gjerë.

Secili vend, me politikat fiskale që aplikon, dëshiron që të arrijë një qëndrueshmëri fiskale dhe ekonomike dhe krijimin kushteve që këto politika të mundësojnë një zhvillim më të shpejtë ekonomik, forcim të ekonomisë vendore, rritje të prodhimit vendor bruto, zvogëlim të papunësisë, rritje të eksportit të prodhimeve vendore dhe rritje të konkurrencës së këtyre prodhimeve ndaj atyre të regjionit dhe më gjerë.

Kosova, pas luftës së fundit është ballafaquar me sfida të shumta, ku më kryesorja ka qenë krijimi i politikave të tilla fiskale, të cilat kishin qëllim emergjent veç donacioneve që vinin nga vende dhe fonde të ndryshme të aplikonin taksa të ndryshme me synim përmbushjen e detyrimeve emergjente për institucionet e Kosovës dhe të popullatës në tërësi, e cila pas periudhës së luftës, kishte nevojë emergjente.

Dihet se, secili vend aplikon politikat e veta fiskale, në përputhje me synimet që dëshiron të arrijë qoftë në synimet e veta makroekonomike apo të ngritjes zhvillimore në ndonjë sektor të veçant.

Kosova në këtë periudhë ka kaluar nëpër sfida të ndryshme, ku pushtetin ekzekutiv fillimisht e ka pasur Unmik me disa shtylla, ku një shtyllë të veçantë ishte krijimi i Politikave fiskale. Pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 2008, kompetencat kalojnë tek institucionet vendore, të cilat gjithsesi janë të mbikqyrura nga ICO e cila shpesh ka ndikuar që vendimet e marra të mos jenë në përputhje me synimet e ekonomisë vendore.

Ne nëpërmjet këtij punimi kemi tentuar që në bazë të analizës së shumë faktorëve , të politikave fiskale të aplikuara në Kosovë dhe vendet që e rrethojnë atë, të rritjes ekonomike të Kosovës, të krahasimit të punësuarve në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë veçanërisht

sektorin prodhues të japim kontribut mbi efektet e politikave fiskale në Kosovë. Punimi tenton që në bazë të krahasimit të dhënave të shohë se cilat ndryshime të politikave fiskale mund dhe duhet të bëhen në Kosovë, më qëllim që bizneset e saj të jenë konkurrense me ato të regjionit. Në bazë të krahasimeve të politikave të japim kontribut në ndryshimin e strukturës së importit dhe eksportit dhe dhënien e mundësisë që dalëngadalë bizneset vendore, veçanërisht ato prodhuese, të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese, kualitetin prodhues dhe prodhimet e tyre të jenë të konkurrense si nga cilësia ashtu edhe nga çmimet, me prodhimet jashtë Kosovës, që kjo rritje të ketë efekte të shumëfishta në të gjitha nivelet e jetës shoqërore në Kosovë.

Periodha e shqyrtuar përfshin vitet nga 1999 deri në vitin 2016 por me theks të veçantë nga viti 2009 pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ku u ndërmorën një sërë reformash në fushën fiskale me synim rritjen ekonomike të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndryshime të infrastrukturës ligjore jo fiskale, të cilat sipas raportit të Bankës Botërore, kanë pasur një ndikim pozitiv në ngritjen e Kosovës në të bërit biznes. Por këto reforma, kanë qenë të pamjaftueshme krahasuar me nevojat imediate në të cilat gjendet ekonomia e Kosovës dhe biznesi si pjesë e saj.

Në përgatitjen e punimit jam bazuar në të dhënat primare të cilat janë mbledhur në terren nga pyetësorët e shpërndarë si dhe nga të dhënat sekondare të mbledhura nga institucionet e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare ku janë analizuar dhe krahasuar publikimet dhe raporte të ndryshme dhe informata të tjera nga fusha fiskale dhe fushat e tjera makroekonomike, të cilat na kanë ndihmuar në nxjerrjen e rezultateve.

1.2 Shtrimi i problemit

Duke u nisur nga fakti se ka mendime të ndryshme nëse politikat fiskale të aplikuara në Kosovë në periudhën 2000 deri 2016 kanë qenë efektive apo jo, kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik apo kanë pasur synim vetëm mbushjen e arkës së shtetit me qëllim të funksionimit normal të tij, kanë pasur efekte në zhvillimin bizneseve dhe në rritjen e punësimit dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve vendosa të përgatis këtë punim. Këto janë disa nga çështjet kryesore me qëllim të analizën e politikave të aplikuara deri tani dhe mundësitë për ndryshimin e tyre me efekt domethënës në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe rritjen e ekonomisë vendore.

Në ditët e sotme edhe vendet më të zhvilluara evropiane dhe botërore bëjnë rishikim të politikave fiskale, me të vetmin qëllim, gjetjen e atyre politikave që janë gjithë përfshirëse dhe me efekte në shumë sfera, si në zvogëlimin e deficitit buxhetor të shteteve të ndryshme si dhe dhënien e mundësisë për një zhvillim të qëndrueshëm duke rritur ekonominë vendore dhe krijimin e kushteve më të favorshme për thithjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta të cilat do të ishin shtytëse për zhvillimin e bizneseve, rritjen e konkurrencës së tyre me efekt multiplikativ në ekonominë e vëndit.

1.3 Qëllimi i studimit dhe objektivat

Qëllimi i këtij punimi është studimi i ndikimit të politikave fiskale, konkurrencës dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë. Ky është arritur nëpërmjet një analize të detajuar të politikave fiskale në Kosovë nga viti 1999 deri në vitin 2016, me theks të veçantë nga viti 2009, kur është shpallur pavarësia e Kosovës, krahasuar kjo me vende të tjera të rajonit e më gjerë.

Objektivat kryesore të këtij punimi janë:

1. Nëpërmjet të kësaj analize të evidentohen të metat eventuale në hartimin e këtyre politikave dhe të përcaktohen rrugët e mundësitë për përmirësimin e tyre në të ardhmen.
2. Dihet se secili vend ka përparësitë apo dobësitë e veta në krahasim me vendet tjera, nisur nga kjo, objektivi i këtij punimi ka qenë që nëpërmjet krahasimit të elementeve të ndryshme të gjenden ato modele të mbledhjes dhe shpërndarjes së të hyrave publike të cilat do të ndikonin në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rritjen e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve, si një qëllim primar i secilit shtet.
3. Kosova, si shteti më i ri ka trashëguar një ekonomi të pazhvilluar, ku pjesa dërmuese e bizneseve kanë një shkallë të ulët të konkurrencës ndaj bizneseve të tjera jo vetëm si rezultat i politikave fiskale por edhe nga ndikimi i një numri të madh faktorësh të tjerë, prandaj objektivi i këtij punimi ka qenë të gjenden ato përparësi që ka Kosova ndaj vendeve të tjera në fusha të ndryshme të cilat do të mundësonin rritjen e konkurrencës së bizneseve Kosovare.
4. Objektivi tjetër është gjetja e alternativave se si mund të rritet prodhimtaria vendore e cila do të kishte një ndikim në ndryshimet e pabarazisë tregtare në krahasim me vendet e tjera. Rritja e prodhimtarisë do të kishte efekte domethënëse dhe multiplikative në shumë sfera dhe do të ndikonte që edhe një numër i madh bizneseve të tjera të angazhoheshin për bizneset prodhuese në Kosovë.

1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Pyetjet kërkimore për të cilat kemi dhënë përgjigje gjatë testimit të hipotezave janë si në vijim:

1. A kanë pasur ndikim të rëndësishëm Politikat fiskale të aplikuara në Kosovë në rezultatin financiar të bizneseve?
2. A kanë pasur ndikim politikat fiskale të aplikuara në Kosovë në zhvillimin e bizneseve në Kosovë?
3. Cili ka qenë ndikimi i treguesve të zhvillimit dhe përfitueshmërisë në rritjen e punësimit në biznese?
4. Cilët tregues kanë pasur ndikim në konkurrueshmërin e bizneseve ?
5. A kanë qenë më pak konkurruese Bizneset e sektorit prodhues në Kosovë se ato të sektorëve tjerë në tregun vendor?

Hipotezat të cilat i kemi testuar bazuar në pyetjet kërkimore të parashtruara më poshtë janë:

Hipoteza 1. Politikat fiskale të vendit kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar dhe zhvillimin e bizneseve

Hipoteza 2. Treguesit e zhvillimit dhe përfitueshmërisë të bizneseve kanë ndikim në rritjen e punësimit në to

Hipoteza 3. Konkurrueshmëria e bizneseve është e kushtëzuar nga treguesit e rritjes, të përfitueshmërisë, treguesve fiskalë si dhe nga veprimtaria e bizneseve

Hipoteza 4. Bizneset e sektorit të prodhimit janë më pak konkurruese se bizneset e sektorëve të tjerë, në tregun vendor

1.5 Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim të doktoratës është bazuar në të dhënat primare dhe sekondare.

Kemi aplikuar metodën analitike ku kemi analizuar të dhënat mbi politikat fiskale të aplikuara në periudha të ndryshme dhe efektet që kanë pasur këto politika në zhvillimet ekonomike të Kosovës.

Gjithashtu kemi aplikuar metodën krahasuese ku kemi krahasuar të dhënat për politikat fiskale dhe rezultatet që kanë dhënë ato në periudha të ndryshme. Këtë metodë e kemi aplikuar kur kemi krahasuar politikat fiskale të ndjekura në vende të ndryshme veçanërisht në vendet e regjionit dhe ish Jugosllavisë për të parë dallimet dhe efektet e këtyre politikave në këto vende duke përfshirë jo vetëm elementet tatimorë që ndikojnë në krijimin e të hyrave por edhe mënyrën e shpërndarjes së tyre me theks të veçantë shpërndarjet që janë bërë në formë të granteve apo subvencioneve për lloje të ndryshme të veprimtarive ekonomike.

Sa i përket përpunimit të dhënave të nxjerra nga pyetësi dhe nga puna në terren ne kemi përdorur metodat e regresionit me të cilat kemi arritur deri te rezultati i kërkuar dhe plotësimi i qëllimit të punimit doktoral.

1.6 Rëndësia e studimit

Konsiderojmë se ky punim doktrate ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për institucionet Kosovare që merren me hartimin e politikave fiskale por mund të ndihmojnë edhe studiuesit e tjerë që të dhënat e nxjerra nga ky punim doktrate ti përdorin për hulumtime të mëtejshme. Po ashtu ky punim mund tu vlejë politikbërësve për gjetjen e

politikave optimale të cilat do të inkurajonin jo vetëm rritjen e bizneseve ekzistuese por edhe futjen e bizneseve të reja nga jashtë si investime të drejtpërdrejta me kapital tërësisht të huaj apo në ndonjë formë tjetër të partneritetit publik privat. Kjo do të kishte efekt në zhvillimin e sferave të veçanta prodhuese të cilat do të kishin përparësitë e veta në krahasim me ato të vendeve të tjera. Sot Kosova karakterizohet me deficit të madh tregtar, import të madh të mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha vendet dhe nuk po arrin të shfrytëzojë përparësitë që ka ndaj vendeve tjera dhe ti fusë ato në aktivitetet ekonomike të duke mundësuar ndryshimin e këtyre raporteve tregtare shumë të pafavorshme. Prandaj ndryshimet e propozuara si rekomandime të këtyre politikave dhe ndërmarrja e masave të kombinuara të nxitjes ekonomike fiskale dhe jo fiskale do të mundësonin sjelljen edhe rritjen ekonomike e cila nuk mund të vijë nëse nuk ka investime të huaja, prodhimtari vendore dhe luftim të ekonomisë joformale e cila sipas të anketuarve është mjaft prezentë në Kosovë.

1.7 Mundësitë dhe kufizimet

Në përgatitjen e këtij punimi kemi studiuar një literaturë të gjërë jo vetëm nga fusha e politikave fiskale por edhe nga fushat e tjera ekonomike më synim arritjen e qëllimit dhe realizimin e objektivave. Kemi shfrytëzuar një literaturë të plotë gjatë punimit të doktoratës dhe krahasimit të dhënave të marra në terren. Veç literaturës shkencore kemi shfrytëzuar edhe legjislacione të vendeve të ndryshme në lidhje me politikat fiskale, me tatimet që aplikohen tek ta dhe mënyrën e shpërndarjes së të hyrave buxhetore si dhe kemi shfrytëzuar disa nga masat që janë marrë në disa vende të tjera, në periudha të ndryshme, e të cilat mund të shfrytëzoheshin edhe në rastin e Kosovës.

Sa i përket të dhënave janë shfrytëzuar ato mbi pozitën e Kosovës në periudhën e ish Jugosllavisë, të dhëna të gjetura në Kosovë ashtu edhe në vendet e tjera të ish Jugosllavisë. Kemi analizuar një numër të madh të raporteve dhe publikimeve të përgatitura nga Autoriteti Qendror Fiskal si dhe të raporteve dhe publikimeve nga institucionet përkatëse në periudhën para shpalljes së pavarësisë edhe pas shpalljes së saj si Ministria e Financave e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Banka Qendrore, Administrata Tatimore, Enti Statistikor, Doganat, Këshilli Kosovar për Raportim Financiar si dhe një numër të organizatave të tjera Kosovare dhe më gjerë nga Bashkimi Evropian të cilat janë marrë me publikime dhe raporte të ndryshme lidhur me ecurinë e ekonomisë Kosovare në periudha të ndryshme veçanërisht nga viti 2000 e më tutje.

Gjatë përgatitjes së këtij punimi doktrate kemi pasur edhe një numër të madh vështirësish të cilat janë paraqitur veçanërisht gjatë mbledhjes së të dhënave në terren, ku një numër i shoqërive tregtare kanë hezitur për të ofruar informatat e kërkuara ose na i kane dhënë ato informata pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore duke na krijuar vështirësi në përpunimin e të dhënave. Për këto është dashur të gjendeshin mënyra alternative për sigurimin e këtyre informatave, ku një ndihmesë na është ofruar nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Kosovës ku një numër i anëtarëve të saj janë të angazhuar në bizneset ku kemi bërë mbledhjen e të dhënave. Ata na kanë ofruar të dhënat e kërkuara me pyetësorët e përgatitur për këtë punim, pas marrjes së autorizimit nga ana e personave përgjegjës, drejtues të bizneseve të cilëve iu kemi dërguar pyetësorët . Gjithashtu edhe disa nga informacionet që nuk janë publike por kanë pasur mundësi të jenë relevante nuk na janë ofruar nga ana e disa institucioneve me arsyetimin se janë në kundërshtim me besueshmërinë dhe ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Kufizim tjetër është fakti se të dhënat e mbledhura në terren paraqesin saktë të dhënat dhe shënimet reale duke përfshirë qarkullimin e bizneseve, punësimin apo edhe informata të tjera. Kjo ndodh pasi të dhënat e pranuar nga të anketuarit i përgjigjen të dhënave të deklaruara në institucionet shtetërore por për shkak të perceptimit të nivelit të lartë të ekonomisë joformale mund të mos jenë reale.

1.8 Shpjegimi i strukturës së punimit

Ky punim i doktoratës është i strukturuar në tri pjesë ku në pjesën e parë që është pjesa teorike përfshihen kapitulli një dhe dy, pjesën e dytë ku përfshihen kapitujt tre, katër dhe pesë që është pjesa më e rëndësishme e punimit, është pjesa empirike dhe pjesa e tretë që është kapitulli i fundit i gjashtë ku kemi dhënë konkluzionet dhe rekomandimet.

Në kapitullin e parë përshkruhet tema që kemi shtjelluar, qëllimi dhe objektivat e tij si dhe mbi pyetjen kërkimore dhe hipotezat kurse kapitulli i dytë përfshin aspektin teorik që ka të bëjë me shkollat kryesore ekonomike dhe mendimet e tyre mbi politikat fiskale dhe sistemin fiskal si dhe rishqyrtimin e literaturës së kaluar dhe asaj moderne në fushën e politikave fiskale.

Në kapitullin e tretë kemi dhënë informata mbi pozitën e Kosovës në Ish Jugosllavi, kemi krahasuar raporte të ndryshme nga burimet sekondare për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2016, kurse në pjesën e dytë të kapitullit të tretë kemi dhënë informacione mbi konkurrencën në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit.

Në kapitullin e katërt kemi përshkruar metodologjinë që kemi përdorur, pyetësoin si dhe mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe vështirësitë që kemi pasur gjatë mbledhjes së të

dhënave. Në kapitullin e pestë kemi interpretuar të dhënat, kemi testuar hipotezat dhe kemi paraqitur rezultatet e pjesës empirike nga burimet primare.

Në pjesën e fundit të punimit që përfshin kapitullin e gjashtë kemi dhënë konkluzionet mbi të gjeturat si dhe kemi bërë rekomandimet bazuar në të dhënat empirike si nga burimet primare ashtu edhe nga burimet sekondare.

1.9 Përmbledhja e kapitullit të parë

Në kapitullin e parë kemi shqyrtuar dhe dhënë informata mbi punimin e doktoratës duke përfshirë qëllimin dhe objektivat e tij, kemi përshkruar metodologjinë që kemi përdorur gjatë punimit, kemi dhënë një shpjegim mbi pyetjet kërkimore dhe hipotezat që kemi paraqitur dhe si dhe kemi treguar mbi mënyrën e shtjellimit të problemit, kemi paraqitur rëndësinë e punimit që është për biznese por edhe për qeverinë. Në këtë kapitull ne kemi treguar edhe mbi mundësitë dhe kufizimet që kemi pasur gjatë punimit dhe literaturën që kemi përdorur si burim sekondar dhe burimet primare që kemi përdorur. Nëpërmjet përgjigjeve që kemi marrë nga pyetësit kemi testuar hipotezat e paraqitura gjatë përgatitjes të këtij punimi dhe në fund të kapitullit kemi dhënë një sqarim të shkurtër mbi strukturën e punimit të doktoratës.

KAPITULLI II:

VËSHTRIMI TEORIK - RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Aspekti teorik mbi politikat fiskale dhe sistemet fiskale

Politikat fiskale janë tërësia e masave që ndërmerr shteti për mbledhjen e të hyrave buxhetore dhe shpërndarjen e tyre me qëllim të financimit të shpenzimeve të shtetit dhe shpërndarjen e tyre varësisht nga qëllimet ekonomike, sociale dhe të tjera.

Politikat fiskale dhe sistemi fiskal janë të lidhura me mbledhjen e të hyrave buxhetore për financimin e aktiviteteve të shtetit.

Secili shtet me politikat e veta fiskale tenton të realizojë objektivat e veta që mund të përmbliken si më poshtë:

- Vlerësimi i kërkesave të financave të shtetit duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet;
- Gjetja e modaliteteve për rritjen e të hyrave;
- Mbikqyrja dhe shpërndarja e të hyrave të shtetit duke përfshirë efikasitetin e shpenzimeve dhe të hyrave që mundësojnë arritjen e objektivave primare të shtetit.

Shteti me politikat e veta fiskale duhet të tentojë që të arrijë objektivat e veta të cilat përveç përmbushjes së nevojave të tij për funksionimin e aparatit shtetëror, qeverinë qendrore dhe lokale, sigurinë, infrastrukturën, mirëqenien sociale të popullatës të mundësojë dhe të ndikojë edhe në rritjen e ekonomisë vendore duke promovuar investime shtesë në sektorin publik dhe privat, të ndërmarrë masa ekonomike të cilat do të mundësonin arritjen e efekteve maksimale në ekonomi si dhe në shpërndarjen e drejtë të

hyrave publike, në shpenzime që përveç mirëmbajtjes së daljeve sociale të aparatit shtetëror krijojnë mundësi për rritje ekonomike.

Katër janë objektivat kryesore të politikave fiskale me anë të së cilave qeveritë duhet të tentojnë të realizojnë synimet e tyre makroekonomike. Më poshtë po japim objektivat kryesore të politikave fiskale:

- Politikat fiskale ndërmerren me qëllim që të realizojnë punësim të plotë
- Politikat fiskale kanë synim që të krijojnë stabilitet ekonomik
- Politikat fiskale duhet të mundësojnë rritje ekonomike dhe
- Politikat fiskale duhet të bëhen në mënyrë që të mundësojnë një drejtësi sociale

Pra secili shtet, gjatë përpilimit të politikave fiskale të cilat duhet të shoqërohen edhe me masa të politikave monetare, merr parasysh rrethanat që ekzistojnë brenda shtetit dhe si synim duhet të ketë realizimin e katër objektivave të paraqitura më lart.

Me qëllim të arritjes së efekteve të dëshiruara me aplikimin e masave fiskale duhet të shikohen ndikimet në aspektin kohor kur aplikohen këto politika dhe nëse ndryshimet e politikave fiskale kanë si qëllim ndikimin në shpenzimet qeveritare dhe tatimin si rezultat kanë stabilizimin ekonomik. Gjithashtu politikat fiskale kanë për qëllim jo vetëm efekte stabilizuese por qëllimi është që ato të kenë efekte në ekonominë në tërësi si rezultat i kursimeve që mund të aplikohen në shpenzimet qeveritare apo i ndërrimit të normave tatimore.

Politikat fiskale janë tërësia e të gjitha masave që ndërmerr shteti në shfrytëzimin e instrumenteve fiskalë lidhur me të ardhurat, pasurinë dhe akumulimin që bëjnë persona

fizikë dhe juridikë me qëllim të mbledhjes së mjeteve për financimin e të dalave publike. Me politikat fiskale shteti ndikon në të gjitha shpenzimet e ekonomisë si pagat, punësimin, rritjen ekonomike etj. Duke udhëhequr një politikë fiskale aktive, shteti rregullon lëvizjet ciklike në ekonomi, ndikon në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë, shton prodhimin vendor dhe me të ndikon në rritjen e punësimit.

Fjala sistem fiskal rrjedh nga literatura anglosaksone dhe është një sinonim për sistemin tatimor dhe buxhetor. Në një pjesë të Evropës, veçanërisht në literaturën franceze, sistemi fiskal përfshin vetëm sistemin e të hyrave publike, respektivisht sistemin tatimor. Por në kuptimin e përgjithshëm sistemi fiskal përfshin të gjitha ngarkesat fiskale që shteti inkason nga personat fizikë dhe juridik dhe tërësinë e legjislacionit i cili i rregullon këto detyrime me qëllim të përmbushjes së nevojave publike. Pra këtu kemi të bëjmë me të gjitha llojet e obligimeve si tatimet, taksat, doganat dhe të gjitha llojet tjera të hyrave publike në njërën anë dhe të legjislacionet nga ana tjetër.

Sistemi bashkëkohor fiskal dhe tatimor dallon ndërmjet shteteve të ndryshme dhe këto dallime janë si rezultat i dallimeve politike dhe ekonomike. Vendi dhe roli i sistemit fiskal në vendet e zhvilluara industriale ndyshon me vendet në tranzicion. Por ka edhe dallime të sistemit fiskal në vendet unitare dhe vendet federale. Disa nga dallimet kryesore në sistemet tatimore janë: niveli i zhvillimit ekonomik, niveli arsimor i popullatës, struktura e fuqisë punëtore, anëtarësimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare, lloji i rregullimit shtetëror, mënyra e financimit të nevojave të përgjithshme dhe të veçanta si dhe karakteristikave të tjera. Nga ana tjetër globalizimi i ekonomisë dhe forcimi i ndikimit të organizatave si OSBE, Organizata Botërore e Tregtisë (WTO), kanë ndikuar që sistemet fiskale edhe pse të ndryshme në një masë të caktuar të jenë konvergjente. Prandaj sot, në

kohën e globalizimit, mund të themi se sistemet fiskale janë si rezultat i trendëve ndërkombëtare të globalizimit se sa si rezultat i ndryshimeve të izoluara nga ato të vendeve tjera.

Në kohën e tanishme trendët e sistemeve fiskale dhe tatimore janë që ato të përfshijnë një numër më të kufizuar të tatimeve dhe lehtësirave tatimore me qëllim që mbledhja e tatimeve të jetë më e thjeshtë. Gjithashtu edhe pse ka ndryshime të sistemeve tatimore ato nuk janë rrënjësore pasi çdo ndryshim rrënjësor në metodat dhe mënyrën e tatimit ndikon në kushtet afarizmit dhe humbjen e një pjese të energjisë së bizneseve në qartësimin e politikave të reja tatimore. Sipas OSBE ndryshimet në sistemet tatimore më shumë janë prezentë në vendet e ish bllokut socialist dhe vendet tjera në tranzicion e më pak në vendet e zhvilluara. Duke pasur parasysh se qëllimi i ndryshimeve në politikat tatimore janë kryesisht me ndikim në zhvillimin ekonomik mund të themi se nevoja për ndryshime fiskale është që të bëhet stimulimi i investimeve. OSBE angazhohet në harmonizimin e sistemit tatimor dhe një numër i madh i vendeve anëtare të OSBE- së përkrahin idenë e harmonizimit tatimor sipas së cilës mundësohet konkurrencë transparente dhe e drejtë në mes të shteteve si dhe bashkëpunimit global me qëllim të eliminimit të sistemeve tatimore preferenciale që janë të dëmshme për konkurrencën veçanërisht të vendeve të ashtuquajtura si parajsa fiskale.

Në aspektin metodologjik sistemi fiskal mund të shikohet nga tre aspekte:

- Aspekti institucional – që nënkupton legjislacionin që rregullon mënyrën e financimit të hyrave publike dhe mënyrën e financimit të dalave publike.

- Aspekti funksional – nënkupton përcaktimin e detyrave themelore të sistemit fiskal në kuadër të një sistemi ekonomik konkret.
- Aspekti politik – nënkupton se sistemi fiskal veç nevojës për përmbushjen e nevojave buxhetore të shtetit, shfrytëzohet edhe për arritjen e objektivave tjera si ekonomike, sociale, demografike dhe politike. Pra ky aspekt ka të bëjë me konsistencën e bazës institucionale dhe funksionimin e mekanizmave të saj si bazë e konceptit politik të orientimit të sistemit ekonomik shoqëror.

Ekzistojnë një numër faktorësh të cilët përcaktojnë strukturën dhe detyrat konkrete të sistemit fiskal që janë si në vijim:

- Karakteri ekonomik shoqëror i sistemit,
- Shkalla e zhvillimit ekonomik të vendit,
- Mënyra e organizimit dhe forma e qeverisjes së shtetit
- Rrrethanat historike, traditat dhe një sërë faktorësh të tjerë.

Sistemi fiskal, me fjalë tjera, paraqet një pjesë të tërësisë së sistemit financiar në të cilën përfshihen edhe sistemi monetar dhe kreditor, sistemi valutator, sistemi bankar, të sigurimit dhe një sërë sistemesh të tjera.

Në kohën moderne sistemi fiskal funksionet e veta i përmbush nëpërmjet një spektri të gjerë të ngarkesave fiskale ku më të rëndësishmet janë tatimet, taksat, akcizat, doganat, sigurimet shoqërore etj. Nëpërmjet sistemit fiskal sigurohen mjetet e nevojshme buxhetore për funksionim e shtetit por gjithashtu sistemi fiskal ka ndikim në aspektin ekonomik, social por edhe në aspektin ndërkombëtar të një shteti.

Tatimet, si pjesë e sistemit fiskal, janë një instrument i rëndësishëm i çmimeve dhe mund të ndikojnë edhe në harmonizimin në mes të ofertës dhe kërkesës si dhe në orientimin e investimeve. Rëndësia e sistemit fiskal në aspektin social është se mund të ndikojë në zvogëlimin e diferencave sociale dhe arritjen e qëllimeve demografike të shtetit. Aspekti ndërkombëtar i sistemit fiskal realizohet nëpërmjet doganave ku mund të mbrohet prodhimtaria vendore apo të favorizohet ndonjë degë ekonomike apo rajon.

Sipas OSBE, tatimet si pjesë më e rëndësishme e sistemit fiskal ndahen në disa grupe si në vijim:

- Tatimi në të ardhura – që përfshin tatimin në fitim dhe tatimin në fitime kapitale të individëve dhe korporatave
- Kontributet për sigurime shoqërore
- Tatimi në paga të fuqisë punëtore
- Tatimi në pasuri
- Tatimi në mallra dhe shërbime – që përfshin tatimin në prodhim, tregti, shërbime si tvsh, akcizat, doganat dhe të ngjashme.
- Llojet e tjera të tatimeve

Termat më të rëndësishëm që lidhen më tatimin janë obliguesi tatimor, baza tatimore, norma tatimore, ngarkesa fiskale. Gjithsesi e një rëndësie të veçantë është se ngarkesa tatimore nuk duhet të jetë ngarkesë e cila e zvogëlon aftësinë ekonomike të obliguesit tatimor dhe duhet të ekzistojë kufiri minimal dhe maksimal ku mund të ngarkohet një obligues tatimor.

Kufiri minimal i ngarkesës fiskale është ai i cili mbulon shpenzimet e caktimit dhe përmbushjes së obligimeve tatimore kurse kufiri maksimal është ai i cili përcaktohet nga të hyrat e përgjithshme të obliguesit tatimor respektivisht PBB.

Sistemi tatimor nga ana tjetër përfshin llojet e tatimeve që aplikohen brenda një vendi dhe principet në bazë të cilave duhet të bazohet një sistem tatimor janë se ai duhet të jetë:

- I drejtë – Tatimet paguhen varësisht nga forca ekonomike e obliguesit tatimor
- I thjeshtë – Sipas së cilës sa më shumë obligues tatimorë të kuptojnë sistemin tatimor
- Neutral – Të mos ndikojë në ndryshimin e rrjedhave ekonomike dhe politike
- I përhershëm – Sa më pak të ndryshojë
- Aplikimi i suksesshëm në praktikë

Sistemet tatimor, bazuar në numrin e instrumentave në të cilat mund të paraqiten ndahet në sistem tatimor monist dhe sistem tatimor pluralist.

Sistemi tatimor monist është ai sistem i cili paraqet vetëm një lloj tatimi të thjeshtë dhe sipas praktikës një sistem i tillë tatimor në kohën e tanishme nuk mund të zbatohet pasi në ditët e sotme para politikës tatimore paraqiten lloje dhe qëllime të ndryshme të tatimit dhe më një numër të madh të normave tatimore të cilat me një sistem monist nuk mund të përmbushnin qëllimet ekonomike, sociale, politike dhe qëllimet e tjera të shteteve. Është e rëndësishme të përmendet se Stiglitz në librin e tij "Ekonomia e sektorit publik"(2005) thekson se sikur sot të aplikohesh vetëm një lloj i tatimit ai do të ishte tatimi në energji.

Sistemi tatimor pluralist bazohet në një numër të caktuar të tatimeve, instrumenteve dhe grupeve tatimore dhe gërshetohet në vete kombinimin e tatimeve të ndryshme veçanërisht

tatimin në të ardhura ku tentohet që për tatimpaguesit që kanë të ardhura më të vogla edhe ngarkesa fiskale të jetë më e vogël dhe anasjelltas.

Në kuadër të sistemit tatimor pluralist mund të bëhet aplikimi më elastik i politikës tatimore dhe më lehtë mund të bëhet stimulimi i një dege të ekonomisë, një rajoni të caktuar apo veprimtarie të caktuar bazuar në nevojat për zhvillim ekonomik shoqëror të një vendi.

Te sistemi tatimor pluralist dy grupet kryesore të tatimeve janë:

- Tatimet e drejtpërdrejta (Tatimi në pasuri, tatimi në të ardhura, tatimi në fitim)
- Tatimet indirekte (Tatim i vlerës së shtuar, akciza, doganat, tatimi në monopol)

Veç tatimeve klasike një rëndësi të veçantë në të hyrat publike marrin edhe akcizat të cilat janë tatime që aplikohen për grupe të veçanta të mallrave dhe shërbimeve dhe kryesisht alkooli dhe pijet alkoolike, duhani, kafeja dhe produktet e tjera të luksit dhe dallojnë nga njëri vend në tjetër dhe kryesisht kanë karakter fiskal.

Doganat hyjnë në grupin e tatimeve indirekte dhe përfaqësojnë instrumentin më të rëndësishëm të politikës tregtare të jashtme. Karakteristikë kryesore e doganave është se ato janë obligime që rrisin koston e importuesit dhe qëllimi kryesor i vendosjeve të doganave është:

- Fiskale – me qëllim të mbushjes së buxhetit shtetëror
- Ekonomike – Ruajtja prodhimit vendor dhe ndikimi në ekonomik
- Sociale – Lirimet e caktuara në importe të prodhimeve dhe lëndë të parë mund të ndikojnë në stimulimin e konsumit dhe punësimit.

Taksat sipas literaturës janë pagesat që personat e ndryshëm bëjnë ndaj organeve shtetërore të cilat janë ekuivalentë me shërbimet që ata përfitojnë nga këto organe dhe këto

pagesa mund të jenë të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, por edhe llojet e taksave mund të jenë të ndryshme varësisht nga organet të cilat i përcaktojnë obligimet për taksa.

2.2 Teoritë ekonomike të lidhura me problemin

Që nga kohërat e lashta ekzistojnë mendime të ndryshme mbi ekonominë në tërësi dhe financat si pjesë e saj. Nga koha e Aristotelit, Ksenofonit dhe mendimtarëve të lashtë grekë është folur mbi problemet financiare jo në mënyrë analitike, por janë përmendur problemet që kanë të bëjnë me borxhet dhe mundësitë e pagesave të tyre, kamatat dhe problemet e tjera me të cilat ballafaqohej shoqëria në atë kohë.

Gjithashtu, në Romën e vjetër është folur për probleme financiare si çështje të tatimit dhe çështje të tjera financiare dhe është me rëndësi të theksohet se në këtë periudhë kemi edhe fillimet e sistemit bankar me hapjen e bankave të para të cilat më vonë, me evoluimin dhe rritjen e nevojave të shkëmbimeve tregtare janë rritur në vazhdimësi. Në historinë e njerëzimit deri në ditën e sotme këto institucione financiare kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Edhe në periudhën e feudalizmit, në shekullin e 13, si autor më i njohur është Toma Akvinski i cili analizoi problematikën e parasë, tatimit dhe rezervave të shtetit.

Në periudhën Merkantiliste fillojnë të trajtohen problemet kreditore dhe monetare dhe ndërkohë fillojnë të forcohen qendrat e ndryshme tregtare dhe ato të sistemit bankar.

Por një qasje më moderne lidhur me financat dhe mënyrës së krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve paraqesin përfaqësuesit e shkollës Klasike të ekonomisë duke përfshirë dy emrat më të njohur të kësaj shkolle Adam Smithi dhe David Rikardo, të cilët trajtuan parinë si një instrument të politikës monetare por analizuan edhe problematikën e tatimit.

Gjatë shekullit 17 dhe 18 edhe sistemi bankar mori një dimension krejt tjetër pasi filluan të hapen edhe bankat emetuese të cilat merreshin me kreditimin e tregtisë.

Në shekullin XX, si autor që merret me çështjet e politikave fiskale, njihet John Maynard Keynes i cili themeloi drejtimin e veçantë në Financat Publike me emrin e Politikave Fiskale.

Politikat fiskale dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik kanë zënë vend të rëndësishëm në literaturën ekonomike që nga koha kur ekonomisti anglez Keynesi doli me idetë e tij mbi ndikimin e shtetit në ciklet ekonomike, të botuara në librin e tij në vitin 1936 me titull, “Teoria e Përgjithshme e punësimit, interesit dhe parasë”. Sipas Keynesit oferta, punësimi i plotë dhe kërkesa efektive ndikojnë në nxjerrjen e ekonomisë nga kriza, kurse si faktor bazë i riprodhimit shoqëror është kërkesa e përgjithshme.

Në literaturën ekonomike Teoria e Keynesit e cila ofroi zgjedhjet teorike për instrumentet praktike ekonomike të daljes nga Kriza e Madhe Ekonomike, u përkrah nga një numër i madh shkencëtarësh nga fusha ekonomike, për një periudhë të gjatë kohe. Ajo konsiderohej si teori bazë e cila ofronte zgjedhjet më të mira për punësimin dhe rritjen e prodhimit në mënyrë substanciale dhe eliminimin e periudhave ciklike.

Teoria e Keynesit niset nga fakti se ekziston diferenca evidente në mes kërkesës globale efektive dhe të ardhurave të realizuara, respektivisht diferenca në mes të akumulimit real dhe të parasë. Kërkesa e përgjithshme paraqitet nëpërmjet shpenzimit dhe investimeve. Kërkesa varet nga të ardhurat kombëtare të realizuara dhe animi i tyre nga shpenzimi. Sipas kësaj teorie rritja e të ardhurave reale përcillet me rritje të shpenzimeve, por rritja e shpenzimeve është më e vogël se sa rritja e të ardhurave pasi një pjesë e të ardhurave shkon në kursime. Kursimi është diferenca në mes të ardhurave dhe shpenzimit

efektiv. Prandaj kusht i rëndësishëm i ekuilibrit në procesin e riprodhimit është që të gjitha kursimet të shpenzohen në investime. Pra sipas Keynesit kemi formulën ku $Kursimi = Investime$, e që realiteti është se nuk mund të ketë shfrytëzim automatik të kursimit për investime pasi aktiviteti investues varet edhe nga faktorë të tjerë, si madhësia e normës së fitimit apo madhësia e normës së kamatës.

Për të krijuar një ekuilibër në mes të shpenzimeve dhe të ardhurave, Keynesi propozon tatim progresiv të ardhurës me qëllim që pastaj shteti të orientojë atë në investime kapitale. Sipas tij, në kushtet e depresionit ekonomik shteti duhet të ndërmarrë masa të politikës fiskale ekspansioniste me qëllim të ringjalljes së kërkesës duke zvogëluar tatimin ose rritjen e të dalave publike të cilat do të kishin një efekt më të madh në ekonomi.

Sipas kësaj teorie duhet të krijohet një grumbull i instrumenteve nëpërmjet të cilave shteti rregullon qarkullimin e parasë dhe kredive, rregullon të ardhurat e banorëve, fitimin e ndërmarrjeve, punësimin, investimet dhe shpenzimin buxhetor respektivisht deficitin apo suficitin buxhetor që domethënë se shteti duhet të jetë subjekt aktiv në orientimin e rrjedhave ekonomike.

2.3 Qasja rreth politikave dhe sistemeve fiskale nga autorët e tjerë pas Keynesit

Ekonomisti Amerikan Pol Samuelson thekson se politikat fiskale shërbejnë për përcaktimin e nevojave për tatim dhe përcaktimin e të dalave publike në një proces i cili është i drejtuar nga pengimi i rënies së ekonomisë vendore mbajtja e një gjendje të tillë në ekonomi apo rritja e saj dhe rritjen e punësimit pa pasur ndikime të mëdha në inflacion dhe deflacion.

Autor tjetër i shquar i cili merret me problematikën e politikave fiskale është edhe R.

A. Musgrave i cili thekson se janë tri funksione kryesore të sistemit fiskal:

- Funksioni shpërndarës– Financimi i ofertave të të mirave publike dhe të shërbimeve
- Funksioni Stabilizues – Veprimi në nivel të kërkesës agregate
- Funksioni rishpërndarës - Shpërndarja e të ardhurave në mes të banorëve me dallime në të ardhura.

Teoricien tjetër është Friedrich August Hayek, ekonomist amerikan, me prejardhje austriake është i njohur si mbrojtës i forte i liberalizmit në ekonomi. Sipas Hayekit sistemi i çmimeve do të përmbushte funksionin e tij vetëm nëse mbizotëron konkurrenca, që do të thotë se prodhuesit individualë duhet të adaptojnë veten nga ndryshimet e çmimeve por nuk mund ti kontrollojnë ato. Hulumtimet themelore të Hayekut në ekonomi lidhen me kapitalin, paranë dhe ciklin e biznesit.

Në librin e tij “Prodhimi dhe çmimi” 1931 argumentoi se cikli i biznesit ka ardhur si rezultat i zgjerimit të kredive të lëshuara nga Banka Qendrore dhe bartja e tyre në kohë që ka çuar në keq shpërndarjen e kapitalit të shkaktuar nga normat e ulëta të interesit që ishin të pa bazuara. Hayek pretendon se paqëndrueshmëria e kaluar e ekonomisë së tregut është si pasojë e përjashtimit të rregullatorit më të rëndësishëm të mekanizmit të tregut të parasë që në vetvete rregullohet nga procesi në treg.

Por personaliteti i cili kishte influencë më të madhe në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar i cili kundërshtonte teorinë Keynesiane ishte Milton Friedman. Sipas Friedmanit dhe studiuesve të politikave monetare ndryshimet e masës së parasë në qarkullimi kanë ndikim

përcaktues në prodhim në periudhën afatshkurtër dhe ndikim në çmime në periudhe afatgjatë. Pra, sipas tyre objektivat e politikës monetare përcaktohen nga shkalla e rritjes së furnizimit me para. Friedman, si prijës, i teorisë monetare theksonte se rritja e furnizimit me para shkakton inflacion latent prandaj autoritetet duhet të fokusohen veçanërisht në mirëmbajtjen e stabilitetit të çmimeve. Sipas tij inflacioni është fenomen monetar dhe ka ndikim edhe në punësim dhe paga. Friedmani propozonte rregulla të qarta monetare, ku furnizimi me para duhet të kalkulohet sipas faktorëve të njohur makroekonomikë dhe financiarë me qëllim të shenjtërimit të nivelit të inflacionit. Ai ishte një kundërshtar i fuqishëm i intervenimit të shtetit në ekonomi duke supozuar se kjo ndërhyrje do të kishte vetëm pasoja negative për ekonominë.

Është me rëndësi të theksohet se politikat fiskale të pjesa dërmuese e shteteve perëndimore deri në vitet 70-ta ka qenë ekspansioniste dhe është bazuar në frymën e teorisë së Keynesit kurse pas viteve 70-ta kanë filluar të aplikohen politikat fiskale restriktive që kërkonin shkurtime buxhetore si rezultat i rritjes së madhe të të dalave publike.

E një rëndësie është edhe fakti se ku veprojnë politikat fiskale dhe monetare në ekonomi dhe sipas teorive të deritanishme bashkëveprimi i shtetit me të dy këto politika është shumë i rëndësishëm dhe kombinimi i të dy këtyre masave jep rezultate më të efektshme. Prandaj theksimi dhe dhënia përparësi e njërës masë ndaj masës tjetër është i pavend por ato duhen trajtuar së bashku edhe pse përshtatja dhe aplikimi i masave të përbashkëta nuk është i lehtë dhe i thjeshtë.

Kështu politika fiskale është më e rëndësishme dhe ndikon në mënyrë efikase në konsumin se sa në rregullimin e investimeve, ku mendohet se politika monetare ka ndikim më të madh. Gjithashtu në rrethanat e recesionit ekonomik politika fiskale ka efekte më të

mëdha se ajo monetare ndërsa politikat monetare kanë efekt më të madh në luftimin e rritjes së ndikimeve që lidhen me inflacionin. Sidoqoftë, me qëllim të arritjes së efekteve sa më të mira për ekonominë e një vendi duhet një bashkëveprim i të dy masave fiskale dhe monetare, duke mos nën vlerësuar asnjërën masë se është më pak e rëndësishme se sa masa tjetër që mund të aplikohet nga ana e shtetit në momente të ndryshme si me qëllim të rritjes ekonomike apo të ndikimit në kushtet e paraqitjes së recesionit në ekonomi.

2.4 Ndikimi i shtetit në ekonomi sipas qasjeve të ndryshme

Rreth ndikimit të politikave fiskale në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik ka punime nga ekonomistë të ndryshëm të cilët japin mendimet e tyre mbi hapat që duhet të ndërmerret shteti me qëllim të stimulimit të përgjithshëm ekonomik dhe mundësisë së evitimit të cikleve të krizave të ndryshme me të cilat ballafaqohen vendet në periudha të ndryshme kohore.

Varësisht nga periudha në të cilat janë paraqitur teoritë e ndryshme mbi ndikimin e shtetit në ekonomi ekzistojnë edhe qasje të ndryshme duke filluar nga ajo mbi intervenimin e shtetit në ekonomi dhe me të edhe në politikat fiskale dhe monetare si dy komponentë bazë të ndikimit në ekonomi deri tek qasja liberale e cila thekson se shteti nuk duhet të ketë influencë të madhe në rrjedhat e përgjithshme ekonomike por duhet të lejojë bizneset që vetë të rregullojnë këto raporte nëpërmjet të prodhimeve dhe konkurrencës së tyre në treg.

Sado që këto janë dy qasje diametralisht të kundërta krizat e ndryshme ciklike që paraqiten nga rasti në rast i japin argumente rrymës e cila kërkon intervenimin e shtetit në ekonomi dhe me të edhe në politika fiskale. Gjithashtu veprimet jo të analizuara mirë të

shteteve të ndryshme i japin argumente rrymës liberale e cila thekson se ndikimi i shtetit në sjelljet ekonomike të jetë në minimum.

Një ndër arsyt kryesore të ndikimit të shtetit në rrjedhat ekonomike është tregu jo perfekt si ai vendor ashtu edhe ndërkombëtar prandaj lidhur me këtë Stiglitz në librin e tij ''Ekonomia e sektorit publik''(2005) thekson se ekzistojnë 6 ndikime në tregun jo perfekt:

- Konkurenca jo perfekte
- Të mirat publike
- Efektet e jashtme
- Tregu i pa kompletuar
- Informatat jo të plota
- Papunësia dhe faktorët e tjerë makroekonomikë

Të ardhurat e mjaftueshme buxhetore ndikojnë në funksionimin normal të shtetit, garantimin e rendit publik dhe funksionimin ligjor të secilit shtet. Por politikat fiskale nuk janë vetëm mbledhja e të ardhurave buxhetore me qëllim të funksionimit të aparatit shtetëror sado që është shumë e rëndësishme por duhet që të ndikojnë që autoritetet publike shtetërore të ndjekin në masë të madhe edhe synimet e politikave të përgjithshme ekonomike, sociale por edhe mjedisore dhe nevojave të përgjithshme të qytetarëve brenda secilit shtet.

Prandaj përmirësimi i infrastrukturës rrugore, krijimi i një sistemi efikas i transportit publik brenda shtetit, një sistem i mirë arsimor, një sistem modern shëndetësor që ofrohet për popullatën, një sistem i mirë që merret me mbrojtjen e ambientit dhe rritjen e punësimit kërkojnë analiza, përkushtim dhe saktësi në shpërndarjen e të hyrave financiare për

mbulimin dhe rritjen e mirëqenies sociale. Nuk mjafton të kesh një sistem efikas të mbledhjes së të hyrave dhe të kesh shpërndarje dhe dislokim të keq të buxhetit të shtetit. Prandaj secili shtet ka specifikat e veta si në mbledhjen e të hyrave buxhetore ashtu edhe në shpërndarjen e tyre pasi sa më efikas që të jetë shteti në mbledhjen e të hyrave dhe gjetjen e qëllimit të tyre dhe për shpenzimin e tyre kjo do të ndikojë edhe në rritjen e mirëqenës për qytetarët, rritjen e punësimit dhe krijimin e kushteve të favorshme për investime shtesë në të ardhmen.

Për të pasur një qeverisje të mirë publike në fushën e krijimit të buxhetit dhe drejtimin financiar të tij duhet:

- transparencë fiskale, duke nënkuptuar një proces të hapur fiskal dhe informacion në lidhje me faktorët ekonomikë të përdorur për krijimin e buxhetit
- përgjegjësi, duke nënkuptuar kontroll të pavarur për shpenzimet dhe drejtimin , financiar dhe
- përgjegjshmëri, duke nën kuptuar kapacitet për t'u përgjigjur në mënyrë fluktuive ndaj ndryshimeve të paparashikuara brenda vendit ose jashtë tij.
- si dhe politikat fiskale synim duhet të kenë të ardhmen duke marrë parasysh kostot që mund të jenë në të ardhmen si mos futja në borxh të analizuar publik si borxh të brendshëm apo të jashtëm si dhe mos vendosjen e barrëve të rënda ndaj brezave të ardhshëm.

Nga viti 2008, shumë vende të botës, si rezultat edhe i ekonomisë globale u përballën më krizë financiare dhe ekonomike e cila filloi si një krizë e sistemit bankar por shumë

shpejt e bë edhe krizë financiare,e cila kërkonte ndërmarrjen e një mori masash fiskale nga shtetet e ndryshme. Nisur nga kjo, shumë vende të cilat ishin prekur nga kjo krizë dhe vendet e tjera të cilat priteshin të prekeshin nga kriza kishin mobilizuar burime të konsiderueshme financiare nëpërmjet programeve të stimujve ekonomikë si rritja e investimeve publike por edhe nëpërmjet stimujve të tjerë të cilët kishin për qëllim mirëqenien sociale. Kjo bën që shpenzimet sociale të rriten ndërsa të ardhurat buxhetore duke përfshirë tatimet dhe kontributet u zvogëluar, nga ana tjetër borxhet publike shënuan rritje dhe me të edhe deficitet e mëdha të vendeve të shumta.

Lidhur me atë se a duhet shteti të intervenojë në ekonomi apo jo,ka edhe mendime të ndryshme nga autorë të ndryshëm,varësisht se çfarë rryme i përkasin. Ata japin argumentet e tyre pro dhe kundër intervenimit të shtetit në ekonomi nëpërmjet masave stimuluese fiskale të cilat konsideroj se janë dhe duhet të jenë në rrjedhat ekonomike. Pra shteti ka dy masa që mund të ndikojë në ekonomi nëpërmjet masave fiskale por edhe nëpërmjet politikave monetare që aplikohen. Ata janë të një rëndësie të madhe në ekonomi ku nuk mjafton dhe nuk mund të kemi ekonomi të qëndrueshme pa bashkë dyzimin e këtyre masave.

Kjo që u tha më lart vlen edhe për Kosovën, vetëm se Kosova është shumë e limituar në politikat monetare pasi si valutë përdoret Euro si valutë e përbashkët Evropiane dhe në sferën monetare i mbasin vetëm disa mbikqyrje të bankave të nivelit të dytë por pa të drejtë pjesëmarrje në politikat emetuese të parasë. Nisur nga kjo shtetit i mbasin vetëm aplikimi i masave në politika fiskale si i vetmi instrument që ndikon në mënyrë pozitive apo negative në rrjedhën e përgjithshme ekonomike.

2.5 Rishikimi i literaturës së kohëve të fundit mbi politikat fiskale

Varësisht prej cilit drejtim ekonomik është drejtimi liberal në ekonomi që kërkon angazhim sa ma të vogël të shtetit në rrjedhat ekonomike apo të ndonjë rryme tjetër prapëseprapë rregullimet fiskale varësisht nga ekonomia në të cilën gjendet shteti janë shumë të rëndësishme. Kështu edhe Purfield (2003) shqyrton rregullimet fiskale në një numër të ekonomive në tranzicion në mes të viteve 1992 dhe 2000 dhe thekson se konsolidimet fiskale të mëdha dhe shpenzime të bazuara janë të suksesshëm në përmirësimin e qëndrueshëm në bilancin primar, brenda dy vjetëve pas rregullimit. Sipas tij studimi që ka bërë ai nuk gjen prova se shtrëngimi fiskal mund të stimulonte rritjen ekonomike reale në afat të shkurtër prandaj konstaton se në periudhën afat gjatë respektivisht dy vjeçare pas ndërrimeve në politikat fiskale priten edhe efektet nga këto ndryshime që janë bërë.

Ka disa studime që janë bërë në vendet në tranzicion kryesisht të vendeve ish bllokut socialist ku theksohet se konsumi reagon në mënyrë jo lineare me ndërhyrjet buxhetore. Kështu në studimin e tyre në disa vende të bllokut socialist (Siwinska dhe Bujak, 2006). theksojnë se familjet priren të sillen në një mënyrë Keynesian në "kohë të mira" kur niveli i deficitit fiskal është i vogël. Pra në kohën e një stabiliteti fiskal tek shtetet e ndryshme, tek ekonomitë familjare rritet konsumi pasi njerëzit në këtë periudhë janë të pritur të shpenzojnë mjetet e tyre financiare kurse sipas studimit të tyre në kohë të vështirësive fiskale dhe me politikat ekspansioniste fiskale që ndërmerren shihet se politikat fiskale ekspansioniste stimulojnë konsumin privat, por në një shkallë shumë më të vogël se ajo që ishte pritur.

Nga ana tjetër Blanchard (1993) arrin në përfundimin se bilanci i buxhetit dhe mbajtja e një niveli të inflacionit të kontrolluar në raport ndaj PBB-së është një tregues i mirë për efektin e kërkesës agregate të politikës fiskale në një vit të caktuar.

Ndikimi i politikave fiskale në kushtet e cikleve të ndryshme ekonomike, si rezultat i një rritje ekonomike në një kohë të caktuar apo i zvogëlimit të ekonomisë në një periudhë tjetër, është analizuar nga studiues të ndryshëm të politikave fiskale. Kështu Woo (2009) dhe Aghion dhe Marinescu (2008) kanë paraqitur dy punime të cilat kanë shqyrtuar se si politika fiskale ndikon tek prodhimi dhe të dy punimet tregojnë se politika pro cikleve fiskale rrit paqëndrueshmërinë e prodhimit dhe mund të dëmtojë rritjen afatgjatë ekonomike prandaj konsiderojnë se politikat fiskale duhet të jenë konsistence dhe jo të zbatohen vetëm si rezultat i cikleve të ndryshme ekonomike.

Në kushtet e deficitit buxhetor shteti mendon masa të ndryshme që duhet të ndërmarrë për mbulimin e atij deficiti dhe ato masa mund të jenë të karakterit fiskal, monetar apo të kombinuara. Tek masat e karakterit fiskal shteti mund të bëjë aplikimin e rregullimeve nëpërmjet ndryshimit të normave tatimore, rritjes së tyre dhe zvogëlimit të shpenzimeve buxhetore por mund të bëjë edhe mbulimin e këtij deficiti nëpërmjet futjes në borxhe publike si brenda apo edhe jashtë shtetit. Prandaj, lidhur me qëndrimin e shtetit studiuesit kanë dhënë ide dhe mendime të ndryshme. Njëri prej tyre Barro kritikon mendimin Rikardian dhe lëniën në dilemë të këtyre veprimeve pa dhënë një përgjigje të qartë. Pika fillestare e Barro në kërkimin ishte vëzhgimi i tij se sipas *"ithtarëve të mendimit Rikardian nuk ka rëndësi se cila do të jetë zgjedhja midis borxhit dhe taksave"* (për financimin e deficitit buxhetor).

Në kushtet e një zhvillimi të hovshëm ekonomik dhe rritjes së të ardhurave fiskale qeveritë kanë mundësi që të mbajnë një tepëri të ardhurave të tyre dhe kjo mund të forcojë pozitën fiskale dhe i japin hapësirë qeverisë për manovrim gjatë rënies së të ardhurave. Barro argumenton se normat e taksave duhet të ndjekin një rrugë të rastit dhe për këtë arsye nuk duhet të reagojnë në ciklin e biznesit, Barro (1979)

Sipas mendimit të disa shkencëtarëve Qeveritë kanë më shumë gjasa për të ndërmarrë përpjekje të konsolidimit kur ekonomia e vendit është duke funksionuar mirë dhe këto përpjekje për rregullime kanë më shumë gjasa të jetë të suksesshme nisur nga raportet e larta të borxhit me GDP-së" (Von Hagen, Hallett dhe Strauch (2001 pp.12-14)

Sipas studiuesve të ndryshëm reformat shoqëruese të taksave dhe reformat e tregut të punës do të rrisin shanset e suksesit të reformave fiskale. Në përgjithësi, zbatimi gradual i reformave mund të rrisin mbështetjen e tyre politike, madje edhe kur këto reforma janë komplementare (Lindbeck, 1994).

Në rastin e vendosjes për ndryshimet fiskale është shumë e rëndësishme se cilat masa duhet të ndërmarrë shteti në situata të caktuara prandaj duhet pasur kujdes se cilat ndryshime fiskale do të kishin efekt më të madh stabilizues në ekonomi. Qeveria duhet të tentojë që të mos bëjë akumulimin e lartë të borxheve publike pasi ato mbesin obligim për gjeneratat e ardhshme prandaj barazia në ndarjen e të ardhurave dhe tentimi që borxhi publik të jetë sa më i pranueshëm është shumë i rëndësishëm për çdo qeveri. Lidhur me këtë edhe Barnett dhe Ossowski kanë thënë se akumulimi i niveleve të larta të borxhit të çon në shpërndarje të interesit të lartë gjatë periudhave të çmimeve më të ulëta të burimeve natyrore që disponon shteti (Barnett dhe Ossowski, 2003)

''Nisur nga kjo edhe shpenzimet që bëjnë qeveritë duhet të bazohen në vlerën aktuale të të ardhurave të pritshme, duke marrë në konsideratë pasigurinë e çmimeve si dhe kohën e harxhimit të burimeve ose tepricës së tyre'' (Barnett dhe Ossowski, 2003; 2).

Prandaj rregullat e detyrueshme fiskale mund të përdoren për të kufizuar përdorimin e të ardhurave të papritura, dhe të garantojë një nivel optimal të kursimeve.(Barnett dhe Ossowski (2003; 3)

Dihet se ekonomia bashkëkohore në fushën e politikave fiskale përveç masave ekspansioniste për rritjen e konsumit dhe zvogëlimin e taksave që përkrahet nga Keynesi dhe masave restriktive të politikave fiskale për rritjen e taksave dhe zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore ka filluar edhe në aplikimin e të ashtuquajturve stabilizator automatik fiskal. Lidhur me këtë disa autorë mendojnë se në rast se politika monetare është mjaft e fuqishme për të stabilizuar ciklin e biznesit, cili është përfitimi që kemi stabilizues automatik? Por (Taylor 2000) thekson se edhe ata që kritikojnë politikën fiskale restriktive janë më të hapur ndaj rolit të stabilizuesve automatikë për shkak të kohës së tyre, por ky përfundim rrallë është i lidhur me një model ose analize të veçantë të mirëqenies.

Sipas Engel sistemi fiskal i një vendi është formuar nga disa faktorë, një nga të cilët është sasia e taksave të mbledhura dhe kjo në fund të fundit përcakton vëllimin e mundshëm të shpërndarjes së këtyre të ardhurave Engel (1999) po sipas tij roli i shtetit nëpërmjet politikave fiskale nuk është asgjë tjetër veç se të sigurojë një kornizë analitike që ndihmon duke theksuar rolin e politikës fiskale në rishpërndarjen e të ardhurave.

Një analizë e gjerë përshkruese e konsolidimit buxhetor në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore në mes të 1996 dhe 2004 është dhënë nga Rzonca dhe Varoudakis (2007). Ata në studimin e tyre theksojnë se rregullimet fiskale në këto ekonomi kanë ndodhur gjatë

periudhave të niveleve të larta të borxhit. Përmirësimet e rezultatit dhe pozicionit fiskal kanë ndodhur dhe janë arritur efekte me ndikim në konsolidimin buxhetor vetëm nga një ulje në një program i shpenzimeve publike, veçanërisht në uljen e pagave dhe mëditjeve, ndryshimet në mënyrën e aplikimit dhe të shpërndarjes së subvencioneve ose në ndryshimet e shpenzimeve të mbrojtjes.

Se si ndikojnë politikat restriktive fiskale në buxhetin e shtetit dhe ndikimi i tij në konsum në ekonominë familjare e analizojnë Bertola dhe Drazhen (1993). Sipas tyre politika restriktive buxhetore shkakton pritjet për një zvogëlim të taksave në të ardhmen dhe një vlerë më të lartë aktuale të ardhurave familjare, e cila stimulon konsumin privat dhe në këtë mënyrë ndikon në rritjen e prodhimit.

Që konsumi ndikon në mënyrë pozitive theksohet edhe në shpjegimet teorike ku thuhet konsumi ka efekte të shëndetshme për ekonominë (Giavazzi dhe Pagano, 1990)

Qëllimi primar i politikave adekuate fiskale është mbulimi i shpenzimeve buxhetore por siç u tha më lart ky mbulim nga qeveritë mund të bëhet nëpërmjet rritjes së normave tatimore apo futjes në borxhe publike. Por rritja e normave tatimore mund të ndikojë në shpërndarjen jo të barabartë të ardhurave dhe mund të shkelet parimi i barazisë në tatime si një parim bazë i cili shoqërohet edhe me drejtësi sociale duke filluar nga shfrytëzimi i të mirave publike deri të shpërndarja e të ardhurave. Prandaj rreth ndikimit të politikave fiskale në të mirat materiale që disponon një shtet dhe mënyrës së shpërndarjes së tyre kanë shkruar shumë autorë por një nga më të rëndësishmit të periudhës moderne është Stiglitz i cili së bashku me Boadway thekson se *"Mallrat publike janë ato mallra që nuk përbëjnë asnjë kosto shtesë për një individ për të shijuar ato dhe duhet një marrëveshje e madhe për të përjashtuar çdo individ që ti gëzojnë ato pra ato janë të pa përjashtuara nga*

shfrytëzimi i tyre. Si shembull i një të mire publike është mbrojtja" (Stiglitz dhe Boadway, 1994).

Lidhur me shpërndarjen e ngarkesës tatimore dhe në përgjithësi fiskale ka studime të shumta të shkencëtarëve të ndryshëm të cilët theksojnë jo vetëm rolin dhe ndikimin e politikës tatimore dhe fiskale në të ardhurat, por analizojnë edhe rolin e shpërndarjes së të mirave publike respektivisht të ardhurave buxhetore ku sipas disa autorëve në shpërndarjen e të ardhurave roli i politikës tatimore është më i vogël në krahasim me rolin e shpërndarjes së shpenzimeve publike. Kështu në studimet e tyre publike (Martínez Vazquez, 2001, (Goni, Lopez dhe Servén, 2011) konsiderojnë rol të vogël dhe aftësinë e politikës tatimore për të përmirësuar shpërndarjen e të ardhurave në krahasim me politikën e shpenzimeve publike.

Rritja e të dalave publike në sektorin publik ka shënuar rritje që nga vitet e 30 të shekullit të kaluar. Kjo rritje, sipas studiuesve, merr rreth 30 % të PBB e në fillim të shekullit të kaluar pjesëmarrja e të dalave publike në PBB ishte vetëm 10 deri në 15 % dhe kjo situatë ka bërë që edhe detyrat e financave publike të zgjerohen dhe këto politika të përfshijnë jo vetëm faktorët politikë, ekonomikë por edhe faktorët socialë, ekonomikë dhe ka bërë që politika fiskale të jetë një komponent i rëndësishëm i tërë politikës ekonomike të vendit.

Nisur nga komponenti social, që duhet të përfshijë politika fiskale në shpërndarjen e të mirave publike dhe krijimin e të hyrave publike shumë autorë theksojnë se duhet një mbikqyrje e duhur në shpërndarjen e të ardhurave në mënyrë që të mos krijohet një pabarazi. Kështu sipas Stiglitz pabarazia në shpërndarje, pa mbikqyrjen e duhur, përfundimisht do të dëmtojë fuqinë e ekonomive dhe do të shkaktojë një paqëndrueshmëri

ekonomike si dhe trazira sociale "*Pabarazia minon forcën e ekonomisë dhe kontribuon në paqëndrueshmëri ekonomike*" (Stiglitz, 2012).

Përveç mbledhjes së të ardhurave shumë e rëndësishme është edhe barazia në shfrytëzimin e tyre. Këtë e tregon edhe studimi i Barros dhe Forbes ku sipas tyre pabarazia e të ardhurave ekzistuese perceptohet të jetë rezultati i qasjes të padrejtë në burimet dhe në këtë mënyrë krijohen gjendje të dëmshme për kohezionin social (Barro 2000, Forbes, 2000).

Por edhe këtu ka qasje të ndryshme lidhur me pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave dhe kjo pabarazi ndoshta mund të ketë efekte pozitive dhe ato mund të stimulojnë rritjen ekonomike të ndonjë lëmi të caktuar. Por ajo mund të shkaktojë edhe probleme të natyrave të ndryshme, si rritje të korrupsionit por edhe jo stabiliteti ekonomik dhe këtë e potencojnë në studimin e tyre Berg dhe Ostry ku theksojnë se për shkak të pabarazisë që ekziston është e nevojshme për të ofruar stimuj për investime dhe rritje ekonomike, pasi sipas tyre ka dëshmi se pabarazia e lartë mund të vonojë rritjen, veçanërisht në qoftë se ajo reflekton defektet e tregut të kreditit apo korrupsionin politik, ose në qoftë se ajo shkakton jo stabilitet politik (Berg dhe Ostry, 2011). Ka edhe studiues të tjerë të cilët theksojnë se kjo pabarazi e të ardhurave ka ndikuar edhe në krizën e fundit financiare të fund dekadës së parë të këtij shekulli prandaj Fitoussi and Saraceno theksojnë se ka disa ide që argumentojnë rolin e një rritje në pabarazinë e të ardhurave, si një faktor i rëndësishëm që kontribuoi në evoluimin e krizës së fundit financiare. Fitoussi dhe Saraceno (2009).

Sipas disa autorëve pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave vjen nga presioni që mund të kenë grupe të ndryshme interesi nëpërmjet aktiviteteve që bëjnë për ndryshime të

shpërndarjes së të ardhurave nëpërmjet tatimeve të ndryshme por edhe nëpërmjet shpërndarjes së të ardhurave të tyre. Kështu Boschini dhe Pettersson theksojnë se presioni nga ana e grupeve të ndryshme të interesit, të kombinuara me institucione të dobëta, të çon në pabarazi në ndarje të ardhurave (Boschini dhe Pettersson, 2007).

Nisur nga këto buxhetet e shtetit dhe shpërndarja e tyre ka një rëndësi të madhe edhe në rritjen ekonomike dhe bilancet buxhetore dhe ndikojnë edhe në rritjen e PPB ku sipas (Lewis, 2013) bilancet buxhetore reagojnë si stabilizues për aktivitetin ekonomik çdo pikë shtesë përqindja e rritjes ekonomike është i lidhur me përmirësimin e bilancit buxhetor prej 0.3 pikë përqindjeje të PBB.

Por tek studiuesit të politikave fiskale ka mendime të ndryshme mbi efektet dhe ndikimet e llojeve të ndryshme të taksave në shpërndarjen dhe rishpërndarjen e të mirave publike. Kështu sipas Marques taksat e drejtpërdrejta kanë më shumë ndikim në rishpërndarjen e të ardhurave në krahasim me taksat indirekte. Efekti rishpërndarës i tatimit mbi të ardhurat është më i madh se efektet e rishpërndarjes së kontributeve për pensione dhe sigurimet shoqërore, sidomos nëse analizohet nga perspektiva e ciklit të jetës (Márquez, 2015).

Sipas autorëve, të një rëndësie të madhe janë efektet multiplikative të politikave fiskale të cilat kanë efekte në konsum dhe investime si në nivel qeveritar ashtu edhe në shpërndarjen e tyre për konsum familjar prandaj efektet multi fiskalë janë zakonisht më të mëdha për konsum të qeverisë, investimet publike dhe shpërndarja për ekonomitë familjare, ndërsa ata janë relativisht të vogla për tatimet indirekte (Spilimbergo, Symansky, dhe Schindler, 2009).

Krijimi i një barazie në shpërndarjen e të ardhurave nacionale është një element shumë i rëndësishëm dhe mundëson zhvillimin dhe krijimin e të ardhurave prandaj një seri e politikës fiskale projektuar për të trajtuar pa barazinë e të ardhurave në rritje dhe varfëria janë futur si elemente konkurruese nga vendet e ndryshme në të gjitha fazat e zhvillimit dhe krijimit të ardhurave.

Nivelet e larta të akumulimit të kapitalit pa zhvillimin e kapaciteteve njerëzore do të ndikojë në kthimin e zvogëluar të kapitalit. Kështu edukimi mund të rrisë rritjen ekonomike duke rritur produktivitetin e punës (Barro, 1997)

Pasiguria në të ardhura krijon një rritje ciklike të investimeve të qeverisë, lidhur me kostot shumë të larta të investimeve e që janë kostot e trajnimit e punëtorëve të rinj, kur nivelet e investimeve janë shumë të larta dhe largimin e punëtorëve kur nivelet e investimeve janë ulur papritur (Devlin dhe Titman , 2004).

Blanchard (1981) argumenton se politika fiskale mund të jetë e motivuar nga konsiderata të tjera ekonomike dhe politike . Kështu, disa masa të politikës fiskale mund të jenë të papritura nga agjentët ekonomikë dhe për këtë arsye mund të përshkruhet si një goditje të politikave fiskale të cilat mund të ndikojnë në kthimin e tregut të aksioneve.

Edhe kur ky veprim i politikave fiskale është parashikuar nga agjentët ekonomikë, ajo ende mund të ketë disa efekte në veprimtarinë e tregut të aksioneve. Politikat e dizajnuara për të rritur efikasitetin në ekonomi kanë një efekt negativ në shpërndarjen e të ardhurave (Atkinson dhe Stiglitz (1980) dhe Stiglitz (1987) dhe se qëllimi i stabilizimit të ciklit ekonomik në kohë të paraqitjes së krizave financiare dhe të krizave të tjera që ndikojnë në zhvillimin ekonomik në tërësi janë marrë si një e dhënë, ndërsa në jetën e përditshme

modelet e reja Keynesian të cilat merren si stabilizuese të aktivitetit ekonomik janë në përgjithësi si rezultat i politikës optimale ekonomike .

Si Atkinson dhe Stiglitz (1980, f. 14) theksojnë, ne kemi nevojë për të ndërtuar modele "*që na lejojnë të parashikojnë efektet e ndryshimeve të politikës jo vetëm mbi ndryshoret agregate të pasurive totale , por edhe në shpërndarjen*". Prandaj teoricienët e ndryshëm theksojnë se duhet pasur kujdes me modelet ekonomike të cilët përdoren pasi ata mund të ndikojnë në rrjedha të përgjithshme dhe mund të kenë ndikim negativ. Judd (1985) vjen në përfundim me të gjeturat e tij se një qeveri dashamirëse, e cila është orientuar në drejtim të rritjes ekonomike nuk duhet të imponojë taksa të rishpërndarjes së kapitalit në afat të gjatë pasi ato janë pengesë e rritjes ekonomike.

Të njëjtën gjë rreth taksimit të kapitalit e sheh edhe Mankiw në hulumtimet e tij. Ai thekson se rezultati më dominues nga modelet dinamike të taksimit optimal është se tatimi i kapitalit duhet të shmanget " (2009, f. 167).

Përveç hulumtimeve të ndryshme të bëra nga shkencëtarë të ndryshëm të cilët propozojnë mënyra të ndryshme të tatimit dhe i japin rëndësi më të madhe një forme të caktuar të tatimit, një element i rëndësishëm në kuadër të politikave fiskale është edhe mënyra e shpenzimit të mjeteve buxhetore respektivisht niveli i konsumit qeveritar të këtyre të hyrave.

Pra sipas studiuesve të ndryshëm shohim në hulumtimet e kryera nga ata që theksojnë se jo vetëm mbledhja e të hyrave buxhetore por një tjetër element shumë i rëndësishëm i politikave fiskale që ndikon në normën e rritjes ekonomike është niveli i shpenzimeve qeveritare dhe shpërndarja e të ardhurave. Pavarësisht se nga orientohen shpenzimet ato do të kenë efekt të madh edhe në rritjen e përgjithshme ekonomike. Edhe rreth shpërndarjes së

të ardhurave buxhetore ka hulumtime të ndryshme të cilat japin ide mbi mënyrën e shpërndarjes së të mirave, varësisht nga të gjeturat e tyre.

Kështu Barro (1989 dhe 1991) konstaton se norma e rritjes së PBB-së për kokë banori dhe raporti i investimeve në krahasim me PBB- në, janë të lidhura negativisht me shpenzimet e qeverisë si pjesë e PBB-së, prandaj nisur nga kjo Barro (1991) sugjeron se konsumi i qeverisë nxit çrregullimet në ekonomi dhe nuk ofron stimuj të tjerë që kompensojnë raportin ndaj PBB-së dhe investimeve dhe ai në bazë të rezultateve të tij thekson se qeveritë duhet të kenë kujdes të madh me konsumin e mjeteve buxhetore.

Një grup autorësh nga ana tjetër theksojnë se konsumi i qeverisë është në proporcion të zhdrejtë me rritjen ekonomike dhe sa më i lartë që të jetë ai konsum aq më e ulët është rritja ekonomike dhe anasjelltas sa më i ulët të jetë konsumi qeveritar aq më e lartë është rritja ekonomike e një vendi. Kështu Grier dhe Tullock (1989) gjejnë një lidhje të fortë negative në mes të rritjes së konsumit të qeverisë si pjesë e PBB-së dhe normës së rritjes së PBB-së reale.

Një autor tjetër, Landau, ka bërë hulumtimin tij në disa periudha kohore, nga të dhënat e mbledhura tek 96 vende dhe arrin në përfundim të ngjashëm me Grier dhe Tullock prandaj në punimin e tij, Landau (1986) bën studim tek 96 vendeve të ndryshme dhe konstaton se konsumi i qeverisë ka efekte negative në rritjen ekonomike dhe ai ka gjetur se ky konsum ka zvogëluar rritjen në katër periudha të cilat i ka marrë si mostra për hulumtim dhe ato periudha janë (vitet 1961- 1970, 1961-1972, 1961 dhe 1974 si dhe hulumtimin për periudhën nga viti 1961 deri në 1976) .

Nga ana tjetër në hulumtimin e tyre Easterly dhe Rebelo (1993) gjejnë se efekti i ndryshoreve fiskale në rritjen ekonomike janë të lidhura në mënyrë të brishtë dhe sipas tyre

e vetmja ndryshore fiskale që ka pasur ndikim në studimin e tyre dhe që është i lidhur vazhdimisht me rritjen e PBB-së dhe investimeve private është suficiti buxhetor qeveritar .

Edhe Oester dhe Kormendi (1989) theksojnë se normat mesatare dhe marginale tatimore që aplikohen nga qeveritë e ndryshme janë të lidhura negativisht me rritjen e PBB prandaj duhet pasur kujdes lidhur me normat tatimore që aplikohen në rrethana ciklike apo në kushte të një stabiliteti ekonomik.

Helms (1985) ka analizuar efektet e rritjes së taksave shtetërore dhe lokale. Ai argumenton se taksat më të larta mund të stimulojnë rritjen ekonomike nëse përdoren për financimin e shpenzimeve të zhvillimit. Helms konstaton se taksat mund të kenë një efekt negativ në rritjen ekonomike në rast se nuk analizohen mirë por ato gjithashtu mund të ndikojnë në rritjen ekonomike kështu ai thekson se në kushtet e regresionet studimet e tij tregojnë se koeficienti i normës së tatimit mund të jetë pozitiv nëse taksat përdoren për të financuar shpenzimet produktive por ato mund të kenë efekte negative nëse faturat tatimore janë përdorur për të financuar nevojat sociale të cilat nuk ndikojnë në rritjen ekonomike.

Të mendimit të njëjtë me Helms janë edhe një grup autorësh të tjerë të cilët theksojnë se shpërndarja e normave tatimore për nevoja të ndryshme sociale e jo për rritjen ekonomike që mund të ndikojnë negativisht në rritje. Alesina dhe Rodrik (1994) dhe Lee (1992) në hulumtimet e tyre gjejnë se për një normë tatimore të caktuar , një rritje në shpërndarjet publike ul normën e rritjes ekonomike.

Prandaj edhe shpenzimet qeveritare që bëhen për të punësuarit në sektorin publik duhet të mbahen konstante e jo të ketë rritje të ndjeshme të tyre dhe këtë e argumentojnë në studimet e tyre empirike të bëra nga Barro (1989) dhe Barro dhe Sala - i- Martin (1992b)

të cilët gjejnë se mbajtja në madhësinë konstante e qeverisë dhe shpërndarjet e të mirave publike janë të lidhura pozitivisht për kokë banori në përputhje me rritjen e të ardhurave .

Sa i përket të ashtu quajturve stabilizator automatik fiskal shumë studiues theksojnë lidhur me nevojën ose jo të aplikimit të këtyre stabilizuesve dhe lidhur me këtë edhe Auerbach and Feenberg (2000), efekti i stabilizatorëve automatik nuk varet vetëm sa ndryshime bëjnë ata në rritjen e të ardhurave të cilat janë në dispozicion por edhe sa janë të rëndësishëm ato në konsumin privat.

Talvi and Vegh (2000) në studimin e tyre janë munduar që të japin një siguri dhe shpjegim politik për sjelljen çuditshëm të politikës fiskale në vendet në zhvillim. Ata në analizat e tyre theksojnë se ndryshimet dhe luhatjet e bazës tatimore janë shumë më të mëdha në vendet në zhvillim se sa në vendet e G7, dhe qëllimi për zbutjen e plotë e taksave nënkupton drejtimin që tentohet të bëhen teprica më të mëdha të buxhetit në kohë të mira kur ekonomia është duke vepruar mirë dhe nga ana tjetër shfrytëzimin e tyre në kohë të këqija dhe kur shteti ballafaqohet me mungesa të mjeteve buxhetore si rezultat i veprimit dhe funksionimit jo të mirë të ekonomisë që mund të ndodh nga faktorë të ndryshëm politikë apo ekonomikë apo të jenë si rezultat i lëvizjeve të ndryshme të kërkesave në treg.

Përafërsisht si Talvi and Veghmendon edhe Gavin 1996 thekson dhe propozon për të bërë buxhetin fiskal në përputhje dhe me lëvizje graduale në drejtim të niveleve të dëshiruara në krahasim me borxhin që mund të jetë në periudhën afatmesme. Prandaj edhe ky thekson se duhet pasur kujdes dhe tepricat fiskale duhet të akumulohen dhe borxhi publik duhet të zvogëlohet gjatë periudhës së një rritje ekonomike të qëndrueshme kurse deficitit buxhetor mund të vijë gjatë periudhës së recesionit prandaj nevojitet që të ketë një qasje që të merren parasysh rrethanat gjatë së cilës mund të lëvizë ekonomia.

Budnevich dhe Le-Fort (1997) japin argumentet e tyre se kush mund të jenë stabilizatorët fiskalë automatikë dhe si mund të reagojnë ata në rrethana të caktuara dhe a mund të jenë ata të dobishëm për të plotësuar fleksibilitet e TVSH- së, dobishmëri e cila mund të jetë edhe falë fleksibilitetit të tatimit në të ardhura personale të cilët së bashku me tvsh mund të reagojnë më shpejt si stabilizator automatik fiskal. Sipas tyre duke pasur parasysh se e fitimi i korporatave ka një luhatje shumë më të lartë ciklike sesa PBB-së dhe aplikimi i tatimeve progresive të tatimit mbi të ardhurat personale por edhe tek të ardhurat e korporatave kjo bën që si tatimi mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimi mbi të ardhurat personale të jenë stabilizues automatik fiskal.

Caballero (2000,2001) propozon që të ketë një komponent të politikës fiskale të indeksuar në kushtet e tregtisë për shkak të luhatjeve të cilat mund të ndodhin në treg prandaj sipas tij kur fitimet tregtare janë të ulëta atëherë duhet të bëhen edhe reduktimet e shpenzimeve që janë më pak të nevojshme dhe këto mund të bëhen duke vendosur rregulla paraprake për rrethanat në të cilat mund të gjendet ekonomia apo edhe e kundërta kur kemi rritje të fitimeve tregtare mund të bëhen edhe pagesat e interesit dhe të kryegjësë së borxhit publik. Në mënyrë të ngjashme këto mund të jenë të indeksuar në kushtet e tregtisë duke vendosur rregulla paraprake duke menduar se burimet e lira financiare si rezultat i një zhvillimi të hovshëm ekonomik të cilat janë tepriçë të mund të shpërndahen për sektorin privat i cili edhe është bartës i zhvillimit.

Nga ana tjetër Alesina and Ardagna (1998), theksojnë se përshtatja e politikave fiskale janë të përdorur kryesisht në shkurtimin e shpenzimeve dhe veçanërisht në paga të zyrtarëve qeveritarë dhe shpërndarjet e ndryshme kurse kur politikat fiskale janë restriktive atëherë kemi karakterizim të ngritjes së normave tatimeve.

Sa i përket veprimeve të politikave fiskale dhe përshtatjes së tyre në kushtet e ndryshme ekonomike nga hulumtimet e tij ka dhënë mendimin edhe (Von Hagen dhe Strauch, 2001) i cili thekson se përshtatjet fiskale që mbështeten kryesisht mbi shkurtime në shpenzime që kanë të bëjnë me shpërndarjet dhe pagesa të pagave zgjasin më shumë dhe mund të jetë ekspansioniste, kurse politikat fiskale që mbështeten kryesisht në rritjen e taksave dhe shkurtime në investimet publike anojnë nga politikat fiskale restriktive dhe mund të jenë të paqëndrueshme.

Giavazzi, Jappelli, and Pagano (2000), në studimet e tyre theksojnë se mund të hasni situata të përshtatjeve fiskale tek vendet e industrializuara dhe në zhvillim ku efektet jo lineare të politikës fiskale mbi kursimet kombëtare çojnë drejt një situatë ku ato politika mund të jenë të lidhura me rritje të mëdha dhe të vazhdueshme në mungesën e mjeteve primare në të ardhmen.

Nga ana tjetër Barro dhe Sala-i-Martin, (1995) theksojnë se politikat fiskale mund të ndikojnë në nxitjen dhe rritjen ekonomike por nëse aplikohen në mënyrë të gabueshme ato do të ndikojnë dhe do të vonojnë rritjen ekonomike, prandaj si ndarja e mjeteve për investim kapital ashtu edhe investimet në ngritjen profesionale të kapaciteteve njerëzore mund të preken nga tatimet dhe shpenzimet e qeverisë dhe me këtë mund të ndikojë në normat e rritjes ekonomike të vendeve në të cilat nuk analizohen sa duhet këto përshtatje fiskale.

2.6 Vlerësimi i politikave fiskale të zbatuara në Kosovë në frymën e teorive ekzistuese në këtë fushë

Hulumtuesit e ndryshëm në fushat ekonomike shikojnë efektet makroekonomike që kanë tatimet që aplikohen dhe këto i masin si tatimet që aplikohen për kokë të banorëve dhe rritje në aspektin makroekonomik. Rritja e normave tatimore mund të zvogëlojë rritjen ekonomike si rezultat i zvogëlimit të kursimit dhe kjo mund të ndikojë edhe në zvogëlimin e kursimit të popullatës dhe me të edhe zvogëlimin e të ardhurave për ekonominë familjare.

Nën ndikim të teorive të sipërpërmendura, ekspertët e UNMIK-ut dhe këshilltarët ndërkombëtarë që kanë pasur ndikim në hartimin e politikave fiskale në Kosovë i kanë dhënë prioritet ruajtjes së stabilitetit marko-ekonomik të vendit e cila edhe është një nga objektivat e politikave fiskale por për objektivat e tjera si punësim të qëndrueshëm, rritjen ekonomike apo edhe drejtësi sociale nuk është shikuar nga ana e Administratës së Unmikut. Ajo në periudhën pas përfundimit të luftës në vitin 1999 prioritet ka pasur rindërtimin e asaj që është shkatërruar e më pak realizimin e qëllimeve të tjera nëpërmjet masave fiskale që janë ndërmarrë atë kohë.

Mirëpo, në situatën e tanishme me një shkallë të lartë të papunësisë dhe bilanc shumë negativ të tregtisë së jashtme, Kosova ka nevojë për politika aktive fiskale. Analizat studimore të viteve të fundit dëshmojnë për probleme të shumta si rezultat i politikave. Cila është politika fiskale dhe si ka ndikuar ajo në zhvillimin ekonomik me theks të veçantë në sektorin privat në Kosovë është paraqitur nga një numër analizash. Këto analiza janë bërë duke i krahasuar edhe me masat e ndërmarra në vendet e tjera të cilat pas krizës së vitit 2007, e cila filloi si krizë e sistemit bankar dhe më vonë përfshiu tërë sistemin financiar, u munduan që nëpërmjet masave të ndryshme fiskale dhe stimuluese të ndikojnë në zbutjen e

saj te secili vend apo edhe të ndërmarrin masa të tjera që do të kishin efekt në rritje ekonomike në veprimtari të caktuara të cilat kanë qenë prioritet i secilës qeveri të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë.

2.7 Politikat fiskale dhe zhvillimi i bizneseve

Rentabiliteti i bizneseve është fitimi i tyre që realizojnë para tatimit dhe interesit që duhet të paguajnë ato në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilën ato zhvillojnë aktivitetin tyre. Secili ndërmarrës investon kapitalin e vet me qëllim të rritjes së kapitalit të tij nëpërmjet fitimeve që realizon nga investimi i atij kapitali në degët ekonomike që vlerësohen se janë më rentabile në krahasim me ato që janë më pak rentabile. Duke pasur parasysh se sot ekonomia botërore është globalizuar dhe mund të konsiderohet se ajo është bërë një treg gjigand ku informatat shpërndahen shpejt mbi përparësitë apo pengesat për investime që mund tu sjellin vendet e ndryshme për investime kjo ndikon që shumë kompani multinacionale para se të bëjnë investimet e kapitalit të tyre të bëjnë analiza të shumta mbi situatën e përgjithshme në vendin në të cilin investojnë kapitalin e tyre, mbi normat dhe vitet në të cilat ato mund të kthejnë investimet e tyre, rreziqet që kanë në investimet e kapitalit të tyre në ndonjë treg të caktuar si dhe mbi faktorët që përcaktojnë se cila lëmi është më shumë dhe cila lëmi është më pak fitimprurës.

Varësisht se a kemi të bëjmë me kushtet në të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin e tyre bizneset brenda një vendi apo edhe më gjerë dhe se ajo do të jetë rentabile apo jo varet nga një mori faktorësh të brendshëm e që lidhen me faktorë brenda tyre dhe faktorë të jashtëm të cilët nuk varen prej tyre por janë të lidhur me klimën e përgjithshme në të cilën zhvillojnë aktivitetin bizneset brenda një vendi të caktuar.

Faktorët e brendshëm janë faktorë në të cilët ndikon drejtpërdrejt drejtimi i biznesit dhe janë pozita e saj në krahasim me konkurrencën, kapitali që posedon, struktura e kualifikimit të personelit, qasja e saj për inovacione, pajisjet dhe teknologjia që aplikon ajo në veprimtarinë e saj dhe krahasimi i saj me teknologjinë që aplikohet nga konkurrenca, mënyra se si bëhet pagesa për të punësuarit dhe a ekzistojnë procedura të stimulimit për të punësuarit që arrijnë rezultate që ndikojnë në rritjen e rentabilitetit, aftësinë e saj për tu përshtatur kushteve të tregut dhe ndryshimeve që paraqiten në të si dhe një mori faktorësh të tjerë të cilët janë brenda strukturës organizative të saj.

Kurse faktorët e jashtëm janë ata faktorë në të cilët nuk mund të ndikojë biznesi por me aktivitetin e saj mund tu përshtatet atyre me qëllim të rritjes së rentabilitetit. Është me shumë rëndësi se si biznesi tu përshtatet këtyre faktorëve dhe nëpërmjet kësaj përshtatje të arrij rezultatet në varësi nga ndikimet që mund të kenë këta faktorë në aktivitetin e përgjithshëm të saj dhe rritjen e zhvillimit të bizneseve. Faktorët e jashtëm janë një mori faktorësh që e rrethojnë biznesin të cilët e që mund të jenë faktorë politikë dhe ekonomikë.

Faktorët politikë lidhen me pozitën e shtetit në regjion, infrastrukturës ligjore që është brenda shtetit, sigurisë që ofron ai për investimet që bëhen aty, gjendjes politike brenda tij dhe një mori faktorësh të tjerë të cilët mund të ndikojnë në vendim marrje për të investuar dhe zhvilluar afarizmin në atë vend.

Nga ana tjetër faktorët ekonomikë kanë të bëjnë me madhësinë e tregut që bizneset mund të shesin produktet dhe shërbimet e tyre, infrastrukturën rrugore dhe infrastrukturën e tjetër të përgjithshme brenda një vendi ku përshihet edhe furnizimi me energji elektrike dhe çmimi i saj si dhe furnizimet e tjera nga grupi i shërbimeve publike që u ofrohen bizneseve, pastaj largësia me tregjet e ndryshme si për furnizim me mallra dhe lëndë të parë ashtu edhe

shitjen e mallrave të tyre, shkallën e tatimeve të drejtpërdrejta që ndikojnë në zhvillimin e biznesit ku përfshihen tatimet në paga, kontributet shoqërore dhe normës së tatimit në korporata që aplikohet nga ana e shtetit.

Sa i përket tatimeve që aplikohen brenda një vendi ata janë mjaft të rëndësishme në zhvillimin e biznesit dhe lidhur me këtë ekzistojnë edhe punime të ndryshme të cilët japin argumentet e tyre për ndikimin e politikave fiskale në zhvillimin e bizneseve.

Dy grupe të tatimeve aplikohen në pjesën dërmuese të ekonomive botërore dhe ato janë tatimet indirekte dhe tatimet e drejtpërdrejta. Sa i përket tatimeve indirekte nga të dhënat e analizuara dihet se ato ndikojnë në konsum por nuk ndikojnë në fitimet e biznesit pasi ato paguhet nga konsumatorët dhe sa më të larta që të jenë ato atëherë ato ndikojnë në konsum duke zvogëluar apo rritur atë kurse nga analizat empirike dhe rishikimi i literaturës konstatohet se tatimet e drejtpërdrejta mund të ndikojnë në rrjedhat e përgjithshme ekonomike, ndikojnë në rritjen ekonomike dhe rritjen e bizneseve të caktuara dhe gjithashtu edhe në rentabilitetin e tyre.

Lidhur me këtë ka edhe hulumtime të ndryshme dhe publikime të punimeve të tyre, kështu sipas Rajan and Zingales (1998) të cilët në punimin e tyre analizojnë efektet e tatimit në korporata dhe ndikimet e tyre në fitimin e bizneseve theksojnë se për qëllime të tatimit në korporata qeveritë duhet të bëjnë analizimin e sektorëve të ndryshëm ekonomik duke parë se cilët sektorë janë më shumë fitimprurës e cilët janë më pak dhe varësisht nga kjo duhet të aplikohen edhe tatimet në korporata. Sipas tyre aty ku fitimi është më i lartë duhet të aplikohen tatime më të larta dhe aty ku fitimi është më i ulët të aplikohen tatime më të ulëta që mund të shkojnë edhe në reduktimin apo afrimin me normën zero në mënyrë që tu

mundësohet nxitja për investime në sektor më pak fitimprurës dhe mund të ndikojnë edhe në krijimin e një ekuilibri ekonomik.

Nga ana tjetër Zilcha and Eldor (2004) tregojnë se nga hulumtimet e tyre kanë ardhur në përfundim se normat e ndryshme në shumicën e vendeve karakterizohen me rezultate asimetrike në fitimin dhe humbjen e ndërmarrjes dhe ndikojnë në mundësitë e bizneseve për investime në inovacione në periudhat e ardhshme.

Kështu taksat e larta në korporata mund të reduktojnë nxitjet për produktivitet në korporata dhe rritjes së shpenzimeve për inovacione dhe atë nëse fitimi tatohet me norma të larta atëherë edhe fitimi që mund të investojnë për investime kapitale është më i vogël .

Në teorinë ekonomike me rentabilitetin e bizneseve kryesisht mendohet në kthimin e investimeve të ndërmarrjeve dhe lidhur me këtë ka shkruar edhe Stigler (1963) i cili thekson se me rëndësi shumë të madhe në teorinë ekonomike është se në kushtet e konkurrencës norma e kthimit të investimeve mund të ndikojë në krijimin e një ekuilibri në të gjitha industritë për shkak se ndërmarrësit tentojnë të lënë industritë që janë më pak fitimprurëse dhe të koncentrojnë investimet e tyre në industri më shumë fitimprurëse.

Nisur nga këto që u thanë më lart, edhe trendi i tatimeve në korporata ka shënuar rënie të vazhdueshme në vendet e ndryshme dhe qëllimi ka qenë që bizneset nga vendet e ndryshme të rrisin konkurrencën dhe të rrisin zhvillimin tyre në krahasim me bizneset e vendeve tjera.

Kështu në publikimin e hulumtimit të tyre në vitin 2005 me titull “Tatimi i Korporatave dhe konkurrenca ndërkombëtare” të bërë nga “Michigan Ross School of Business” mbi nivelin e tatimit në korporata në periudhën nga viti 1982 deri në vitin 1999 në disa vende të mëdha dhe në disa vende të tjera me madhësi të vogël erdhën në përfundim se derisa

tatimet në korporata në vitin 1982 në vendet e vogla ishin rreth 33 % në vendet e mëdha në atë vit ishin mbi 40 % kurse në vitin 1999 kishim shkurtim të taksave. Kështu në vendet e vogla këto taksa kishin rënë në 23 % kurse në vendet e mëdha kishin rënë në 27 % dhe e gjithë kjo ishte bërë me qëllim të rritjes së konkurrencës së ekonomisë vendore në krahasim me vendet e tjera dhe me të edhe rritjen e rentabilitetit të bizneseve vendore.

Kështu Klassen, Lang dhe Wolson (1993) gjejnë se korporatat shumëkombëshe amerikane kanë raportuar kthimin më të madh të kapitalit dhe rentabilitet më të lartë në vendet ku kanë norma më të ultë të tatimit në korporata në krahasim me fitimet e tyre në Amerikë edhe pas uljes së tatimeve në vitin 1986.

Edhe Banka Botërore në hulumtimin e saj mbi indikatorët e zhvillimit në botë në periudhën 1970 deri në vitin 2000 gjen se si rezultat i ekonomisë globale, ofrimit të kushteve më të favorshme për investime të huaja dhe normave të zvogëluara të tatimeve, pjesëmarrja e investimeve të drejtpërdrejta në prodhimin botëror është rritur nga 0.5 % që ishte në vitin 1970 në 3,9% në vitin 2000 që domethënë se rreth 8 herë është rritur kjo pjesëmarrje.

Nisur nga kjo dhe me qëllim që bizneset Kosovare të rrisin konkurrencën, me qëllim të ndikohet në rritjen e investimeve të huaja në Kosovë dhe rritjes së zhvillimit të tyre, qeveria e Kosovës nga janari i vitit 2009 ka bërë zvogëlimin e dy tatimeve që ndikojnë në afarizmin e përgjithshëm të bizneseve dhe atë ka zvogëluar tatimin në të ardhura të korporatave nga 20 % në 10 % dhe tatimit në paga që është progresiv nga shkallët tatimore që aplikoheshin deri atëherë 0,5,10 dhe 20 në shkallë të reja që aplikohen e që janë 0,4,8 dhe 10%.

Në të njëjtën kohë edhe shumica e vendeve të tjera të regjionit bëjnë zvogëlime dhe lehtësira të ndryshme për bizneset vendore dhe ato që investojë kapitalin e tyre dhe këtë me

qëllim të rritjes së konkurrencës së ekonomisë së tyre dhe mundësisë së rritjes së fitimeve për investuesit që investojnë kapitalin e tyre.

Në këtë periudhë këto zvogëlime të tatimeve në Kosovë nuk janë përcjellë edhe me zvogëlime të taksave doganore për pjesën dërmuese të mallrave që importoheshin me përjashtim me vendet e Ceft-as dhe si i tillë nuk ka dhënë ndonjë ndikim të madh në rritjen ekonomike, rritjen e konkurrencës së bizneseve vendore dhe rritjes së rentabilitetit dhe fitimit të tyre i cili do u mundësonte që fitimet e tyre të ri investonin në ngritjen e kapacitete të reja apo në projekte që kishin qëllime inovacionet që janë shumë të rëndësishme për një ekonomi në kushtet e globalizmit.

Vlen të theksohet se sipas studimeve një ndryshim sado i vogël në normën e tatimit në të ardhura të korporatave mund të ketë ndikim edhe në rrjedhën e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, kështu sipas një hulumtimi të kryer nga OSBE sugjerohet se çdo rritje prej 1 % në tatim në të ardhura të korporatave ndikon në rënien e investimeve të huaja direkt prej 3.7 %.

Sipas këtij hulumtimi çdo zvogëlim i tatimit në të ardhura të korporatave do të ketë në njërin anë efekt në rritjen e kthimit në kapital ku përfshihen edhe rritja e investimeve të kapitalit vendor por edhe të huaj, forcimin e iniciativave për investime si dhe zëvendësimin e fuqisë punëtore me kapital dhe nga ana tjetër kemi edhe efektin e rritjes së kthimit në paga duke përfshirë edhe rritjen e konsumit dhe rritjen e produktivitetit.

Lidhur me rritjen e tatimit dhe ndikimin tyre në paga kanë shkruar edhe Arulampalam, Devereux dhe Maffini (2012) të cilët në punimin e tyre theksojnë se rritja e një Euro taksa ndikon në zvogëlimin për 49 cent të pagave reale.

2.8 Përmbledhja e kapitullit

Në këtë kapitull ne kemi bërë një analizë të literaturës nga fusha e ekonomisë dhe financave dhe mendimet ekonomike nga shkollat e ndryshme ekonomike e veçanërisht jemi fokusuar mbi mendimet mbi politikat fiskale, sistemet fiskale nga periudha e Keynesit dhe mendimtarëve të tjerë pas tij. Jemi fokusuar edhe në punimet shkencore të mendimtarëve të të periudhave të ndryshme veçanërisht të periudhës moderne ku kanë bërë edhe analiza empirike mbi ndikimet e politikave fiskale në shtete të ndryshme apo në grup të shteteve si të OSBE apo edhe të vendeve të tjera. Në fund të këtij kapitulli kemi përshkruar edhe të dhëna nga literatura e ndryshme mbi konkurrencën dhe rentabilitetin dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm të cilët rrisin apo zvogëlojnë konkurrencën e një vendi ndaj vendit tjetër në ekonomi apo edhe të konkurrencës së bizneseve të një vendi ndaj vendit tjetër.

KAPITULLI III :

POLITIKAT FISKALE, SISTEMI FISKAL DHE KONKURUESHMËRIA E BISNESEVE NË KOSOVË

3.1 Kosova dhe politikat fiskale të ndjekura gjatë periudhës kur ishte pjesë e RSFJ

Kosova, pas përfundimit të luftës së dytë botërore mbeti si pjesë e Jugosllavisë duke gëzuar një autonomi të brishtë. Gjatë kësaj periudhe, deri me kushtetutën e vitit 1974 politikat fiskale ishin kryesisht të centralizuara dhe pushteti Qendror Federativ përcaktonte politikat fiskale, të cilat pastaj duhet të zbatoheshin nga njësitë federale. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 Kosova fiton statusin e njësisë Federale dhe fillon një periudhë e decentralizimit të pushtetit në Federatën Jugosllave ku edhe politikat fiskale fillojnë të decentralizohen. Njësitë federale që ishin pjesë e Federatës Jugosllave marrin një autonomi të theksuar në fushën e politikave fiskale dhe ky decentralizim ishte i shtrirë në atë që njësitë federale ishin të pavarura në përcaktimin e tatimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte dhe shpërndarjen e të hyrave buxhetore si dhe mënyrës së mbledhjes së tyre. Ky decentralizim kishte të bënte vetëm me politikat fiskale kurse politikat monetare deri në shpërbërjen e Federatës Jugosllave ende ishin të centralizuara dhe të gjitha kompetencat në këto fusha ishin të institucioneve qendrore. Sa i përket të hyrave Federative në atë kohe ato mbledheshin vetëm nga taksat doganore për mallrat që importoheshin dhe disa tatime indirekte kurse pjesa tjetër rreth 40% që nevojitej për mbulimin e shpenzimeve të nivelit federativ shkonin nga Njësitë federale për mbulimin e të dalave publike.

Të gjitha format e tatimit direkt kishin kaluar tek Njësitë federale përfshirë edhe Kosovën, e cila me Kushtetutën e vitit 1974 mori disa nga elementet e para të shtetësisë në

shumë fusha të jetës ekonomike dhe politike duke përfshirë edhe pjesën e politikave fiskale. Sa i përket të hyrave, në të dy periudhat në atë centraliste ashtu edhe në atë të decentralizimit me Kushtetutën e vitit 1974 burimi kryesor i të hyrave ka qenë tatimi në qarkullim, kryesisht i shitjeve me pakicë kurse tatimi në vlerën e shtuar që kishte filluar të aplikohet në ekonomitë e zhvilluara të Evropës Perëndimore, Kanadasë dhe vendeve të tjera të industrializuara nuk aplikohet. Duke pasur parasysh se ekonomi private edhe pse lejoheshin disa veprimtari të vogla të zhvillonin aktivitetin, tatimi në të ardhura personale si njihet sot në ekonomitë e zhvilluara ekzistonte, por kishte vetëm tatim nga pagat dhe kontributet shoqërore që paguheshin për disa qëllime të caktuara, të përcaktuara në legjislacionin e asaj kohe.

Nëse krahasojmë të dhënat për periudha të ndryshme të shpenzimeve publike që janë bërë në ish Federatën Jugosllave shohim se ka diferenca të mëdha të shpenzimeve dhe të dalave publike varësisht a janë bërë ato para vitit 1974 kur pushteti ishte kryesisht i centralizuar apo pas vitit 1974 ku kishte një decentralizim të tërësishëm.

Nga tabela që do të paraqesim më poshtë shohim se të dalat publike ka pësuar ndryshime të mëdha nga viti në vit si rezultat i bartjes së kompetencave nga niveli qendror tek njësitë Federale apo Njësitë e tjera të pushtetit lokal.

Kështu ndërsa në vitet 1947 – 1951 federata merrte pjesë në të dalat publike me 63.1% ato vijnë duke rënë nga vit në vit dhe në vitin 1986 mbasin vetëm 21.90 të dalave të përgjithshme shtetërore. Gjithashtu edhe Njësitë federative në vitet 1947 – 1951 merrnin pjesë në të dalat publike me 24.3 %, pas decentralizimit të pushtetit kjo përqindje nga viti në vit shkonte duke u rritur dhe në vitin 1986 ishte 38.7%.

Edhe shpenzimet e pushtetit lokal si rezultat i decentralizimit ishin rritur nga 12.6 në vitin 1947 në 37.2% në vitin 1986.

Më poshtë japim një tabelë të decentralizimit fiskal që ishte në Jugosllavi në periudha të ndryshme.

Tabela Nr. 1 – Decentralizimi Fiskal – Pjesëmarrja e niveleve të ndryshme të qeverisjes në të dalat publike

<i>Niveli</i>	<i>1947- 951</i>	<i>1954-1959</i>	<i>1968-1970</i>	<i>1982</i>	<i>1984</i>	<i>1986</i>
<i>Federata</i>	63.1	56.3	53.1	18.2	19.7	21.9
<i>Njësiti Federale</i>	24.3	14.2	18.3	40.3	39.5	38.7
<i>Pushteti Lokal</i>	12.6	29.5	28.6	38.3	37.4	37.2
<i>Të pashpërndara</i>				3.2	3.4	2.2

Burimi: Bogoev, Ksente, Rreziku i Decentralizimit, Rasti i Jugosllavisë, 1991, faqe 63

3.1.1 Diferencat zhvillimore në Kosovës krahasura me vendet e tjera

Ekonomia e ish Jugosllavisë ka pasur diferenca të mëdha zhvillimore në mes Njësive të tyre Federative ku nga njëra ishte veriu shumë i zhvilluar kurse pjesa tjetër ishte shumë më pak e zhvilluar . Nga njëra anë kishim Slloveninë e cila sa i përket Prodhimit të Brendshëm Bruto për çdo banor krahasohej me vende të ndryshme perëndimore si Spanja apo Zelanda e Re, Kroacia apo Vojvodina krahasohej me Greqinë dhe Portugalinë kurse nga ana tjetër ishte Kosova si vend më i pazhvilluar dhe në atë kohë krahasohej me Pakistanin.

Diferenca në PBB për çdo banor ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë shkonin në 1/8. Gjithashtu edhe niveli i papunësisë ndërmjet njësive Federative ishte shumë i madh ku në Kosovë ishte më i theksuari dhe kishte periudha që shkonte deri në 57.8 % kurse mesatarja e papunësisë në ish Jugosllavi ishte rreth 15 %.

Me qëllim të zbutjes së diferencave zhvillimore ishte krijuar një fond i veçantë për zhvillimin e Njësive Federative të pazhvilluara ku ishte menduar që të investohej në njësitë

federale të Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës të cilat për nga niveli i zhvillimit ekonomik ishin larg Njësive të tjera Federale e kjo diferencë më e theksuar ishte me Kosovën si rezultat i mos zhvillimit të saj në një periudhë të gjatë që nga përfundimi i Luftës së dytë botërore. Sipas këtij fondi republikat më të zhvilluara duhet të investonin në ndërtimin e kapaciteteve prodhuese në Njësitë e tjera federale të pazhvilluara por ky fond nuk ka arritur të zbusë këto diferenca për shkak se edhe investimet e bëra nga njësitë e zhvilluara tek Njësitë Federative të pazhvilluara ishin seleksionuese dhe kryesisht investohej aty ku ato mendonin të kishin dobi në të ardhmen, punët ndërtimore dhe pajisjet bliheshin nga vetë ato, Njësi Federale dhe pjesa dërmuese e të punësuarve ishin nga ato vende prandaj edhe rezultatet që janë pritur nga ky fond ishin të mangëta.

Nga të dhënat e marra mbi prodhimin shoqëror bruto mestar për çdo banor shihen diferenca të mëdha në mes të viseve të zhvilluara me pjesën e pazhvilluar që ishin pjesë e Federatës Jugosllave. Këto diferenca zhvillimore dhe pjesëmarrja e Njësive federative jo vetëm që ishin zvogëluar por nga viti në vit ato rriteshin dhe nëse krahasojmë vitin 1952 ku Prodhimi i Brendshëm Bruto për çdo banor në Slloveni ishte më i larti më 181.82 në Kosovë ishte më i ulëti me 46.51 apo shprehur ndryshe kjo diferencë ishte 3.9 herë. Në vitin 1960 diferenca në mes të Sllovenisë dhe Kosovës ishte 180.53 me 37.36 respektivisht 4.83 herë ishte më e lartë PBB në Slloveni, në vitin 1970 Prodhimi II Brendshëm mesatar bruto në Slloveni ishte 193.64 kurse në Kosovë 34.45 respektivisht 5.62 herë dhe në vitin 1989 kur fillon edhe shpërbërja e Jugosllavisë kjo diferencë ishte 196.8 në Slloveni me 25.66 në Kosovë respektivisht 7.67 herë.

Pra vetëm këto të dhëna krahasuese tregojnë për diferenca të mëdha zhvillimore si dhe faktin se Fondi i krijuar i ashtuquajtur për zhvillimin e viseve të pazhvilluara nuk

kishte dhënë asnjë rezultat por vetëm kishte thelluar hendekun e diferencave të mëdha në mes të pjesëve të ndryshme të Federatës Jugosllave. Nga paraqitja tabelore e cila do të paraqitet më poshtë lidhur me prodhimin brendshëm bruto për çdo banor në Jugosllavi në periudhën nga viti 1952 deri në vitin 1989 shihen edhe diferencat e tjera që kanë ekzistuar në mes të njësive Federale.

Tabela Nr. 2 – Prodhimi Brendshëm Bruto për çdo banor në ish jugosllavi në periudha të ndryshme vlerat në dollar amerikan ndaj vlerave mesatare

Njësia Federative/Viti	1952	1960	1970	1980	1989
Bosnja e Hercegovina	95.5	75.95	67.58	65.98	67.91
Kroacia	121.39	119.30	125.56	126.68	126.26
Maqedonia	71.42	63.85	69.95	67.24	64.75
Sllovenia	181.82	180.53	193.64	198.32	196.8
Serbia	92.52	91.80	89.30	89.59	91.51
Mali i Zi	87.6	65.67	76.36	79.00	73.7
Kosova	46.51	37.36	34.45	28.21	25.66
Vojvodina	89.54	107.78	105.82	112.75	119.28

Burimi: Vojniq,1995,78-81

3.1.2 Diferencat në punësim të Kosovës me viset e tjera

Dihet se politikat fiskale tentojnë të krijojnë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm e me të edhe rritje të punësimit si rezultat i atij zhvillimi. Gjithashtu edhe sa i përket nivelit të papunësisë kishte diferenca të mëdha në mes të njësive federale të Jugosllavisë ku këto diferenca ishin aq të mëdha sa lehtësisht mund të thuhej se nuk kishte të bëjë me një vend të njëjtë ku në njërin anë ishin zonat veriore me nivel të ulët të papunësisë dhe të ardhura për frymë banori të mëdha dhe nga ana tjetër ishte zona jugore e shtetit ku printe Kosova si vendi më i pazhvilluar dhe me një shkallë ekstreme të papunësisë. Edhe struktura arsimore ishte shumë e pavolitshme për Kosovën me një numër shumë të vogël të personave të

kualifikuar me përgatitje shkollore dhe kjo ndikonte edhe vendimet që merreshin për investime strategjike të cilat mund të kishin ndikim në zbutjen e nivelit të lartë të papunësisë. Duke pasur parasysh se ekonomia para aprovimit të kushtetutës së vitit 1974 ishte e centralizuar dhe de centralizimi kishte filluar nga viti 1968 kur ishin bërë disa amendamente kushtetuese ku njësive federale iu dhanë një numër i madhe i kompetencave shtetërore ngritja e kapaciteteve të reja bëhej me vendim të organeve federative apo republikane ku për investime në Kosovë vendosej për kapacitete që ishin më pak fitimprurëse duke ndarë për nevoja të veta investimet që ishin më fitimprurëse dhe kishin mundësi më të mëdha të punësimit.

Nga të dhënat që kemi ne kemi analizuar lidhur me nivelin dhe shkallën e punësimit për periudhën nga viti 1980 deri në vitin 1990 kur vjen shpërbërja e Jugosllavisë shohim se nga njëra anë kemi Slloveninë e cila gati sa nuk ka pasur të papunë dhe Kosovën e cila është ballafaquar me nivel të lartë të papunësisë. Kështu në vitin 1980 papunësia në tërësi në ish Jugosllavi ishte 13.8 %,në Slloveni si pjesa më e zhvilluar ishte vetëm 1.4% kurse Kosova kishte shkallën e papunësisë prej 39.0%. Kjo shkallë e papunësisë në Kosovë ishte rritur vazhdimisht dhe në vitin 1985 kishte arritur nivelin prej 54.20 të papunësisë kurse mesatarja në federatën Jugosllave ishte 16.3,e në Slloveni si vendi më i zhvilluar ishte ende nën nivelin prej 2%. E njëjta situatë ka vazhduar deri në shpërbërjen e Jugosllavisë. Nga paraqitja tabelore të cilën e japim më poshtë shohim për diferencat e mëdha në punësim në mes të njësive të ndryshme federale ku Kosova kishte nëpër të gjitha periudhat shkallën më të lartë të papunësisë.

Tabela Nr. 3 – Niveli i papunësisë tek njësitë federale të ish Jugosllavisë

	1980	1981	1982	1983	1984	1985	1986	1987	1988	1989	1990
<i>RSFJ</i>	13.8	13.8	14.4	14.9	15.7	16.3	16.6	16.1	16.8	14.9	15.9
<i>Mali i Zi</i>	17.5	18.1	19.3	21.6	23.5	24.6	24.6	23.6	26.3	21.6	21.6
<i>Maqedonia</i>	27.9	29.0	28.1	26.4	26.7	27.6	27.7	27.3	27.1	21.9	22.9
<i>Kosova</i>	39.0	39.1	41.0	44.5	49.9	54.2	57.1	57.0	57.8	36.3	38.4
<i>Kroacia</i>	5.7	6.1	6.9	7.4	7.7	7.9	7.9	7.8	8.5	8.0	8.6
<i>Sllovenia</i>	1.4	1.6	1.7	2.0	1.9	1.8	1.7	1.8	2.5	3.2	4.8
<i>Serbia</i>	18.9	17.7	17.9	17.3	17.0	17.4	17.9	17.8	18.1	15.6	16.4
<i>Vojvodina</i>	14.4	14.6	15.1	15.6	15.7	15.7	15.6	13.9	14.3	13.6	16.6
<i>B e H</i>	16.6	16.7	17.9	20.3	23.0	24.4	24.3	23.1	24.1	20.3	20.6

Burimi: WoodWard,1995, faqe 384

3.1.3 Ndikimet e Kosovës dhe politikat e ndjekura në ekonomi në tërësi dhe fushën fiskale nga viti 1989 deri në 1999

Kushtetuta e vitit 1974 i mundësoi autoriteteve Kosovare që në mënyrë të pavarur, në një numër të madh të sferave, të organizojnë jetën institucionale. Duke parë një gjë të tillë dhe menjëherë pas aprovimit të Kushtetutës së vitit 1974 fillojnë të dalin rryma të ndryshme radikale dhe nacionaliste në Serbi duke përfshirë Akademinë e Arteve dhe të Shkencave të cilat filluan menjëherë aktivitetin e tyre nëpërmjet propagandës për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Kjo politikë bëri që të gjitha Njësitë federale të Ish Jugosllavisë të shohin këtë politikë të Serbisë dhe të kërkojnë krijimin e shteteve të tyre të

pavarura e cila solli shkatërrimin e ish Jugosllavisë. Prandaj edhe pse për disa vite Kosova kishte krijuar një mëvetësi në disa fusha dhe përfshirë edhe politikat fiskale, pas vitit 1989 u suprimua Autonomia e Kosovës dhe nga kjo periudhë deri në vitin 1999, me hyrjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë me emrin e Unmik-ut ishin shkaktuar dëme të mëdha ekonomisë Kosovare të cilat ka qenë shumë vështirë për tu riparuar si rezultat i shkatërrimit të pronës publike, shoqërore dhe private dhe që kanë bërë që jeta institucionale dhe ekonomike në Kosovë të rëndohej dhe të bëhej e padurueshme për popullatën..

Gjatë kësaj periudhe nga institucionet publike dhe shoqërore janë larguar mbi 150,000.00 punëtorë shqiptarë dhe në të gjitha institucionet që merreshin me politika zhvillimore, fiskale dhe të jetës tjetër shoqërore kishin mbetur të punësuar vetëm punëtorë nga nacionalitetet tjera të cilët ishin pakicë në Kosovë. Dëmi që i është shkaktuar ekonomisë Kosovare, sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti Ri Invest i cili kishte marrë një projekt nga Banka Botërore për të bërë këtë hulumtim është mbi 1.2 miliard marka gjermane.

Duke u nisur nga kjo, në Kosovë janë zhvilluar institucionet paralele të cilat merreshin me grumbullimin e të hyrave nga qytetarët, bizneset dhe diaspora nëpërmjet këshillave lokale të financimit që mbikëqyrej nga Këshilli Qendror për financim i Kosovës dhe nëpërmjet të cilit financoheshin veprimtaritë më të domosdoshme për mbijetesë si arsimi, shëndetësia dhe institucionet tjera paralele që mundësonin kryerjen e aktiviteteve për mbijetesë të popullatës. Në këtë periudhë të hyrat ishin ndarë nga disa burimi si nga pagat që duhej te paguheshin 3% nga to, pastaj nga numri i personave që ishin të punësuar jashtë vendit por edhe nga pagesat tjera vullnetare nga ana e bashkë atdhetarëve tanë jashtë vendit. Pra gjatë kësaj periudhe okupimi nuk kemi të bëjmë me politika fiskale të mirëfillta

por më se të domosdoshme për mbijetesë. Gjithashtu nga ajo kohë nuk ka pasur ndonjë transparencë të mirëfilltë mbi shumën e mjeteve të grumbulluara dhe mbi mënyrën e shpenzimit të tyre prandaj nuk mund të hasim ndonjë të dhënë të saktë të mjeteve të grumbulluara dhe mënyrën e shpenzimit të tyre. Kjo situatë ka zgjatur deri në vitin 1999 ku pas sulmeve të Aleancës Veri Atlantike të NATO, Forcat Jugosllave, me tërë aparaturën e vjetër shtetërore të instaluar në Kosovë nëpërmjet Serbisë u detyruan të lejojnë Kosovën të pranojë futjen e Kombeve të Bashkuara me Misionin e Unmikut. Në këtë periudhë kemi fillesat e politikave fiskale të cilat janë aplikuar në Kosovë të cilat kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme por jo të mjaftueshme që do të ndikonin në masë të mjaftueshme për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe strukturore të ekonomisë Kosovare.

3.1.4 Politikat fiskale të udhëhequra nga UNMIK- u nëpërmjet Autoritetit Qendror Fiskal pas vitit 1999 deri në vitin 2008

Pas largimit të pushtetit okupues Serb nga Kosova dhe futjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara më 11 Qershor 2009, Pushtetin në Kosovë e kishte Misioni i Kombeve të Bashkuara me emrin e UNMIK-ut, si mision i përkohshëm deri në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Pushtetin legjislativ Misioni i Unmik-ut e zhvilloi nëpërmjet disa shtyllave ku me çështjet që kishin të bënin me zhvillimin ekonomik, privatizimin dhe politikat fiskale merrej e ashtuquajtura Shtylla e dytë e cila e kishte themeluar edhe Autoritetin Qendror Fiskal një zëvendësim për Ministrinë e Financave. Ai kishte autoritetin por edhe detyrën për të përgatitur legjislacionin e nevojshëm për mbledhjen e të hyrave si dhe për mënyrën e shpenzimit të atyre të hyrave. Në fillim AQF kishte për qëllim që të angazhohej për themelimin e Departamenteve të ndryshme ekonomike që merreshin me politikat fiskale,

makroekonomike dhe të tjera dhe me dislokimin e mjeteve të ndryshme që në atë periudhë, në masë më të madhe, ishin nga donacionet e më pak nga mbledhjet e të hyrave buxhetore që bëheshin qoftë nga të hyrat që mblidheshin në kufi apo edhe nga të hyrat e tjera që mblidheshin brenda vendit. Në fillim të hyrat buxhetore qoftë ato që mblidheshin nga doganat dhe akcizat në kufi por edhe ato brenda vendit ishin shumë të vogla dhe me një pjesëmarrje të vogël në buxhetin e përgjithshëm. Por të cilat nga viti në vit filluan të rriten duke zvogëluar proporcionin në mes të ardhurave nga donacionet dhe të ardhurave që mblidheshin në Kosovë qoftë në kufi gjatë hyrjes së mallit nga importi apo edhe gjatë realizimit të hyrave vendore.

Në vitin 1999 nuk kishte të hyra buxhetore që mblidheshin nga bizneset brenda territorit të Kosovës por kryesisht ishin tri lloj taksash që mblidheshin në kufi si:

- Të ardhurat nga doganat në shumë prej 10%
- Tatimi në shitje i cili më vonë zëvendësohet me Tvsh në import prej 15%
- Akciza, e cila ishte e diferencuar varësisht nga prodhimet që importoheshin.
- Tatimi i parë brenda vendit i cili kishte filluar të aplikohet ishte i

ashtuquajtur i tatimi në hoteleri dhe pije i cili ishte aplikuar nga viti 2000 dhe ku bizneset hoteliere që kanë pasur një qarkullim të caktuar mbi 1000 Marka gjermane në muaj është dashur të paguajnë një taksë fikse prej 9% për shërbimet hoteliere dhe qarkullimin që kishin brenda muajit duke mos zbritur shpenzimet apo ndonjë të dalë tjetër për paga që paguanin. Ky tatim sado që ishte modest dhe nuk kishte ndonjë ndikim në buxhetin e Kosovës së asaj kohe, i cili ishte shumë i vogël, kishte rëndësi pasi dalëngadalë filloi të vendosë themelet e krijimit të një

administrate shtetërore që merrej me mbledhjen e tatimeve Brenda territorit të Kosovës.

Më vonë filloi të aplikohet i ashtuquajturi tatim i paragjykuar ku varësisht nga vendndodhja çdo biznes paguante kuotën fikse nga 100 deri në 200 Euro dhe një taksë në qarkullim që ishte 3% mbi limitin e caktuar të qarkullimit.

Nga korriku i vitit 2001 filloi të aplikohet si tatim tjetër indirekt për herë të parë në Kosovë edhe Tvsh-ja e cila kishte normë standarde prej 15 % dhe normë prej 0% për Eksporte dhe për mallra që furnizoheshin nga donacionet dhe të ardhurat e tjera që vinin nga qeveritë e shteteve tjera të cilat ndihmonin ekonominë Kosovare në periudhën e pasluftës. Nga viti 2002 filluan të bëhen disa ndryshime në politikat fiskale kryesisht në tatime të drejtpërdrejta dhe filluan të aplikohen dy tatime: tatimi në të ardhura të Korporatave dhe tatimi në të ardhura personale.

Tatimi në të ardhura të korporatave që aplikohet nga viti 2002 kishte normë fikse prej 20% në fitim që paguanin korporatat e ashtuquajtura të mëdha e që sipas legjislacionit ishin ato që kishin qarkullim vjetor mbi 100,000 Euro i cili si bazë për tu tatuar si korporatë e madhe u zvogëlua në 50,000.00 Euro por norma e tatimit në të ardhura të korporatave prej 20 % mbeti deri në fund të vitit 2008.

Për bizneset individuale dhe individët aplikoheshin tatimi progresiv varësisht nga të ardhurat neto që realizonin bizneset individuale apo individët brenda vitit dhe ajo ndarje bëhej më poshtë:

Të ardhurat	Norma e tatimit
0 - 960	00
960 – 3000	5%
3000 – 5400	10%
Mbi 5400	20%

Kjo periudhë e zhvillimit të aktiviteteve të biznesit karakterizohej kryesisht me aktivitete të ndërtimtarisë pasi shkatërrimet që kishin ndodhur gjatë luftës duhej në mënyrë emergjente të rindërtoheshin kështu që një sasi e madhe e materialeve ndërtimore ishin ndihma humanitare të dhëna nga qeveritë dhe vendet e tjera dhe hyrjet e mallit komercial në kufi ishin më të vogla kurse sa i përket prodhimit vendor në atë kohë ai ishte simbolik. Sa i përket të ardhurave fiskale që mbledheshin në periudhën nga viti 2000 ishin mjaft të ulëta pasi edhe niveli i ekonomisë ishte shumë i vogël dhe as që mendohej për ndonjë rritje ekonomike prandaj edhe prodhimi i brendshëm bruto bazohej nga donacionet që ishin premtuar dhe ishin dhënë për Kosovën menjëherë në periudhën pas përfundimit të luftës.

Në tabelën e paraqitur më poshtë do të shohim se sa ishte niveli i të hyrave buxhetore që mbledheshin në periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2004 dhe shpenzimet buxhetore për atë periudhë.

Tabela Nr. 4 – Buxheti i Konsoliduari Kosovës 2000–2004

Vlerat në miliona Euro

	2000	2001	2002	2003	2004
Të hyrat buxhetore	249.0	362.4	509.2	589.7	615.0
Shpenzimet buxhetore	204.1	239.5	401.6	542.6	748.5
Diferenca	+ 44.9	+ 122.9	+ 107.6	47.1	-133.5

Burimi: Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, Raporti vjetor 2005, Qershor 2006 ,faqe 49

Nga paraqitja tabelore shohim se të hyrat buxhetore nga viti 2000 që kanë qenë 249 milion janë rritur në vitin 2004 në vlerë prej 615 milion apo 246.98 % por që deri në vitin 2004 Kosova për shkak të ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale që ishte prioritet primar i Unmik-ut ishte gjithmonë në suficit duke filluar prej 44.9 milionëve në vitin 2000, 122.9 milion në vitin 2001, 107.6 milion në vitin 2002 dhe 47.1 milion në vitin 2003 kurse viti 2004 ishte viti i parë ku Kosova kishte një deficit prej 133.5 milion Euro duke pasur parasysh se Kosova kishte suficit të akumuluar nga vitet e kaluara ajo ende nuk kishte ndonjë borxh publik i cili sado që dukej se ishte një gjë e mirë, prapëseprapë ka pasur ndikime në drejtimin e mjeteve financiare në projekte dhe investime kapitale.

Sa i përket strukturës së të hyrave, pjesëmarrja më e madhe e tyre ishte nga mbledhja e të hyrave në doganë dhe të tatimeve indirekte kurse tatimet e drejtpërdrejta kishin një pjesëmarrje shumë të vogël në të hyrat e përgjithshme buxhetore.

Tabela Nr. 5 – Të ardhurat buxhetore në Kosovë viti fiskal 2004 Vlerat në miliona Euro

Viti / Lloji i të ardhurave buxhetore	2004	%
Tatimet indirekte	474	77 %
Tatimet e drejtpërdrejta	61	10 %
Tatimet jo tatimore	80	13 %
Totali	615	

Burimi: Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës, Raporti vjetor 2005, Qershor 2006 ,faqe 50

Nga të dhënat e paraqitura më lart shohim se sado që shkalla e mbulimit të eksportit me import ka filluar të rritet nga viti 2001 deri në vitin 2004 përsëri në vlerë nominale kemi rritje të bilancit negativ tregtar ku nga vlera nominale prej 673,941,000.00 që ishte deficitit tregtar në vitin 2001 ai është rritur në 1,006,780,000.00 në vitin 2004.

3.1.5 Ndryshimet e politikave fiskale nga viti 2005 deri në vitin 2008

Në vitin 2005 fillon të aplikohet pakoja e re fiskale me aprovimin e disa rregulloreve të reja të cilat kishin të bënin me aplikimin e tatimit në të ardhura të korporatave, tatimit në të ardhura personale dhe ndryshimet e rregullores së TVSh -së . Këto rregullore të ndryshuara kishin mbetur në fuqi deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 2008.

Thelbi i këtyre ndryshimeve të legjislacionit fiskal të bërë nga shtylla e dytë e Unmik- ut prapë nuk tentonte në përmirësimet e të bërit biznes, në rritjen e konkurrencës së bizneseve apo të gjenerimit të vendeve të reja të punës por thelbi ishte ruajtja e një stabiliteti makro fiskal, mos futja e Kosovës në borxhe të jashtme pasi që Kosova nuk ishte pjesë e organizatave të ndryshme financiare deri në shpalljen e pavarësisë së asaj nuk i ishte lejuar futja në borxhe të jashtme dhe kjo kishte ndikim mjaft të madh edhe në aftësinë konkurruese të ekonomisë kosovare pasi mos marrja e kredive investuese dhe pa mundësia e futjes së kapitalit të freskët ndikonte në mënyrë negative në rrjedhat e përgjithshme.

Sado që Ministrinë, nëpërmjet të ashtuquajturave Institucione të Qeverisjes së Përkohshme, ishin të zgjedhura nga populli prapëseprapë të gjitha vendimet vareshin nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ku pa nënshkrimin respektivisht aprovimin e tillë asnjë rregullore nuk kishte fuqi ekzekutive, kështu që doemos duhej aprovimi i tij.

Gjatë kësaj periudhe nga viti 2005 fillon periudha ku pjesa e donacioneve fillon të ulet ndjeshëm dhe të hyrat publike mblidheshin kryesisht nga bizneset vendore kryesisht në kufi si rezultat i importimit të mallrave të ndryshme e më pak në tregun e brendshëm si rezultat i transaksioneve që bëheshin brenda territorit të Kosovës.

Megjithatë këto ndryshime prapëseprapë pjesa më e madhe e të hyrave që realizoheshin dhe priteshin të realizoheshin ishin të hyra nga pikat doganore dhe jo nga aktivitetet brenda vendit.

Edhe në Kosovë aplikoheshin tatimet e drejtë për drejta dhe jo të drejtë për drejta të cilat duhet të paguheshin nga individët dhe korporatat e ndryshme varësisht nga lloji i tatimeve.

Tatimet e drejtpërdrejta

Nga tatimet e drejtpërdrejta që aplikoheshin për shoqëritë tregtare dhe individët nga viti 2005 dhe që vazhduan të aplikoheshin në Kosovë deri në fund të vitit 2008 ishin këto lloje:

Tatimi në të ardhura personale

Ky tatim ishte tatimi më gjithpërfshirës i cili aplikohet dhe ende aplikohet në Kosovë dhe kishte karakter të tatimit progresiv që ishte menduar se ata të cilët realizojnë më shumë të ardhura duhet të paguajnë më shumë në krahasim me ata të cilët realizojnë më pak të ardhura. Ky ishte vjetor dhe në të ardhurat vjetore të realizuara nga individët apo bizneset individuale kishte këto norma tatimore:

Të ardhurat vjetore deri 960 Euro Norma ishte 0

Të ardhurat vjetore nga 960.01 Euro deri në 3000 Euro norma ishte 5%

Të ardhurat vjetore nga 3000.01 deri në 5400 Euro norma vjetore ishte 10%

Të ardhura vjetore mbi 5400.01 norma vjetore ishte 20%.

Pra ky lloj i tatimit kishte për qëllim që ata që realizojnë të ardhura më të mëdha të paguajnë më shumë tatim në krahasim me ata që realizojnë të ardhura më të vogla edhe pse

diferenca për tatim që duhej të paguhej për nivele të ndryshme ishte shumë e vogël për shkak të diferencave të vogla të pragut që kalohej nga një normë tatimore në normën tjetër.

Tatimi në të ardhura të korporatave

Tatimi tjetër që aplikohet nga grupi i tatimeve të drejtë për drejta ishte edhe tatimi në të ardhura të korporatave i cili në fitimin e realizuar nga Korporatat kishte normë prej 20%. Pra të gjitha korporatat të cilat zhvillonin aktivitet në Kosovë dhe Njësitë e huaja që zhvillonin aktivitet ekonomik në Kosovë për fitimin e realizuar duhet të paguanin 20%. Pra nga kjo shihet se ky tatim nuk ishte progresiv siç ishte tatimi në të ardhura personale por kishte një normë të vetme tatimore të cilës i nënshtroheshin të gjitha korporatat pa marrë parasysh numrin e të punësuarve, llojin e veprimtarisë apo të ndonjë karakteristike tjetër që do të mund të ndikonte në normën tatimore.

Tatimi në dividend

Tatimi në dividend paguhej nga të gjithë aksionarë të cilët realizonin fitim nga korporatat dhe fitimin nuk e futnin në ri investim por e deklararin si dividend me qëllim të tërheqjes në të ardhmen dhe në momentin e pagesës së dividendësh Korporata ishte e obliguar që ta mbajë në burim para çdo pagese dhe norma e tatimit në dividendë ishte 20 %.

Pikërisht ky lloj tatimi ka bërë që pjesa dërmuese e shoqërive tregtare të regjistruara deri në atë kohë sipas statistikave nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ku ishte Departamenti për regjistrimin e bizneseve, ishin biznese individuale. Kjo ishte për shkak se obligimet fiskale që kishte një biznes individual ishte shumë më e vogël në krahasim me obligimet që duhej të paguajë një individ nëse kishte vendosur që të investonte kapitalin e vet.

Kjo mund të ilustrohet me faktin se nëse dy individë investojnë kapitalin e tyre në dy shoqëri tregtare të ndryshme njëri në një biznes Individual e tjetri në një Korporatë si i vetëm në të (legjislacioni Kosovar lejon një gjë të tillë) dhe nëse fitimi në të dy këto shoqëri tregtare ishte i njëjtë për shembull 100.000 Euro atëherë edhe obligimi që duhej të paguhej ishte i ndryshme dhe fitimi neto që realizohej pas pagesës së obligimeve tatimore ishte i ndryshëm.

Më poshtë paraqesim formën tabelore të obligimeve tatimore dhe fitimit neto që i mbetet një investitori varësisht nga forma e regjistrimit të shoqërisë.

Tabela Nr. 6 – Krahasimi i obligimeve tatimore në mes të shoqërive tregtare me status të ndryshëm

Lloji i shoqërisë	Fitimi para tatimit	Tatimi në fitim/ TAP për shoqëri	Tatimi në dividendë	Totali i tatimit të paguar	Fitimi neto
Korporata	100,000.00	20,000.00	16,000.00	36,000.00	64,000.00
Biznes Individual	100,000.00	19,262.00	00	19,262.00	80,738.00

Burimi; Autori (2014)

Pra nga tabela e paraqitur më lart shohim se nëse një individ realizon fitim të njëjtë para tatimit në shumë prej 100,000. Euro fitimi neto pas shpërndarjes që i mbetet atij varësisht nga forma e regjistrimit të biznesit ishte 80,738.00 Euro për një kapital të investuar në një biznes individual në krahasim me vetëm 64,000.00 Euro për kapitalin e investuar në shoqëri tregtare të regjistruara si korporata.

Përqindja e tatimit direkt në rastin e korporatës ishte 36% në krahasim me përqindjen prej vetëm 19.26% tek biznesi individual.

Për të ilustruar këtë situatë nga të dhënat të cilat do ti paraqesim më poshtë shohim se, në vitin 2008 numri i bizneseve të regjistruara nga viti 2004 rritet për 27033 dhe struktura e këtyre ndërmarrjeve është e paraqitur në poshtë ku janë të dhënat për formën juridike të tyre si dhe për aktivitetin më të cilin merreshin në fund të vitit 2008.

Tatimet jo të drejtpërdrejta

Të gjitha shoqëritë tregtare në Kosovë, pa marrë parasysh formën e regjistrimit të tyre, të cilat realizonin një qarkullim brenda periudhës 12 mujore mbi 50,000.00 Euro apo dëshironin që vullnetarisht të regjistroheshin bëheshin deklarues të tvsh-së dhe norma e tvsh- së që aplikohet nga fillimi i aplikimit të saj në korrik të vitit 2001 ishte 15% në shitjet brenda vendit si normë standarde dhe 0 % për eksporte dhe të ardhurat nga organizatat ndërkombëtare qeveritare. Gjithashtu aplikohet norma e përjashtuar nga tvsh për shërbime shëndetësore, barna, tokë dhe banesa dhe disa shërbime të tjera ku tek këto shërbime dhe shitje nuk llogaritej tvsh por nuk kishte të drejtë edhe në zbritjen e tvsh-së në blerjet e realizuara. Sado që kjo normë e tvsh – së standarde në përgjithësi ishte më e vogël se ajo në regjion dhe më gjerë, prapëseprapë për shkak se nuk ishte e përshkallëzuar nuk krijonte ndonjë favor ndaj normave që aplikoheshin në regjion dhe më gjerë.

Mangësi kryesorë ishte edhe fakti se nëse ndonjë shoqëri e regjistruar si korporatë apo si biznes individual, për të zhvilluar aktivitet prodhues që ishte shumë me rëndësi për ekonominë Kosovare, nuk kishte asnjë zbritje të tvsh-së për lëndën e parë të importuar apo të blerë brenda vendit por nuk kishte zbritje as për makinerinë e importuar por kishte mundësi të kërkonte shtyrjen e pagesës së tvsh-së në import të makinerisë për një periudhë gjashtëmujore.

Nisur nga fakti se periudha nga fillimi i blerjes së kësaj makinerie deri në fillimin e aktivitetit prodhues në shumicën e rasteve merrte më shumë kohë, atëherë edhe kjo shtyrje e pagesës së tvsh-së nuk prodhonte ndonjë rezultat pozitiv për bizneset prodhues pasi shumica e tyre duhej që para kalimit të prodhimit të paguanin tvsh në import të makinerisë gjë që dëmtonte aftësinë financiare të shoqërive të cilat një pjesë të madhe të kapitalit të tyre duhej ta paguanin për tvsh në makinerinë e importuar.

Nga shtatori i vitit 2015 pragu për regjistrim në tvsh ishte zvogëluar në 30,000.00 Euro dhe është bërë përshkallëzimi i tvsh-së ku tani kemi dy norma të tvsh-së ajo standarde prej 18%, norma e ulët prej 8% dhe norma 0 për eksporte dhe shitje për Kforin dhe Organizatat qeveritare dhe jo qeveritare të cilat angazhoheshin në projekte humanitare dhe zhvillimore në Kosovë.

3.1.6 Struktura e të hyrave buxhetore nga viti 2005 deri në vitin 2008

Duke pasur parasysh se Kosova gjatë kësaj periudhe aplikonte një politikë fiskale tejet të matur, për shkak të mos mundësisë së futjes në borxhe të jashtme atëherë edhe buxheti i paraparë dhe i realizuar nëpër periudha të ndryshme deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës ishte kryesisht në suficit pasi edhe përgatitja e tij bëhej me një kujdes të theksuar veçanërisht rreth planifikimit të hyrave që mund të realizoheshin.

Por struktura e të hyrave që janë realizuar në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2008 nuk ka ndryshuar shumë dhe përsëri të hyrat kryesore që marrin pjesë në të hyrat e përgjithshme buxhetore janë të hyrat tatimore nga tatimet e mbledhura në kufi dhe pastaj vijën të hyrat tatimore të mbledhura brenda territorit të vendit. Edhe pse këto të hyra të mbledhura brenda vendit nga viti në vit kanë pasur një rritje të ndjeshme përsëri pjesëmarrja e tyre në të hyrat e përgjithshme ka mbetur pothuajse e njëjtë dhe tregon një

ekonomi të brishtë të Kosovës e cila bazohet tërësisht nga importi i prodhimeve të huaja e shumë pak nga prodhimtaria dhe shërbimet brenda vendit .

Kështu nëse analizojmë si shembull të hyrave buxhetore për periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2008 shohim edhe të hyrat e realizuara nga kufiri, të hyrat vendore si dhe të hyrat jo tatimore të cilat mbledhen nga niveli qendror dhe ai lokal.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqesim të hyrat të realizuara për vitet fiskale nga 2005 deri në vitin 2008.

Tabela Nr. 7 – Të hyrat e realizuara nga viti 2005 deri në vitin 2008			Vlerat në 000 Euro	
Buxheti i Kosovës	2005	2006	2007	2008
Gjithsej të hyrat		975,696	1.170,366	989,126
Të hyrat nga tatimet kufitare		456,393	531,591	604,196
Të hyrat nga tatimet brenda		164,078	182,542	200,834
Të hyrat vetjake		97,579	189,106	171,251
Të hyrat nga donacionet		19,563	11,643	12,845
Të hyrat nga privatizimit		238,083	255,484	--

Burimi: MFE – Raporti vjetor 2005, 2006, 2007 dhe 2008

Nga tabela e paraqitur më lart për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2008 të hyrat janë rritur nga viti në vit. Por edhe pse ka tejkalim të hyrave të realizuara me ato të parapara përsëri struktura e këtyre të hyrave është e pavolitshme.

3.1.7 Sistemet fiskale të ndjekura nga vendet e Ballkanit deri në vitin 2008

Të gjitha vendet e Ballkanit, bazuar në specifikat e veta si vende që kanë kaluar nga një sistem politik socialist në sistemin e ekonomisë së tregut, kanë pasur politikat e veta fiskale me të cilat janë orientuar në thithjen e investimeve të huaja dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Me qëllim të realizimit të objektivave të qeverive të tyre të gjitha këto vende kohë pas kohe bënë edhe ndryshimet e normave tatimore duke tentuar që këto ndryshime të siguronin kërkesat e tyre për mbulimin e shpenzimeve buxhetore nga njëra anë, zvogëlimin e deficitit të hyrave të tyre dhe nga ana tjetër edhe që këto reforma të kenë ndikim në rritjen e tyre ekonomike. Duke pasur parasysh se shtetet e ndryshme të Ballkanit, gati të gjitha kanë dalë nga lëvizjet e viteve 90 dhe kanë kaluar nga një ekonomi centraliste, të planifikuar në një ekonomi të tregut ato kishin mjaft vështirësi në adaptimin e politikave të tyre ekonomike si rezultat i ndryshimit të rrethanave të tërësishme shoqërore dhe ekonomike prandaj këto tentonin që me reformat e tyre në politikat fiskale të ndikonin në thithjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta të cilat janë promotor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe do të bënin ndryshime strukturore ekonomike të cilat ishin më se të nevojshme për këto shtete.

Më poshtë paraqesim formën tabelore të normave të tatimit që ishin aplikuar nga vendet e ndryshme të regjionit nëpër periudhën nga viti 1992 deri në vitin 2009 ku në përgjithësi shohim se këto shtete nga viti në vit respektivisht në periudha të shpeshta kanë reduktuar normat për lloje të ndryshme të tatimeve me qëllim që ta bëjnë ekonominë e tyre

më atraktive për investime të huaja dhe që ekonomia e tyre të rritë konkurrencën me ekonomitë e vendeve të tjera jo vetëm të regjionit por edhe më gjerë.

Tabela Nr. 8 – Normat tatimore në vende të ndryshme të regjionit nëpër periudha të ndryshme duke përfshirë periudhën 1992 deri në vitin 2009

VENDI	TAP	TAK	TVSH
Shqipëria	Norma nga 5% deri në 30%. Nga 1 Korriku 2007 norma është 10%.	Në fillim ishte 30%, Pastaj 20%, nga Janari 2008 norma 8%	Nga 1996 norma standarde 20% dhe norma 0%
Bullgaria	1992 - 2002 ishin 6 Norma: 20;24;28;32;36;dhe 40% Nga 2002 – 2008 ishin 4 norma nga 20 deri 40% Nga 2008 është 10 %	Deri në vitin 2002 norma ishte 25% kurse për biznese të vogla 20% Nga viti 2002 norma 23.5% pastaj 15 % kurse nga viti 2007 norma është 10%	1994 – 1999 = 20% Nga viti 1999 aplikohet norma prej 20 % dhe norma e përjashtuar
Kroacia	1994 Norma 0 Nga 2001 tri norma 15%; 25% dhe 35% Nga viti 2003 ishte norma shtesë prej 45%	Nga viti 1994 norma 20%	1998 norma 22% dhe 0
Maqedonia	Deri në vitin 2002 dy norma dhe atë 15% dhe 18%..Nga 2002 deri në 2007 aplikoheshin tri norma progresive 15%; 18% dhe 24%.Nga 1 janari 2007 deri në 1 janar 2008 norma ishte 12% Nga Janari 2008 norma është 10%.	Në fillim ishte 30% Pastaj ra në 15% Në vitin 2007 norma ishte 12% Nga viti 2008 norma tatimore është 10%	Nga viti 200 ekzistojnë dy norma 19% norma e lartë dhe 5% norma e ulët
Rumania	Rumania: Kishte 5 norma dhe atë: 18%,23%,28%,34%, dhe 40% më 2009 ishte 16%	Paraprakisht 38%, nga 2003 është 25% kurse nga viti 2009 është 16%	Nga viti 1993 deri në vitin 2002 normat 22% dhe 11%. Nga viti 2003 aplikohen normat 19% dhe 9%
Serbia	Ishte 14%, pastaj 10%, 15% dhe 20% tani është 10%	Deri në vitin 2003 ishte 20 deri 30%	Më parë norma 20% nga viti 2005 aplikohen

		nga viti 2003 njëherë 12% dhe më vonë 10% kurse për lojëra të fatit dhe të ardhura nga interesi maksimum 20%	norma 18%, 8% dhe 0% për barna dhe libra.
Mali i Zi	Më parë ishte 14%, pastaj normat në të ardhura personale lëviznin nga 10%, 15%, dhe 20%	Më parë 20 deri 30% nga viti 2003 14% më vonë 10%	Paraprakisht norma ishte 20% dhe e përjashtuar në shërbime publike dhe produkte ushqimore
Kosova	Nga 2002 deri në 2008 katër norma dhe atë: 0%, 5%, 10% dhe 20% kurse nga 1 janari 2009 katër norma 0%, 4%, 8% dhe 10%	Nga viti 2002 deri në vitin 2008 norma ishte 20% kurse nga janari i vitit 2009 është 10%	Nga viti 2001 deri më 2008 norma 15%, 0% e përjashtuar dhe norma e përjashtuar kurse nga viti 2009 është 16%

Burimi: Bedri Peci, Thesis Kosova, nr. 2, 2009, faqe 39

3.1.8 Ndryshimet dhe politikat fiskale të ndjekura nga Qeveria e Kosovës pas vitit

2009

Pas pavarësisë së Kosovës, nga viti 2008, fillon periudha kur pjesa më e madhe e kompetencave kishin kaluar në duar të institucioneve vendore dhe sado që ajo mbikëqyrej nga ana e një përfaqësuesi të Bashkimit Evropian përsëri kompetencat në pjesën më të madhe të aktiviteteve ishin bartur tek Qeveria e Kosovës. Nisur nga kjo, edhe në fushën e politikave fiskale u bënë disa ndryshime që në atë kohë u duk se ishin mjaft substanciale dhe do kishin rëndësi në zhvillimin e ekonomisë, gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe që si synimi parësor ishte thithja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta të cilat janë shumë të rëndësishme për ekonominë e çdo vendi.

Duke pasur parasysh se çdo ekonomi ka specifikat e veta dhe politikat fiskale duhen bazuar edhe në to, në Kosovë nuk është ndjekur një gjë e tillë por janë bërë ndryshime të

cilat kanë pasur efekte në norma tatimore duke u përcjellë me ndryshimet që ishin bërë në vendet e regjionit por pa e përcjellë edhe më ndonjë ndryshim tjetër stimulues i cili do të jepte një nxitje të theksuar për bizneset vendore dhe për ato të huaja të cilat mendonin të zhvillonin afarizmin e tyre në Kosovë.

Ndryshimet që janë bërë në fund të vitit 2008 dhe kanë filluar të aplikohen nga janari i vitit 2009 kanë qenë në tri lloje të tatimeve, është zbritur norma e tatimit në të ardhura personale, është zvogëluar tatimi në të ardhura të Korporatave dhe tatimi në dividend që aplikohet deri në atë periudhë me norma prej 20%, është eliminuar dhe aksionarët e korporatave nga ai vit për fitimet e tërhequra nuk paguajnë tatim. Nga ana tjetër kemi ndryshim të normës së tvsh – së e cila deri në vitin 2009 ishte 15% kurse nga viti 2009 ajo rritet për 1%, dhe deri në shtator të vitit 2015 kemi pasur një normë të tvsh-së prej 16% për të gjitha mallrat që shiten në tregun vendor me përjashtim të disa mallrave dhe shërbimeve si shëndetësore dhe ato të industrisë së barnave dhe shitjen e banesave dhe tokave të cilat kanë qenë të përjashtuara nga tvsh-ja.

Pas krizës ekonomike dhe financiare të vitit 2008 kemi një tkurrje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në pjesën më të madhe të ekonomisë botërore e cila u manifestua edhe në ekonominë Evropiane dhe të Ballkanit prandaj shumica e vendeve të Ceftas, organizëm që përbëhet kryesisht nga vendet e Ballkanit që orientim kanë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, bën disa ndryshime të politikave fiskale kryesisht zvogëlimin e normave tatimore në tatimet e drejtpërdrejta të cilat synim primar kishin tërheqjen e investimeve të huaja. Nisur nga kjo situatë, siç u tha më lart edhe Kosova bëri disa ndryshime në politikat fiskale të cilat kryesisht ishin në orientim të zvogëlimit të normave tatimore por jo edhe të ofrimit të ndonjë mekanizmi tjetër fiskal apo të natyrës tjetër i cili

do të ndikonte në përballimin e rrethanave që ishin krijuar nga paraqitja e kësaj krize financiare.

Edhe Kosova, për shkak të mos përfshirjes në shumë mekanizma ndërkombëtare financiare apo të natyrës tjetër, shkallës së vogël të pjesëmarrjes së mallrave dhe shërbimeve vendore në tregun e jashtëm ishte më pak e prekur nga kjo situatë por kishte edhe një shkallë të varësisë nga ekonomitë kryesisht nga ndikimi i krizës të vendeve të Evropës Perëndimore. Shkak ishte zvogëlimi i prurjes së mjeteve financiare nga mërgata e qytetarëve Kosovarë të punësuar në vendet e ndryshme të cilët si rezultat i krizës ekonomike të paraqitur tek këto vende ose kishin humbur vendet e tyre të punës ose kishin zvogëlim të ardhurave të tyre që realizonin në këto vende.

Duke shqyrtuar ndikimin e tarifave doganore në rritjen ekonomike, Knight (1993) kanë provuar se: niveli i tarifave mbi mallrat kapitale dhe të ndërmjetme ka një efekt të ndjeshëm në rritjen ekonomike; vendet me tarifa më të ulëta rriten më shpejt se ato, që aplikojnë tarifa të larta. Prandaj nisur nga kjo, edhe në Kosovë, si në shumë vende të tjera përreth u bë zvogëlimi i normave tatimore dhe ishin përafërsisht të njëjta me normat e tatimit në Korporata që aplikohesh në Shqipëri, Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni kurse tvsh-ja kishte disa dallime pasi tek disa vende aplikohesh një normë standarde kurse tek disa vende të tjera aplikohesh një normë standarde e tvsh-së dhe një normë e ulët për prodhime të konsumit të gjerë të cilat kanë ndikim substancial në jetën e përgjithshme të popullatës pasi janë prodhime apo shërbime që konsumohen në masë më të madhe. Më poshtë paraqesim tabelën me tri lloje të tatimeve të aplikuara në këto vende të cilat marrin pjesë në krijimin e të ardhurave tatimore tek pjesa dërmuese e këtyre vendeve dhe atë tatimit në të ardhura të korporatave , tatimit në të ardhura personale si dy lloje të tatimeve të drejtpërdrejta dhe

Tvsh si tatim jo i drejtpërdrejtë i cili llogaritet në konsum dhe ka pjesëmarrjen më të madhe në të hyrat tatimore në shumicën e vendeve në të cilat aplikohet.

Tabela Nr. 9 – Norma Tatimore në vendet ndryshme të CEFTA-s pas vitit 2009

SHTETI	TAK	TAP	TVSH
Kosova	10	10	16
Shqipëria	10	10	20
Serbia	10	14	8 & 18
Mali i Zi	9	15	17
Bosnja dhe Hercegovina	30	15/25	7 & 17
Kroacia	20	15-45	22
Maqedoni	12	12	5 & 18
Moldavia	15	10 - 22	5/8/20

Burimi: Legjislacionet tatimore të shteteve të CEFTA-s

Nëse krahasojmë pragun e TVSH me vendet e rajonit dhe me vende të OECD Kosova deri në vitin 2015 ka pasur pragun i cili ishte nga më të lartit dhe i afrohet pragut të vendosur në Britaninë e Madhe, Japoni, Irlandë dhe Poloni. Gjithashtu deri në vitin 2015 nuk pasur norma të shkallëzuara të TVSH ndërsa ky tatim konsiderohet se është tatimi i cili më së shumti ndikon në luftën kundër ekonomisë jo formale që në Kosovë është mjaft shqetësuese dhe sipas disa hulumtimeve sillet deri në 30%. Prandaj me të drejtë mund të thuhet se politika të dobëta fiskale dhe progresi ekonomik i bazuar më shumë në ndihmën e donatorëve dhe mjetet që vinin nga mërgata, janë probleme të cilat nuk sigurojnë një strategji të qëndrueshme ekonomike. Menaxhimi i Politikave fiskale mund të konsiderohet

se është çelës i suksesit ekonomik, i rritjes së PBB duke ndikuar në zhvillimin e sektorit privat, orientimin e bizneseve në sektorë primarë, rritjen e eksportit dhe konkurrencës në treg dhe njëkohësisht mbulimin e qëndrueshëm sistematik dhe pa pengesa të shpenzimeve publike dhe mirëqenien e qytetarëve. Prandaj rëndësi të veçantë ka identifikimi i modeleve më të përshtatshme, brenda strukturës fiskale, pra përzgjedhja e modelit i cili i përshtatet politikave primare dhe synimeve afatgjata për zhvillimin e ekonomik të vendit.

Duke e ditur se vlera e ulët e eksporteve nga Kosova vjen si rezultat i prodhimit vendor në shkallë të ulët, kjo imponon një nivel të lartë të importit, për të përmbushur nevojat e konsumit. Krahas nevojës për rritje të prodhimit, rritja e eksportit, po ashtu, kërkon rritjen e produktivitetit në prodhimin ekzistues, në mënyrë që prodhimet tona të jenë sa më konkurruese në tregjet e jashtme. Sidoqoftë, rritja e prodhimit vendor dhe veçanërisht e eksporteve, në kushte të globalizimit, kur evoluimi teknologjik dhe inovacionet në procesin e prodhimit kanë marrë hov në zhvillim nënkupton një proces jo të lehtë, i cili nuk varet vetëm nga mundësia për të prodhuar, por edhe nga aftësia për të konkurruar si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Për këtë arsye, rritja e prodhimit dhe eksporteve kërkon një bashkëveprim edhe më të madh ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve tjera në vend, për të siguruar rritjen e nivelit të përgjithshëm të produktivitetit të fuqisë punëtore, e cila do të ndikonte në rritjen e efikasitetit dhe konkurrencës së industrisë vendore. Rritja e produktivitetit padyshim nënkupton një proces të gjatë, i cili fillon nga rritja e cilësisë së arsimimit bazik deri te programet më të avancuara për nxitjen hulumtimeve zhvillimore, të cilat janë parakusht për zhvillimin e inovacioneve dhe rritjen e konkurrencës së produkteve të prodhuara në atë ekonomi. Në fakt, një prej rregullave, të cilat duhet të aplikohen lidhur me rritjen e

konkurrencës në aspektin e përgjithshëm e veçanërisht të rritjes së konkurrencës së faktorit njerëzor dhe e pranuar globalisht, ka të bëjë me nevojën për investime thelbësore në shkollim dhe në trajnim permanent të fuqisë punëtore (të gjitha veprimet këtu mund të merren përmes modeleve të politikës fiskale në shpërndarje dhe shpenzime buxhetore).

Thënë kështu, grumbullimi i të hyrave dhe orientimi i shpenzimeve duke siguruar rritje ekonomike është e lidhur ngushtë me rritjen e aftësisë sonë për të rishikuar ose ri dizajnuar modelin e deritashëm të zhvillimit ekonomik të vendit, përmes vendosjes së instrumenteve adekuate, të përshtatshme të politikës fiskale.

Përkundër rritjes së lehtë ekonomike, niveli aktual i PBB në Kosovë në vitin 2012 ishte 4.2 miliardë euro, dy herë më pak se Shqipëria dhe IRJM-së dhe tri herë më pak se Bosnja dhe Hercegovina (BQK 2012). Varfëria mbetet problem në Kosovë, bazuar në raportet e ESK-së, niveli i papunësisë në Kosovë është rreth 43% kur 34% e njerëzve jetojnë në varfëri me më pak se 1,41 euro në ditë, 18% jetojnë në varfëri të skajshme. Numri i hyrjeve të reja në tregun e punës është shumë i lartë në krahasim me vendet në rajon. Vlerësohet se numri i të rinjve që hyjnë çdo vit në tregun e punës është i tillë që kërkohet së paku një rritje reale ekonomike prej 7.0% vetëm për të filluar absorbimi i këtyre hyrjeve të reja dhe për të kontribuar në uljen e numrit të madh ekzistues të papunëve. Ne sot kemi një rol relativisht të dobët të sektorit privat, një de balancë të madhe tregtare ku importet dominojnë dukshëm eksportet dhe ku eksportet dominohen kryesisht nga metalet dhe mineralet bazë të prodhuara nga kompanitë e mëdha. Për shkak të mjedisit jo të favorshëm për biznes dhe në mungesë të kulturës kreative ndërmarrësish, Kosova ka mungesë të firmave zbuluese me rritje të shpejtë, të cilat janë kontribuuesit kryesorë në krijimin e vendeve të punës në ekonominë e zhvilluara perëndimore. Kësaj gjendje të

pafavorshme i prin edhe struktura ekonomike e bizneseve në Kosove e cila është jashtëzakonisht e pavolitshme nga numri total i bizneseve aktive. Në bazë të statistikave mbi 50% operojnë në sektorin tregtar që karakterizohet me investime të vogla dhe joproduktive. Kjo strukture kufizon kapacitetin e sektorit privat për gjenerimin e vendeve të punës.

Si në të gjitha vendet e tjera, edhe në Kosovë, të hyrat buxhetore mblidhen nga të hyrat tatimore dhe të hyrat jo tatimore dhe mblidhen nga dy nivele:

- Niveli qendror merret me mbledhjen e të hyrave tatimore dhe doganore ku Dogana mbledhë të hyrat në kufi nga taksat doganore, akciza dhe tvsh në importe dhe brenda vendit nga akciza në aparate të lojërave të fatit dhe akciza që duhet të paguajnë bizneset vendore që merren me prodhimin e alkoolit apo edhe të lëngjeve me bazë gazit.
- Nga ana tjetër Administrata Tatimore e Kosovës si mbledhës i dytë i të hyrave buxhetore, merret me mbledhjen e të hyrave tatimore brenda vendit siç janë tatimi në të ardhura personale, tatimi në burim në të ardhura personale, tatimet e mbajtura në burim në dividendë, lojëra të fatit dhe qira, tatimin e vlerës së shtuar në qarkullimin brenda vendit si dhe tatimin në të ardhura të korporatave. ATK bën edhe mbledhjen e kontributeve për pensione që duhet të paguajnë të gjithë të punësuarit dhe shoqëritë tregtare, por këto janë të hyra që derdhen në Trustin e Kursimit të Pensioneve i cili menaxhon këto mjete.

Nga niveli qendror kemi edhe të hyra jo tatimore të karaktereve të ndryshme të cilat mblidhen nga ana e Ministrive për dhënien e lejeve dhe licencave për biznese dhe individë.

Nga ana tjetër niveli lokal që është i organizuar në Kosovë në nivel të Komunave, si të hyra tatimore ka të hyrat nga tatimi në pronë me të cilat administrojnë në mënyrë të pavarur dhe të hyrat të cilat i krijojnë nga taksat dhe licencat e tjera të cilat paguajnë qytetarët dhe bizneset e ndryshme për shërbimet që u ofrojnë atyre komunat. Edhe me këto taksa dhe pagesa të tjera që bëhen nëpër komuna, ato në mënyrë të pavarur, menaxhojnë dhe i shfrytëzojnë për nevoja të komunitetit që jeton në to. Duke pasur parasysh se këto të hyra të mbledhura nga niveli lokal nuk u mundësojnë komunave që të realizojnë në mënyrë të pavarur funksionimin e të tyre, atëherë gjatë përgatitjes së buxhetit nga ana e Ministrisë së Financave iu jepen të ardhura shtesë dhe varësisht nga rezultatet e komunave në mbledhjen e të hyrave të tyre ato mund të përfitojnë edhe grande shtesë për projekte kapitale brenda territorit të komunës.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës janë ndërmarrë disa reforma në sferën fiskale. Kështu në vitin 2009 kemi disa ndryshime që kishin të bënin me zvogëlim të normave tatimore, kryesisht ato të tatimit në të ardhura personale dhe korporata, të cilat u zvogëluan nga 20% në 10% me qëllim të zgjerimit të bazës tatimore dhe të rritjes së efikasitetit të mbledhjes të ardhurave tatimore brenda vendit. Si rezultat i kësaj reforme, nga viti në vit, kemi edhe rritjen e të ardhurave tatimore që mbledhen brenda vendit por që edhe kjo ende është shumë larg nga të ardhurat që mund të mbledhen të cilat do të arriheshin në rast të një shtrirje më të gjerë të tatimpaguesve. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, të nxjerra nga të dhënat e ATK japim një pasqyrë mbi llojet e tatimeve të brendshme që administrohen nga niveli qendror që është ATK dhe të hyrat e mbledhura në periudhën e analizuar nga viti 2009 deri në 2016.

Tabela Nr. 10 – Të hyrat e realizuara nga tatimet brenda vendit

Vlerat në 000 Euro


Lloji i Tatimit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Tatimi i paragj.	2,722	443	875	409	70	-----	-----	-----
Tatimi ne fitim	7,731	466	1,805	117	163	-----	-----	-----
Tvsh	83,198	113,046	122,327	131,394	149,000	136,939	155,153	180,363
Tatimi ne paga	36,356	33,710	56,075	60,752	61,962	67,875	72,081	80,327
Tatimi ne Bi	24,684	25,762	3,689	26,202	28,309	33,080	30,759	33,161
Tatimi në interes, qira	15,715	11,741	1,385	1,648	1,650	10,499	6,399	11,254
Tatimi ne korporata	36,279	36,414	54,963	63,372	64,110	55,318	67,894	81,278
Totali	206,681	221,585	261,123	283,898	305,451	303,695	332,281	386,385

Burimi : ATK, Raporti i punës për vitin 2010, faqe 8; Raporti i punës për vitin 2013 faqe 9 dhe raporti i punës për vitin 2016

Mbi tatimet e paguara dhe llojet e tyre në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2013 do ti paraqesim edhe në mënyrë grafike ku do të shohim grafikisht mbi lëvizjet e pagesave për lloje të ndryshme të tatimeve në periudhën e cekur më lart.

Më poshtë japim paraqitjen grafike të tatimeve të paguara.

Grafiku Nr. 1 – Paraqitja grafike e të hyrave të realizuara nga ATK nga viti 2009 deri në vitin 2016



Nëse krahasojmë pjesëmarrjen e të hyrave tatimore të mbledhura si në kufi ashtu edhe brenda vendit ajo është si më poshtë në vitet e analizuara:

Tabela Nr. 11 – Krahasimi i të hyrave tatimore me të hyrat totale Vlerat në 000,000 Euro

Emërtimi / Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të hyrat nga tatimet në kufi	532	604	634	6 99	8 26	8 42	834	872	952	1,035
Të hyrat nga tatimet brenda	182	201	182	1 94	2 31	2 51	271	307	332	386
Të hyrat totale tatimore	714	805	816	893	1057	1093	1105	1179	1284	1,421
Totali i të hyrave	915	989	1,161	1 ,195	1 ,313	1,551	1,445	1,462	1,707	1,778
% e të hyrave tatimore në të hyrat totale	78.03	81.40	68.28	74.72	80.5	70.47	76.47	80.64	75.21	79.92

Burimi: Autori (2017) Të dhënat e përpunuara nga tabelat paraprake

Nga të dhënat e paraqitura më lart shohim se të hyrat tatimore në buxhetin e përgjithshëm në Kosovë marrin pjesë nga 68.28 % në vitin 2009 deri në 81.40 vlera më e madhe në vitin 2008 por nëse krahasohet kjo pjesëmarrje me hyrat tatimore te vendet e BE shohim se atje të hyrat tatimore në buxhet marrin pjesë në të ardhurat nga tatimet me 58.2 % dhe të ardhurat nga kontributet shoqërore me 31.1 % kurse pjesa tjetër janë të hyra jo tatimore e që nga ky raport shihet se ka dallim të madh me rastin e Kosovës pasi në Kosovë, përveç mjeteve që ndahen për pension, të cilat nuk kanë asnjë ndikim në buxhetin e shtetit ende nuk aplikohet asnjë kontribut shoqëror i cili siç shihet nga të dhënat merr pjesë me një vlerë të konsiderueshme në të ardhurat e përgjithshme buxhetore të vendeve të BE. Nga të dhënat e paraqitura nga ana e ATK-së në raportet e tyre për vite të ndryshme shohim se në përgjithësi të hyrat për lloje të ndryshme të tatimeve janë rritur nga viti në vit. Në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009 janë rritur për 7.21% raporti në mes të

221,585,852 më 206,681,573 kurse ato të vitit 2012 ndaj 2011 janë rritur për 17.84 % ; ato të vitit 2012 ndaj vitit 2011 janë rritur për 8.72% kurse rritja e të hyrave nga viti 2013 në krahasim me vitin 2012 është për 7.59%.

Nisur nga fakti se në shumë shtete të zhvilluara përveç tatimit në qarkullim respektivisht tvsh-së edhe të tatimit në paga dhe tatimit në të ardhura të individëve zënë një vend të rëndësishëm në politikat fiskale. Këtu është inkurajuese se kemi një rritje të tatimit në paga nga viti në vit dhe kjo rritje në periudhën krahasuese 2013 me vitin 2009 është 25,605,062.00 Euro, apo shprehur në përqindje kemi një rritje prej 70.42%.

Nëse krahasojmë rritjen e të hyrave të mbledhura brenda vendit për periudhën nga viti 2013 me vitin 2009 atëherë kjo rritje e të hyrave tatimore brenda vendit është 47.78 % kurse rritja e të ardhurave të prodhimit vendore bruto për periudhën nga viti 2013 në krahasim me vitin 2009 sipas raporteve të Bankës Qendrore të ishte 16.5% dhe rritja e PBB në vitin 2009 ishte 3.5%, në vitin 2010 ishte 3.2%, në vitin 2011 ishte 4.5% , në vitin 2012 ishte 2.9% dhe në vitin 2013 ishte 3.4%.

Pra nëse krahasojmë rritjen e të hyrave tatimore brenda vendit në periudhën krahasuese që ishte 47.78 % në krahasim me rritjen e prodhimit brenda vendit prej 16.5% kemi një rritje prej 2.89 herë. Por edhe përkundër kësaj rritje ende pjesa më e madhe e të hyrave realizohen brenda pikave kufitare dhe nga raportet e doganës. Në tabelën në vijim shohim se si ka qenë rrjedha e të hyrave nga viti 2009 deri në vitin 2016 nëpër pikat doganore dhe akcizës në kufi dhe brenda vendit.

Nga kjo në konstatojmë se edhe pse në periudhën e studiuar rritja ekonomike ishte vetëm 16.5% të ardhurat buxhetore në po të njëjtën periudhë janë rritur afër 50% dhe tregon se në vjeljen e të ardhurave ka probleme apo kemi rritje të ngarkesës tatimore dhe doganore për


periudhën krahasuese pasi kemi një diferencë mjaft të madhe në mes të këtyre dy pozicioneve mjaft të rëndësishëm dhe që përcaktojnë edhe rritjen ekonomike të një vendi e në këtë rast rritjen e Kosovës dhe bizneseve të saj si bartës të zhvillimit ekonomik.

Tabela Nr. 12 – Të hyrat e realizuara nga pikat kufitare								Vlerat në 000 Euro
Lloji i tatimit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Taksa doganore	98,312	104,090	121,100	117,200	120,100	126,300	131,400	
Akciza	206,917	232,500	284,500	302,900	300,900	315,400	360,600	
Tvsh - ja	252,464	419,500	361,300	417,800	412,200	423,900	456,500	514,461
Të hyrat tjera	2,147	2,200	2,200	4,600	3,700	5,080	3,300	
<i>Totali i të hyrave</i>	<i>635,038</i>	<i>700,030</i>	<i>27,100</i>	<i>844,800</i>	<i>838,400</i>	<i>871.800</i>	<i>951,800</i>	

Burimi: Raporti vjetor i doganës për vitin 2009, faqe 14; viti 2011 faqe 6; Viti 2014 faqe 5 viti 2016

Kurse në grafikun më poshtë paraqesim në mënyrë grafike diferencën në mes të hyrave të mbledhura në kufi.

Grafiku Nr. 2 – Paraqitja grafike e të hyrave të mbledhura nga pikat doganore



Nga të dhënat e paraqitura më lart shihet se nga viti në vit kemi rritje të të hyrave në pikat kufitare dhe kjo rritje shprehur në përqindje është 10.23% në vitin 2010 ndaj vitit 2009, rritje prej 18.15 % në vitin 2011 ndaj 2010, rritje e të hyrave kufitare prej 2.14% në viti 2012 ndaj 2011 dhe kemi zvogëlim të hyrave kufitare në vitin 2013 ndaj 2012 prej 0.76%.

Të hyrat doganore në periudhën krahasuese në vitin 2013 ndaj 2009 janë rritur në total prej 32 % pra kemi një rritje më të vogël të hyrave të mbledhura në kufi me ato vendore ku siç u tha më lart gjatë kësaj periudhe krahasuese të hyrat e mbledhura nga niveli qendror për tatime janë rritur për 47.78% në krahasim me rritjen e të hyrave në doganë në vlerë prej 32%.

Por dëshpëruese ende është se tvsh që merr pjesën më të madhe të hyrave buxhetore të Kosovës, akoma mblidhet në kufi si rezultat i importit të mallrave dhe shërbimeve e shumë më pak brenda vendit si rezultat i aktivitetit ekonomik të shtuar respektivisht rritjes së nivelit të prodhimit brenda vendit i cili do të ndikonte në masën më të madhe në rritjen e përgjithshme ekonomike.

Tabela Nr. 13 – Krahasimi i tvsh- së të mbledhur brenda vendit në krahasim me tvsh –në e mbledhur në kufi nga viti 2009 deri në vitin 2016 **Vlerat në 000 Euro**


Lloji i tatimit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Tvsh – ja në kufi	252,464	419,500	361,300	417,800	412,200	423,900	456,500	514,461
Tvsh –ja brenda	83,198	113,047	122,327	131,395	149,185	136,939	155,154	180,363
Diferenca	169,265	306,453	238,973	286,405	263,015	286,961	301,346	334,098

Burimi: Autori (2017)

Pra nga tabela e paraqitur më lart dhe paraqitja grafike që do të bëhet më poshtë lidhur me diferencat në mes tvsh-së të mbledhur në kufi dhe asaj të mbledhur brenda vendit,shohim

se ato janë të mëdha dhe gjithmonë janë rreth 250 milion Euro. Kjo dëshmon se Kosova gjithsesi duhet të orientohet drejt krijimit të vlerës brenda vendit apo në një ardhme të afërt me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese të bizneseve që zhvillojnë aktivitet, mbledhja e tvsh – së të kalohet nga kufiri brenda vendit. Kjo mund të bëhet nëse rritet disiplina fiskale dhe organet shtetërore përgjegjëse për implementimin e politikave fiskale rritin dhe trajnojnë burimet e veta njerëzore dhe teknologjike për implementimin e legjislacioneve që gjithsesi duhet të ndryshohen dhe këtë në të mirë të ekonomisë si tërësi dhe shtetit si bartës i përgatitjes së legjislacionit fiskal dhe legjislacionit tjetër që është më se i domosdoshëm për ndryshime për shkak të këtyre raporteve.

Grafiku Nr. 3 - Paraqitja grafike e tvsh-së të mbledhur në kufi me tvsh-në e mbledhur brenda vendit



Burimi: Autori (2017)

Nga tabela më lart shohim se tvsh, si tatim indirekt në qarkullim, ende në pjesën më të madhe mbledhet në kufi dhe kjo diferencë është shumë e madhe dhe tregon se ekonomia

si tërësi ende varet kryesisht nga importi pasi ka shumë pak vlerë të re të krijuar brenda vendit dhe kjo shprehet edhe në të hyrat buxhetore të realizuara.

Tvsh ja totale e mbledhur si në kufi ashtu edhe brenda vendit është e paraqitur në tabelën në vijim dhe nga këto krahasime shohim se si tvsh e mbledhur në kufi ashtu edhe ajo e mbledhur brenda vendit nga viti në vit ka rritje dhe kjo rritje për periudhën nga viti 2013 në krahasim me vitin 2009 si periudhë krahasuese pas ndryshimeve të pakos fiskale është shprehur në mjete monetare prej 159,735, 575 kemi rritje të tvsh të mbledhur në kufi apo shprehur në përqindje është 63.27%.

Tvsh e mbledhur brenda vendit në periudhën krahasuese ka rritje në vlerë monetare prej 65,986,292 euro apo shprehur në përqindje 79.31 %. Pra edhe pse rritja e shprehur në përqindje ndërmjet tvsh-së të mbledhur brenda vendit nga ajo në kufi ka rritje prej 16.04% përsëri shprehur në vlera monetare ende është diferencë e madhe në mes të tvsh-së të mbledhur në kufi me atë të mbledhur brenda vendit.

Tabela Nr. 14 – TVSH totale të mbledhura në kufi dhe brenda vendit Vlerat në 000 Euro

Lloji i tatimit	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Tvsh-ja në kufi	252,464	419,500	361,300	417,800	412,200	423,900	456,500	514,461
Tvsh-ja brenda	83,197	113,047	122,327	131,394	149,184	136,939	155,154	180,363
Totali	335,663	532,547	483,627	549,194	561,384	560,839	611,654	694,824
Tvsh-brenda %	24.78 %	21.22 %	25.29 %	23.92 %	26.57 %	24.41 %	25.36%	25.95 %

Burimi: Autori (2017) Krahasimet nga tabelat paraprake

Tvsh-ja është burimi kryesor i të ardhurave buxhetore por edhe pse ka ngritje në vlerë nominale të tvsh-së të mbledhur brenda vendit, nga viti në vit, përsëri në raportin ndërmjet të tvsh-së të mbledhur brenda vendit në krahasim me atë të mbledhur në kufi ende kjo

pjesëmarrje është shumë e ulët dhe tregon mbi shkallën e ulët të hyrave të mbledhura brenda vendit. Siç shihet në tabelën e paraqitur më lart ajo sillet nga 24.78 % që ishte në vitin 2009 deri në 26.57% që ishte pjesëmarrja më e madhe e këtij tatimi të mbledhur në vitin 2013 .

3.1.9 Reforma fiskale e vitit 2015 dhe ndryshimet tjera që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve

Qeveria e Kosovës pas vitit 2013 me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes bëri disa reforma të cilat ndikuan që edhe Kosova të ketë ngritje në të bërit biznes sipas raportit bankës botërore por vetëm në vitin 2015 aplikoj pakon fiskale të ashtuquajtura pako fiskale një sipas së cilës pako u bënë një numër i caktuar i ndryshimeve fiskale të cilat si qëllim kryesor kishin rritjen ekonomike të vendit veçanërisht rritjen e prodhimit vendor i cili sot ë ndikonte një zbutjen e pa barazisë tregtare që ka Kosova.

Ndryshimet kryesore që u bënë me këtë pako fiskale ishin:

Lirimet për pagesë të tvsh-së në kufi për një numër të caktuar të lëndës së parë që përdorej në prodhim

Lirimet për pagesë të tvsh-së për makineri

Zvogëlimi i pragut për regjistrim në tvsh nga 50,000.00 Euro në 30,000.00 Euro

Përshkallëzimi i Tvsh-së ku norma standarde e tvsh-së që ishte 16 % ishte rritur në 18 % por për një numër të prodhimeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në standardin e popullatës aplikohet norma e ulët e tvsh-së prej 8 %.

3. 1.10 A duhet të eliminohet pragu për regjistrim në tvsh në Kosovë ?

Tatimi i vlerës së shtuar si tatim indirekt merr pjesën më të madhe të hyrave që mblidhen nga Administrata Tatimore. Pragu i limitit të regjistrimit në Kosovë nga 50,000.00 Euro qarkullim vjetor nga shtatori i vitit 2015 është zvogëluar në 30,000.00 Euro që do të thotë se të gjitha bizneset dhe personat fizikë që kanë qarkullim mbi 30,000.00 Euro brenda vitit duhet të regjistrohen si deklarues të tvsh-së.

Kështu pjesëmarrja e tvsh-së së paguar në krahasim me totalin e tatimeve të mbledhura nga ATK – ja sipas raporteve të dorëzuara nga ATK-ja është si në vijim

Tabela Nr. 15 – Të hyrat tatimore për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2016 Vlerat 000

Tatimi/ Viti	2014	2015	2016	%
Tatimi i vlerës së shtuar	136,939,023	155,153,654	180,363,400	46.7
Tatimi i mbajtur në burim në paga	67,875,126	72,081,313	80,327,270	20.8
Tatimi për biznese Individuale	33,080,529	30,759,022	33,161,625	8.6
Interes, Qira dhe drejta pronësore	10,499,342	6,393,399	11,254,117	2.9
Tatimi në korporata	55,318,972	67,893,662	81,278,873	21.0
Gjithsej	303,712,992	332,281,059	386,385,285	100.0

Burimi: ATK, Raporti vjetor 2016

Duke pasur parasysh se rreth këtij pragu dhe faktit se a duhet të ketë fare prag për regjistrim në tvsh zhvillohen diskutime nga të dhënat sekondare të pranuar nga ATK- ja është analizuar qarkullimi total i deklaruar nga të gjitha bizneset, qarkullimi total i deklaruesve të tvsh-së, pagesat totale të tvsh-së, pjesëmarrja e tvsh-së paguar në qarkullimin e deklaruesve të tvsh –së dhe nga këto të dhëna ne kemi paraqitur se cilat do të ishin të hyrat buxhetore që mund të mblidhen nëse nuk do të kishte fare prag për regjistrim

në tvsh dhe a do të ishte në interes të buxhetit të Kosovës dhe të bizneseve që mos të ketë fare prag të regjistrimit në tvsh.

Në tabelën në vijim paraqesim qarkullimin total të deklaruesve të tvsh-së dhe pjesëmarrjen e tvsh-së paguar në qarkullimin total.

Tabela Nr. 16 – Qarkullimi dhe pagesat e deklaruesve të TVSH-së

Viti / Qarkullimi	2013	2014	2015	2016
Qarkullimi deklaruesit e tvsh-së	7,495,889,960	7,569,508,444	8,346,902,234	8,997,831,282
Tvsh e paguar	149,184,989	136,939,023	155,153,654	180,363,400
Pjesëmarrja e tvsh-së paguar në qarkullim	1.99 %	1.81 %	1.86 %	2.00 %

Burimi: Atk -2017

Nga qarkullimi total i deklaruar në ATK dhe qarkullimi i deklaruesve të tvsh – së kemi nxjerrim qarkullimin e bizneseve që nuk janë deklarues të tvsh dhe duke u bazuar në pjesëmarrjen e tvsh-së së paguar në qarkullimin total të tyre kemi konstatuar se cili do të ishte ndikimi në të hyrat buxhetore nëse nuk do të kishte prag për regjistrim të tvsh- së.

Tabela Nr. 17 – Krahësimi i qarkullimit total dhe qarkullimi të deklaruesve të tvsh-së të deklaruar në tvsh dhe pagesat e tatimeve

Viti / Qarkullimi	2013	2014	2015	2016
Qarkullimi total	7,696,241,399.00	7,776,409,135.00	8,545,834,314.00	9,187,505,571.00
Qarkullimi deklaruesit e tvsh-së	7,495,889,960.00	7,569,508,444.00	8,346,902,234.00	8,997,831,282.00
Qarkullimi i bizneseve jo deklarues të tvsh-së	200,351,439.00	206,900,691.00	198,932,181.00	189,674,289.00
Pjesëmarrja e tvsh-së paguar në qarkullim	1.99 %	1.81 %	1.86 %	2.00 %
Të hyrat që mund të mbledhen	3,987,442.00	3,743,014.00	3,697,785.00	3,802,060.00

Burimi: Autori, (2018)

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe gjithnjë duke u bazuar nga të dhënat e pranuar nga ATK-ja dhe duke krahasuar me pjesëmarrjen e tvsh-së paguar në ATK me qarkullimin e deklaruesve të tvsh-së konstatojmë se në rast se nuk ka prag për regjistrim të tvsh-së ndikimi buxhetor do të ishte të ishte afër 4,000,000.00 Euro prandaj konsiderojmë se efektet e regjistrimit të gjithë bizneseve në tvsh nuk do të ishin produktive për argumentet si në vijim ngase:

- Vlera e tvsh – së që mund të mblidhet nga të gjitha bizneset nuk ka ndonjë ndikim të madh në të hyrat totale që mblidhen nga ATK-ja.
- ATK- nuk ka kapacitete të mjaftueshme për kontrollimin e të gjithë bizneseve dhe të mund të ndodhte në vend që të orientohehin në biznese të mëdha një pjesë e kapaciteteve të saj të angazhohej në biznese shumë të vogla.
- Do të ishte një kosto shtesë për biznese shumë të vogla si në pagesën e tvsh-së por edhe në angazhimin e profesionistëve për mbajtje të evidencës kontabël
- Atk do të duhej të orientohej më shumë në përmbushjen e detyrimeve të bizneseve që janë deklarues të tvsh- së dhe të bizneseve që janë afër pragut të tvsh-së dhe të cilët bëjnë shmangie tatimore me qëllim duke mos deklaruar xhiron reale të tyre me të vetmin qëllim që të mos regjistrohen si deklarues të tvsh-së.

3.1.11 Barra tatimore në Kosovë dhe disa vende të Ballkanit

Tatimet janë detyrime për pagesë ku personi dhe ndërmarrja që paguan tatimet nuk merr një përfitim të drejtpërdrejtë nga shteti. Varësisht nga normat tatimore dhe politikat fiskale që aplikohen në vendet e ndryshme kemi edhe detyrimet që bien në barrë të tatimpaguesve për pagesë.

Barra tatimore është shuma totale e tatimeve të paguara si dhe detyrimeve tjera duke përfshirë detyrimet për dogana, akciza apo edhe obligimeve tjera dhe të sigurimeve shoqërore të cilat paguhen nga një grup i caktuar i tatimpaguesve dhe i cili krahasohet me një grup tjetër të tatimpaguesve.

Dihet se secili vend përcakton sistemet e ndryshme tatimore të cilat bazohen me kapacitetet e atij sistemi duke përfshirë barrën tatimore për tatimpaguesit, si shpërndarjen e tatimeve si dhe mënyrën se si bëhet përshtatja e ngarkesës fiskale sipas peshës dhe kontributeve të tyre në investimet publike. Gjithashtu me rëndësi është që barra tatimore të jetë në përputhje me faktorët e ndryshëm ekonomik ngase politikat fiskale dhe ngarkesat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhet të cilat arrihen nëpërmjet politikës tatimore, doganore dhe politikave të tjera sociale që ndjekin shtetet e ndryshme dhe të cilat kanë për qëllim nxitjen ambientit ekonomik dhe që rritja e të ardhurave buxhetore mund të stimulojnë zhvillimin e aktivitetit të biznesit dhe me te edhe rritjen ekonomike apo mund të ndodhë e kundërta që aplikimi i ngarkesave të mëdha fiskale do të ndikonin në rënien e aktivitetit biznesor.

Më poshtë japim normat tatimore në vendet e Ballkanit në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2016.

Tabela Nr. 18 – Normat mesatare tatimore në Ballkan

Shteti / Viti	2014	2015	2016
Maqedonia	7.4	12.9	13.0
Kosova	15.3	15.2	15.20
Kroacia	18.8	20.0	20.9
Mali i Zi	22.3	21.6	22.2
Bosnja dhe Hercegovina	23.3	23.3	22.6
Bullgaria	27.0	27.0	27.0
Shqipëria	30.7	36.5	36.5
Serbia	38.6	39.7	39.7
Rumani	43.2	42.0	38.4
Greqi	49.9	49.6	50.7

Burimi: World Bank, 2017

Nga tabela e paraqitur më lartë shihet se normat më të vogla tatimore prej vendeve të Ballkanit ka në Maqedoni, pastaj në Kosovë kurse normat më të larta tatimore janë në Rumani dhe Greqi si vende të Bashkimit Europian.

Përpos normave tatimore të aplikuara ka dallim në vendet e Ballkanit norma tatimore me barrën tatimore fiskale ku në disa vende më e madhe është ngarkesa fiskale se sa normat tatimore kurse në disa të tjera e kundërta.

Në tabelën më poshtë paraqesim dallimet në mes të normave tatimore dhe ngarkesës fiskale

Tabela Nr. 19 – Dallimet në mes të normave tatimore dhe ngarkesave fiskale në vendet e Ballkanit në vitin 2016

Shteti / Viti	Barra Tatimore sipas normës tatimore 2016	Barra Tatimore sipas pagesës së taksave 2016
Maqedonia	13.0	25.6
Kosova	15.20	23.5
Kroacia	20.9	38.1
Mali i Zi	22.2	38.2
Bosnja dhe Hercegovina	22.6	37.8
Bullgaria	27.0	28.6
Shqipëria	36.5	24.4
Serbia	39.7	36.0
Rumani	38.4	29.6
Greqi	50.7	40.6

Burimi: World Bank, 2017

3.2 Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve totale në Buxhetin e Kosovës dhe krahasimi me PBB

Siç u tha edhe më lart ekonomia në pjesën më të madhe bazohej kryesisht në donacionet dhe dërgesat e marra nga diaspora, por në tërësi, pjesën më të madhe të prodhimit të brendshëm bruto nga viti 2001 deri në vitin 2004 e krijonte konsumi si rezultat i donacioneve dhe dërgesave financiare nga mërgata. Të hyrat buxhetore në vitin 2000 ishin vetëm 249 milion kurse PBB në atë vit ishte 2520 milion që d.m.th se pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në PBB ishte vetëm 9.88 %. Nga viti 2000 filloi edhe rritja e të hyrave buxhetore të cilat sado të vogla por merrnin një pjesëmarrje më të madhe në PBB dhe kështu në vitin 2001 të hyrat buxhetore ishin 362.4 milion dhe merrnin pjesë në PBB me 14.8 % dhe deri në vitin 2004 kur në fund të atij viti për herë të parë u bë një reformë apo

më mirë të themi u krijua një legjislacion më i qartë tatimor dhe të hyrat buxhetore ishin 615 milion kurse PBB ishte 2,501 milion apo shprehur në përqindje PBB në vitin 2004 ishte më e vogël se ajo në vitin 2001 për 0.76 % kurse të hyrat buxhetore kishin rritur pjesëmarrjen në PBB në 24.51 % .

Se sa ishte PBB në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2004 dhe nga cilët sektorë vinte rritja më e madhe e saj do ta paraqesim në tabelën në vijim.

Tabela Nr. 20 – Prodhimi i brendshëm bruto nga viti 2001 - 2004			Vlerat në 000,000 Euro	
VITI/ SEKTORI	2001	2002	2003	2004
Sektori privat	2,135	2,090	2,109	2,173
Sektori qeveritar	202	268	351	507
Donatorët / Dërgesat nga jashtë	1,097	869	689	582
Eksporti neto	-914	-780	-735	-761
Totali	2,520	2,447	2,414	2,501

Burimi: Autoriteti Bankar dhe i Pagesave e Kosovës, Raporti vjetor 2005, Qershor 2006 , faqe 39

Pra nga ato që u thanë më lart dhe nga të dhënat e paraqitura në tabelë shohim se nga viti 2001 deri në vitin 2004 PBB për shkak se ekonomia bazohej kryesisht në donacione dhe dërgesat e qytetarëve kosovarë që jetonin dhe punonin jashtë vendit dhe sektori privat si bartës i zhvillimit ekonomik sapo kishte filluar të marrë iniciativat e para në vend kemi rritje ekonomike dhe edhe të PBB kemi zvogëlim të PBB nga viti në vit kështu PBB me e madhe ishte në vitin 2001 kurse në 3 vitet e tjerë pasues ai ishte zvogëluar. Kjo kishte ndodhur edhe për shkak të rënies së vazhdueshme të donacioneve të cilat patën ndikim në rritjen e konsumit në atë periudhë dhe rënia e tyre u bë mjaft shpejt, nga 1,097 milion në vitin 2001 në 582 milion në vitin 2004 apo shprehur në përqindje kemi një rënie prej 53.05%. Rritja më e madhe në prodhimin e brendshëm bruto është bërë nga sektori

qeveritar ku nga 202 milion në vitin 2001 kjo shumë është rritur në 507 milion në vitin 2004 apo shprehur në përqindje 250.99 %.

Pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në prodhimin e brendshëm bruto nga viti 2001 deri në vitin 2004 ishte mjaft e vogël pasi ende konsumi dhe shpenzimet e tjera buxhetore bazoheshin kryesisht nga të hyrat nga donacionet dhe dërgesat në mjete financiare e popullatës që punonin dhe jetonin jashtë vendit.

Tabela Nr. 21 – Pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në PBB në Kosovë nga viti 2001 deri në vitin 2004
Vlerat në 000,000 Euro

VITI / SEKTORI	2001	2002	2003	2004
Prodhimi i brendshëm bruto	2,520	2,447	2,413	2,501
Të hyrat buxhetore	239.5	401.6	542.6	748.5
Përqindja e pjesëmarrjes	9.5	16.41	22.48	29.92

Burimi: Autori (2014)

Nga të dhënat e paraqitura shohim se pjesëmarrja e të hyrave buxhetore në prodhimin e brendshëm bruto kanë shkuar duke u rritur vazhdimisht nga viti në vit. Në periudhën menjëherë pas luftës nga viti 2000 pjesëmarrjen më të madhe në prodhimin shoqëror bruto e kishin mjetet e siguruara nga donacionet e ndryshme por vazhdimisht nga viti në viti donacionet kanë filluar të kenë rënie dhe nga ana tjetër kemi rritje të vazhdueshme të të hyrave buxhetore vetjake të cilat në vitin 2000 ishin vetëm 9% të prodhimit vendor bruto kurse në vitin 2004 ato arritën në 29.92 % të prodhimit vendor bruto.

Gjatë kësaj periudhe kemi edhe një deficit të madh tregtar i cili është si rezultat i mungesës së prodhimit vendor ku kryesisht i tërë aktiviteti ekonomik bazohej në një masë të madhe vetëm në tregti dhe mallrat importoheshin nga vendet e ndryshme e veçanërisht nga ato të regjionit. Struktura në mes të importit dhe eksportit ishte tejet e pavolitshme dhe

kjo tregon edhe njëherë se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë analizë të mirëfilltë me të cilën do të rritej ekonomia vendore nëpërmjet prodhimit. Duke pasur parasysh se ende kishte një sasi të madhe të mjeteve financiare që derdheshin nga donatorët për mbulimin e të dalave buxhetore dhe shpenzimeve të tjera arrihej të mbahej qëndrueshmëria fiskale e cila për politikë bërësit nga Misioni i Unmik-ut ishte primare. Se sa i madh ishte ky deficit tregtar do ta shohim në tabelën në vijim ku shihet se në vitin 2001 importi mbulohej nga eksporti i mallrave dhe shërbimeve me vetëm 1.5 % e cila në vitin 2002 u rrit në mënyrë simbolike në 3.2 %, në vitin 2003 në 3.7 % dhe në vitin 2004 në vetëm 5.3%

Pra gjatë kësaj periudhe edhe në vitet në vazhdim kemi një diferencë të madhe në mes të mallrave që importoheshin dhe atyre që eksportoheshin. Kjo pasi nuk ishte ndërmarrë ndonjë reformë strukturore nga përgjegjësit që në atë kohë ishin nga Misioni i Unmik-ut të.

Buxheti i Kosovës, ende në një masë të madhe bazohet në të hyrat tatimore që merren në kufi, gjatë importimit të mallit dhe në të hyrat tatimore që merren brenda territorit të Kosovës dhe këto janë të hyrat kryesore të buxhetit. Një pjesë tjetër e buxhetit bazohet në të hyrat jo tatimore që merren si nga institucionet e nivelit qendror dhe pjesa tjetër që merren nga niveli lokal. Deri tani në Kosovë nuk shtesë të kontributeve shoqërore si për shëndetësi, mbrojtje të ambientit, papunësi apo ndonjë formë e kontributeve të tjera shoqërore, të cilat do të ndikonin që edhe ndarjet buxhetore për mbrojtje sociale dhe shërbime të tjera të mbrojtjes të popullatës të jenë më të mëdha. Kjo ndodh me vendet e Bashkimit Evropian, ku sipas statistikave të Eurostatit, nga tërë të hyrat buxhetore tek vendet e ndryshme të BE, të hyrat nga kontributet shoqërore merrnin pjesë me 31.1%.

Prandaj vonesat 15 vjeçare në implementimin e kontributeve shoqërore ka patur pasoja të mëdha për popullatën. Këto pasoja janë ndierë veçanërisht në pjesën e mbrojtjes së shëndetit të popullatës dhe në ndarjet buxhetore për mbrojtje të tjera sociale për popullatën për shkak të nivelit të lartë të papunësisë dhe të varfërisë që mbretëron në Kosovë. Nga të dhënat që do të paraqesim mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore nga viti 2007 deri në vitin 2016 do të shohim mbi llojet e të hyrave buxhetore dhe shpenzimet buxhetore në periudhën e cekur më lart dhe pjesëmarrjen e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në PBB. Nga të dhënat e paraqitura në këtë tabelë shohim se deri në vitin 2012 Kosova nuk kishte borxh publik të deklaruar si të jashtëm apo edhe të brendshëm por nga ky vit shihet se mjetet e marra si hua janë të paraqitura si hyrje buxhetore dhe në anën tjetër edhe si detyrime që ka Kosova ndaj vendeve të tjera apo edhe si borxh të brendshëm. Ky borxh është akoma më i vogli në rajon.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë më poshtë shohim se të hyrat buxhetore totale nga viti 2007 kanë qenë 914,882.000 Euro në vitin 2013 janë rritur në 1,445,165.000 Euro në vlerë prej 530,283,000 Euro apo shprehur në përqindje kemi rritje prej 57.96% kurse shpenzimet buxhetore në periudhën e analizuar janë rritur nga 676,086.000 Euro në 1,511,558.000 Euro në vlerë prej 835,472,000 Euro apo shprehur në përqindje 123.57 % që në vlerë rritja e shpenzimeve në periudhën e analizuar në tabelë në krahasim më rritjen e të hyrave ka qenë për 159,386,000 Euro.

Tabela Nr. 22 – Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore nga viti 2007 deri në vitin 2013; 000 Euro

Emërtimi / Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Të hyrat -tatimet në kufi	531,591	604,196	634,146	6 99,385	8 26,592	8 42,787	834,080
Të hyrat -tatimet brenda	182,542	200,834	181,659	1 94,218	2 31,360	2 51,151	270,763
Të hyrat jo tatimore – Niveli Qendror	25,724	29,066	29,657	4 8,451	5 9,912	4 4,835	39,103
Të hyrat jo tatimore - Niveli lokal	29,237	42,784	48,293	5 2,028	5 5,621	5 9,448	55,850
Grandet – të Hyrat tjera dividendë	145,788	112,246	266,942	200,425	139,761	185,404	161,535
Huamarrje e jashtme						93,677	4,634
Huamarrje e brendshme						73,313	79,200
Totali i të hyrave	914,882	989,126	1,160,697	1,194,508	1 ,313,252	1,550,615	1,445,165
Pagat	208,923	228,059	268,925	316,200	3 88,303	4 09,245	418,546
Mallra dhe shërbime	153,403	173,668	319,274	258,567	224,393	231,697	242,703
Subvencionet dhe Shpërndarjet	154,552	210,006	257,767	2 53,484	2 56,476	2 80,317	315,619
Shpenzimet kapitale	159,208	351,651	406,382	4 59,272	5 31,290	5 54,813	534,690
Totali i shpenzimeve	676,086	963,384	1,252,348	1 ,287,523	1 ,400,462	1,476,072	1,511,558
Teprica e vitit	238,796	25,743	(91,652)	(93,015)	(87,209)	74,543	(66,393)
Bilanci akumuluar	449,762	475,505	383,853	290,838	203,629	278,171	2 11,778

Burimi: MFE – Raportet vjetore financiare viti 2007 deri në vitin 2013

Sa i përket të hyrave, rritjen më të madhe e kemi tek të hyrat nga pikat doganore të cilat nga vlera prej 531,591,000 që ishin grumbulluar në vitin 2007 janë rritur në 834,080,000 në vitin 2013 apo një diferencë në vlerë prej 302,489,000 Euro respektivisht 56.90 % kurse të hyrat nga tatimet të mbledhura brenda vendit janë rritur nga 182,542,000 Euro në shumën prej 270,763,000 Euro apo kemi një rritje prej 88,221,000 Euro apo shprehur në përqindje 48.33 %,

Rritje mjaft të madhe jo në vlerë por shprehur në përqindje e kanë të hyrat jo tatimore, ku të hyrat që inkasohen nga niveli qendror janë rritur nga vlera e inkasuar prej 25,724,000 Euro që ishte në vitin 2007 në vlerën e inkasuar prej 39,103,000 Euro apo në vlerë kemi rritje prej 13,379,000 Euro e shprehur në përqindje rritja është 52.00 % , gjithashtu edhe të hyrat jo tatimore nga komunat janë rritur nga vlera e grumbulluar prej 25,724,000 në vitin 2008 në vlerën prej 55,850,000 në vitin 2013 që do të thotë se kemi një rritje në vlerë prej 30,126,000 Euro apo shprehur në përqindje rritje prej 117.11 %.

Nëse analizojmë të hyrat e tjera nga grandet , dividendët që paguajnë bizneset publike për fitimet e realizuara, të hyrat nga fondi i privatizimit për bizneset të cilat kanë përfunduar procedurat e likuidimit nga ana e AKP-së shohim se ato paraqiten përafërsisht në të njëjtin nivel, me përjashtim të vitit 2009, ku kemi një rritje të theksuar e cila ka ardhur si rezultat i pagesës së dividendëve nga PTK. Gjithashtu karakteristikë është se deri në vitin 2012 Kosova nuk ka pasur fare borxh të jashtëm apo të brendshëm, por në këtë vit, për herë të parë është futur në borxhe dhe atë në borxh të jashtëm në vlerë prej 93,677,000 Euro dhe borxh të brendshëm në vlerë prej 73,313,000 Euro. Edhe në vitin pasues 2013 kemi prapë financimin e buxhetit me një borxh të jashtëm në vlerë prej 4,634,000 Euro dhe me borxh të brendshëm në vlerë prej 79,200,000 Euro.

Sa i përket shpenzimeve rritja më e madhe e shpenzimeve është bërë për shpenzime kapitale të cilat në vitin 2007 kanë qenë 159,208,000 Euro kurse në vitin 2013 kanë qenë 534,690,000 Euro, apo rritja në mes të vitit 2007 me vitin 2013 ka qenë në vlerë prej 375,482,000 apo shprehur në përqindje 235.84 %. Këto shpenzime në të dalat e përgjithshme të buxhetit në vitin 2007 merrnin pjesë 23.54% kurse në vitin 2013

pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e përgjithshme ishte 35.37 % pra kemi një rritje prej 11.83% nëse krahasohet viti 2007 me vitin 2013.

Edhe shpenzimet për paga kanë një pjesëmarrje mjaft të madhe në shpenzimet e përgjithshme buxhetore dhe ato në vitin 2007 ishin 208,923,000 Euro në vitin 2013 ishin rritur në 418,546,000 Euro apo rritje në vlerë prej 209,623,000 apo shprehur në përqindje kemi një rritje prej 100.33%. Sa i përket pjesëmarrjes në shpenzimet totale shpenzimet e pagave të sektorit publik në vitin 2007 merrnin pjesë më 30.90% kurse në vitin 2013 ato merrnin pjesë me 27.68 % ku shohim se ka një rënie të pjesëmarrjes së shpenzimeve të pagave prej 3.22 %.

Karakteristikë tjetër e shpenzimeve buxhetore është se ndarjet për subvencione dhe shpërndarjet e tjera janë rritur nga 154,552,000 Euro që ishte në vitin 2007 në 315,619,000 Euro apo një rritje prej 161,067,000 Euro dhe sipas mendimit të autorëve të ndryshëm që janë dhënë në pjesën tek rishikimi i literaturës nëse këto mjete nuk jepen për qëllime produktive atëherë nuk ndikojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike. Gjithashtu nga tabela e paraqitur më lart shohim se Kosova gjithmonë ka një rezervë monetare në fund të çdo viti e cila është mbi 200,000,000 euro pasi kërkesa e Fondit Monetar Ndërkombëtar është që rezervat buxhetore të jenë mbi këtë vlerë. Gjithashtu nëse analizojmë këtë buxhet shohim se këto rezerva në vitin 2007 kanë qenë 449,762,000 euro kurse në vitin 2013 kanë rënë në vetëm 211,778,000 Euro si dhe nga 7 periudhat e analizuara në 4 prej tyre ka pasur deficit buxhetor në vitin 2009, 2010, 2011 dhe 2013 në vlerë totale prej 338,269,000 euro. Sa i përket financimit të buxhetit nga viti 2014 deri në vitin 2016 në tabelën më poshtë japim raportin mbi mbledhjen e të hyrave tatimore, jo tatimore dhe të hyrave tjera nga të cilat janë mbuluar shpenzimet buxhetore.

Tabela Nr. 23 – Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore nga viti 2014 deri në vitin 2016
Vlerat 000 Euro

	2014	2015	2016
Tatimet direkte	188,012	197,720	232,121
Tatimet indirekte	1,003,048	1,103,476	1,227,392
Kthimet tatimore	(33,516)	(35,644)	(38,381)
Të hyrat jo tatimore	175,277	191,267	175,343
Hua marrja	113,836	166,719	154,412
Grandet dhe ndihmat	12,092	13,310	8,735
Pranimet tjera	3,829	70,526	18,286
Totali i të hyrave	1,462,579	1,707,374	1,777,908

Burimi: MFE e Kosovës, Raporti financiar 2016

Nga kjo tabelë shohim se të hyrat e drejtëpërdrejta për periudhën dy vjeçare nga 2014 deri në vitin 2016 janë rritur për 44,109,000.00 milion apo shprehur në përqindje 23.46 %, kurse të

hyrat nga tatimet indirekte në periudhën dy vjeçare janë rritur për 224,344,000.00 Euro, nga 1,003,048,000.00 Euro në 1,227,392,000 respektivisht shprehur në përqindje 22.36 %. Pjesëmarrja e të hyrave tatimore në të hyrat totale në vitin 2014 ka qenë 79.14 %, në vitin 2015 ka qenë 74.12 % dhe në vitin 2016 ka qenë 79.93 %.

Kurse nga ana tjetër në këtë raport shohim se grandet kanë një rënie të ndjeshme ngase deri sa në vitin 2014 grandet e pranuar ishin 12,092,000.00 Euro në vitin 2016 ato kanë rënë në vetëm 8,735,000.00 Euro.

Tabela Nr. 24 – Raporti i shpenzimeve buxhetore për vitet 2014 – 2016 Vlerat 000 Euro

	2014	2015	2016
Shpenzimet e pagave, mallrave dhe shërbimeve	696,824	735,305	748,091
Subvencionet dhe tranfere	364,526	422,099	475,103
Shpenzimet kapitale	412,920	407,926	452,299
Pagesa e borxhit	36,587	49,008	87,751
Totali i të dalave	1,510,856	1,614,337	1,763,242
Para të gatshme në fillim të vitit	256,539	163,501	211,778
Para të gatshme në fund të vitit	271,204	256,539	163,501

Burimi: Burimi: MFE e Kosovës, raporti financiar 2016

Sa i përket shpenzimeve buxhetore për këto vite shihet se pjesa më e madhe e shpenzimeve janë për paga, mallra dhe shërbime, pastaj për investime kapitale dhe subvencione dhe tranfere. Gjithashtu vërehet rritja e pagesës së borxhit ku në vitin 2014 është paguar borxh në vlerë prej 36,587,000.00 Euro kurse në vitin 2016 borxhi i paguar është rritur më shumë se 100 % dhe ai i paguar ka qenë në vlerë prej 87,751,000.00 Euro.

Një element më shqetësues është se kemi rënie të parasë së gatshme që disponon Kosova ku deri se ajo në fillim të vitit ishte 211,778,000.00 Euro në fund të vitit ka rënë në 163,501,000.00 Euro.

3.2.1 Prodhimi i brendshëm bruto në Kosovë

Ekonomia e Kosovës dhe shteti në tërësi, pas përfundimit të luftës në vitin 1999, doli më një ekonomi të shkatërruar dhe dëme të mëdha materiale jo vetëm në fushën ekonomike por me dëme të konsiderueshme dhe të pariparueshme edhe në ekonominë familjare. Periudha menjëherë pas vitit 1999 karakterizohet si një periudhë emergjente, ku ekonomia

e shkatërruar dhe Kosova në tërësi varej nga donacionet nga jashtë , dërgesat e qytetarëve Kosovarë e shumë më pak nga prodhimtaria vendore dhe aktivitetet e tjera ekonomike që zhvilloheshin në Kosovë. Niveli i ndihmave humanitare dhe donacioneve tjera nga vendet e ndryshme ishte burim kryesor në vitin 1999, 2000 dhe nga viti në vit ai kishte rënie duke u zëvendësuar me të hyrat që krijoheshin nga veprimtaritë ekonomike në Kosovë.

Kështu në vitin 2001 vlera e donacioneve dhe dërgesave financiare nga diaspora kosovare që merrnin pjesë në Prodhimi i Brendshëm bruto ishte 1,097,000,000.00 apo shprehur në përqindje ishte 51.38 %; $1,097,000,000.00 / 2,135,000,000.00$ dhe kjo pjesëmarrje e donacioneve dhe dërgesave të pranuar nga jashtë prej diasporës nga viti në vit vinte duke u zvogëluar. Kështu në vitin 2002 kishte një vlerë prej 869 milion, në vitin 2003 ishte 689 milion e kështu me radhë. Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën numër 24 ku është paraqitur edhe prodhim i brendshëm bruto.

Nga të dhënat që janë të paraqitura mbi rritjen e PBB në Kosovë nga viti 2001 deri në vitin 2013 shohim se kemi një rritje prej 145% të PBB e cila është nxjerrë në krahasimin e PBB në vitin 2001 nga 2,135,000,000.00 me PBB në vitin 2013 në 5,232,860,000.00.

Por pyetja qëndron në atë se këto krahasime dhe përqindje mbi rritjen ekonomike nga viti 2001 deri në vitin 2016 a tregojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe rritje të standardit të qytetarëve si rezultat i kësaj rritje. Të gjithë parametrat e tjerë tregojnë se kjo rritje ka ardhur si rezultat i një ekonomie të dëmtuar tërësisht dhe sado që në shikim të parë duket rritje e madhe për periudhën krahasuese, kjo ka qenë shumë e pamjaftueshme pasi nga viti në vit kemi rritje të varfërisë, rritje të papunësisë dhe nuk kemi rritje të qëndrueshme të investimeve të huaja të drejtpërdrejta si nga qytetaret Kosovarë që jetojnë

jashtë apo edhe nga investimet e huaja të drejtpërdrejta të cilat do të mundësonin punësime më të mëdha të popullatës së aftë për punë.

Në tabelën në vijim do të japim PBB për periudhën 2001 deri 2004, pastaj periudhën nga 2005 deri në 2008 dhe tabelën e tretë krahasuese nga viti 2009 deri në 2013. Kjo ndarje është bërë kështu për shkak se nga viti 2001 deri në fund të vitit 2004 kemi pasur një grup të tatimeve që janë aplikuar në Kosovë kurse nga janari i vitit 2005 bëhen ndryshime në politikat fiskale dhe aplikohen disa lloje të tjera të tatimeve të cilat nuk kanë pësuar ndryshime deri në fund të vitit 2008. Kurse nga janari i vitit 2009 ndërmerren një mori reformash fiskale të cilat kishin për qëllim uljen e disa normave tatimore në tatimet e drejtpërdrejta dhe rritjen e normës së tatimit në konsum, tvsh-së, me qëllim që të joshen investitorët e huaj, investitorët vendorë dhe qytetarët me prejardhje nga Kosova, të cilët kapitalin e tyre do ta investonin në Kosovë.

Tabela Nr. 25 – PBB nga viti 2001 deri në vitin 2004

Vlerat në 000,000 Euro

VITI/ SEKTORI	2001	2002	2003	2004
Sektori privat	2,135	2,090	2,109	2,173
Sektori qeveritar	202	268	351	507
Donatorët / dërgesat nga jashtë	1,097	869	689	582
Eksporti neto	-914	- 780	-735	-761
Totali	2,520	2,447	2,413	2,501

Burimi: Autoriteti Qendror Fiskal, 2005. Raporti vjetor

Nga viti 2005 fillon të zbatohet pakoja e re fiskale, ku u bënë disa ndryshime në legjislacionin tatimor por jo me ndonjë ndikim të veçante në biznese pasi kryesisht u bënë ndryshime në emërtime të legjislacionit por jo me ndonjë përmbajtje të theksuar e cila do

t'i jepte shtytje zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Por sa i përket PBB tani kemi një rritje të saj e cila ishte mjaft e theksuar në aspektin e shifrave por që nuk ndjehej edhe në jetën e përditshme pasi nuk u shoqërua me mirëqenie më të madhe të popullatës.

Tabela Nr. 26 – PBB nga viti 2005 deri në vitin 2008 me çmime konstante Vlerat 000,000Euro

<i>Sektori / Viti</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>
Konsumi	3,442	3,558	3,877	4,439
Investimet	713	798	926	1,142
Eksporti Neto	-1,101	-1,195	-1,411	-1,732
Totali	3,068	3,192	3,425	3,804
% e Rritjes	3.8	3.9	3.9	5.4
PBB për banor (në euro)	1,482	1,520	1,611	1,759

Burimi: BQK, Raporti vjetor 2008, faqe 20

Kurse në tabelën e mëposhtme do të paraqesim PBB për periudhën pas aplikimit të reformës fiskale.

Tabela Nr. 27 – PBB nga viti 2009 deri në vitin 2013 në Kosovë Vlerat në 000,000 Euro


<i>Sektori / Viti</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>
Konsumi	4,280	4,760	5,074	5,336	5,545
Investimet	1,166	1,213	1,433	1,620	1,704
Eksporti Neto	-1,534	875	-1,867	-1,979	-2,035
Totali	4,594.1	4,741.1	4,954.5	4,978	5,214
% e Rritjes	3.5 %	3.2 %	4.5 %	2.9 %	5.4 %
PBB për çdo banor (në euro)	1,848	1,996	2,127	2,249	2,321

Burimi: Ministria e Financave, Departamenti për makroekonomi, 2014

Sipas informatave të prezantuara më lart shohim se norma reale e rritjes së PBB për periudhën nga 2009 deri në 2013 ishte 17.5 % dhe në vitin 2009 ishte 3.5%, në vitin 2010 3.2%, në vitin 2011 4.5% , në vitin 2012 ishte 2.9% dhe në vitin 2013 ishte 5.4%.

Se si ka qenë rritja ekonomike në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2013 do ta shohim në grafikun e mëposhtëm ku shihet se Kosova nuk ka pasur një rritje të vazhdueshme ekonomike dhe rritje të PBB por kjo ka ardhur si rezultat i investimeve qeveritare në infrastrukturën rrugore, futjes së qeverisë në kredi të jashtme dhe shfrytëzimit të atyre mjeteve për ndërtim infrastrukturor.

Grafika Nr. 4 – Paraqitja grafike e përqindjes së rritjes së PBB nga viti 2009 deri në vitin 2013



Burimi: Ministria e Financave. PBB, Viti 2008 – 2013, faqe 9

3.2.2 PBB në Kosovë nga viti 2013 deri në vitin 2016 nëpër sektor ekonomik

Nga ana tjetër në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas të dhënave të ESK kemi rritje të PBB me çmim konstant për periudhën trevjeçare prej 15.48 %, kështu PBB në vitin 2013 ishte 5,232,600,000.00 Euro, në vitin 2014 PBB ishte 5,391,751,000.00 Euro, në vitin 2015 ishte 5,795,498,000.00 Euro dhe në vitin 2016 PBB në total ishte

6,043,370,000.00 Euro.

Më poshtë gjejmë paraqitjen tabelore të PBB për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 nëpër sektorët e ndryshëm ekonomik.

Tabela Nr. 28 – PBB Sipas sektorëve ekonomik 2013 – 2016, çmimi constant					Vlerat në 000 Euro	
Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015	2016	Rritja 2013-2016	% Rritjes 2013 -2016
Bujqësia, Pylltaria	626,312	643,883	634,700	618,100	-8,212	- 1.31
Industria nxjerrëse	131,451	123,047	116,460	114,238	-17,213	-13.09
Industria përpunuese	585,050	577,245	603,672	643,248	58,198	9.94
Furnizimi me energji dhe gaz	138,021	146,627	173,057	199,104	61,083	44.25
Furnizimi me ujë	51,356	54,322	55,560	44,675	-6,681	-13.00
Ndërtimtaria	350,058	330,653	387,963	415,083	65,025	18.57
Tregtia me shumicë dhe pakicë	638,730	708,775	714,134	743,406	104,676	16.39
Transporti	217,726	232,851	211,606	218,277	551	0.25
Hotelet dhe restorante	38,087	52,177	53,370	61,328	23,241	61.02
Informimi dhe komunikimi	53,414	115,190	116,426	110,311	56,897	106.52
Aktivitetet financiare dhe sigurimi	202,085	222,652	259,703	221,402	19,317	9.56
Afarizmi me pasuri të patundshme	455,278	465,944	499,315	501,599	46,321	10.17
Aktivitetet profesionale	75,461	75,036	87,768	92,675	17,214	22.81
Aktivitetet administrat.	21,680	21,685	34,088	34,573	12,893	59.47
Administrimi publik dhe i mbrojtjes	505,884	459,833	430,657	457,033	48,851	9.66
Edukimi	163,479	169,878	220,414	237,416	73,937	45.23
Shëndetësia	73,291	82,890	101,518	109,891	36,600	49.93
Aktivitete zbavitëse	23,452	26,978	23,328	23,940	488	2.08
Shërbimet tjera	8,517	9,164	10,322	12,977	4,460	52.36
PBB total me çmim bazë	4,359,332	4,518,832	4,734,060	4,859,275	499,943	11.46

Tatimet në produkte	958,805	894,331	1,091,796	1,213,998	255,193	26.61
Subvencionet në produkte	(85,277)	(21,412)	(30,358)	(29,903)	(55,374)	-64.93
PBB me çmim konstant	5,232,860	5,391,751	5,795,498	6,043,370	810,510	15.48

Burimi: Autori , 2017, Përpunimi i të dhënave nga ESK, Statistikat ekonomike, PBB 2008 -2016

Nëse krahasojmë rritjen e PBB nga viti në vit për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas qasjes në shpenzime kemi këtë rritje të PBB me çmim konstant.

Tabela Nr. 29 – PBB sipas metodës së shpenzimeve 2013 – 2016, çmimet konstante Vlerat në 000 Euro

	2013	2014	2015	2016	Rritja 2013-2016	% Rritjes 2013 - 2016
Shpenzimet e konsumit final	5,437,800	5,742,600	5,994,200	6,131,500	693,700	12.75
Formimi kapitalit bruto	1,460,200	1,397,900	1,596,500	1,721,300	261,100	17.88
Eksporti neto	1,665,200	-1,748,800	-1,795,200	-1,809,500	144,300	8.66
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	944,700	1,081,900	1,119,100	1,304,300	359,600	38.06
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2,609,900	2,830,700	2,914,300	3,113,800	504,000	19.31
PBB me çmime konstante	5,232,800	5,391,700	5,795,500	6,043,400	810,600	15.49
Norma reale e rritjes	3.4 %	1.2 %	4.1 %	4.1 %		

Burimi: Autori , 2017, Përpunimi i të dhënave nga ESK, Statistikat ekonomike, PBB 2008 -2016

3.2.3 Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB në vendet e Bashkimit European nga viti 2009 dhe deficitit buxhetor

Kriza financiare e vitit 2008 la mjaft pasoja te një numër i vendeve të Unionit European, të cilat si pasoje e kësaj krize financiare, kaluan në recesion ekonomik dhe u ballafaquan me vështirësi të shumta financiare veçanërisht si rezultat i rritjes së deficitit buxhetor dhe me te edhe i rritjes së borxhit publik. Vendet e ndryshme të Bashkimit European kanë specifikat e tyre si në krijimin e të hyrave, diferenca të mëdha në shkallët

tatimore që aplikojnë por edhe në ndarjet buxhetore që bëjnë për financimin e shpenzimeve qeveritare.

Sipas të dhënave nga Eurostati deficitit buxhetor i të gjitha vendeve të Bashkimit European në vitin 2009 ishte -6.8 % në 27 vendet e Bashkimit European kurse në vendet e Eurozonës ishte më i vogël për 0.5% dhe ishte -6.3%, por ky nivel i deficitit buxhetor nga viti në vit shkoi duke u rritur kështu në vitin 2010 ishte 6.4 % dhe nga viti në vit ai deficit shkonte duke u rritur.

Nga ana tjetër edhe borxhi publik ishte mjaft i madh dhe në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2012 ai si përqindje ndaj PBB në 27 vendet e BE u rrit për 24.3% kurse në vendet e Eurozonës rritja e borxhit publik ishte 22.3%.

Nisur nga kjo situatë dhe rritjes së vazhdueshme të deficitit buxhetor të shteteve anëtare të BE si dhe rritjes së borxhit publik u lidh Traktati ndër qeveritar i 25 vendeve të BE. Britania e Madhe dhe Republika Çeke nuk e nënshkruan një traktat të tillë i cili ka filluar të aplikohet nga Janari i vitit 2013 dhe ka përcaktuar disa rregulla në mënyrë që shtetet të kenë një buxhet të balancuar në mënyrë që si rezultat i rrethanave ciklike të krizave financiare apo të krizave të tjera disa vende anëtare të BE të mos kenë mundësi të paguajnë borxhet e tyre publike dhe të kenë deficite të mëdha buxhetore.

Disa nga rregullat kryesore të cilat përfshinte ky traktat ishin:

- Qeveritë e çdo vendi anëtar çdo reformë të madhe në sferën ekonomike që dëshironin të bënin duhej së pari ta vinin në diskutim publik në mbledhjet e qeverisë evropiane

- Buxhetet duhej të ishin të balancuara dhe deficitit buxhetor nuk duhej të kalonte 3% të PBB dhe Borxhi Publik nuk duhej të kalonte 60% të PBB dhe nëse ai kalonte 60 % të PBB atëherë vendi i cili kishte kaluar këtë përqindje të borxhit publik duhej të bënte shkurtimin e borxhit me 1/20 të tepricës së borxhit.

Pas kësaj periudhe fillon edhe reforma në pjesën dërmuese të vendeve anëtare, veçanërisht në vendet e Evropës Lindore dhe Jugore, ku si qëllim primar kishin reduktimin e shpenzimeve publike për investime në nivel sa ma të pranueshëm dhe me qëllim të arritjes së objektivave të parapara me traktat, pastaj zvogëlimin e të dalave publike për mirëqenie sociale, zvogëlimin e të dalave publike për shëndetësi dhe papunësi, pastaj reforma të tjera me qëllim të zvogëlimit të punësimit në sektorin publik dhe zvogëlimin e të ardhurave të punësuarve në këtë sektor. Në aspektin e rritjes së të ardhurave buxhetore u rritën tatimet kryesisht të konsumit dhe në disa vende tatimet në të ardhura personale me qëllim të mbajtjes së deficitit buxhetor në limitin e paraparë me traktat.

Të ardhurat buxhetore në vendet e BE sipas statistikave të Eurostatit në vitin 2011 ishin 44.7 të PBB kurse të dalat ishin 49.1% të PBB kurse tek vendet e Eurozonës të hyrat buxhetore ishin 45.4 të PBB kurse shpenzimet buxhetore ishin 49.5 % të PBB.

Sa i përket burimit kryesor të hyrave buxhetore në vendet e BE merrnin pjesë tatimet me 58.2%, kurse kontributet shoqërore me 31.1% dhe pjesa tjetër ishin të hyra jo tatimore.

Nga ana tjetër tek vendet e Eurozonës pjesëmarrja e tatimeve në të hyrat buxhetore të jetë në 55%, kurse kontributet shoqërore 34.6 % dhe pjesa tjetër janë të hyra jo tatimore.

Por siç u tha edhe më lart secili shtet ka edhe specifikat veta dhe ka dallime të mëdha në të hyrat buxhetore që krijojnë. Kështu Danimarka prej të hyrave të përgjithshme

buxhetore 84 % i siguron nga tatimet kurse vetëm 16 % nga kontributet shoqërore dhe të hyrat tjera jo buxhetore kurse vendet e Evropës Lindore të cilat ishin pjesë e Bllokut socialist dhe janë anëtar të BE, si Sllovenia, Hungaria apo Sllovakia tatimet përbënin më pak se 50 % të ardhurave qeveritare kurse pjesa tjetër mbulohet nga Kontributet Shoqërore dhe të hyrat të tjera jo tatimore.

Edhe sa i përket pjesëmarrjes të shpenzimeve buxhetore në PBB ka dallime të mëdha në mes të vendeve anëtare ku Danimarka prin me 57.9 % të PBB, pasuar nga Franca me 55.9% dhe Finlanda me 54 % kurse vendet me pjesëmarrje më të vogël të shpenzimeve buxhetore janë vendet e Evropës Lindore si Bullgaria me 35.2 % të PBB, pastaj Sllovakia 37.4 %, Lituania me 37.5 % e kështu me radhë.

Gjithashtu edhe struktura e të dalave publike tek vendet e BE është heterogjene por në përgjithësi pjesa më e madhe e të dalave publike shkon në mbrojtjen sociale dhe shëndetësi ku vetëm në këto dy grupe të dalave publike % sillet rreth 54.1 % të shpenzimeve totale dhe atë 39.4% shkon për mbrojtjen sociale dhe 14.7 të shpenzimeve totale shkojnë për shëndetësi. Shpenzimet e tjera shkonin nën 75 të PBB dhe ishin 6.5% për administratë publike, për arsim ishin 5.5% , çështje të tjera ekonomike 4.7% dhe rendi publik dhe siguria 1.9% kurse pjesën tjetër të shpenzimeve publike përbënin mbrojtja, argëtimi, kultura, feja, strehimi dhe mbrojtja mjedisore.

Nga ana tjetër sipas raportit të Organizatës Botërore të Ekonomisë (WEO) ekonomia në këto vende ka filluar të rikupërohet dhe përveç Greqisë e cila në vitin 2015 nuk ka pasur rritje ekonomike pjesa dërmuese e vendeve të Eurozonës kanë pasur rritje të PBB-së.

3.2.4 Pjesëmarrja e të hyrave dhe shpenzimeve totale në PBB e Kosovës dhe krahasimi me vendet e BE

Një element shumë i rëndësishëm krahasues është edhe pjesëmarrja e të hyrave tatimore dhe të hyrave të tjera në PBB dhe kjo pjesëmarrje ndryshon varësisht se si janë të projektuara të hyrat buxhetore brenda vendeve të caktuara. Në vendet më të zhvilluara, një pjesëmarrje mjaft të madhe në të hyrat buxhetore kishin edhe kontributet shoqërore dhe jo vetëm të hyrat tatimore kurse në Kosovë deri më tani ende sipas legjislacionit nuk është paraparë asnjë lloj i detyrimeve shoqërore dhe përveç pjesës së pensioneve që paguhet në Trustin e Kursimit të Pensioneve nuk ka kontribute të tjera për të cilat obligohen të punësuarit. Për të parë se cila është pjesëmarrja e të hyrave publike dhe shpenzimeve publike në Kosovë në krahasim me PBB ne kemi bërë paraqitjen tabelore të këtyre të dhënave të cilat janë si në vijim:

Tabela Nr. 30 – Krahasimet e të hyrave tatimore të mbledhura në kufi dhe brenda vendit me PBB në Kosovë
Vlerat në 000,000 Euro

Emërtimi/Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PBB	3,804	4,594	4,741	4,954	4,978	5,214	5,392	5,795	6,043
Të hyrat - kufi	604	634	699	826	842	834	864	948	1047
% në PBB	15.87	13.8	14.74	16.67	16.91	15.99	16.02	16.35	17.32
Të hyrat brenda	201	182	194	231	251	271	304	332	386
% në PBB	5.28	3.96	4.10	4.66	5.04	5.20	5.64	5.73	6.38
Të hyrat tatimore totale	805	816	893	1057	1093	1105	1,168	1,280	1,433
% në PBB	21.16	17.76	18.83	21.33	21.95	21.20	21.66	22.08	23.71
Të hyrat totale	989	1,160	1,194	1313	1,550	1,445	1,449	1,690	1,778
% në PBB	26.00	25.25	25.18	26.50	31.13	27.70	26.87	29.16	29.42

Burimi: Autori (2014) Përpunimi i të dhënave nga tabelat paraprake

Nga të dhënat e paraqitura më lart shohim se të hyrat buxhetore nga të gjitha llojet e të hyrave tatimore dhe jo tatimore marrin pjesë në PBB në vitin 2016 me 29.42 % kurse vlera më e vogël e pjesëmarrjes së të hyrave të përgjithshme në PBB ishte në vitin 2010 me pjesëmarrje prej 25.18 % kurse pjesëmarrja më e madhe prej 31.13 % ishte në vitin 2012 që ishte pjesëmarrja më e madhe e të hyrave buxhetore në PBB, por kjo pjesëmarrje e të hyrave buxhetore në PBB në krahasim me mesataren e BE është shumë e vogël. Sipas Eurostat të hyrat buxhetore tek vendet e BE në periudhën e krahasuar ishte mesatarisht 44.7 % kurse në vendet e Eurozonës kjo pjesëmarrje mesatarisht ishte 45.4 %.

Sa i përket shpenzimeve dhe pjesëmarrjes së tyre në PBB në Kosovë ajo sillet nga 19.73 % në vitin 2007 dhe ajo është rritur në 28.99 % në vitin 2013 kurse nëse analizohet kjo pjesëmarrje me vendet e BE e cila është prej 35.2 % që është vlera më e vogël në Bullgari deri në 58.2 % që është në Danimarkë.

Tabela Nr. 31 – Pjesëmarrja totale e shpenzimeve buxhetore në PBB në Kosovë 000,000 Euro

<i>Emërtimi/ Viti</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>
PBB	3,425	3,804	4,594	4,741	4,954	4,978	5,214	5,392	5,795	6,043
Totali i shpenzim.	676	963	1,252	1,288	1,400	1,476	1,512	1,511	1,614	1,763
% në PBB	19.73	25.31	27.25	27.16	28.25	29.65	28.99	28.02	27.85	29.17

Burimi: Autori (2014) Krahasimet nga tabelat paraprake

Nga krahasimet mes të hyrave dhe shpenzimeve në Kosovë dhe pjesëmarrja e tyre në PBB në krahasim me të hyrat dhe shpenzimet e vendeve të BE shohim se ka diferenca mjaft të mëdha por këto për shkak të specifikave ekonomike janë normale pasi këto diferenca ekzistojnë edhe brenda vendeve të BE vendet janë mjaft heterogjene dhe me strukturë të ndryshme të zhvillimit ekonomik.

3.2.5 Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB në vendet e Rajonit dhe krahasimi me Kosovën

Secili nga vendet e ndryshme të Ballkanit Perëndimor, të cilët janë vende fqinje të Kosovës, karakterizohen me strukturë të ndryshme ekonomike ku secila nga to i jep prioritet varësisht nga qëllimi i tyre edhe drejtimit të zhvillimit të tyre dhe politikave fiskale që aplikon. Këto do të kenë ndikim më të madh në rritjen e PBB, rritjen e mirëqenies së qytetarëve të tyre dhe zvogëlimin e papunësisë e cila është mjaft e theksuar tek të gjitha vendet e Ballkanit.

Kriza financiare e vitit 2008 e cila ka vazhduar edhe në vitet pasuese ka prekur edhe vendet e ndryshme të Rajonit varësisht nga struktura e tyre dhe pjesëmarrja e mallrave dhe shërbimeve të tyre me vendet e tjera jashtë rajonit, të cilat kanë qenë të prekura më shumë nga ajo krize dhe kishin kaluar në një fazë të recesionit ekonomik.

Kjo krizë e cila ishte nisur si krizë bankare dhe më vonë mori përmasa globale të një krize financiare pati pasoja tek pjesa dërmuese e vendeve të rajonit të cilët me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë së tyre morën një mori masash fiskale dhe monetare si zvogëlimi i normave tatimore për lloje të ndryshme të tatimeve, krijimi i zonave të tilla ekonomike me lirime tatimore me qëllim të inkurajimit të investimeve të huaja në vendet e tyre, sigurimin e depozitave bankare deri në nivele të caktuara, stimulimin e shitjes së produkteve strategjike të vendit të tyre me kushte të volitshme ku kreditonin sistemin bankar për norma të caktuara të kredisë dhe një mori masash të tjera të cilat kishin ndikim të përgjithshëm në ekonomi.

Nisur nga kjo dhe me qëllim që të mos ketë rënie të PBB në shumicën e vendeve të Rajonit janë bërë ndryshime të normave tatimore kryesisht në tatimet e drejtpërdrejta si

tatimi në paga dhe tatimi në fitim të korporatave ku është bërë zvogëlimi i tyre apo edhe eliminimi i tyre për një periudhë të caktuar nëse investitorët e huaj investojnë kapitalin tyre dhe për këtë prin Maqedonia e cila varësisht nga numri i punëtorëve që punësojnë dhe kapitalit që investojnë korporatat e huaja ka bërë pushime tatimore për një periudhë 10 vjeçare kurse për korporatat të tjera të cilat ri investojnë kapitalin e tyre dhe nuk e tërheqin nuk kanë pasur obligime për pagesë në fitimin e tyre.

Në vendet të cilat nuk kanë bërë pushime tatimore janë bërë zbritje të normave të tatimit kështu në Mal të Zi ajo nga viti 2005 ishte zvogëluar në 9%, në Maqedoni ishte 10% për kompanitë vendore dhe ato të cilat kishin filluar aktivitetin para kësaj krize, Serbi, Kosovë dhe Shqipëri ishte 10%.

Sa i përket Tvsh-së ajo ishte nga 17 % norma e lartë dhe 7 % norma e ulët në Mal të Zi, Maqedoni ishte 18 %, në Kosovë 16 % në Shqipëri 20 % kurse për barna dhe shërbime të tjera mjekësore 10 % dhe në Serbi aplikoheshin dy norma 18% dhe 8 %.

Të gjitha këto ndryshime u bënë pasi vërehej se si rezultat i krizës financiare dukej se shtetet do të kalojnë në recesion dhe qëllimi ishte që nëpërmjet këtyre politikave të ndikojnë kryesisht në investimet e huaja që në këtë periudhë kishin shënuar rënie dhe si rezultat i kësaj krize edhe PBB në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit ishte zvogëluar që tregonte se kishte një zvogëlim të aktivitetit ekonomik.

Nga vendet të cilat ishin prekur më shumë dhe kishin rënie të PBB ishte Serbia por edhe vendet tjera të rajonit edhe pse ishin munduar të ndërmarrin reforma të ndryshme me të vetmin qëllim që gjatë kësaj periudhe të prekeshin sa më pak nga kjo krizë nuk ia kishin arritur edhe pse ndikimi i krizës varej shumë edhe nga struktura ekonomike që kishin

vendet e caktuara si dhe nga shkalla e bashkëpunimit që kishin këto vende të rajonit me vendet të cilat ishin prekur më shumë nga kriza.

Në tabelën më poshtë do të japim paraqitjen tabelore të PBB për vendet fqinje të Kosovës në periudhën nga 2007 deri në vitin 2013.

Tabela Nr. 32 – PBB në vendet e Ballkanit sipas Bankës Botërore Vlerat në miliard dollar

Vendi / Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	%
Shqipëria	10.7	12.88	12.04	11.33	12.89	12.34	12.92	20.74
Serbia	40.29	49.26	42.62	39.46	46.47	40.74	45.52	12.98
Maqedonia	8.34	9.91	9.4	9.41	10.49	9.75	10.77	29.13
Kosova	4.83	5.69	5.65	5.83	6.70	6.50	7.07	46.37
Mali i Zi	3.67	4.52	4.14	4.11	4.50	4.05	4.42	20.43

Burimi: www.tradingeconomics.com

Nga tabela e paraqitur më lart shohim se rritjen më të madhe të PBB për këtë periudhë e ka pasur Kosova me 46.37% apo me rritje mesatare vjetore për tërë këtë periudhë prej 6.62 %, por edhe përkundër kësaj rritjeje për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik në të kaluarën, luftës së zhvilluar në fund të viteve 90- ta të shekullit të kaluar, statusit politik të pa zgjidhur, reformave të ngadalshme ekonomike dhe të natyrave të tjera ka ndikuar që të ardhurat për kokë të banorit të Kosovës janë më të vogla nga të gjitha vendet e rajonit dhe se edhe pse ka rritje të ardhurave për çdo banor nga viti në vit ato përsëri janë ende më të voglat në rajon dhe rritja e tyre shprehur në përqindje në periudhën e analizuar nga viti 2007 deri në vitin 2013 sipas të dhënave të World Trading Economics ka qenë 15.93% kurse rritjen më të madhe të ardhurave për çdo banor në periudhën e analizuar e ka pasur Shqipëria me rritjen prej 24.87%. Se si ka qenë niveli i rritjes së të ardhurave për kokë banori për periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013 në të

gjitha vendet fqinje më të cilat kufizohet Kosova do të shohim në tabelën në vijim dhe vlerat janë të paraqitura në dollarë amerikanë.

Tabela Nr. 33 – Të ardhurat për çdo banor në rajon

Vlerat në dollar

Vendi / Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	%
Shqipëria	3136	3398	3536	3685	3798	3857	3916	24.87
Serbia	3950	4180	4066	4106	4197	4174	4302	8.91
Maqedonia	3341	3520	3505	3620	3702	3682	3777	13.04
Kosova	2416	2460	2522	2585	2675	2727	2801	15.93
Mali i Zi	4402	4699	4424	4524	4665	4543	4690	6.54

Burimi: www.tradingeconomics.com

Nga paraqitja tabelore shohim se edhe ndaj rritjes së PBB më të madhe që e kishte Kosova në periudhën e analizuar nga viti 2007 deri në vitin 2013 përsëri të ardhurat për çdo banor janë më të vogla në rajon dhe janë për 1.67 herë më të vogla se të ardhurat për kokë të banorit në Mal të Zi të cilat janë më të larta nga vendet fqinje të Kosovës dhe janë në vlerë prej 4690 dollarë. Nga këto të dhëna shohim se edhe pse shprehur në vlerë dhe përqindje në periudhën e analizuar Mali i Zi ka rritjen më të vogël por të ardhurat për çdo banor aty janë më të lartat në rajon.

Nga tabela e paraqitur më lart është edhe një karakteristikë tjetër ku të gjitha vendet me të cilat është në fqinjësi Kosova me përjashtim të Shqipërisë përqindja e rritjes së PBB në nivel të vendit është më e lartë se rritja e të ardhurave për kokë banori kurse në Shqipëri është e kundërta ku përqindja e rritjes së të ardhurave për kokë banori është më e lartë se sa rritja e PBB në nivel të vendit dhe kjo ka ardhur si rezultat i migrimit të madh të popullatës së Shqipërisë jashtë vendit dhe zvogëlimit të numrit të banorëve në Shqipëri e cila mendoj

se është mjaftë shqetësuese për shtetin Shqiptar dhe kjo situatë duhet të adresohet në mënyrë emergjente.

Në tabelën në vijim paraqesim përqindjen e rritjes PBB për periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2015 të vendeve të rajonit të dhënat e marra nga Organizata Botërore Ekonomike.

Tabela Nr. 34 – Përqindja e rritjes së PBB në vendet e rajonit 2012 – 2015

Vendi	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	1.6	1.4	1.9	2.7
Bosnja dhe Hercegovina	-1.2	2.5	1.1	2.1
Kosova	2.8	3.4	1.2	3.0
Maqedonia	-0.5	2.7	3.8	3.2
Mali i Zi	-2.5	3.5	1.3	3.2
Serbia	-1.0	2.6	-1.8	0.5

Burimi: WEO (2016)

Të gjitha vendet e rajonit kanë edhe diferenca në mes të pjesëmarrjes së të hyrave buxhetore në PBB dhe të shpenzimeve buxhetore në PBB , dhe kjo është e natyrshme për shkak të dallimeve zhvillimore të ekonomisë dhe këto dallime ekzistojnë edhe në mes të vendeve të ndryshme të BE.

Prandaj në tabelën në vazhdim do të shohim si ka qenë pjesëmarrja e të hyrave dhe shpenzimeve publike tek vendet e rajonit shprehur në përqindje ndaj PBB, ku kemi këtë situatë në periudhën krahasuese nga viti 2009 deri në vitin 2013.

Tabela Nr. 35 – Pjesëmarrja e të hyrave totale në PBB tek vendet e rajonit shprehur në përqindje

Emri / Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	26.1	26.2	25.5	24.7	25.5
Serbia	38.8	39.6	40.1	--	--
Mali i Zi	43.2	43.3	40.3	38.0	--
Maqedonia	31.4	33.2	32.7	--	--
Bosnja dhe Hercegovina	39.3	37.3	40	39.9	39.1
Kosova	27.25	27.16	28.25	29.65	28.99

Burimi: www.tradingeconomics.com

Kurse sa i përket pjesëmarrjes së shpenzimeve totale nga vendet e analizuara të shprehura në përqindje në PBB kemi këtë raport.

Tabela Nr. 36 – Pjesëmarrja e shpenzimeve totale në PBB, shprehur në përqindje

Emri / Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	33.2	29.3	29	28.4	29.1
Serbia	43.3	42.3	41.6		
Mali i Zi	46.4	47.1	45.0	41.9	
Maqedonia	34.3	35.7	34.7		
Bosnja dhe Hercegovina	42.0	39.4	40.7	41.4	39.9
Kosova	27.25	27.16	28.25	29.65	28.99

Burimi: www.tradingeconomics.com

3.2.6 PBB në Kosovë nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas sektorëve ekonomik

Nga ana tjetër në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas të dhënave të ESK kemi rritje të PBB me çmim konstant për periudhën trevjeçare prej 15.48 %, kështu PBB në vitin 2013 ishte 5,232,600,000.00 Euro, në vitin 2014 PBB ishte 5,391,751,000.00 Euro, në vitin 2015 ishte 5,795,498,000.00 Euro dhe në vitin 2016 PBB në total ishte 6,043,370,000.00 Euro.

Më poshtë gjejmë paraqitjen tabelore të PBB për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 nëpër sektorët e ndryshëm ekonomik.

Tabela Nr. 37 – PBB sipas sektoërëve ekonomik 2013 – 2016, çmimi constant Vlerat në 000 Euro

Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015	2016	Rritja 2013-2016	% Rritjes
Bujqësia, Pylltaria	626,312	643,883	634,700	618,100	-8,212	- 1.31
Industria nxjerrëse	131,451	123,047	116,460	114,238	-17,213	-13.09
Industria përpunuese	585,050	577,245	603,672	643,248	58,198	9.94
Furnizimi me energji dhe gaz	138,021	146,627	173,057	199,104	61,083	44.25
Furnizimi me ujë	51,356	54,322	55,560	44,675	-6,681	-13.00
Ndërtimtaria	350,058	330,653	387,963	415,083	65,025	18.57
Tregtia me shumicë dhe pakicë	638,730	708,775	714,134	743,406	104,676	16.39
Transporti	217,726	232,851	211,606	218,277	551	0.25
Hotelet dhe restorante	38,087	52,177	53,370	61,328	23,241	61.02
Informimi dhe komunikimi	53,414	115,190	116,426	110,311	56,897	106.52
Aktivitetet financiare dhe sigurimi	202,085	222,652	259,703	221,402	19,317	9.56
Afarizmi me pasuri të patundshme	455,278	465,944	499,315	501,599	46,321	10.17
Aktivitetet profesionale	75,461	75,036	87,768	92,675	17,214	22.81
Aktivitetet administrative	21,680	21,685	34,088	34,573	12,893	59.47
Administrimi publik dhe i mbrojtjes	505,884	459,833	430,657	457,033	48,851	9.66
Edukimi	163,479	169,878	220,414	237,416	73,937	45.23
Shëndetësia	73,291	82,890	101,518	109,891	36,600	49.93
Aktivitete zbavitëse	23,452	26,978	23,328	23,940	488	2.08
Shërbimet tjera	8,517	9,164	10,322	12,977	4,460	52.36
PBB total me çmim bazë	4,359,332	4,518,832	4,734,060	4,859,275	499,943	11.46
Tatimet në produkte	958,805	894,331	1,091,796	1,213,998	255,193	26.61
Subvencionet në produkte	(85,277)	(21,412)	(30,358)	(29,903)	(55,374)	-64.93
PBB me çmim konstant	5,232,860	5,391,751	5,795,498	6,043,370	810,510	15.48

Burimi: Autori , 2017, Përpunimi i të dhënave nga ESK, Statistikat ekonomike, PBB 2008 -2016

Nëse krahasojmë rritjen e PBB nga viti në vit për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 sipas qasjes në shpenzime kemi këtë rritje të PBB me çmim konstant.

Tabela Nr. 38 – Sipas metodës së shpenzimeve 2013 – 2016, çmimet konstante 000 Euro

	2013	2014	2015	2016	Rritja 2013-2016	% Rritjes 2013 - 2016
Shpenzimet e konsumit final	5,437,800	5,742,600	5,994,200	6,131,500	693,700	12.75
Formimi i bruto kapitalit	1,460,200	1,397,900	1,596,500	1,721,300	261,100	17.88
Eksporti neto	-1,665,200	-1,748,800	-1,795,200	-1,809,500	-144,300	8.66
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	944,700	1,081,900	1,119,100	1,304,300	359,600	38.06
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2,609,900	2,830,700	2,914,300	3,113,800	504,000	19.31
PBB me çmime konstante	5,232,800	5,391,700	5,795,500	6,043,400	810,600	15.49
Norma reale e rritjes	3.4 %	1.2 %	4.1 %	4.1 %		

Burimi: Autori , 2017, Përpunimi i të dhënave nga ESK, Statistikat ekonomike, PBB 2008 -2016

3.2.7 Borxhi Publik i Kosovës dhe krahasimi me vendet e rajonit

Deri në shpalljen e Pavarësisë Kosova nuk ka pasur borxh të jashtëm por ka pasur borxh publik brenda vendit. Ai ka qenë në përmasa të vogla nëse krahasohet me PBB dhe kjo situatë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk ka qenë pjesë e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe nuk ka mundur të futet në borxhe publike. Pas anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim edhe Kosova filloi të marrë disa kredi për financimin e disa projekteve por nga borxhi total

obligimi kryesor është ai i cili është trashëguar nga koha e të qenit pjesë e ish Jugosllavisë dhe tani është duke paguar kështu ndaj FMN.

Por edhe kundrejt këtyre përsëri borxhi publik i Kosovës në krahasim me PBB është mjaft i vogël dhe në vitin 2013 ishte 9.1% .

Më poshtë në formë tabelore paraqesim borxhin publik të Kosovës ndaj kreditorëve të brendshëm dhe të jashtëm nga viti 2009 deri në vitin 2013 sipas MF të Kosovës të paraqitur në raportin mbi borxhin publik të çerekut të parë të vitit 2014.

Tabela Nr. 39 – Borxhi Publik i Kosovës				Vlerat në miliona Euro	
	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi i jashtëm	249.01	260.42	253.60	336.60	323.76
Borxhi i brendshëm				73.31	152.51
Borxhi Total	249.01	260.42	253.6	409.92	476.27
% në PBB	6.37 %	6.22 %	5.51 %	8.44 %	9.10 %

Burimi : MFE – Raporti mbi borxhin publik, Mars 2014

Nga të dhënat e paraqitura më lart dhe nëse krahasojmë borxhin publik të Kosovës në raport me PBB në krahasim me vendet e tjera do të shohim se Kosova ka borxhin më të vogël publik. Në tabelën më poshtë do të paraqesim pjesëmarrjen e borxhit publik të vendeve fqinje të Kosovës në raport me PBB.

Tabela Nr. 40 – Pjesëmarrja e borxhit publik të vendeve fqinje të Kosovës ndaj PBB shprehur në %					
Shteti / Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	59.5	58.5	59.5	61.9	63.8
Serbia	32.8	41.8	45.4	56.2	59.6
Mali i Zi	38.25	40.94	45.98	53.97	56.84
Maqedonia	26.2	27.2	32	38.4	40.4
Bosnja dhe Hercegovina	21.8	25.6	35.5	36.6	34.4

Burimi: www.tradingeconomics.com

Nga të dhënat e paraqitura më lart shohim se borxhin më të madh publik nga vendet e rajonit e ka Shqipëria në raport me PBB me 63.8 %, pastaj vijnë Serbia me 59.6 % dhe Mali i Zi me 56.84 % kurse Kosova në fund të vitit 2013 ka pasur borxh publik në vlerë prej 476 milion Euro apo në raport me PBB ka qenë 9.1 % që është borxhi më i ulët publik nga të gjitha vendet krahasuese të rajonit.

Në dhjetor të vitit 2013 Qeveria e Kosovës ka hartuar strategjinë për borxhin shtetëror 2014 – 2017 i cili program është përpiluar në përputhje me legjislacionin përkatës për menaxhimin e financave publike si dhe të objektivave për menaxhimin e borxhit dhe rrezikut, planit vjetor të huamarrjes për vitin 2014 dhe strategjisë afatmesme të borxheve 2014 – 2017.

Objektivi kryesor i këtij Programi është të siguroj që deficitin buxhetor dhe nevojat buxhetore për shërbimin e borxhit, të financohen me koston më të ulët të mundshme gjithmonë brenda niveleve të pranueshme të rrezikut.

Sipas këtyre objektivave borxhi shtetëror do të menaxhohet në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Planin vjetor të huamarrjes do të synoj sigurimin e financimit efikas të deficitit buxhetor në përputhje me Ligjin Vjetor të Buxhetit
- Aktivitetet në tregjet vendore dhe ndërkombëtare do të kryhen me përgjegjësi, në mënyrë profesionale, transparente dhe në kohë.
- Me rastin e planifikimi të aktiviteteve për huamarrje të brendshme vëmendja do të fokusohet në zhvillimin afatgjatë të tregut në vend të përfitimeve të mundshme afat shkurtër.

Do të sigurohen kushtet më të favorshme për çdo transaksion të huamarrjes në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në këtë strategji.

Table Nr. 41 – Borxhi Publik i Kosovës 2014 - 2016

Vlerat në miliona Euro

	2014	2015	2016
Borxhi i jashtëm – Kreditë e drejtëpërdrejta	316.54	339.88	373.8
Borxhi i jashtëm –Kreditë e nën huazuara	9.81	28.90	
Letrat me vlerë nominale – Borxh vendor	259.52	380.55	479.00
Totali i borxhit	585.87	749.33	852.80
Pjesëmarrja në PBB	10.09 %	12.39 %	14.10 %

Burimi: Qeveria e Kosovës, Programi i borxhit publik 2016 - 2018

3.3 Zhvillimi i bizneseve në Kosovë

Pas përfundimit të luftës sado që një numër i madh i bizneseve ishin të dëmtuara në masë të madhe ato dalëngadalë filluan të rimarrin veten dhe të fillojnë aktivitetin e tyre ekonomik në fillim kryesisht në tregti kurse më vonë edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë. Gjithashtu gjatë kësaj kohe filloi edhe përgatitja e legjislacionit të nevojshëm me të cilin përcaktohet mënyra e regjistrimit të bizneseve ngase një pjesë e madhe e dokumentacionit të bizneseve ishte shkatërruar si rezultat i zhvillimeve të viteve paraprake. Nisur nga kjo filloi regjistrimi i bizneseve kryesisht në aktivitetet joprodhuese dhe në fund të vitit 2004 në Kosovë ishin të regjistruara 40907 biznese kryesisht të vogla të cilat kishin nga 1 deri 4 punëtorë dhe sipas statistikave 94% të bizneseve kishin këtë numër të punëtorëve kurse në fund të vitit 2008 në Kosovë ishin të regjistruara 67950 ku prapë përqindja ishte e njëjtë se mbi 94% të tyre ishin biznese të vogla që kishin të punësuar nga 1- 4 punëtorë.

Tabela Nr. 42 – Numri i bizneseve të regjistruara në fund të vitit 2004 në Kosovë

<i>Aktiviteti ekonomik</i>	<i>Biznese jo individuale</i>	<i>Biznese individuale</i>	<i>Gjithsej</i>
Bujqësia dhe peshkimi	41	433	474
Industria	480	3586	4066
Ndërtimtari	255	1862	2117
Prodhuesit e të mirave	776	5881	6657
Tregtia	1135	19486	20621
Hotele, Kafe dhe restorante	109	3383	3492
Transporti dhe komunikacioni	166	5556	5722
Shërbime të tjera	358	4067	4425
Prodhuesit e shërbimeve	1768	32492	34620
Gjithsej	2544	38373	40917

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, Seria 3, Statistikat ekonomike, Repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë 2004 – 2008 , faqe 11

Nga këto të dhëna të paraqitura nga Enti Statistikor i Kosovës shohim se në fund të vitit 2004 nga gjithsej 40917 biznese të regjistruara vetëm 6657 ishin biznese që ofronin aktivitete prodhuese respektivisht 16.26 % të tyre. Nga ana tjetër sa i përket formës së regjistrimit të tyre prej gjithsej 40917 biznese të regjistruara 93.78 ishin biznese individuale kurse pjesa tjetër kishte forma të tjera të regjistrimit duke përfshirë persona juridikë, ndërmarrje shoqërore, ortakëri apo edhe forma të tjera të parapara me legjislacionin mbi shoqëritë tregtare në Kosovë. Gjithashtu pjesëmarrja e bizneseve prodhuese me status të personit tjetër ndaj atij individual në fund të vitit 2004 ishte 11.65% ndaj 88.35% respektivisht 776 biznese ishin prodhuese jo individuale.

Bizneset e regjistruara, të cilat zhvillojnë aktivitet ekonomik në Kosovë janë kryesisht biznese të vogla të cilat kanë nga 1 deri 10 punëtorë. Klasifikimi i bizneseve në

Kosovë në të vogla, të mesme dhe të mëdha bëhet varësisht për qëllimet e institucionit kështu që një klasifikim për madhësinë e ndërmarrjeve bëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nga ESK, nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe nga ATK.

Tabela Nr. 43 – Numri i bizneseve të regjistruara në fund të vitit 2008 në Kosovë

Aktiviteti ekonomik	Biznese jo individuale	Biznese individuale	Gjithsej
Bujqësia dhe peshkimi	275	1009	1284
Industria	1278	5467	6745
Ndërtimi	725	3093	3818
Prodhuesit e të mirave	2278	9569	11847
Tregtia	2548	28896	31444
Hotele, Kafe dhe restorante	328	6180	6508
Transporti dhe komunikacioni	468	8476	8944
Shërbime të tjera	1324	7883	9207
Prodhuesit e shërbimeve	4668	51435	56103
Gjithsej	6946	61004	67950

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, Seria 3, Statistikat ekonomike, Repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë 2004 – 2008, faqe 13

Nga tabela e paraqitur më lart shohim se numri i bizneseve të regjistruara si aktive që ushtronin aktivitetin prodhues në krahasim me fundin e vitit 2004 ishte rritur nga 16.26% në 17.43 % por kjo nuk kishte ndikuar në zhvillimin e hovshëm të kapaciteteve prodhuese. Gjatë kësaj periudhe kishte një rritje të bizneseve të regjistruara prodhuese jo individuale në krahasim me ato individuale dhe kjo përqindje ishte 19.22% ku nga numri total i bizneseve prodhuese të regjistruara në fund të vitit 2008 që ishin 11847, 2278 kishin status jo individual e cila kishte një domethënie për shkak se për ngritjen e kapaciteteve prodhuese nevojitej një kapital më i madh dhe kishte ardhur në shprehje rritja e investimeve

të huaja apo bashkimi i dy apo më shumë personave me qëllim të krijimit të personave juridik si dhe vinte në shprehje fakti i cili ishte paraqitur në shembullin më lart se për fitim të njëjtë varësisht nga forma e regjistrimit të shoqërisë tregtare duhej të paguhej më shumë apo më pak tatim. Edhe pse numri i bizneseve të regjistruara ishte shumë më i madh por një numër i tyre vetëm se ishte regjistruar si biznese por nuk e zhvillonin afarizmin e tyre prandaj kishte një dallim mjaftë të madh në mes të bizneseve të regjistruara dhe të atyre që ishin aktive.

Për qëllime të këtij punimi të doktoratës në klasifikimin e bizneseve kemi marrë klasifikimin sipas ESK ku sipas tyre numri i bizneseve aktive të gjitha llojeve nga viti 2008 deri në vitin 2013 ka qenë si më poshtë:

Tabela Nr. 44 – Numri bizneseve sipas Entit Statistikor të Kosovës

Sektorët ekonomike	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Xehetari dhe gurëthyes	206	199	204	201	229	149
Prodhim	4065	4103	4112	4246	4598	3736
Furnizim me energji elektrike	46	52	63	9	68	28
Ndërtimtari	2362	2456	2564	2702	3038	2094
Tregti me shumicë dhe pakicë	20815	21125	19775	19791	20509	16091
Transport	1213	1228	1135	1168	1160	1166
Akomodim	3498	3559	3364	3459	3715	3126
Teknologji Informative	3615	3706	3731	3696	3563	626
Furnizim me ujë dhe veprimtari publike	1414	1449	1874	1546	1685	144
Shërbime të tjera	3891	4209	4241	4558	3192	1897
Totali	41124	42086	41063	41425	41757	29057

Burimi: ESK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2015, faqe 161

Numri total i bizneseve aktive në fund të vitit 2013 sipas ESK ka qenë 29057 pasi në këtë vit nuk janë përfshirë ato të cilat nuk kanë deklaruar të gjitha llojet e tatimeve.

Sa i përket sektorëve ekonomikë numri më i madh i bizneseve i takon tregtisë me 16091 biznese apo shprehur në përqindje (55.4%), industria përpunuese 3736 (12.9%), akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 3126 (10.8%), ndërtimtaria me 2094 (7.2%), shërbimet bizneseve dhe shërbimeve të tjera me 1897 (6.5%), transporti, depot dhe telekomunikacioni me 1166 (4.0%), informacione dhe komunikim me 626 (2.2%), industria nxjerrëse 149 (0.5%), furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete të përmirësimit të tokës me 144 (0.5) si dhe prodhimi, furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të freskët arrijnë rreth 28 (0.1%).

Sa i përket radhitjes të bizneseve sipas madhësisë së tyre sipas ESK ndahen sipas numrit të punëtorëve dhe atë:

Tabela Nr. 45 – Ndarja e bizneseve sipas madhësisë së tyre

Klasifikimi	Numri i punëtorëve
Mikro njësi	1 - 9
Biznese të Vogla	10 - 49
Biznese të Mesme	50 - 249
Biznese të Mëdha	Mbi 250

Burimi: ESK, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2015, faqe 167

Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve në Kosovë janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe sipas strategjisë për zhvillimin e NVM –ve për periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2016 të zhvilluar nga MTI dhe Agjencia për mbështetjen e NVM qëllimi kryesor i kësaj strategjie është përmirësimi i mjedisit të biznesit me qëllim të rritjes së shpejtë dhe të qëndrueshme të NVM dhe kjo strategji është ndër sektoriale dhe përfshin një numër të institucioneve shtetërore përgjegjëse për zbatimin e saj. Kjo strategji ka identifikuar një tërësi mangësish në sektorin e NVM veçanërisht mungesën e rritjes së shpejtë të ndërmarrjeve që merren me

inovacione dhe të cilat mund të kenë ndikim kryesor në krijimin e vendeve të punës. Kjo strategji me qëllim të zhvillimit të NVM ka përcaktuar shtatë qëllimet kryesore të cilat do të kishin efekt dhe do të përmirësonin gjendjen e NVM. Këto shtatë qëllimet kryesore janë si në vijim: 1) Përmirësimi i kornizës legislative, 2) Qasja në financa, 3) Kultura e ndërmarrësish, 4) Konkurrenca e NVM-ve, 5) Partneriteti Publiko – privat; 6) Forcimi i institucioneve të cilat do të mbështetnin NVM si dhe 7) Grupet minoritare.

Me qëllim të zhvillimit të bizneseve në Kosovë janë disa programe qeveritare dhe jo qeveritare të cilat si nga aspekti i asistencës teknike por edhe të financimit të bizneseve kanë ndihmuar NVM nëpër periudha të ndryshme pas vitit 1999 e këndej. Disa nga projektet që kanë ndihmuar NVM kanë qenë **Projekti i Asistencës Teknike për Mjedisin e Biznesit**, financuar nga Banka Botërore, ka vepruar midis viteve 2005 dhe 2012. Qëllimi kryesor i programit ishte për të përmirësuar mjedisin e biznesit duke ulur pasigurinë e proceseve kyçe, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të lidhura si dhe forcimin e të drejtave pronësore.

Zhvillimi i Biznesit të Kosovës është një projekt i financuar bilateral nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme në mes të vitit 2011 dhe 2013. Ky projekt ka qenë i fokusuar në krijimin e një inkubatori të biznesit dhe inovacionit. Tema e përgjithshme ishte që të rrisë kompetencën dhe për të inkurajuar inovacionin dhe ndërmarrësin, veçanërisht në mesin e grave dhe të rinjve.

Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) filloi të punojë në Kosovë në vitin 1999 dhe ende vazhdon ndihmën për bizneset dhe institucionet qeveritare. Programi aktual fokusohet në tre fusha që janë me prioritet: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimimin dhe administratën publike, demokracinë dhe shoqërinë civile. GIZ

është duke i ofruar përkrahje qendrave të kompetencës në Kosovë në disa sektorë të tilla si kozmetike, shërbime, shëndetësi, dhe TIK.

Menaxhimi Turn Around (MTA) dhe Shërbimet Këshillimore të Biznesit (SHKB) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) janë programe plotësuese të asistencës teknike që kombinojnë ndihmë të drejtpërdrejtë në nivelin e ndërmarrjes për NVM-të e qëndrueshme përmes një vargu të gjerë të sektorëve të industrisë. MTA ka për qëllim të ndërtojë një drejtim të fortë e kompetent të ndërmarrësish dhe ristrukturimin nëpërmjet transferimit të praktikave më të mira ndërkombëtare për NVM-të.

USAID (Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara) është përqendruar kryesisht në Kosovë për mbështetjen e rritjes ekonomike, demokracisë, dhe qeverisjes dhe iniciativat e posaçme dhe programet ndër sektoriale që trajtojnë çështje të tilla si të rinjtë ose zbutja e konflikteve jashtë objektivës të saj thelbësore tematike.

Me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes në Kosovë janë bërë një numër i reformave jo fiskale nga viti 2012 e këndej dhe fiskale nga viti 2015 të cilat kanë bërë që Kosova të ketë një ngritje në përmirësimin e kushteve të bërit biznes kështu sipas raportit të bankës botërore për të bërit biznes Kosova në vitin 2011 ka qenë në vendin 119 kurse në vitin 2015 ajo fal një numri të reformave kryesisht jo fiskale është ngritur në vendin e 75.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim renditjen e Kosovës në të bërit biznes në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2015.

Tabela Nr. 46 – Renditja e të bërit biznes e Kosovës sipas Bankës Botërore

Viti	2011	2012	2013	2014	2015
Renditja e përgjithshme	119	117	96	86	75
Fillimi i biznesit	163	165	126	100	42
Marrja e lejeve të ndërtimit	173	169	152	136	135
Furnizimi me energji elektrike		120	120	121	112
Regjistrimi i pronës	65	66	75	58	34
Marrja e kredisë	32	24	24	28	23
Mbrojtja e investitorëve minoritar	173	172	95	98	62
Pagesa e tatimeve	41	45	42	43	63
Tregtia jashtë vendit	130	129	122	121	118
Zbatimi i kontratave	155	157	139	138	138
Zgjidhja e jo likuiditetit	31	31	86	83	164

Burimi: Banka Botërore 2016

3.3.1 Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

Ekonomia e Kosovës karakterizohet me një deficit të madh tregtar që nga viti 2001 deri në tërë periudhën krahasuese të pasqyruara në këtë punim. Ky deficit tregtar, me gjithë masat për zbutjen e tij, përsëri mbetet shumë i lartë dhe dëshmon se në Kosovë ka nevojë për ndryshime rrënjësore në krijimin e kushteve më të mira të afarizmit për bizneset e cila do të kishte një ndikim në thithjen e investimeve të huaja, të cilat do të mund të ishin një promotor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Nevojiten reforma rrënjësore jo vetëm në fushën e politikave fiskale por ato duhet të shoqërohen edhe me një numër të madh komponentësh të tjerë të cilat vlerësohen nga investitorët e jashtëm. Kosova është një treg i vogël prej më pak se 2 milion banorë dhe vetëm ofrimi i kushteve shumë të favorshme për

investitorët nëpërmjet instrumenteve fiskalë dhe jo fiskalë do të ndikonte pozitivisht në vendimet e investorëve potencialë për investimin e kapitalit të tyre. Krijimi i një ambienti të shëndoshë të zhvillimit të aktiviteteve të bizneseve e me norma më të ulëta tatimore në fusha të caktuara, ku përparësitë krahasuese vijnë në krahasim me ekonomitë e vendeve të tjera, fuqizimi i sistemit të drejtësisë, negociata të drejtpërdrejta me investitorë strategjikë, përmirësimet e kushteve të bërit biznes, siguria e kapitalit, janë disa nga parakushtet të cilat do të ndikonin në rritjen e prodhimtarisë vendore dhe në zvogëlimin e deficitit të madh tregtar me të cilën karakterizohet ekonomia e Kosovës gjatë gjithë periudhës nga përfundimi i luftës në vitin 1999 deri tani.

Edhe pse, siç u tha edhe më lart, nga viti 2001 disa herë janë bërë ndryshime të politikave fiskale, ato përsëri kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk kanë qenë të shoqëruara me masa të tjera jo fiskale. Këto politika fiskale më shumë ka qenë e orientuar në ndërrimin e normave tatimore dhe jo në analizën e situatës së përgjithshme makroekonomike e cila do të çonte në një zhvillim të i qëndrueshëm ekonomik dhe zbutje të papunësisë.

Se sa ka qenë ky deficit i madh tregtar këtë e tregon tabela në vijim, që përfshin periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2016.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë shohim se përqindja e mbulimit të eksportit me import është shumë e ulët, nga 1.5% në vitin 2001 në 11.7% në vitin 2016. Kjo tabelë tregon për një deficit të madh tregtar, i cili sado në përqindje të mbulimit të eksportit me import, ka përsëri zvogëlim në vlerë. Ky mbulim nga viti në vit ka ardhur duke u rritur dhe në vitin 2001 diferenca në mes të eksportit me import ishte 673,941,000.00 euro kurse në vitin 2016 kjo diferencë ishte 2,480,020,000.00 Euro. Kjo dëshmon edhe njëherë për nevojën e menjëhershme të ndërmarrjes së hapave nga ana e

qeverisë pikësëpari për stimulimin e prodhimit vendor dhe gjetjen e mekanizmave për stimulimin e eksportit veçanërisht të prodhimeve strategjike, të cilat kanë ndikim më të madh në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Përqindja e mbulimit të eksportit me import asnjëherë nuk ka qenë mbi 13.7 % dhe në vitin 2016 ky mbulim ka rënë në 11.7 %.

Tabela Nr. 47 – Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme të Kosovës Vlerat në 000 Euro

Viti	Eksportet	Importet	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4.9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10.3
2009	165,328	1,935,541	-1,770,213	8.5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,769	13.7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,184	12.8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11.0
2013	293,842	2,449,064	-2,155,221	12.0
2014	324,543	2,538,337	-2,213,794	12.8
2015	325,294	2,634,693	-2,309,399	12.3
2016	309,688	2,789,708	-2,480,020	11.7

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme, 2016 , faqe 9, Janar 2017

Sa i përket strukturës së importit nga viti 2008 deri në vitin 2013 me vende të ndryshme ka strukturë si më poshtë:

Tabela Nr. 48 – Struktura e importit sipas vendeve në përqindje në periudhën 2005 – 2013

Vendet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BE	37.9	34.8	36.3	36.4	39	38.3	38	39	41.2
CEFTA	38	41.1	36.8	37.2	35.8	37.2	35.1	33.7	30.6
EFTA	1.6	1.8	2.1	1.8	1.2	1.1	1.0	1.1	0.9
Vendet tjera EU	8.4	8.4	7.5	7.3	7.7	7.2	7.7	8.3	8.7
Vendet tjera jo EU	3.1	2.5	3.1	3.7	3.5	3.0	3.6	3.7	4.2
Vendet nga Azia	6.1	6.5	7.5	7.0	7.6	7.2	7.6	7.4	7.3
Të tjera	4.8	4.9	6.7	6.6	5.1	6.1	7.1	6.8	6.0
Totali	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme, 2013 , faqe 207, Dhjetor 2015

Partnerët kryesorë tregtarë gjatë vitit 2013, nga Bashkimi Europian, kanë qenë Italia me importe në vlerë prej 228,519,000.00 Euro dhe eksporte në vlerë prej 74,363,000.00 Euro, Italia dhe Gjermania me importe në vlerë prej 252,594,000.00 Euro dhe eksporte në vlerë prej 10,85,000 Euro kurse shkëmbimet më të mëdha tregtare me vendet e rajonit janë me Maqedoninë, Serbinë dhe Shqipërinë.

Më poshtë paraqesim tabelën mbi importet dhe eksportet me partnerët kryesorë ekonomikë:

Tabela Nr. 49 – Partnerët kryesor tregtar të Kosovës në vitin 2013**Vlerat në 000 Euro**

Vendi	Eksporti	Importi	Bilanci Tregtar
Italia	74,363	228,519	-154,156
Shqipëria	43,774	110,597	-66,823
India	28,953	14,429	14,523
Maqedonia	26,139	185,020	-158,880
Mali i Zi	17,310	11,387	5,923
Serbia	14,463	285,356	-270,892
Gjermania	10,985	252,594	-241,609
Turqia	7,393	204,922	-197,529

Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës, Statistikat e tregtisë së jashtme, 2013 , faqe 208, Dhjetor 2015

3.4 Konkureshmëria, dhe krahasimet me vendet e ndryshme

Për çdo ekonomi është shumë e rëndësishme sa ajo është konkureshme me mallrat, shërbimet dhe faktorët e tjerë ndaj ekonomive të vendeve të regjionit apo edhe më gjerë. Me qëllim të rritjes së konkurrencës së një vendi ndaj vendit tjetër i cili synim kryesor ka rritjen e investimeve të huaja në vende të ndryshme janë bërë një numër i madh reformash të cilat stimulojnë korporatat e ndryshme për të investuar kapitalin e tyre tek vendet e treta. Kjo do të ndikonte në rritjen ekonomike, rritjen e PBB dhe zvogëlimin e shkallës së papunësisë me të cilën sot ballafaqohet një numër shumë i madh i vendeve të botës jo vetëm në vendet e pazhvilluara apo në zhvillim por edhe i vendeve të zhvilluara Europiane apo edhe më gjerë. Aftësia konkureshme e ekonomisë së një vendi është rezultat i masave dhe veprimeve sistematike dhe të instrumenteve të politikës makroekonomike, rrethit ku vepron, si dhe aftësive drejtuese, komerciale si dhe të një grumbullit të faktorëve gjeografikë, organizativë dhe demografikë që ndikojnë në aftësinë konkurruese të ekonomisë.

Ruajtja e një rritje ekonomike të qëndrueshme është e pa imagjinueshme pa rritjen e konkurrencës dhe modernizimin e ekonomisë e cila mund të vijë si rezultat i aktiviteteve që lidhen me inovacione dhe aktiviteteve tjera, të rritjes së njohurive teknike dhe profesionale të fuqisë punëtore.

Reformat që ndërmerren nga shtetet e ndryshme janë të shumfishta, por një numër i madh reformash janë bërë edhe në politikat fiskale dhe tatimore, ku secili vend, bazuar në kushtet e veta apo edhe në vendimet politike, ndërmerr reforma të tilla që mendon se do të japin rezultate më të mira në aspektin makroekonomik.

Forcimi i produktivitetit dhe konkurrencës duhet të jetë një ide themelore në zbatimin e politikave ekonomike. Masat e shpejta dhe të mira të drejtimit në ekonomi të cilat ndikojnë

në rritjen e konkurrencës së ekonomisë së një vendi mund të sigurojnë një rrugë të duhur të zhvillimit ekonomik dhe më tej edhe të rritjes së mirëqenies sociale. Këto masa duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe si qëllim primar kanë rritjen e konkurrencës. Në konkurueshmërinë e një vendi ndikojnë shumë faktorë por nga të gjitha më e rëndësishme është konkurueshmëria e ndërmarrjeve për shkak se ato janë bartës të zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye kur të flasim për konkurueshmërinë bizneset janë të vendosura në plan të parë në raport me faktorët e tjerë të cilët e karakterizojnë makroekonominë. Gjithsesi nuk duhet të anashkalohen edhe faktorët tjerë që na rrethojnë dhe të cilët kanë ndikim të rëndësishëm në konkurrencën e sektorëve të veçantë ekonomikë.

Një grup i faktorëve të cilët ndikojnë në konkurueshmëri janë edhe shpenzimet e larta të afarizmit të bizneseve, ngarkesa fiskale, borxhi jashtëm i një vendi, mos stimulimi i bizneseve në inovacione të cilat do të kishin ndikim në rritjen e konkurrencës, infrastruktura dhe kushtet e tjera në të cilat zhvillojnë aktivitetin bizneset. Një pengesë në rritjen apo zvogëlimin e konkurueshmërisë janë edhe pengesat që mund të bëhen bizneseve nga institucionet veçanërisht institucionet lokale por në konkurueshmëri mund të ndikojnë edhe interesat afat shkurtër të shtetit si kontrolli i çmimeve, legalizimi i monopolit, konkurrenca në mes të vetë institucioneve, politikat jo transparente të shtetit lidhur me përkrahjen e bizneseve të ndryshme por edhe mbrojtja e pa bazuar e ekonomisë.

Rreth aftësisë konkuruese janë bërë studime të shumta dhe si teori e parë e konkurueshmërisë është ajo merkantiliste ku sipas kësaj teorie, ari dhe argjendi janë pasuri e vetme shoqërore prandaj me masat e politikave të tregtisë së jashtme duhet të mundësohet që ari dhe argjendi të fitohet nga eksporti kurse më pak të harxhohet me import.

Adam Smithi me teorinë e tij të përparësive absolute theksonte se nuk ka nevojë për mbrojtje të tregut dhe se tregtia e lirë është zgjidhja më e mirë. Nga ana tjetër David Rikardo është i njohur me teorinë e përparësive krahasuese ku sipas tij një shtet duhet të prodhojë ato produkte që kanë produktivitet më të lartë kurse prodhimet me produktivitet të ulët duhet ti ja lërë vendeve të tjera.

Sipas teorive bashkëkohore theksohet se teknologjia ndikon në prodhim dhe faktorët e prodhimit dhe ndikimi më i madh është në prodhimet e reja deri sa ajo teknologji të mos imitohet nga vendet e tjera dhe se shtetet dhe bizneset kur të përfundojë konkurueshmëria e teknologjisë për prodhimin e një produkti duhet të orientohet në inovacione dhe gjetje të teknologjive të reja për prodhimin e produkteve tjera.

Pra me fjalë të tjera të jesh konkurues do të thotë të jesh më superior ndaj konkurentëve që gjenden në treg.

Gjithsesi rritja e vazhdueshme e ekonomisë globale ka bërë që të studiohen dhe analizohen faktorët që ndikojnë në konkurrencë dhe të jepen definicione të ndryshme për te edhe pse nuk mund të themi se ka një qasje të qartë të definicionit dhe të matjes së konkurrencës. Kështu Porter (1990) thekson se edhe pse ka definicione të ndryshme për konkurrencën nacionale ajo është një fenomen makroekonomik që varet prej kurseve valutore, normave të kamatave, deficitit buxhetor por edhe të fuqisë së lirë punëtore.

Po ashtu Porter (1995) thekson se konkurrenca nënkupton produktivitet që realizohet duke përdorur fuqinë punëtore, kapitalin dhe resurset natyrore dhe se ajo është e lidhur me burimet që posedon ekonomia e një vendi dhe ajo paraqet një masë të standardit jetësor të popullatës.

Kurse Trabolda (1994) thekson katër faktorë që ndikojnë në konkurrueshmërinë e një vendi janë:

- 1) Mundësia e shitjes së mallrave në tregun global – eksporti,
- 2) mundësia e tërheqjes së investimeve,
- 3) mundësia e përshtatjes së ekonomisë si dhe
- 4) mundësia e krijimit dhe rritjes së të ardhurave që janë në dispozicion.

Nga ana tjetër sipas OSBE (1992) është i pranuar qëndrimi se konkurrueshmëria definohet si hap ku sipas kushteve të favorshme të tregut vendi mund të prodhojë mallra dhe shërbime të cilat plotësojnë kushtet e konkurrueshmërisë ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë mundësojnë rritjen e ekonomisë vendore dhe standardit të popullatës.

Kurse forumi ekonomik botëror (WEF,2012) e definojnë konkurrueshmërinë si një tërësi e institucioneve, politikës dhe faktorëve të tjerë të cilët përcaktojnë nivelin e produktivitetit të vendit dhe i cili produktivitet përfaqëson nivelin e qëndrueshmërisë të prosperitetit që një ekonomi mund të arrijë.

Nga ana tjetër Berger (2013) thekson se infrastruktura, aftësia për inovacione dhe sistemi arsimor janë bartësit e konkurrueshmërisë në Evropë.

Rëndësia për rritje ekonomike dhe rritje të transaksioneve ndërkombëtare ka ndikuar në rritjen e konkurrencës së ekonomisë vendore duke ndikuar në sistemet e taksave të korporatave për të akomoduar dhe përgatitur legjislacionin tatimor, për të marrë parasysh investimet e huaja. Ndërmarrja e këtyre masave nuk ka qenë një proces i lehtë apo i thjeshtë. Kështu zhvillimi i politikave tatimore është bërë me qëllim të arritjes së rezultateve të tilla që do të mundësonin jo vetëm investime më të mëdha nga jashtë por edhe rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve që ishin dhe zhvillonin aktivitetet brenda

vendit dhe ndërmarrja e gjithë këtyre masave shoqërohet edhe me vështirësi të tjera të cilat mund të shoqërohen me më pak tatime të drejtpërdrejta të paguara në buxhetin e shtetit gjë e cila nëse nuk jep efektet e dëshiruara duhet të kompensohet me tatime të tjera të konsumit.

Sipas raportit të bankës botërore nga viti 1980 kemi një rritje të madhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe kjo ka ndodhur për shkak të lehtësirave tatimore që vendet e ndryshme ofrojnë për bizneset e ndryshme me qëllim të transferimit të kapitalit në vendet e tyre e kjo jo vetëm me zvogëlimin e shkallëve të ndryshme tatimore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetet në një vend por edhe me negociata të drejtpërdrejta me investitorë strategjikë të cilëve iu krijohen një mori kushtesh duke përfshirë edhe taksa preferenciale për tatime të drejtpërdrejta që kanë të bëjnë më tatimin në korporata apo edhe tatimeve të tjera të cilat rrisin konkurrencën e vendit në të cilën do të bëhen këto investime apo edhe taksa preferenciale për industri të veçanta Shtetet e caktuara konsiderojnë se ajo pjesë e industrisë ka efekte të tërësishme në ekonomi. Ka shtete të cilat me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së investimeve të huaja kanë bërë edhe legjislacione të tilla që përcaktojnë se cilat biznese mund të lirohen nga pagimi i tatimit në korporata në rrethana të caktuara. Kështu Desai (1999) sugjeron që praktikat e tatimeve të jashtme janë të dizajnuar në mënyrë që tentojnë të bëjnë dallime në mes kapitalit të lëvizshëm dhe atij më pak të lëvizshëm duke ofruar kushte më shumë atraktive për kapitalin e lëvizshëm. Gjithashtu është një karakteristikë tjetër se korporatat e mëdha arrijnë të ndikojnë në shtetet e vogla që të transferojnë kapitalin e tyre aty dhe të paguajnë taksa më të vogla dhe pjesën e taksave të larta që paguajnë në shtetet e mëdha ta kompensojnë më taksat e ulëta që paguajnë në shtetet e vogla ku kanë transferuar kapitalin e tyre. Kështu Harris (1993)

thekson se gjatë analizimit të korporatave multinacionale amerikane për periudhën nga 1984 deri në vitin 1988 gjen se ato kanë paguar më pak tatime për filialet e tyre në vendet e ndryshme si rezultat i marrëveshjes me qeveritë e vendeve ku kanë transferuar filialet e tyre.

Në aspektin global tatimet në të ardhura të korporatave sipas data bazës botërore të tatimeve të analizuara në 68 vende të ndryshme kanë rënë nga 45.9 % që ishin në 1982 në 32.9 % në vitin 1999. Sipas hulumtimit si shembull marrim nivelin e tatimit në të ardhura në korporata që kanë paguar kompanitë multinacionale amerikane për aktivitetet e tyre jashtë vendit në vitin 1982. Ata kanë paguar mesatarisht 46 % tatim në të ardhura të korporatave kurse në vitin 1999 kjo pagesë kishte rënë në 26 % kurse pjesëmarrja e tatimit në të ardhura të korporatave në nivelin global në PBB u rrit nga 2.1 % që ishte në vitin 1982 në 2.4 % në vitin 1999.

Sipas hulumtimeve të kryera nga shkencëtarë të ndryshëm, në shumicën e rasteve konstatohet se vendet e vogla me qëllim të rritjes së konkurrencës prijnë me norma më të ulëta të tatimeve për bizneset në krahasim me vendet e mëdha të cilat në shumicën e rasteve kanë norma më të larta të tatimeve në biznese. Kështu Bretschger and Hettich (2002) analizojnë normat e tatimit të bizneseve në mes të vendeve me madhësi të ndryshme në 14 vende të OECD në periudhën nga viti 1967 dhe 1996 dhe raportojnë se vendet e vogla kanë norma efektive të taksave në korporata në krahasim me vendet e mëdha që kryesisht aplikojnë norma më të larta.

Përveç zvogëlimit të tatimit në të ardhura të korporatave që është aplikuar nga shumica e vendeve e veçanërisht vendeve të vogla, një element i cili mund të ndikojë në rritjen e konkurrueshmërisë është edhe dhënia e granteve dhe subvencioneve të ndryshme për

sektorë të caktuar ekonomikë që kanë një rëndësi strategjike për vendin si në aspektin e punësimit, rritjes ekonomike apo edhe në rritjen e mirëqenës së përgjithshme të qytetarëve. Deri tani në këtë pjesë dhamë disa informata mbi tentimin e shteteve për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore prandaj në vazhdim do të shqyrtojmë aspektin makroekonomik të konkurrencës i cili ka të bëjë më shumë me konkurrencën e ekonomisë si tërësi ndaj vendeve të tjera dhe aspektin mikroekonomik të konkurrencës që ka të bëjë me konkurrencën e bizneseve të një vendi ndaj bizneseve të tjera.

3.4.1 Qasja makroekonomike në konkurrencë

Në aspektin makroekonomik kemi të bëjmë me konkurrencën e ekonomisë së një vendi në tërësi ndaj vendeve të tjera ku në të ndikojnë një numër i caktuar faktorësh ekonomikë, politikë, strategjikë, madhësia e tregut, pozita gjeografike, lidhjet me vendet e tjera dhe shumë faktorë të tjerë të cilët mund të determinojnë pozitën e saj në rangun ndërkombëtar. Duke pasur parasysh se çdo vendi ka edhe specifikat e tij në konkurrencën ndaj një vendi tjetër dalin në pah përparësitë krahasuese që ka një ekonomi ndaj një ekonomie tjetër siç mund të jenë resurse të bollshme natyrore në krahasim me vendet e tjera, teknologji të avancuar në krahasim me teknologjinë në vendet e tjera, fuqi punëtore të kualifikuar, të mjaftueshme dhe më të lirë në krahasim me vendet tjera dhe një numri të faktorësh të tjerë jo vetëm ekonomikë por edhe politikë.

Sipas aspektit makroekonomik konkurrueshmëria nacionale mund të definohet si aftësi e vendit të arrijë rritje ekonomike më shpejtë se vendet e tjera dhe të rris mirëqenjen e vendit në atë mënyrë që struktura ekonomike e një vendi mund të ndryshojë dhe ti përshtatet ndërrimeve të ekonomisë ndërkombëtare, Bienkowski (2006).

Nga ana tjetër ka edhe qasje tjetër për dallimet në konkurueshmëri kështu Krugman (1994) thekson se ka dallime të rëndësishme në mes të konkurueshmërisë së ekonomisë së një vendi dhe të konkurueshmërisë së bizneseve dhe se konkurueshmëria është një dukuri e pakuptimtë kur aplikohet në lidhje me ekonominë nacionale.

Por në grupin e faktorëve makroekonomikë përveç të tjerash kanë ndikim edhe politikat fiskale respektivisht masat që ndërmerr shteti për të rritur konkurrencën e ekonomisë së tij ndaj vendeve të tjera dhe që mund të përfshihen jo vetëm normat tatimore që aplikohen për lloje të ndryshme të tatimeve por edhe mundësia e krijimit të zonave të lira tregtare, subvencionimi i lëmenjve të ndryshëm ekonomikë, shpejtësia dhe liria e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve të vendit në krahasim me vendet e tjera dhe një mori faktorësh të tjerë të cilët janë përcaktuese në aftësitë konkurruese të ekonomisë së vendit.

Me qëllim që të shihet ndikimi makroekonomik i politikave fiskale ajo mund të shikohet nga aspekti afatshkurtër dhe afatgjatë që ka në ekonominë e një vendi. Kështu në aspektin afatshkurtër nëse kemi si shembull zvogëlimin e ndonjë takse ajo mund të ndikojë në kërkesën e përgjithshme si rezultat i rritjes së konsumit të artikujve të caktuar të cilët si rezultat i zvogëlimit të ndonjë norme tatimore janë më të kërkuara në tregun e vendit apo edhe jashtë.

Në aspektin afatgjatë zvogëlimi i ndonjë tatimi mund të ndikojë në mënyrë stimuluese që të punohet më shumë, të kursehet më shumë dhe si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të mund të investohet në të ardhmen në rritjen e kapaciteteve prodhuese.

Një element shumë i rëndësishëm në rritjen e konkurrencës është i lidhur ngushtë edhe me mundësitë e inovacioneve të cilat do të kishin ndikim në rritjen e konkurrencës së

ekonomisë. Nivelet e larta të konkurrencës në tregjet e produktit kontribuojnë në rritjen e PBB për kokë banori, duke stimuluar rishpërndarjen e burimeve drejt aktiviteteve më produktive, konkurrenca mund të rrisë fitimet shtesë nga inovacioni dhe në këtë mënyrë të inkurajojë investimet. Më shumë konkurrencë mund të nxisë inovacionin dhe rritjen për shkak se ajo mund të reduktojë të ardhurat para zbulimit të firmës më shumë se redukton të ardhurat pas periudhës së zbulimit të bërë nga ana e shoqërisë tregtare.

Duke pasur parasysh se ekonomia e Kosovës së pari krahasohet me konkurrencën e ekonomive të regjionit nga analizat e bëra shihet se mes viteve 2000 dhe 2008 ekonomitë e vendeve të regjionit kishin përjetuar një rritje mjaft të shpejtë ekonomike, pa norma të larta të inflacionit dhe kishin një rritje të stabilitetit makroekonomik dhe mikrofinanciar. Kjo periudhë kishte krijuar një situatë të rritjes së konkurrencës së ekonomive të regjionit por jo edhe të Kosovës pasi ishte periudha e pasluftës ku Kosova doli nga ajo e shkatërruar jo vetëm në aspektin e infrastrukturës por dhe dëmtime të mëdha të ekonomisë. Gjatë viteve 2000 deri në 2005 Kosova kishte marrë donacione të shumta nga vendet mike jo vetëm për krijimin dhe mbajtjen e një stabiliteti financiar por edhe për ngritjen e kapaciteteve ekonomike të cilat do të rrisnin prodhimtarinë vendore dhe konkurrencën.

Por kriza e fundit ekonomike financiare botërore e vitit 2007 dhe 2008 dhe viteve pasuese e cila siç u tha më lart filloi si krizë bankare e më vonë mori përmasa të tjera me efekte shumë negative. Edhe pse me më pak ndikim se në vendet e tjera pasi kjo krizë tek vendet e tjera të Ballkanit kishte ndikim në një rënie të mprehtë në tregtinë e jashtme dhe në prodhimin industrial në të gjithë rajonin ajo prapëseprapë reflektoi dhe pati pasoja të drejtpërdrejta në disa vende kurse në disa vende të tërthorta si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik. Në vendet me të cilat ekonomitë e vendeve të Ballkanit kishin transaksione

ekonomike, financiare dhe një numër të transaksionesh të tjera ajo u ndje më pak. Kriza nënvizoi faktin se rritja ekonomike tek vendet e Ballkanit para vitit 2008 është mbështetur në një masë të madhe në llogaritë rrjedhëse të jashtme financiare veçanërisht llogaritë rrjedhëse të Investimeve të Huaja të drejtpërdrejta dhe bartjet ndërkombëtare të kapitalit që kompensuan tregtinë e madhe dhe të paqëndrueshme dhe deficitet e llogarisë aktuale. Kjo krizë ka detyruar qeveritë në rajon për të bërë zgjedhje të politikave të tilla të cilat do të kenë implikime për rritjen e konkurrencës së tyre afatgjatë dhe në të përfshihen ndërmarrja e një numri të madh reformash strukturale dhe fiskale të cilat do të mundësonin dhe do të kishin ndikim në ekonominë në tërësi. Kosova për shkak të strukturës së vet ekonomike shkallës së ulët të prodhimtarisë, shkallës së ulët të eksportit dhe nivel shumë të lartë të importeve të mallrave u prek më pak se ekonomitë e tjera kryesisht tek dërgesat e mjeteve monetare nga qytetaret që punojnë në vendet që janë prekur nga kjo krizë por kjo nuk do të thotë se kjo krizë nuk ka pasur efekte të tjera negative edhe në ekonominë e Kosovës e cila edhe sot ka një strukturë tejet të pavolitshme të bilancit tregtar dhe të pagesave më ekonomitë tjera kryesisht me vendet e regjionit por edhe me vendet e tjera Evropiane nga të cilat kryesisht importon e shumë pak eksporton.

3.4.2 Qasja mikroekonomike në konkurrencë

Deri sa në aspektin makroekonomik kemi të bëjmë me konkurrencën e ekonomisë së një vendi ndaj asaj të vendit tjetër analizimi i aspektit mikroekonomik të konkurrencës ka të bëjë me mundësitë që kanë bizneset e një vendi ndaj vendit tjetër, ndihmesa që mund të japë shteti për bizneset e atij vendi, stimulimi i eksportit për bizneset specifike, subvencionimi i aktiviteteve të caktuara të cilat mund të jenë strategjike për një ekonomi.

Qasja në infrastrukturë e këtyre bizneseve, teknologjia që aplikojnë ato në prodhimtari, përgatitja profesionale e të punësuarve dhe aftësia e tyre për tu adaptuar inovacioneve dhe kërkesave të ekonomisë bashkëkohore janë mundësi të tjera në këtë drejtim.

Një ndër faktorët përcaktues në konkurrencën e një biznesi ndaj bizneseve tjera është çmimi, pasi për mallra të cilësisë së njëjtë, ai mall apo shërbim që ka çmim më të lirë ka përparësi ndaj mallrave të tjera.

Por sado që është shumë i rëndësishëm si faktor çmimi nuk është përcaktues i vetëm dhe primar në kushtet e tanishme ekonomike dhe të globalizimit, ku tërë bota është bërë si një treg unik dhe informatat mbi çmimin, cilësinë dhe premiset e tjera të ekonomisë barten në mënyrë të shpejtë nëpërmjet rrjeteve sociale të informimit apo edhe nëpërmjet internetit. Prandaj në rritjen e konkurrencës së një prodhimi ndaj prodhimit tjetër përveç çmimit shumë i rëndësishëm është kualiteti i mallit, cilësia dhe dizajni i tij, shpejtësia e bartjes tek blerësit, afatet e pagesave dhe një mori faktorësh të tjerë që mund të jenë përcaktues për rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe rritjen e konkurrencës së bizneseve të një vendi ndaj ekonomisë së vendit tjetër.

Në rritjen e kësaj konkurrence shteti mund të ndikojë me nxitjen e masave fiskale dhe jo fiskale të cilat do të rritnin përparësitë konkurruese të bizneseve vendore Kosovare ndaj bizneseve të tjera që tregtojnë apo ofrojnë mallra dhe shërbime të njëjta. Shteti me politikat fiskale mund të ndikojë në këto rrjedha duke bërë adaptimin e normave tatimore për lloje të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve për të cilat konsiderohet se janë të një rëndësie strategjike, subvencionimi i veprimtarive të caktuara, subvencionimi i eksportit me qëllim të zvogëlimit të deficitit të madh tregtar që ka sot Kosova me vendet e tjera jo vetëm të regjionit por edhe më gjerë.

Duke pasur parasysh se bizneset, në kushtet e ekonomisë së tanishme, janë nën presion të rritur nga konkurrenca globale, ato duhet të zbulojnë dhe të shtojnë produktivitetin e tyre për t'iu përshtatur nevojave të tregut. Në mënyrë që të plotësojë kërkesën në rritje të konsumatorit të brendshëm dhe të jashtëm, si nxitës i rritjes së konkurrencës mund të jetë vetëm sektori privat vendor i cili duhet të bëjë këtë rritje nëpërmjet paraqitjes së produkteve të reja të cilat janë edhe më konkurruese.

Deri tani bizneset Kosovare kanë qenë shumë pak konkurruese ndaj bizneseve të tjera dhe kjo manifestohet në raportet mes eksporteve dhe importeve të Kosovës me vendet e tjera, i cili asnjëherë nuk ka mundur të tejkalojë 13% të mbulimit të eksportit me import.

Sado që në terminologjinë ekonomike mund të hasim fenomenin se kjo shkallë e mbulimit nuk paraqet ndonjë problem duke treguar se ekonomia po lëviz, kjo nuk ka domethënie në rastin e Kosovës pasi ekonomia e saj në masë të madhe mbështetet edhe në prurjet e mjeteve financiare të qytetarëve Kosovarë që jetojnë në vendet e ndryshme të Evropës dhe më gjerë dhe ku sipas raportit të Bankës Qendrore niveli i sjelljeve të mjeteve monetare nëpër vite të ndryshme pas vitit 2005 është mbi gjysmë miliardi euro.

Konkurrenca duhet të shikohet edhe nga fakti se a ka të bëjë me konkurrencën në krahasim me bizneset dhe ekonominë jashtë vendit dhe në krahasim me konkurrencën e bizneseve brenda një vendi.

Tek konkurrenca e jashtme respektivisht me bizneset jashtë vendit janë shumë të rëndësishëm një mori faktorësh të cilët janë përmendur edhe më lart dhe të cilët mund të ndikojnë në konkurrenca me bizneset tjera dhe ato janë : pozita gjeografike e vendit, shkalla e industrializimit të atij vendi, faktorët politikë, infrastruktura rrugore, burimet e lëndës së parë, fuqia punëtore dhe kualifikimi i tyre, politikat fiskale dhe politikat e tjera

ekonomike që aplikohen nga ana e shtetit dhe një mori faktorësh të tjerë të cilët do të ndikonin në rritjen e konkurrencës së bizneseve të një vendi.

Në rast se një vend ka burime të qëndrueshëm si lëndë të parë, pozitë të volitshme gjeografike, politika të mira ekonomike, qasje të lehtë në kapitalin financiar dhe me norma të ulëta të interesit si dhe stabilitet politik atëherë ai ka përparësi ndaj një ekonomie tjetër dhe masave tjera shtesë që mund të marrë një qeveri ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe rritjen ekonomike të një vendi.

Sa i përket konkurrencës brenda një vendi edhe këtu Qeveria duhet të krijojë rrethana që të gjitha bizneset brenda një vendi të kenë mundësi të barabarta dhe jo diskriminuese të cilat u mundësojnë atyre që në frymën e një konkurrence të shëndoshë të angazhohen në shitjen e produkteve dhe shërbimeve të tyre në tregun vendor dhe më gjerë. Nëse shteti krijon kushte të barabarta për të gjithë bizneset atëherë kjo gjë është e shëndoshë për ekonominë pasi shtyn bizneset vendore në inovacione, rritjen e kualifikimit profesional të punësuarve, rritjen e kualitetit të prodhimeve dhe shërbimeve të tyre si dhe dizajnimin e atyre produkteve të cilat rrisin edhe aftësinë konkurruese të ekonomisë vendore në krahasim me ekonomitë e tjera.

Ekonomia Kosovare si tërësi dhe bizneset veç e veç kanë disa përparësi krahasuese në krahasim me ekonomitë e disa vendeve të tjera por nevojitet që shteti nëpërmjet politikave të tyre ekonomike dhe fiskale të arrijë kanalizimin e këtyre përparësive në drejtimin e duhur i cili do të ndikonte dhe do të kishte efekte shumë të rëndësishme në pjesëmarrjen e përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve Kosovare jo vetëm në tregun vendor por edhe më gjerë.

3.4.3 Konkureshmëria e bizneseve Kosovare

Që nga pas lufta bizneset kosovare janë ballafaquar me sfida të ndryshme të cilat i kanë bërë ata jo konkurente në krahasim me bizneset e vendeve të tjera. Në fillim ata janë ballafaquar me dëmtime të mëdha të pronës si rezultat i daljes nga lufta kurse më vonë janë ballafaquar me një numër të madh sfidash ku janë përfshirë pengesa nga më të ndryshme si struktura e pa favorshme e pajisjeve dhe aparaturës tjetër për zhvillimin e aktivitetit të tyre, strukturë e pa favorshme e kuadrove, numër i madh i të rinjve të pa papunë por të cilët nuk ishin të përgatitur sa duhet për tregun e punës, politikat fiskale jo adekuate që do të ndikonin në zhvillimin e bizneseve dhe do të merrnin parasysh rrethanat që ekzistonin në Kosovë, vështirësitë infrastrukturore dhe të furnizimit me energji, burokraci dhe mungesë e legjislacionit në disa fusha kanë qenë barriera të cilat kanë ndikuar në nivelin e ulët të konkurrueshmërisë së bizneseve dhe ekonomisë kosovare në tërësi.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 u mundua që të bëhen disa hapa në përmirësimin e klimës të bërit biznes kështu që në planin e qeverisë për periudhën nga 2011 deri më 2014 u përcaktuan objektivat për përmirësimin e mjedisit për zhvillimin e sektorit të prodhimtarisë veçanërisht të bizneseve të vogla dhe të mesme me që rast ishin paraparë një mori masash për të mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme si inovacioni i Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, transferimi i njohurive dhe teknologjisë, zhvillimi dhe grupimi i sektorëve të ndryshëm të industrisë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të sektorëve dhe më të edhe rritjen e konkurrueshmërisë.

Treguesi i nivelit të konkurrencës quhet indeksi i konkurrencës globale dhe merret me matjen e një numri të komponentëve makroekonomike dhe mikroekonomike dhe të cilët janë kryesisht të vlerësuar në 7 shtatë shkallë.

Sipas indeksit global të konkurrencës të gjithë faktorët matës të konkurrencës janë të grupuar në 12 shtylla të cilat tregojnë aspekte të ndërlikuara të ekonomisë reale.

12 shtyllat me të cilat matet niveli i konkurrueshmërisë janë:

- **Institucionet** – lidhet me kornizën administrative dhe ligjore brenda së cilës individët, bizneset dhe qeveria në ndërlidhmëni ndërmjet vete gjenerojnë të hyra dhe realizojnë prosperitet ekonomik. Kosova ballafaqohet me një sundim të brishtë të ligjit e cila është një pengesë serioze në të bërit biznes në Kosovë dhe me të edhe në mundësinë e rritjes së konkurrencës së bizneseve kosovare. Bizneset kosovare ende ballafaqohen me procedura të shumta burokratike, veçanërisht në zgjidhjen e kontesteve të ndryshme gjyqësore, ku vonesat në zgjidhjen e tyre ndikojnë në afarizmin e bizneseve.
- **Infrastruktura** – Ndikon në zvogëlimin e kohës dhe kostos së bizneseve dhe më të edhe zhvillimin më të mirë regjional brenda një vendi. Në Kosovë janë bërë investime të shumta, kryesisht në infrastrukturën rrugore, e cila u mundëson bizneseve transferimin e mallrave në kohë më të shpejtë në drejtim të njëri tjetrit, por ka një numër të pengesave tjera me të cilat ende ballafaqohen bizneset si janë mungesa e energjisë elektrike, e furnizimit me ujë dhe pengesa të tjera që shkaktojnë vështirësi në zhvillimin normal të bizneseve.
- **Ambienti makroekonomik** – Për qëllime të konkurrencës është shumë e rëndësishme stabiliteti makroekonomik i vendit që lidhet me sigurimin e rritjes ekonomike, zvogëlimin e papunësisë, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe shkallë të ulët të inflacionet dhe mundësisë së zvogëlimit të deficitit të bilancit të pagesave.

Kosova deri tani ka pasur prioritet ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të cilën ka arritur të bëjë por nga ana tjetër orientimi në ruajtjen e qëndrueshmërisë makro fiskale ka ndikuar që të mos ketë një rritje të pritshme ekonomike veçanërisht në sektorin e prodhimit edhe pse ekonomia kosovare nga viti 2008 e këtej ka pasur një rritje ekonomike nga 3 deri 4 % rritje e cila është e pamjaftueshme dhe do të ndikonte në rritjen e konkurrencës së bizneseve kosovare dhe zvogëlimin e debalancit të madh tregtar që ende ekziston ku eksportet e vendit mbulohen vetëm rreth 12% me importe.

- **Arsimi dhe shëndetësia** – Mbrojtja shëndetësore dhe ajo në punë ka rëndësi për konkurrencën e një ekonomie prandaj është me rëndësi ngritja e nivelit shëndetësor dhe arsimor të të punësuarve të një vendi. Kosova ka një sistem arsimor jo konkurrues por edhe sistemi shëndetësor, veçanërisht sistemi shëndetësor që lidhet me mbrojtjen në punë të të punësuarve lë shumë për të dëshiruar. Kosova ende nuk ka filluar implementimin e ligjit për sigurimet shëndetësore dhe kjo është një pengesë e madhe si për të punësuarit ashtu edhe për bizneset.
- **Arsimi i lartë dhe treningu profesional** – Është një indikator shumë i rëndësishëm në rritjen e konkurrueshmërisë pasi secili shtet që dëshiron të ketë një prosperitet duhet ti kushtojë rëndësi të madhe arsimit të fuqisë punëtore dhe trajnimit të vazhdueshëm të të punësuarve me qëllim të rritjes së shkathtësive të tyre në përputhje me nevojat e sistemeve prodhuese. Sipas raportit të Bankës Botërore të vitit 2010 bizneset kosovare u ofrojnë shumë pak trajnime të punësuarve të tyre dhe pjesëmarrja e punëtorëve në trajnime të Evropës Juglindore është pesë herë me e

madhe se trajnimet që bëjnë punëtorët kosovarë. Po sipas të njëjtit burim pjesëmarrja e të punësuarve të Evropës Qendrore dhe të Azisë është katër herë më e madhe se pjesëmarrja në trajnime e të punësuarve nga Kosova. Gjithashtu bizneset kosovare deklarojnë se shkathtësitë e punëtorëve nuk janë në nivel të kënaqshëm dhe veçanërisht ka mungesë të shkathtësive praktike por edhe në rastet kur punëtorët kanë këto aftësi ato nuk janë të certifikuara formalisht dhe kryerja e këtyre trajnimeve dhe certifikimeve ka rëndësi edhe për investime të huaja direkte në Kosovë.

- **Efikasiteti i tregut të mallrave** – Kjo shtyllë ka të bëjë me aftësinë e ekonomisë së një vendi që të prodhojë një spektër të gjerë të prodhimeve dhe shërbimeve që do iu përshtaten kërkesave dhe nevojave të tregut. Kosova nevojitet që të bëjë hapa të shumtë në këtë fushë me qëllim të rritjes së aftësisë së ekonomisë së saj në mënyrë që të nxisë prodhimin vendor dhe të krijohen kushte për prodhime konkurruese si për nga cilësia ashtu edhe çmimi i tyre. Deri tani kemi një numër të vogël të bizneseve prodhuese të cilat kryesisht prodhojnë për tregun vendor por janë të pakta bizneset që prodhojnë për tregun e jashtëm. Kosova si edhe rajoni ka kryesisht një fuqi punëtore të lirë por nuk mjafton vetëm kjo për rritjen e prodhimtarisë dhe përshtatjen e prodhimeve vendore me ato që prodhohen në rajon, në tregjet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.
- **Efikasiteti i tregut të punës** – Lidhet me aftësinë e fuqisë punëtore të një ekonomie e cila ka mundësi të shpërndarjes së fuqisë punëtore prej një dege të ekonomisë në tjetrën, pa shkaktuar ndryshime shoqërore. Efikasiteti i tregut të punës ka të bëjë

edhe më faktin që ti jepet rast njerëzve të aftë që të dalin në pah me vlerat e tyre por që të ketë edhe mundësi të barabarta për punësim, pa marrë parasysh gjininë e të punësuarve.

Edhe në këtë shtyllë Kosova mbetet mjaft prapa nga ekonomitë tjera si të rajonit ashtu edhe më gjerë. Ashtu siç u tha më lart Kosova nuk ka të zhvilluar një sistem arsimor i cili do të bazohet në përgatitjen e fuqisë punëtore për treg të punës, respektivisht për mundësinë e shpërndarjes së fuqisë punëtore nga një veprimtari në tjetrën. Edukimi dhe shkollimi në Kosovë i të rinjve, bazohet kryesisht në aftësimin teorik dhe shumë pak bazohet në shkollimin praktik dhe në shkolla profesionale të cilat do të përgatitnin kuadro të nevojshëm dhe të aftë për punë pas përfundimit të shkollimit të tyre. Nevojitet një ridizajnim i sistemit arsimor duke u orientuar më shumë në shkolla profesionale sipas nevojave të tregut vendor dhe të jashtëm në mënyrë që të rinjtë dhe fuqia punëtore në tërësi të jenë në gjendje të përshtaten me kërkesat e tregut.

Në vendet e zhvilluara të Europës një rëndësi e veçantë iu jepet shkollave profesionale për të rinjtë por edhe të fuqisë punëtore e cila ka mbetur e papunë dhe bëhet rikualifikimi i tyre varësisht nga kërkesat e tregut. Një gjë e tillë deri tani në Kosovë nuk ka ndodhur por është një domosdoshmëri për institucionet vendore që të orientohen në përgatitjen e shkollave dhe institucioneve tjera arsimore bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregjeve vendore dhe të jashtme.

- **Zhvillimi i tregut financiar** – Ndikon në konkurueshmërinë e ekonomisë së një vendi pasi një treg i sofistikuar financiar mundëson orientimin e mjeteve të lira financiare nga bizneset më fitimprurës që janë në treg por edhe orientimin e

mjeteve financiare në projektet investuese më të mira që ofrohen nga bizneset. Rëndësi ka zhvillimi i tregut financiar pasi një sistem bankar stabil iu jep mundësi bizneseve të rrisin kapacitetet dhe konkurueshmërin e prodhimeve dhe shërbimeve të tyre por gjithashtu jep mundësi edhe për zhvillimin e mënyrave alternative të financimit duke mos përfshirë vetëm kreditë bankare por edhe gjetjen e financimeve të tjera siç janë bashkëpjesëmarrja në projekte të ndryshme të cilat do të mundësonin rritjen e kapaciteteve të bizneseve vendore.

Në Kosovë veç sistemit bankar të nivelit të dytë nuk kemi treg financiar dhe nuk ka ndonjë plan zhvillimor i cili do të bazohet në financimin e bizneseve të suksesshme veçanërisht atyre në sferën e prodhimeve të cilat do të financoheshin me norma preferenciale të kredive për investime të reja.

Deri tani bizneset kryesisht janë orientuar në marrjen e kredive nga bankat e nivelit të dytë por që normat e interesit të kredive kanë qenë ndër më të lartat në rajon dhe deri vonë dy shifrore. Kohëve të fundit vërehet një rënje e normave të interesit por ato mbeten mjaftë të mëdha dhe ndikojnë shumë në koston e të bërit biznes dhe në zvogëlimin e konkurueshmërisë së prodhimeve dhe bizneseve që zhvillojnë aktivitetin në Kosovë.

- **Përgatitja teknologjike** – Në ditët e sotme teknologjia është një ndër shtyllat kryesore që mundëson rritjen e konkurrencës së një ekonomie, prandaj jo vetëm aplikimi i teknologjive të reja por edhe sigurimi i kushteve për shfrytëzimin e tyre efikas ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e konkurrencës. Shtetet e zhvilluara me një teknologji të avancuar nuk bazohen vetëm në investime të huaja direkte por kërkojnë që nëpërmjet programeve të tyre dhe standardeve teknike që

vendosin mbështeten në inovacione dhe investimet e tyre i orientojnë në hulumtime dhe zhvillim.

Një numër i konsideruar i bizneseve zhvillojnë aktivitetin me një teknologji të vjetruar dhe-nganjëherë edhe importet e pajisjeve dhe makinerisë tjetër nuk është në përputhje me nevojat dhe teknologjitë bashkëkohore që aplikohen në vendet e zhvilluara. Nevojë strategjike e bizneseve në Kosovë është që të jenë të përgatitur me teknologjinë bashkëkohore e cila përdoret në vendet e zhvilluara pasi aplikimi i asaj teknologjie rrit produktivitetin e punës, efikasitetin dhe cilësinë e prodhimeve. Me qëllim të aplikimit të kësaj teknologjie nevojiten mjete financiare për blerjen e tyre por edhe aftësimin adekuat të fuqisë punëtore e cila do të punojë me ato pajisje. Bizneset që aplikojnë këto standarde bashkëkohore të teknologjisë janë të pakta dhe kanë arritur të depërtojnë me prodhimet e tyre në tregjet vendore dhe ndërkombëtare dhe kanë një afarizëm të qëndrueshëm dhe rentabil por janë edhe konkurues si në cilësi ashtu edhe parametrat tjerë me prodhimet e huaja por kjo nuk mund të thuhet me numrin më të madh të bizneseve tjera të cilët aplikojnë ende teknologji të vjetruar dhe në mungesë të kapitalit financues nuk kanë mundësi të bëjnë ndërrime të domosdoshme teknologjike. Sa i përket inovacionit edhe pse kjo ka qenë një strategji e vendosur nga qeveria për ofrimin e mjeteve financiare dhe lehtësirave të tjera për inovacione deri tani është arritur shumë pak në këtë fushë.

- **Madhësia e tregut** – Edhe ky është një element shumë i rëndësishëm në konkurrshmëri pasi madhësia e tregut mundëson edhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë si dhe rritjen e cilësisë së prodhimeve të tyre me kosto të ulët për njësi të prodhimit.

Duke pasur parasysh se tregu i Kosovës është një treg relativisht i vogël bizneset kosovare duhet të kenë një strategji që orientimi i tyre të mos jetë vetëm tregu i Kosovës por edhe ai rajonit dhe më gjerë. Që të arrijnë këto synime ata duhet të përgatiten që mallrat dhe shërbimet e tyre të jenë cilësore dhe konkurruese me ato që ofrojnë bizneset e tjera. Për të arritur këtë duhet angazhim jo vetëm i këtyre bizneseve por edhe i shtetit i cili me stimuj të ndryshëm fiskal dhe jo fiskal krijon një bazë për rritje të vazhdueshme të bizneseve vendore.

- **Aftësia dhe sofistikimi afarist** – Edhe kjo shtyllë është mjaft e rëndësishme në rritjen e konkurrueshmërisë pasi një ekonomi është konkurruese dhe produktive nëse bizneset që zhvillojnë aktivitetin në një ekonomi janë produktive dhe arrijnë të krijojnë produkte cilësore dhe konkurruese me çmim në treg.
- **Inovacioni** – Ka një rëndësi të madhe në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë së një vendi dhe roli që i jep shteti përkrahjes së inovacioneve dhe zbulimeve në fusha të ndryshme ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve. Është me rëndësi ndarja e mjeteve dhe ofrimi i lehtësirave për bizneset inovative pasi ato jo vetëm që krijojnë vende të reja pune por kanë efekte edhe në rritjen e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve të një vendi. Prandaj pikërisht vendet të cilat janë të zhvilluara dhe kanë një ekonomi konkurruese i japin një rëndësi shumë të madhe inovacioneve jo vetëm të fushës së teknologjisë së prodhimit por edhe të shërbimeve të cilat kohëve të fundit zënë një vend shumë të rëndësishëm në ekonomitë e zhvilluara.

Sa i përket Kosovës duhet të theksohet se tregu i Kosovës është i pa ekuilibruar si në aspektin e përbërjes po ashtu edhe në aspektin e madhësisë dhe shpërndarjes së bizneseve. Dy dobësitë kyçe që vërehen brenda tregut kosovar janë:

- Normat e ulëta të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të kualifikuar të kombinuar me normat e ulëta të punësimit të fuqisë punëtore të aftë për punë dhe
- Krijimi i bizneseve të sektorit terciar që sjellin vlera të ultë të shtuara.

Sipas OSBE (2012C) nivelet e larta të konkurrueshmërisë në tregjet e produktit kontribuojnë në rritjen e PBB për kokë banori duke stimuluar ri alokimin e burimeve drejt aktiviteteve më produktive.

Sipas raportit global të konkurrueshmërisë të Forumit Ekonomik Botëror nga 140 vende për të cilat është bërë matja e konkurrueshmërisë për vitet 2015 dhe 2016 në vendin e parë është Zvicra, që pasohet nga Singapori, SHBA, Gjermania kurse Kosova fare nuk është përfshirë në matje. Prej vendeve të rajonit më mirë është e pozicionuar Maqedonia në vendin e 60, Mali i zi në vendin e 70, Kroacia në vendin e 77, Greqia vendin e 81, Shqipëria në vendin 93, Serbia në vendin e 94 dhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 111.

Ndërsa Kosova nuk është përfshirë fare në këtë matje e cila është bërë nga ana e Forumit Ekonomik Botëror por bazuar në indikatorët matës të cilët janë të parapara sipas këtij forumi pozita e saj nuk do të ishte fare më e mirë se e vendeve tjera të rajonit.

Sipas Aghion (2005) konkurenca mund të rrisë fitimet shtesë nga inovacioni dhe në këtë mënyrë të inkurajojë investimet. Më shumë konkurrencë mund të nxisë inovacionin dhe rritjen për shkak se ajo mund të reduktojë të ardhurat para inovuese të biznesit më shumë se redukton të ardhurat pas inovuese të saj.

Tabela Nr. 50 – Renditja e konkurrueshmërisë sipas Forumit Ekonomik Botëror prej vitit 2014 deri në vitin 2016 për disa vende

Vendi	Vlerësimi	Renditja 2015 - 2016	Renditja 2014 - 2015
Zvicra	5.76	1	1
Singapori	5.68	2	2
SHBA	5.61	3	3
Gjermania	5.53	5	4
Sllovenia	4.28	59	70
Maqedonia	4.28	60	63
Mali i Zi	4.2	70	67
Kroacia	4.07	77	77
Greqia	4.02	81	81
Shqipëria	3.93	93	97
Serbia	3.89	94	94
Bosna dhe Hercegovina	3.71	111	n/a

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, 2017


Në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës ekziston Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë i cili është përgjegjës për krijimin e infrastrukturës, bazës institucionale dhe financiare për zhvillimin e shkencës dhe kërkimeve, si dhe promovimin e zhvillimit teknologjik. MASHT gjithashtu është drejtpërdrejt përgjegjëse për financimin e projekteve kërkimore, por ajo ka mungesë buxhetore dhe se financimi i projekteve kërkimore ka filluar vonë nga viti 2008 me themelimin e Qendrës për Inovacione dhe Transfer të Teknologjisë e cila ka për detyrë që të sigurojë mbështetje për lidhjet në industrinë e shkencës në Kosovë. Në vitin 2011, MASHT-i ka ndarë 200.000 euro për dhjetë projekte kërkimore në fusha të ndryshme dy prej tyre kishin rëndësi për sektorin e biznesit. Më vonë ndarjet buxhetore në fushën e kërkimit janë rritur por prapë për kërkimet në fushën e bizneseve janë ndarë shumë pak mjete financiare dhe rezultatet kanë qenë shumë të vogla.

Buxheti i Kosovës për Hulumtim dhe zhvillim është shumë i vogël, kështu në vitin 2010 janë ndarë vetëm 1 milion euro për këtë qëllim që është shumë pak krahasuar me

vendet e rajonit , ku për shembull sipas raportit të Bankës Botërore të vitit 2010 buxheti për Hulumtim dhe Zhvillimi i Ministrisë së Shkencës, Arsimit dhe Sporteve në Kroaci ishte 163.4 milion euro.

Në tabelën në vazhdim japim ndarjet buxhetore për hulumtim dhe zhvillim nga vendet e ndryshme ku shihet se ndarjet buxhetore të Kosovës për këtë qëllim në krahasim me PBB janë më të vogla se të secilit vend tjetër. Në grafikonin më poshtë japim ndarjet e mjeteve financiare për hulumtim dhe zhvillim në disa vende krahasuar me PBB.

Grafika Nr. 5 – Ndarjet buxhetore për hulumtim dhe zhvillimi në krahasim me PBB për vitin 2010



Burimi: UNESCO Instituti për Statistika website, <http://stats.uis.unesco.org/>, të future më 19 Mars 2013

Kosova ka nevojë për hartimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv të inovacionit i cili do të angazhohej për ngritje të mëtutjeshme të kapaciteteve veçanërisht kapitalit njerëzor. Krijimi i një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të financimit duhet të ndihmojë për të siguruar se fondet janë shpërndarë në projekte me potencial të cilët kishin mundësi për një kthim më të lartë në vitet vijuese. Zbatimi i programeve të financimit dhe masat e tjera të politikave duhet të jenë të ndara në mënyrë rigoroze nga organet qeveritare

përgjegjëse për hartimin e politikave, në mënyrë që të sigurohet transparenca e financimit të projekteve të caktuara.

3.5 Përmbledhja e kapitullit

Në kapitullin e tretë kemi bërë një analizë empirike të dhënave sekondare që i kemi marrë mbi pozitën e Kosovës në ish Federatën Jugosllave në fushën ekonomike pas përfundimit të luftës së dytë botërore deri në 1989, pastaj shkurtimisht kemi dhënë disa informata mbi periudhën 1989 deri në 1999 kur ishte suprimuar autonomia e Kosovës. Kemi paraqitur me pak fjalë si bëhej mbledhja e të hyrave për institucionet paralele që kishte Kosova dhe si financoheshin disa nga departamentet kryesore të asaj kohe. Gjithashtu në këtë kapitull ne kemi bërë ndarjen e politikave fiskale në tri periudha :

nga viti 1999 deri në vitin 2004, pastaj nga viti 2004 deri në vitin 2008 kur është bërë një reformë fiskale dhe nga viti 2009 deri në vitin. Në këtë kapitull ne kemi bërë krahasime të mënyrës së mbledhjes së të hyrave buxhetore në Kosovë, burimet kryesore të hyrave, pastaj kemi sqaruar mbi mënyrën e tyre, pjesëmarrjen e të hyrave dhe shpenzimeve në PBB.

Gjithashtu në këtë kapitull ne kemi krahasuar politikat fiskale të Kosovës me vendet e regjionit si dhe me vendet e BE duke krahasuar edhe nivelin e pjesëmarrjes së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në PBB të Kosovës në krahasim me ato të vendeve tjera si dhe barrën tatimore në vendet e ndryshme dhe krahasimin me Kosovën. Gjithashtu kemi dhënë edhe një pasqyrë të rritjes dhe zhvillimit të bizneseve në Kosovë nga viti 1999 deri në vitin 2016.

KAPITULLI IV: MBLEDHJA E TË DHËNAVE NË TERREN

4.1 Puna kërkimore në terren

Siç është thënë edhe në fillim të këtij punimi pyetjet kërkimore në të cilat kemi hulumtuar dhe kemi dhënë përgjigje me testimin e hipotezave janë:

1. A kanë pasur ndikim të rëndësishëm Politikat fiskale të aplikuara në Kosovë në rezultatin financiar të bizneseve?
2. A kanë pasur ndikim politikat fiskale të aplikuara në Kosovë në zhvillimin e bizneseve në Kosovë?
3. Cili ka qenë ndikimi i treguesve të zhvillimit dhe përfitueshmërisë në rritjen e punësimit në biznese?
4. Cilët tregues kanë pasur ndikim në konkurrueshmërinë e bizneseve ?
5. A kanë qenë më pak konkurruese Bizneset e sektorit prodhues në Kosovë se ato të sektorëve tjerë në tregun vendor?

Kurse hipotezat të cilat i kemi testuar bazuar në pyetjet kërkimore të parashtruara më poshtë janë:

Hipoteza 1. Politikat fiskale të vendit kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar dhe zhvillimin e bizneseve

Hipoteza 2. Treguesit e zhvillimit dhe përfitueshmërisë të bizneseve kanë ndikim në rritjen e punësimit në to

Hipoteza 3. Konkurrueshmëria e bizneseve është e kushtëzuar nga treguesit e rritjes, të përfitueshmërisë, treguesve fiskalë si dhe nga veprimtaria e bizneseve

Hipoteza 4. Bizneset e sektorit të prodhimit janë më pak konkurruese se bizneset e sektorëve të tjerë, në tregun vendor

Për testimin e hipotezave janë përdorur dy burime kryesore:

1. Burimet primare

Të dhënat e mbledhura nga 425 biznese me anë të pyetësorëve dhe 215 pyetësorëve nga bizneset e mëdha që zhvillojnë aktivitet në Kosovë dhe 210 pyetësorë të mbledhur nga biznese të cilat kanë pjesëmarrje më të vogël në qarkullimin e përgjithshëm dhe pjesëmarrje më të vogël në të hyrat tatimore të mbledhura nga ATK dhe Dogana e Kosovës si dy institucione bazë për mbledhjen e të hyrave tatimore. Pyetësi i përgatitur ka pasur 50 pyetje të integruara ku të intervistuarit kanë mundur të përgjigjen me nga 1 deri 5.

Gjithashtu ne kemi përgatitur një pyetësor për institucionet relevante si MF. ATK, Doganat e Kosovës, MTI dhe Odave Ekonomike si dhe disa OJQ – ve të cilat merren me analiza të rrjedhave ekonomike dhe fiskale ku nga zyrtarët e këtyre institucioneve është kërkuar që të përgjigjen tek kolonat me numra nga 1 deri në 5 në pyetjet që kemi përgatitur vetëm për ta. Ne nga ta kemi pranuar 28 përgjigje në pyetësorët e dërguar.

2. Burime sekondare

Të dhënat sekondare janë mbledhur nga raportet e ndryshme të institucioneve qeveritare siç janë Ministria e Financave e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik si dhe të agjencive të ndryshme siç është Administrata Tatimore e Kosovës, Doganat e Kosovës, Enti Statistikor i Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës si dhe nga odat e ndryshme ekonomike që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Kosovë. Gjithashtu kemi shfrytëzuar të dhënat e mbledhura nga institucionet ndërkombëtare financiare si FMN, BB, BERZH, OSBE por edhe nga raportet e ndryshme vjetore të

vendeve fqinje të Kosovës dhe më gjerë të cilat na janë nevojitur për të bërë analiza krahasuese të ndryshme për rrjedhat fiskale në Kosovë dhe vende të tjera.

4.2 Popullata dhe kampioni i studimit

Me qëllim të kryerjes së studimit janë marrë kampionet nga bizneset e mëdha që veprojnë në Kosovë të cilat kanë rëndësinë më të madhe në krijimin e të hyrave buxhetore si dhe nga kompanitë e tjera më të vogla të cilat veprojnë por kanë ndikim më të madh në të hyrat e përgjithshme buxhetore dhe efektin e përgjithshëm ekonomik që kanë këto biznese.

Në bazë të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës në fund të vitit 2013 në Kosovë kanë qenë aktive 29057 biznese prej të cilave shumica kanë qenë biznese tregtare 16091, prodhim 3736, xehetari dhe gurëthyes 149 dhe pjesa tjetër e bizneseve që kanë zhvilluar aktivitet në mënyrë aktive kanë qenë biznese nga veprimtari të tjera ekonomike që nuk janë përfshirë në numrin e paraqitur më lart.

Kampioni është përzgjedhur sipas formulës së Yamane (1973) dhe ndarja është bërë nga 500 pyetësorët e përgatitur, 250 i janë dërguar bizneseve të mëdha të cilat kanë ndikim të madh në të hyrat e përgjithshme dhe pjesa tjetër, prej 250 pyetësorë i është dërguar bizneseve të cilat janë në numër shumë më të madh por ndikimi i tyre është shumë më i vogël në të hyrat e përgjithshme.

Si kriter për përcaktimin e këtyre bizneseve është marrë raporti vjetor i punës i ATK-së për vitin 2013 ku prej 29057 bizneseve aktive ato të cilat bëjnë pjesë në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj janë 400 dhe të cilat, nga të vlera e përgjithshme e tatimeve të realizuara nga ana e ATK-së për vitin 2013 në vlerë prej 305,451,932 milion euro, 400

biznese janë inkasuar të hyra tatimore në vlerë prej 185,620,941 apo shprehur në përqindje 60.77%.

Formula për marrjen e kampionit që për këtë hulumtim është:

$$n = \frac{N}{1 + N * e^2}$$

Ku : n = Kampioni zgjedhur

N = Popullata

E = Niveli i rëndësisë 95 %

$$n = 29057 / 1 + 29057 * 0.05^2$$

$$n = 29057 / 1 + 29057 * 0.0025$$

$$n = 29057 / 1 + 72.64$$

$$n = 29057 / 73.64$$

$$n = 394.58$$

Pra Kampioni i zgjedhur në bazë të formulës së Yamanit duhet të jetë 394 , ne kemi dërguar 500 pyetësorë tek bizneset e ndryshme por kemi marrë përgjigje nga vetëm 425 prej tyre të cilave iu kemi dërguar pyetësorët.

Siç u tha edhe më lart, pyetësorët janë ndarë për dy grupe të bizneseve ku 250 iu dërguan bizneseve të mëdha që administrohen nga DTM dhe 250 të tjerat iu dërguan bizneseve të tjera të cilat kanë qarkullim mbi 50000 Euro brenda vitit kalendarik dhe janë deklarues të tvsh –së por nuk e kanë ndikimin si grupi i parë. Nga 250 pyetësorët e dërguar tek shoqëritë që administrohen nga DTM kemi marrë 217 përgjigje kurse nga 250

pyetësorët e tjerë kemi marrë përgjigje nga 208 pyetësorë që do të thotë se kemi marrë përgjigje në 425 pyetësorë kurse pjesa tjetër ose nuk kanë pranuar të përgjigjen ose janë përgjigjur në vetëm disa pyetje dhe nuk i kanë plotësuar kriteret që të përfshihen në anketë .

Prej këtyre pyetësorëve nga të cilët kemi marrë përgjigje 353 janë biznese individuale kurse pjesa tjetër 72 biznese janë korporata ku sipas legjislacionit kosovar në këtë grup hyjnë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë aksionare si dhe njësitë e kompanive të huaja që janë të regjistruara në Kosovë.

Sa i përket institucioneve qeveritare dhe joqeveritare ne pyetësorin që kemi përgatitur për ta e kemi dërguar nëpër Ministrinë e ndryshme dhe Agjencitë e tyre që merren me punë që lidhen me ekonomi dhe zhvillim si dhe tek Odat Ekonomike dhe OJQ që veprojnë në Kosovë dhe ne atyre u kemi dorëzuar nga disa pyetësorë varësisht nga madhësia e institucionit rreth 5 për Ministri kurse tek OJQ dhe Odat Ekonomike nga 2 pyetësorë gjithsej të dorëzuar kanë qenë 44 prej të cilave ne kemi marrë përgjigje në vetëm 28 raste që do të thotë se në 16 pyetësorë të dërguar nuk kemi marrë përgjigje.

4.3 Metodologjia e përdorur

Me anë të këtij punimi ne kemi vlerësuar korrelacionin në mes të ndryshoreve me anë të analizës së regresionit ku me rëndësi ka qenë analizimi i ndikimit të politikave fiskale në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik , konkurrencën dhe zhvillimin e bizneseve që veprojnë në Kosovë. Në punim kemi bërë krahasimin e të dhënave sasiore të marra nëpërmjet analizave të ndryshme statistikore nga institucione të ndryshme me të dhënat cilësore të mbledhura në terren me anë të pyetësorëve me qëllim të testimit të hipotezave të cilat i kemi shtruar në këtë punim.

4.4 Mbledhja e të dhënave si dhe përpunimi i tyre

4.4.1 Pyetësi

Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve të cilët përfshijnë periudhën 5 vjeçare nga viti 2008 deri në vitin 2013. Bazë fillestare është marrë viti 2008 pasi nga viti 2009 janë bërë disa ndryshime në politikat fiskale të cilat nuk janë ndryshuar më deri në vitin 2013. Pyetësi ka pasur 55 pyetje të ndara në 5 pjesë dhe brenda pjesëve ka qenë pjesa e ndarë veçmas për bizneset prodhuese nga të cilat janë kërkuar disa informata shitesë dhe veçmas për bizneset e tjera të cilat kanë pasur ofrimin e informatave të tjera.

Pjesa e parë e pyetësit ka pasur informata të përgjithshme për biznesin dhe ka pasur pesë pyetje, pjesa e dytë ka qenë informata mbi politikat fiskale dhe mendimet e të anketuarve lidhur me politikat e aplikuara dhe në te janë përfshirë 15 pyetje ku 11 të parat kanë qenë për të gjitha bizneset kurse 4 të fundit vetëm për ato prodhuese, pjesa e tretë ka përfshirë informata mbi konkurrencën dhe ka pasur gjithsej 25 pyetje prej të cilave 10 kanë qenë për të gjitha bizneset kurse 15 kanë qenë vetëm për bizneset prodhuese, pjesa e katërt ka pasur 5 pyetje dhe ka përfshirë informatat për të punësuarit për të gjitha bizneset dhe pjesa e fundit ka përfshirë treguesit financiarë dhe ka pasur 5 pyetje.

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë koduar dhe janë futur në sistemin për përpunimin e tyre nëpërmjet të programit të SPSS.

4.4.2 Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave primare

Gjatë mbledhjes së të dhënave kemi hasur vështirësi mjaft të mëdha pasi një numër i bizneseve të caktuara hezitonin të ofronin informatat e kërkuara në pyetësor. Në fillim një numër i caktuar i pyetësorëve janë dërguar nëpërmjet postës elektronike por përgjigja ka

qenë shumë e shkurtër prandaj është dashur që pyetësorët të dërgohen në mënyrë fizike tek bizneset apo tu jepet personave përgjegjës të cilët kanë mundur të jepnin këto informata. Duke pasur parasysh këto vështirësi një ndihmesë të madhe na ka dhënë Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Kosovës. Ku pjesa dërmuese e personave përgjegjës për plotësimin e këtyre pyetësorëve janë edhe anëtarë të Shoqatës, duke ndihmuar që anëtarët e saj të plotësojnë këtë pyetësor.

Një pjesë e pyetësorëve nuk është kthyer fare 33 tek bizneset e mëdha por pjesa prej 217 pyetësorëve është plotësuar dhe na janë ofruar informatat e kërkuara.

Një vështirësi tjetër ka qenë edhe saktësia e këtyre informatave pasi bazuar në nivelin e ekonomisë jo formale, që sipas disa analizave në Kosovë sillet deri në 30%, atëherë edhe informatat e pranura nga të anketuarit kanë të bëjë vetëm me informatat zyrtare të cilat ata kanë dorëzuar në institucionet shtetërore siç është ATK, MTI, Këshilli Kosovar për Raportim financiar tri institucione ku bizneset Kosovare kanë obligim për dorëzimin e raporteve të tyre financiare dhe raporteve të tjera gjithëpërfshirëse varësisht nga aktiviteti që zhvillojnë ato.


KAPITULLI V: INTERPRETIMI I TË DHËNAVE

5.1 Bizneset e përfshira në studim

Nga pyetësorët e pranuar nga bizneset që u kemi dërguar, 425 kanë dhënë përgjigje dhe nga ato 215 ishin biznese tregtare të mëdha të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të qarkullimit total që realizojnë bizneset tregtare në Kosovë. Pjesa tjetër e bizneseve të përfshira në hulumtim, që janë 210, janë biznese të tjera të cilat janë më të vogla si për nga numri i punëtorëve, nga të hyrat tatimore që paguajnë, si dhe nga pjesëmarrja në qarkullimit të përgjithshëm, por edhe këto janë deklarues të tvsh-së pra kanë qarkullimin vjetor mbi 50000 Euro por më të vogël se 2,000,000 euro.

Nga bizneset të cilat kanë marrë pjesë në hulumtim 50 janë prodhuese, 250 tregtare dhe pjesa tjetër biznese të cilat ushtrojnë aktivitet tjetër shërbyes ndonjë veprimtari tjetër ekonomike.

Grafika Nr. 1 – Numri i bizneseve të përfshira në hulumtim



Burimi: Autori (2014)

Personat që kanë dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara kanë qenë persona përgjegjës për financat e bizneseve dhe nga ta 86 kanë qenë përgjegjës të financave, 51 drejtorë financiarë dhe pjesa tjetër prej 288 kanë qenë përgjegjës të kontabilitetit apo persona të tjerë përgjegjës në biznes.


Grafika Nr. 2 – Pozita e personave të anketuar në ndërmarrje



Burimi: Autori(2014)

Sa i përket pronësisë prej 425 bizneseve të anketuara, 353 prej tyre kanë qenë individuale. Korporatat të cilat janë përfshirë në hulumtim, kanë qenë 72 dhe biznese të tjera nuk ka pasur të përfshira në hulumtim. Kjo në njëfarë mënyre korrespondon edhe me regjistrimin e bizneseve dhe strukturën e tyre, ku nga të dhënat e paraqitura më herët dhe të marra nga ESK, kemi parë se pjesa dërmuese e tyre që zhvillojnë aktivitet janë biznese të regjistruara si individuale kurse shumë më pak janë korporata apo ndonjë formë tjetër e regjistrimit e paraparë në legjislacionin kosovar.

Grafika Nr. 3 - Bizneset e përfshira në anketim sipas llojit të pronësisë



Burimi: Autori (2014)

Nga bizneset në të cilat është kryer hulumtimi 95 % kanë deklaruar se nuk e kanë ndërruar veprimtarinë kurse 5 % janë deklaruar se e kanë ndërruar atë.

Sa i përket mjeteve financiare, pjesa dërmuese e tyre, ka deklaruar se ato i kanë siguruar nga mjetet vetjak, 10% nga kreditë bankare dhe 10% nga familja, miqtë dhe të afërmit.

5.2 Politikat fiskale sipas personave të përfshirë në hulumtim për të gjitha bizneset

Nga 425 biznese të përfshira në hulumtim, 353 prej personave të cilët kanë dhënë përgjigjet kanë deklaruar se politikat fiskale të aplikuara në Kosovë, nga viti 1999 deri në 2013 kanë qenë të pafavorshme, ndërsa 72 persona kanë deklaruar se politikat fiskale kanë qenë të favorshme.

Sa i përket tatimeve, pjesa dërmuese e tyre, kanë deklaruar se ata janë deklarues i TVSh-se, tatimit për të punësuarit dhe tatimit në të ardhura të korporatave. Nuk ka pasur biznese të përfshira në hulumtim që kanë qenë deklarues të tatimit për biznese të vogla

individuale apo tatimit për korporata ku sipas legjislacionit në Kosovë në këtë grup hyjnë bizneset të cilat gjatë vitit kalendarik kanë xhiro më të vogël se 50000 Euro.

Sa i përket tatimeve totale të paguara nga viti 2008 deri në 2013, sipas deklaramit të personave në hulumtim, vlera e pagesave ka pësuar ndryshime nga viti në vit ku në vitin 2008 ka qenë një vlerë më e madhe e tatimit të paguar nga të gjitha ndërmarrjet e përfshira në hulumtim kurse më vonë kjo ka pasur devijime nga viti në vit. Këto devijime janë paraqitur në analizën statistikore të cilën do ta pasqyrojmë më vonë tek analizimi statistikor i të dhënave.

Sa i përket se a duhet të ketë ndryshime të politikave fiskale, pjesa dërmuese e personave që kanë dhënë përgjigje, kanë theksuar se duhet të ketë ndryshime të politikave fiskale 425 nga të intervistuarit 414 e mendojnë se politikat fiskale të aplikuara në këtë periudhë kanë qenë jo të favorshme dhe nuk kanë pasur ndikim pozitiv në rrjedhat e përgjithshme ekonomike. Kjo kërkon ndryshime në politikat fiskale 2 të anketuar kanë deklaruar se nuk duhen bërë ndryshime dhe 5 kanë deklaruar se nuk kanë informacion për këtë.

Gjithashtu, pjesa dërmuese e personave që janë përgjigjur nëse duhet të rritet disiplina fiskale mendojnë se kjo disiplinë duhet të rritet në mënyrë që të zvogëlohet ekonomia joformale, e cila së bashku me ndryshimet e politikave do të kishin efekt pozitiv në ekonominë vendore. Kjo shihet edhe nga pyetja pasuese, ku pjesa dërmuese e pjesëmarrësve kanë deklaruar se mendojnë se ka privilegje fiskale për biznese të ndryshme e të cilat krijojnë një gjendje jo të barabartë ndërmjet bizneseve tregtare, pjesëmarrës në tregun dhe prodhimtarinë kosovare.

Sa i përket normave tatimore që aplikohen në Kosovë për lloje të ndryshme të tatimeve, personat e anketuar janë përgjigjur duke plotësuar njërin nga fushat 1 deri në 5, ku me 1 do të shënohet për norma e cila konsiderohet e ulët dhe me 5 norma shumë e lartë.

Nga përgjigjet e marra prej personave të anketuar për tatimin në paga që aplikohet në Kosovë me normë progresive 0, 4 , 8 dhe 10 % varësisht nga paga që kanë, nga 425 pyetësorët 242 përgjigje kanë qenë 1, kurse 132 janë përgjigjur me 2 dhe pjesa tjetër kanë dhënë përgjigjet të tjera.

Sa i përket TVSH, 206 persona janë përgjigjur me 2 dhe 132 me 3, kurse pjesa kanë dhënë përgjigje të tjera.

Tek taksat doganore kemi një situatë ku pjesa dërmuese e personave të anketuar në dallim nga dy tatimet e kaluara (tatimi në paga dhe TVSH –ja kanë konsideruar se janë mesatar), tek taksat doganore, pjesa dërmuese e pjesëmarrësve janë përgjigjur me 4 dhe 3, duke menduar se taksat doganore gjatë importit të mallrave dhe lëndës së parë janë të larta. Kjo ndodh pasi për hyrjet varësisht nga lloji i mallrave, paguhet Tvsh prej 16%, dogana prej 10% nëse importet nuk janë nga vendet e CEFT-a dhe akcizë e cila ndryshon varësisht nga lloji i mallrave. Kjo paguhet në litra, kilogram apo njësi tjetër, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm nga doganat e Kosovës.

Tek akciza, disa janë përgjigjur se kjo taksë është e pa aplikueshme tek një numër i caktuar i tyre pasi akciza, sipas legjislacionit kosovar aplikohet për mallra specifike në doganë dhe në tregun vendor për prodhimet e pijeve të gazuara dhe aparate të ndryshme të lojërave të fatit, ku për çdo aparat aktiv,duhet të paguajë akcizë me një kuotë fikse,e cila ndryshon varësisht nga lloji i aparatit.

Sa i përket tatimit në fitim, i cili sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë nga viti 2009 është 10%, pjesa më e madhe janë përgjigjur me numër 3 dhe 2, duke theksuar se kjo normë e tatimit nuk është e lartë dhe nuk paraqet ndonjë problem të theksuar që do shkaktonte vështirësi në afarizmin dhe rritjen e aftësive të tyre konkurruese si në tregun vendor ashtu edhe në atë të jashtëm.

Pra nga përgjigjet e marra lidhur me llojet e ndryshme të tatimeve, konstatojmë se përgjigjet dallojnë varësisht për cilin tatimi ka qenë pyetja këtë përgjigje të personave të anketuar e kemi paraqitur në formë grafike.

Sa i përket pjesës së deklaruesve të TVSH –së duke pasur parasysh se fillimisht ato janë të deklaruesit e TVSH-së, pragu i hyrjes në tvsh deri në fund të vitit 2013 ka qenë 50,000.00 Euro për bizneset tregtare të cilat gjatë periudhës 12 mujore (jo viti kalendarik) tejkalojnë këtë qarkullim. Më vonë periudha 12 mujore është ndërruar me vit kalendarik dhe nga shtatori i vitit 2015 pragu për regjistrim në tvsh ka rënë në qarkullim vjetor prej 30,000.00 Euro.

Gjithashtu pjesa dërmuese e bizneseve kanë deklaruar se ata kanë qenë deklarues të TVSH –së nga viti i parë kur kanë hapur biznesin e tyre.

Në pyetjen se si e vlerësoni pragun e hyrjes në TVSH nga 425 persona, 167 janë përgjigjur se pragu është mesatar 100,247 se pragu është i ulët dhe 11 se ai është i lartë.

Gjithashtu edhe tek pyetja tjetër që ka të bëjë me pozitën e bizneseve tregtare pas regjistrimit të tyre në tvsh si deklarues i TVSH– së, pjesa dërmuese kanë deklaruar se kjo gjë nuk ka pasur ndonjë ndikim në afarizmin e tyre si në aspektin pozitiv apo negativ, pozita e tyre konkurruese ka mbetur e njëjtë dhe nuk kanë pasur ndonjë përfitim nga të

qenit deklarues të tvsh-së. Kurse 181 kanë deklaruar se pozita e tyre është përmirësuar dhe vetëm 6 kanë deklaruar se pozita e tyre është dobësuar.

Në pyetjen që në mënyrë cilësore të përshkruhet se çfarë mendojnë personat e anketuar për politikën fiskale dhe se a duhen ndërmarrë masa dhe reforma substanciale nga ana e institucioneve kompetente kosovare, kemi marrë një numër të caktuar përgjigjesh. Pjesa më e madhe e personave të anketuar nuk janë përgjigjur me shkrim dhe nga përgjigjet e marra janë dhënë mendime të ndryshme si për ndërrimin e normave të tatimeve ndryshimet e pragjeve të tysh atij të TVSH-së dhe atij në paga, mbi lirin e pagimit nga taksa doganore për lëndën e parë të importuar jo vetëm nga vendet e Ceft-as por nga të gjitha vendet e tjera. Më pas ata kërkojnë lirin nga dogana dhe TVSH-ja për gjithë makinerinë e importuar në Kosovë, lirin nga pagesa e akcizës për një numër të caktuar të mallrave që përdoren si ambalazh në prodhimtari, e cila e rëndon koston e prodhimit, diferencimin e TVSH-së jo vetëm në një normë standarde por në më shumë se një normë ku mallra të domosdoshme të jetesës të kenë një normë të ulët të TVSH-së apo do të liroheshin nga pagesa e TVSH-së. Gjithashtu ata kërkojnë një normë tjetër më të lartë të TVSH-së për mallra të cilat kanë një rëndësi më të vogël në konsumin e përditshëm dhe kanë një pjesëmarrje më të vogël në qarkullimin total si dhe një normë më të lartë të aplikuar për mallra që konsiderohen si mallra të luksit dhe shfrytëzohen nga qytetarët me të ardhura më të mëdha dhe mundësi më të mëdha për blerje të tyre.

5.2.1 Politikat fiskale sipas personave të përfshirë në hulumtim, pjesa vetëm për bizneset prodhuese

Pyetësi lidhur me ndikimin e politikave fiskale në afarizmin e bizneseve është i ndarë në dy pjesë, pjesa e përgjithshme ku në të janë përgjigjur të gjithë te anketuarit dhe në pjesën e dytë ku janë përgjigjur personat vetëm nga bizneset prodhuese dhe kjo pjesë është e ndarë në katër pyetje për të parë se cilat taksa paguajnë bizneset prodhuese gjatë importimit të lëndës së parë dhe cila është përqindja e taksave importuese, brenda vendit që paguajnë.

Kështu në pyetjen se bizneset prodhuese a paguajnë doganë , tvsh dhe taksa të tjera gjatë importimit të mallit, të gjithë janë përgjigjur me po dhe asnjë pyetësor nuk ka përgjigje se ato nuk paguajnë ndonjë nga këto taksa.

Sa i përket përqindjes së taksës doganore që paguajnë, pjesa dërmuese kanë theksuar se paguajnë 10% taksë doganore kurse pjesa tjetër kanë deklaruar se paguajnë taksë doganore prej 1% apo 0 varësisht nga mallrat dhe vendet nga importohen. Kjo ka ndodhur pasi lënda e parë që importohet nga vendet e Ceftas nuk ka taksë doganore nëse prejardhja e këtyre mallrave është nga këto vende.

Sa i përket TVSH-së, të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim kanë thënë se paguajnë tvsh për lëndën e parë dhe mallrat e tjera që importojnë dhe norma e tvsh-së që ata paguajnë është 16%.

Sa i përket akcizës në lëndë të parë, nga numri total i pjesëmarrësve në hulumtim në bizneset prodhuese, 49 kanë deklaruar se nuk paguajnë akcizë, kurse 15 kanë deklaruar se paguajnë akcizë ose në kg ose me ndonjë masë tjetër matëse dhe paguhet edhe për lëndë të parë sidomos për ambalazhin më bazë plastmase. Kjo ndikon në rritjen e kostos së

prodhimit dhe në zvogëlimin e aftësisë konkurruese të disa bizneseve prodhuese që kanë pjesëmarrëse në hulumtim.

Sa i përket makinerive që blejnë për prodhimtarin e tyre, nga 425 pjesëmarrës në hulumtim një pjesë ka deklaruar se nuk paguajnë taksë doganore për makineritë e importuara kurse pjesa tjetër kanë deklaruar se paguajnë taksë doganore për makineritë e importuara. Por pyetjet për TVSH-në nëse paguajnë TVSH, të gjithë pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë në hulumtim kanë deklaruar se paguajnë tvsh për makineritë e importuara.

Pyetja tjetër lidhur me makineritë e importuara ka të bëjë me normën e taksës doganore dhe TVSH-së që paguajnë bizneset e përfshira në hulumtim dhe të gjitha ato kanë deklaruar se paguajnë 10% taksë doganore dhe 16 % tvsh për makineritë e importuara. Shumica e tyre konsiderojnë se kjo jo vetëm që i pengon në aftësitë e tyre konkurruese por një pjesë e mirë e mjeteve financiare që mund t'i angazhonin në prodhimtari ata duhet që ti ndajnë për detyrimet ndaj shtetit edhe pse konsiderojnë se me prodhimtarinë që mund të bëjnë këto mjete shumë shpejt do të kompensojnë shtetin. Kështu, respektivisht, në mënyrë indirekte do të rriteshin të hyrat buxhetore, nga rritja e qarkullimit të prodhimtarisë vendore, e tatimit në paga, me rritjen e numrit të punësuarve si dhe e të tatimit në fitim e rritjes së fitimit të bizneseve.

5.3 Aftësitë konkurruese të bizneseve të përfshira në hulumtim

Edhe pjesa e pyetësorit lidhur me konkurrencën e bizneseve të marra në hulumtim është ndarë në dy pjesë, në pjesën ku janë përgjigjur të gjitha bizneset dhe pjesën tjetër të cilës iu janë përgjigjur vetëm bizneset prodhuese.

Pjesa e parë për konkurrencën ka pasur 10 pyetje dhe disa nën pyetje kurse pjesa e dytë që ka qenë vetëm për bizneset prodhuese ka pasur katërmbëdhjetë pyetje shtesë.

Tek pjesa e parë, pyetjet kanë qenë të orientuara për të parë vlerësimet e personave nga bizneset tregtare për dhënien e vlerësimeve të tyre lidhur me klimën e përgjithshme të bizneseve në Kosovë dhe për të dhënë një opinion për vlerësimin dhe funksionimin e tyre në vite të ndryshme, para ndryshimeve në politikat fiskale të 2008 dhe pas ndryshimeve të bëra në vitin 2009.

Kështu nisur nga kjo, pjesa dërmuese e personave që kanë marrë pjesë në hulumtim, kanë konstatuar se në Kosovë nuk ka klimë të favorshme për të bërë biznes dhe pjesa më e madhe e tyre mendojnë se një ndër vështirësitë që kanë në të bërit biznes dhe rritjen e kapaciteteve të tyre është edhe fakti se ka biznese të cilat në një mënyrë apo tjetër janë të privilegjuara në aspektin fiskal. Kjo i vë këta në pozitë të pabarabartë në tregun vendor.

Sa i përket faktit se mallrat dhe shërbimet që këto biznese ofrojnë në tregun kosovar të anketuarit theksojnë se janë mjaftueshëm të njohura dhe këtë nuk e paraqesin si problem të afarizmit të tyre por pjesa më e madhe konstatojnë se mallrat dhe shërbimet nuk konsumohen sa duhet dhe kjo zvogëlon aftësinë konkurruese dhe ndikon në mos shfrytëzimin e kapaciteteve të tyre duke ndikuar në zvogëlimin e mundësisë për investime shtesë në veprimtarinë e tyre.

Sa i përket njohjes së mallrave dhe shërbimeve në tregun e jashtëm, pjesa dërmuese e personave që kanë marrë pjesë në hulumtim konsiderojnë se këto mallra apo shërbime nuk janë të njohura sa duhet dhe si shkak kryesor është marketingu jo i duhur që kanë bërë. Një pjesë e vogël konstatojnë se nuk e dinë shkakun pse mallrat e tyre nuk janë të njohura në tregun jashtë Kosovës. Sa i përket kualitetit dhe çmimit asnjë nga të anketuarit nuk mendon

se ky është problem i mos prezencës së mallrave dhe shërbimeve të tyre në tregun e jashtëm.

Sa i përket vlerësimit të afarizmit të tyre në periudhën 2008 deri në 2013, pjesëmarrësit në hulumtim deklarojnë nga 1 deri në 3 për vlerësimin afarizmit të tyre ku me 1 ata vlerësojnë shumë mirë afarizmin e tyre kurse me 3 vlerësojnë jo mirë atë. Nga totali prej 425 pyetësorësh nga të cilët kemi marrë përgjigje, deklarami ka qenë i njëjtë.

Gjithashtu anketuesve iu është dhënë edhe një formë grafike për plotësimin e 14 përgjigjeve në pyetjet që iu janë parashtruar për të vlerësuar si pengesë në afarizmin e tyre ku me 1 = pengesë shumë e madhe; 2 = pengesë e madhe; 3 = është pengesë; 4 = pengesë e vogël dhe 5 = nuk është pengesë.

Përgjigjet e marra nga anketuesit kanë qenë të ndryshme, varësisht nga fakti si i shikojnë ata këto pengesa dhe përgjigjet kanë qenë si më poshtë:

Tabela Nr. 51 – Rezultatet e Pyetësorit për politikat fiskale për Biznese

	1	2	3	4	5
Tatimet e larta	87	146	86	84	22
Puna e ATK – së – Burokracia	50	234	80	47	14
Ligjet në fuqi jo adekuate	104	160	111	37	13
Konkurrenca e ashpër	20	140	199	16	50
Korrupsioni	44	92	162	109	18
Evazioni Fiskal	30	155	177	49	18
Ekonomia jo formale	19	179	149	44	34
Krimi apo vjedhjet	13	76	122	155	54
Kredi marrja biznesit	55	157	78	103	37
Aftësitë drejtuese të shoqërisë	11	58	60	89	207

Lejet dhe licencat për biznese	19	153	147	99	--
Niveli joadekuat i të punësuarve	14	68	62	70	7
Furnizimi me energji elektrike	34	34	112	129	116
Furnizimi me material, makineri	55	102	103	59	106
Vonesat e arkëtimeve	41	59	146	161	14
Të tjera					

Burimi: Autori (2014)

Sa i përket vlerës së investimeve kapitale në vite nga përgjigjet e marra nga të anketuarit kemi këtë vlerë të investimeve:

2008 = 41,022,838 2009 = 78,625,319 2010 = 135,800,464

2011 = 32,943,016 2012 = 19,003,919 2013 = 30,358.846

Pra nga informatat e mara nga pyetësorët shohim se nga të gjitha bizneset që kanë marrë pjesë në intervistë vlera më e madhe është investuar në vitin 2010 prej 135,800,464 euro kurse vlera më e vogël është investuar në vitin 2012 vetëm 19,003,919 Euro.

Sa i përket vlerës së mjeteve, respektivisht pasurive kapitale neto sipas vlerës kontabël, për periudhën e studiuar shohim se pasuritë kapitale më të mëdha kanë qenë gjatë vitit 2011 në vlerë prej 592,358,616 Euro kurse vlera më e vogël e pasurive kapitale neto të deklaruar nga ana e të intervistuarve ka qenë në vitin 2008 prej 411,294,677 Euro.

Duke pasur parasysh se kjo pjesë e pyetësorit, lidhur me konkurrencën, është përqendruar te ndërmarrjet prodhuese me qëllim që të që të njihet vlera e shpenzimeve që ata bëjnë për lëndën e parë dhe pjesëmarrjen e saj në koston totale, nga të gjithë intervistuarit kemi marrë përgjigjen se vlera e shpenzuar për lëndë të parë në vitin 2008 ka qenë 243,603,000; në 2009 = 239,063,000; në 2010 = 218,238,000.00 Euro ; në 2011 =

235,266,000.00; në 2012 = 224,291,000.00 Euro dhe në vitin 2013 = 170,232,000.00 .

Nga këto vlera shohim se vlera më e madhe e shpenzimeve për lëndë të parë ka qenë në vitin 2008 që ishte 243,603,000.00 Euro kurse shpenzimet më të vogla për lëndë të parë ishin në vitin 2013 në vlerë prej 170,232,000.00 Euro.

Sa i përket pjesëmarrjes së lëndës së parë në koston totale, pjesa dërmuese kanë konstatuar se kjo shkon nga 40% deri në 60% kurse pjesa tjetër janë shpenzime të punëtorëve, materialit, apo shtesë tjetër që është e domosdoshme për prodhimtari dhe shpenzimet e tjera fikse apo jo fikse që përfshihen në koston e shpenzimeve të shitjes.

Eksporti ka një pjesëmarrje të vogël tek pjesa dërmuese e bizneseve të përfshira në hulumtim si dhe në tërë ekonominë Kosovare. Këtë e dëshmon fakti se nga 66 biznese prodhuese të përfshira në hulumtim vetëm 22 prej tyre kanë eksportuar prodhimet kurse pjesa tjetër prej 44 bizneseve prodhuese kanë deklaruar se nuk i eksportojnë mallrat dhe shërbimet e tyre dhe vlera që eksportohet është shumë e vogël. Kështu pjesëmarrja e eksporteve në qarkullimin total është nga 20% deri në 30% nga xhiroja totale që kanë këto biznese.

Një faktor shumë i rëndësishëm në zvogëlimin e kostove fikse është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese nga bizneset që kanë marrë pjesë në anketim dhe ku shfrytëzimi i kapacitetit është nga 0 % deri në 70 %.

Sa i përket kualitetit të prodhimeve nga bizneset e përfshira në anketim pjesa dërmuese e tyre kanë deklaruar se ata konsiderojnë se prodhimet e tyre janë cilësore, asnjë nuk ka deklaruar të kundërtën.

Edhe sa i përket çmimeve, pjesa dërmuese e të intervistuarve kanë deklaruar se prodhimet e tyre janë konkurruese me prodhimet e vendeve të tjera dhe vetëm një numër i

vogël ka deklaruar se ato nuk janë konkuresuese apo nuk e dinë nëse çmimet e prodhimeve të tyre janë konkuresuese me çmimet që ofrohen nga konkurenca.

Sa i përket pyetjes se kush është konkurenca e prodhimeve të tyre me bizneset prodhuese vendore, ato të huaja apo të dyja nga të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim 39 kanë deklaruar se janë bizneset vendore, 25 kanë deklaruar se janë bizneset e huaja dhe vetëm 15 kanë deklaruar se konkurrencë e tyre janë edhe kompanitë vendore dhe kompanitë e huaja që funksionojnë në Kosovë.

Sa i përket mundësisë së subvencionimit dhe faktit se shteti a duhet të subvencionojë prodhimet vendore, pjesa dërmuese kanë deklaruar se shteti duhet të bëjë subvencionimin e prodhimeve vendore. Por tek pyetja tjetër në vazhdim nëse keni marrë ndonjë subvencion, vetëm 10 biznese kanë deklaruar se kanë marrë subvencion kurse pjesa dërmuese e tyre kanë deklaruar se nuk kanë marrë asnjë subvencion, i cili do iu kishte dhënë mundësi për rritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese, zhvillimin e trajnimit të personelit, rritjen e punësimit apo ndonjë shtytje tjetër me ndikim në rritjen e konkurrencës së tyre.

Edhe pjesa që ka pranuar se ka marrë subvencione ka deklaruar se ato janë marrë kryesisht nga organizmat e tjerë qeveritarë apo jo qeveritarë, që funksionojnë në Kosovë, duke përfshirë agjencitë të ndryshme si USAID nga SHBA, disa nga Qeveria Zvicerane, ajo Daneze apo edhe nga Banka Evropiane apo ndihma të tjera nga Komisioni European dhe OJQ që financohen nga vendet e tjera. Nga të gjithë të anketuarit vetëm pak prej tyre kanë deklaruar se kanë marrë subvencione apo grante nga institucionet qeveritare apo ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Pyetja tjetër mbi mundësinë e vendosjes së masave mbrojtëse të shtetit për prodhimet vendore, nga totali i të anketuarve, nga bizneset prodhuese, kanë deklaruar se shteti duhet të ndërmarrë masa mbrojtëse për shkak se edhe shtetet e tjera marrin masa për mbrojtjen e prodhimeve të tyre. Edhe pse pjesa dërmuese e të intervistuarve konsiderojnë se kanë vështirësi të shumta në afarizmin e tyre, si rezultat i konkurrencës vendore apo të huaj, nivelit të lartë të ekonomisë joformale, shkalla e ulët e subvencioneve të dhëna nga ana e shtetit, ata mendojnë se kanë perspektivë me prodhimet e veta si në tregun vendor ashtu edhe në atë të huaj.

Gjithashtu nga të intervistuarit nga bizneset prodhuese shumica prej tyre mendojnë të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese në të ardhmen.

5.4 Informata mbi të punësuarit

Në pjesën e katërt të pyetësorit janë përgjigjur të gjithë të intervistuarit pa marrë parasysh numrin, llojin e veprimtarisë së tyre. Ata janë përgjigjur lidhur me karakteristikat e të punësuarve që kanë, numrin e tyre, përgatitjen shkollore dhe nivelin e pagave të punësuarve të tyre në vite.

Ata janë përgjigjur edhe për pagën mesatare dhe pjesëmarrjen e pagave të paguara për të punësuarit. Nga hulumtimi shihet se kjo pjesëmarrje në shpenzimet totale ka ndryshuar varësisht nga veprimtaria e biznesit, fitimi që ka pasur ai dhe pozita e tij në tregun vendor dhe më gjerë si dhe nga forma e regjistrimit të biznesit. Kjo përqindje ka qenë nga 25 deri në 30.

5.5 Informata mbi rezultatin financiar

Pjesa e pestë dhe e fundit e pyetësorit ka përfshirë informata mbi rezultatin financiar dhe në të është kërkuar që të përgjigjen të gjitha bizneset që kanë marrë pjesë në hulumtim. Kjo pjesë ka qenë e formuluar në analizën e të dhënave sasiore lidhur me disa tregues financiarë të cilët do na jepnin një pasqyrë mbi pozitën e këtyre bizneseve nga viti 2008 deri në vitin 2013. Ai ka përfshirë të dhëna lidhur me qarkullimin e përgjithshëm të këtyre bizneseve, fitimin apo humbjen e realizuar nga ana e tyre, pjesëmarrjen e shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe atyre fikse në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të biznesit si dhe përqindjen e marzhit bruto të aplikuar nga këto biznese gjatë afarizmit të tyre.

Qarkullimi ka qenë një ndër kriteret e marrë për hulumtim nga të gjitha bizneset në të cilat është bërë hulumtimi.

5.6 Rezultatet nga hulumtimi i bërë me institucionet qeveritare dhe organizatat e tjera joqeveritare

Me qëllim të përfshirjes në hulumtim edhe të palës tjetër e cila merret me përpilimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij dhe organizatave që monitorojnë një gjë të tillë dhe që të mos kemi në hulumtim vetëm përgjigjet e bizneseve, të cilat influencohen nga këto politika, ne kemi përgatitur edhe një pyetësor tjetër i cili iu është dërguar disa nga institucioneve qeveritare dhe organizatave joqeveritare që merren me analizën e rrjedhave ekonomike në Kosovë dhe më gjerë si dhe disa odave ekonomike në të cilat janë të organizuara bizneset e ndryshme.

Përgjigjet e marra nga anketuesit kanë qenë të ndryshme, si nga institucionet qeveritare dhe përgjigjeve që janë marrë nga pjesa tjetër që merret me analizën e

fenomeneve ekonomike. Nga 50 pyetësorë që kemi dorëzuar, ne kemi marrë përgjigje vetëm nga 28 nga to prej të cilave 16 ishin përgjigje të OJQ ve kurse 12 nga zyrtarë të institucioneve qeveritare. Më poshtë po japim përgjigjet e përmbledhura nga 28 pyetësorët e pranuar: 1 = pengesë shumë e madhe; 2 = pengesë e madhe; 3 = është pengesë; 4 = pengesë e vogël dhe 5 = nuk është pengesë.

Tabela Nr 52 – Rezultatet e anketës tek Institucionet qeveritare dhe OJQ

	1	2	3	4	5
Tatimet e larta		4	12	4	8
Puna e ATK – së – Burokracia	4	6	6	10	12
Ligjet në fuqi jo adekuate	4	8	4	9	3
Konkurrenca e ashpër		10	11	4	3
Korrupsioni	6	5	5	4	8
Evazioni Fiskal	8	4	4	9	3
Ekonomia jo formale	5	3	8	7	5
Krimi apo vjedhjet	2	6	13	7	
Kredi marrja biznesit	14	8	4	2	
Aftësitë drejtuese të shoqërisë	16	6	3	3	
Lejet dhe licencat për biznese	9	8	5	4	2
Niveli joadekuat i të punësuarve	10	7	4	4	3
Furnizimi me energji elektrike	15	4	3	6	1
Furnizimi me material, makineri	7	3	5	8	5
Vonesat e arkëtimeve	11	4	7	4	2
Të tjera					

Burimi: Autori (2014)

5.7 Analiza statistikore dhe interpretimi i të dhënave primare

Të dhënat, të cilat i paraqitëm më lart do ti interpretojmë nëpërmjet përqindjes së pjesëmarrjes së përgjigjeve në totalin dhe frekuencën e tyre nga devijimet.

Në vazhdim do të paraqesim analizën statistikore të disa prej pyetësorëve të cilët mendojmë se kanë një rëndësi më të madhe në hulumtim.

Mbledhja e të dhënave

Njësi anketuese për mbledhjen e të dhënave kanë qenë ndërmarrja tregtare dhe prodhuese dhe më pak ato shërbyese. Pyetësi përmban pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë me karakteristikat e përgjithshme të ndërmarrjes, pyetje të përgjithshme për ndërmarrjen dhe pyetje që kanë të bëjnë me çështjet fiskale dhe ndikimin e tyre në konkurrueshmërinë, rentabilitetin dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë. Përgjigjet e të anketuarve shprehin bindje, perceptime dhe opinione të tyre dhe nuk janë të dhëna objektive të marra nga pasqyrat financiare apo dokumentacioni zyrtar i ndërmarrjeve.

Futja e të dhënave në data bazë dhe kodimi i tyre

Pas mbledhjes së të dhënave nga terreni është bërë futja e të dhënave në data bazën e krijuar në programin Excel. Data baza në Excel është bërë duke paraqitur pyetjet nëpër kolonat e faqes së excelit. Përgjigjet e marra janë koduar me numra. Pyetjet me përgjigje ordinare apo shkallë të likerit janë koduar me numra prej 1 deri në 5, ka pasur edhe pyetje me përgjigje nominale, siç janë lloji i pronësisë, vazhdimi i i veprimtarisë, dega prodhuese, etj.

Gjatë procesit të përpunimit të dhënave disa pyetje është dashur të ri kodohen me qëllim të analizimit të dhënave të mbledhura në terren.

Përpunimi i të dhënave

Pas futjes së të dhënave në data bazën e excel është bërë importimi i të dhënave në programin SPSS duke ua përshtatur të dhënat dhe emërtimin e tyre këtij programi. Pastaj përpunimi i të dhënave është bërë në këtë program përmes disa analizave.

Analiza e thjeshtë e të dhënave ka bërë nxjerrjen e rezultateve të thjeshta në formë të frekuencave dhe të përqindjeve sipas strukturës së përgjigjeve dhe gjithashtu përqindjet përmbledhëse të tyre.

Analiza e tabelave të kryqëzuara. Shumica e tabelave të kryqëzuara janë zhvilluar në mënyrë të thjeshtë për të parë bashkëveprimin e dy variablave. Por gjithashtu përmes kësaj analize është bërë edhe varësia në mes të dy ndryshoreve përmes testit `Chi Square`, e cila tregon nëse dy ndryshore kanë marrëdhënie statistikore të rëndësishme në dallimet e përgjigjeve të dhëna.

Përmes analizës së tabelave të kryqëzuara janë kryqëzuar disa nga pyetjet kryesore të pyetësorit i cili është i ndarë në pesë pjesë ku pjesa e parë kanë qenë informata të përgjithshme, pjesa e dytë informata mbi politikat fiskale, pjesa e tretë informata mbi konkurrueshmërin, pjesa e katërt mbi treguesit financiar dhe pjesa e pestë informata mbi të punësuarit.

Përveç këtyre, përmes testit të korelacionit të Pearson-it është bërë testimi i korelacionit në mes të disa variablave të caktuara, i cili tregon nëse dy variabla kanë lidhje statistikore të

rëndësishme në mes vete, dhe nëse ajo lidhje është pozitive apo negative dhe nëse është lidhje e fortë apo e butë.

Analiza e regresionit linear është përdorur për të matur ndikimin e disa faktorëve financiarë dhe sektorialë në performancën financiare të ndërmarrjeve publike. Esenca e kësaj metode bazohet nëse faktorë të caktuar kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në performancën financiare të ndërmarrjeve. Faktorët janë variabla të pavarura, të cilët pritet të ndikojnë në variable e varur në këtë rast performancën financiare të ndërmarrjes. Konsiderohet se një faktor ka ndikim në variable e varur kur vlera p e tij është $p < 0.05$, apo deri në nivelin 5% të rëndësisë statistikore.

Statistikat dhe testi i një mostre është përdorur për të analizuar variablat e një mostre duke gjetur mesataren e tyre dhe nëse dallimet në mesatare janë statistikisht të rëndësishme. Në vazhdim paraqesim disa nga statistikatat mbi të dhënat e mbledhura me anë të pyetësorit.

Forma e organizimit të ndërmarrjeve të anketuara (1= BI; 2= Korporatë; 3= Tjetër)

Lloji i biznesit	Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmblendhëse
Biznes individual	353	83.1	83.1	83.1
Korporatë	72	16.9	16.9	100.0
Totali	425	100.0	100.0	

Çka mendoni për politikat fiskale të aplikuara pas vitit 1999 në Kosovë kanë qenë?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmblendhëse
Të pafavorshme	311	73.2	73.2	73.2
Të favorshme	114	26.8	26.8	100.0
Totali	425	100.0	100.0	

Vlerëso lartësinë e normave tatimore prej 1 deri 5. Ku, 1 = normë e ulët, 5 shumë e lartë, nëse janë të aplikueshme tek ndërmarrja juaj:

Tatimi në paga: prej 1 = E ulët; 5 = shumë e lartë					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmblledhëse
Valid	1	244	57.4	57.4	57.4
	2	131	30.8	30.8	88.2
	3	50	11.8	11.8	100.0
	Totali	425	100.0	100.0	
TVSH: 1 = E ulët 5 = Shumë e lartë					
		Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmblledhëse
1		37	8.7	8.7	8.7
2		204	48.0	48.0	56.7
3		131	30.8	30.8	87.5
4		38	8.9	8.9	96.5
5		15	3.5	3.5	100.0
Totali		425	100.0	100.0	

Taksa doganore: Prej 1 = E ulët – 5 = Shumë e lartë				
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmblledhëse
2	27	6.4	6.4	6.4
3	249	58.6	58.6	64.9
4	130	30.6	30.6	95.5
5	19	4.5	4.5	100.0
Total	425	100.0	100.0	

Akciza: 1= E ulët – 5 = Shumë e lartë				
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmbledhëse
1	9	2.1	2.8	2.8
2	60	14.1	18.5	21.3
3	209	49.2	64.5	85.8
4	43	10.1	13.3	99.1
5	3	.7	.9	100.0
Total	324	76.2	100.0	
Mungojnë në sistem	101	23.8		
Total	425	100.0		

Tatimi në fitim: 1 = E ulët – 5 = Shumë e lartë				
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja vlefshme	Përqindja përmbledhëse
1	44	10.4	21.7	21.7
2	124	29.2	61.1	82.8
3	9	2.1	4.4	87.2
4	26	6.1	12.8	100.0
Total	203	47.8	100.0	
Mungojnë në Sistem	222	52.2		
Totali	425	100.0		

Vlera mesatare e lartësisë së normave tatimore

Statistikat përshkruese 1= E ulët 5 = Shumë e lartë			
	N	Mesatarja	Devijimi standard
Tatimi në paga	425	1.54	0.696
TVSH	425	2.51	0.904
Periodha pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës deri te kriza e sistemit bankar e cila më vonë kaloi në Krizë financiare pati pasoja në shumë vende të botës por për shkak të strukturës ekonomike më pak u ndie në Kosovë edhe pse gjatë kësaj periudhe kemi një rënie të vazhdueshme të investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Rritja ekonomike e Kosovës bazohej në privatizimin e një numri të madh të ndërmarrjeve shoqërore, futjen në ndonjë fond zhvillimor mjetet e privatizimit si dhe bazohej në investimet e huaja. Por efektet nga këto pritje nuk dhanë rezultatet e duhura.

Në bazë të literaturës së shqyrtuar dhe analizës së kryer shohim se tatimi në të ardhura personale së bashku me tvsh në, ka efekt më të shpejtë dhe mund të ndikojë si stabilizator fiskal. Kjo duhet të merret parasysh varësisht se cili është qëllimi i qeverisë në rritjen e konsumit i cili mund të bëhet me zvogëlimin e tatimit në paga apo e kundërta rritja e të hyrave buxhetore nëpërmjet rritjes së tatimit në pagat. Në Kosovë në periudhën 16 vjeçare që është periodha e trajtimit të këtij punimi, pas aplikimit të tatimit dhe kontributeve në paga nga viti 2002 vetëm njëherë në vitin 2009 janë bërë ndryshimet në normat tatimore në paga i cili sipas legjislacionit Kosovar është progresiv dhe sipas tij ai që ka të ardhura më të mëdha paguan më shumë tatim dhe kontribute në krahasim me atë i cili ka të ardhura më të vogla.

Nëse analizohen të hyrat buxhetore të Kosovës në të gjitha periudhat e hulumtuara para ndryshimeve në vitin 2009 dhe pas tyre dhe bazuar në madhësinë e tyre atëherë shohim se akcizat, si tatim që mbledhet në kufi, tatimi në të ardhura të korporatave dhe

TVSH-së, janë burime potenciale të stabilizimit automatik dhe mund të kenë ndikim në rrjedhën e përgjithshme ekonomike nëpërmjet shkurtimeve buxhetore për të dala të ndryshme publike. Në kushtet e të ardhurave të paqëndrueshme do të ishte e nevojshme që të hyrat nga këto tatime sipas qasjes strukturore të buxhetit të ruheshin gjatë rritjes ekonomike për periudha të viteve kur ka nevojë si rezultat i tkurrjeve ekonomike.

Zgjedhja e një instrumenti fleksibël për grumbullimin e mjeteve buxhetore nëpërmjet tatimeve në kufi apo të atyre që mbliidhen brenda vendit dhe koordinimi me të dalat publike të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike dhe implementimi i tyre lidhur dizajnimin e një kornize të qëndrueshme jo vetëm për të grumbulluar mjete buxhetore por edhe mbi mënyrën e shpenzimit të tyre, janë disa prej çështjeve kryesore që duhet të shqyrtohen nga politik bërësit në Kosovë veçanërisht në fushën fiskale. Normalisht duhet të ketë një analizë të qartë lidhur me koston që mund të kenë vendimet që kanë të bëjnë me këto ndryshime dhe përfitimet nga to nëse kemi ndonjë përfitim afatshkurtër por i cili do të kishte efekte negative në periudhën afatgjatë atëherë nuk do të duhej të zbatohet një strategji e tillë.

Për shembull aplikimi i një TVSH të ndryshueshme për lloje të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve mund të ketë edhe ndikim në efektet në aspektin afatshkurtër atëherë kur nevojat e shtetit janë për përmbushjen e detyrimeve publike por të cilat në aspektin afatgjatë mund të kenë ndikime negative pasi rritja e normave të tvsh për mallra të caktuara nëse bëhet për mallra të konsumit të gjerë ndikon në zvogëlimin e konsumit nga ana e qytetarëve. Nga ana tjetër ndryshimet e normave tatimore të shpeshta të tatimit në të ardhurat e korporatave mund të rrisë pasigurinë e bizneseve sidomos pasigurinë në planifikimit financiar, që bëjnë korporatat për të ardhurat që mund ti realizojnë nga fitimet

e tyre dhe vendosin që fitimet e tyre ti ri investojnë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre ekonomike.

Politika tatimore dhe fiskale duhet të jetë në mënyrë ideale e përkushtuar për të ndihmuar dhe për të rregulluar konsumin si dhe të kenë ndikim më të madh në investime produktive dhe fitimprurëse të cilat mund të realizohen nga kursimet e njerëzve në periudhat e kaluara apo investimet e tilla produktive do të vinin si rezultat i investimit të kapitalit në ekonomi, si të investimeve të huaja apo edhe të investimeve të mërgatës e cila një pjesë të mjeteve financiare të krijuara nga puna e tyre jashtë vendit do të kishte investuar në Kosovë. Për shkak të mungesës së stimujve financiarë dhe stimujve të tjerë në periudhën e analizuar kanë munguar në masë të madhe këto shuma edhe pse interesimi i tyre ka qenë mjaft i madh.

Ndryshimet që janë bërë në politikat fiskale kanë qenë kryesisht ndryshimet në normat tatimore dhe janë zbatuar nga viti 2009 deri në vitin 2015. Gjatë periudhës nga viti 2012 deri në vitin 2015 më tutje janë bërë edhe disa ndryshime të tjera të cilat kanë qenë jo fiskale por kanë përmirësuar klimën e biznesit, kryesisht tek bizneset e reja, ku janë shkurtuar procedurat e regjistrimit të tyre, marrjes së lejeve të ndryshme dhe lejeve të tjera mjedisore të cilat më parë kanë qenë një pengesë mjaft e madhe jo vetëm për bizneset e vjetra por veçanërisht për bizneset e reja brenda dhe jashtë. Shpesh si rezultat i këtyre masave burokratike ato nuk kanë vendosur të investojnë kapitalin e tyre në Kosovë por korporatat e ndryshme kanë bartur kapitalin e tyre në vende të tjera të regjionit apo edhe më larg pikërisht për shkak të kushteve të cilat u kanë ofruar vendet e tjera. Nga viti 2015 bëhen disa ndryshime ku zvogëlohet pragu i regjistrimit në tvsh nga 50,000.00 Euro

qarkullim vjetor në 30,000.00 Euro dhe nga ana tjetër kemi aplikimin e normave të ndyshme të tvsh-së për mallra të ndyshme që janë 8 dhe 18%.

Ndryshimi dhe aplikimi i politikave fiskale dhe politikave të tjera nga ana e qeverisë është e një rëndësie jetike për Kosovën, ku një pjesë e popullatës ballafaqohet me varfëri ekstreme dhe pamundësi të punësimit si rezultat i një strukture tejte të pavolitshme të ekonomisë kosovare, ku prodhimet vendore, të cilat janë konkurruese me prodhimet e tjera janë shumë të vogla pasi kostoja e prodhimeve të tyre është më e lartë se e mallrave që importohen. Kjo vjen për shkak se një numër shtetesh subvencionojnë prodhimet e tyre të dedikuara eksportit me mjete financiare varësisht nga sasia që eksportojnë por edhe me lehtësira të tjera fiskale që ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve të tyre prandaj edhe Kosova duhet të ndjekë gjurmët e vendeve që stimulojnë prodhimtarinë e mallrave në vendet e tyre pasi krijimi i vlerës së re në prodhim ka rëndësi të veçantë për një ekonomi. Shumica e vendeve të regjionit kanë disa përparësi të cilat mund ti shfrytëzojnë për rritjen ekonomike ku si shembull mund të marrim Kroacinë, Malin e Zi dhe Shqipërinë që kanë përparësitë e tyre në turizëm. Serbia ka një industri më të zhvilluar veçanërisht industrinë ushqimore dhe Maqedonia e cila nëpërmjet disa reformave fiskale ka arritur të tërheqë investitorët e huaj në një numër të caktuar veprimtarish. Prandaj edhe Kosova duhet të shfrytëzojë përparësitë e veta si popullatë e re dhe e aftë për tu futur me sukses në tregun e punës, rezerva të disa metaleve të cilat mundësojnë ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese, zhvillimin e kapaciteteve përpunuese të industrisë së ushqimit, ngritjen dhe kthimin e kapaciteteve përpunuese të drurit, të cilat në periudha të caktuara kishin arritur falë cilësisë së të zinin vend të rëndësishëm jo vetëm në vende të Evropës por edhe në ShBA dhe Kanada. Të gjitha këto mund të realizohen vetëm me një përkrahje të

shtetit e cila do të ishte permanente për bizneset vendore që mund dhe duhet jo vetëm të mbijetojnë në kushtet e konkurrencës së pamëshirshme por edhe të rrisin kapacitetet e veta. Kjo mund të bëhet nëse aplikohen masa stimuluese nga ana e shtetit si fiskale ashtu edhe jo fiskale por që janë të domosdoshme në rrethanat e tanishme në të cilat gjendet ekonomia e Kosovës.

6.2 Rekomandime

Nisur nga të dhënat e analizuara nga hulumtimi i kryer tek 425 biznese të veprimtarive të ndryshme dhe me pronësi të ndryshme por të cilat marrin pjesë në masë të madhe në qarkullimin e tërësishëm që bëhet në Kosovë konstatojmë se me qëllim të krijimit të rrethanave për një zhvillim të qëndrueshëm nevojitet që Qeveria e Kosovës nëpërmjet të dikastereve të tyre veçanërisht tri ministrive që merren me zhvillimin ekonomik si MF, MTI dhe MZHE të ndërmarrë reforma nxitëse nga të cilat disa prej tyre janë të karakterit fiskal si:

- Lirimin nga pagesa e doganës dhe tvsh-së për të gjithë lëndën e parë që importohet jo vetëm për një numër të kufizuar të lëndës së parë. Deri në vitin 2015 ka qenë e liruar lënda e parë vetëm me vendet e CEFT-as kurse nga viti 2015 ka filluar aplikimi i të ashtuquajturës pako fiskale 1 ku janë liruar nga pagesa e tvsh-së nga detyrimet doganore dhe tvsh –ja në importe një pjesë e lëndës së parë, dhe një gjë e tillë është mirë pritur nga bizneset kosovare veçanërisht prodhuese dhe ka dhënë rezultatet e veta por me qëllim të stimulimit të prodhimit duhet që nga këto detyrime të lirohet e gjithë lënda e parë dhe komponentët e tjera që shfrytëzohen në prodhimtari.

Sado që në fillim do të dukej se buxheti humb nga mos pagesa e detyrimeve në kufi për lëndën e parë efektet e tyre do të shihen si rezultat i rritjes së vlerës në prodhim ku detyrimet barten brenda vendit por ndikojnë edhe në gjenerimin e-vendeve të punës

- Aplikimi i normave të diferencuara të tatimeve të drejtpërdrejta për tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimin në të ardhura të bizneseve individuale ku tjetër normë tatimore do të ketë për ndërmarrjet që merren me prodhimtari e tjetër normë për ndërmarrjet që merren me tregti, nëse ndërmarrja zhvillon aktivitetet të përzier atëherë në bazë të pjesëmarrjes në qarkullimin total të përcaktohet edhe norma tatimore që duhet të paguaj nga fitimi i deklaruar. Edhe pse në shikim të parë kjo masë duket vështirë e realizueshme në praktikë aplikimi i saj do të kishte një ndikim në orientimin e bizneseve nga prodhimtari dhe do të ndikonte në rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve prodhuese kosovare. Duke pasur parasysh se si anëtare e Ceftas dhe disa organizatave tjera Kosova kryesisht nuk ka aplikuar masa mbrojtëse për prodhimet e veta në importe dhe nuk ka stimuluar eksportin me subvencionime të ndryshme si bëhet në vendet e tjera mund të aplikoj norma të diferencuara tatimore për një numër të caktuar të prodhimeve vendore që do të konsideroheshin të një rëndësie strategjike për zhvillimin ekonomik
- Nga literatura e shqyrtuar shohim se me qëllim të krijimit të ekuilibrit të përgjithshëm ekonomik dhe barazisë në shpërndarje aplikohen norma të diferencuara të tatimeve të drejtpërdrejta varësisht nga përqindja e fitimit të industrisë përkatëse dhe rëndësisë që ka ajo për shtetin si tërësi. Kështu në industritë që kanë norma më të larta të fitimit të aplikohen norma më të larta tatimore në

krahasim me industritë tjera ku norma e fitimit që realizon ai sektor ekonomik është më i vogël.

Në Kosovë një gjë e tillë mund të aplikohet për industrinë e mineralëve ngase sipas hulumtimeve Kosova ka rezerva mjaftë të mëdha të mineraleve të ndryshme prandaj aplikimi i normave të ndryshme për prodhimet e kësaj industrie do të ndikonte në zhvillimin e kapaciteteve përpunuese të kjo industri dhe rritjen e punësimit. Sot kapacitetet minerale në Kosovë shfrytëzohen në masë shumë të vogël dhe janë të orientuara vetëm për shitjen e koncentratit si lëndë të parë nga mineralet por duhet përpunim i mëtutjeshëm që do të kishin dhënë një vlerë të shtuar shtesë për ekonominë kosovare.

- Lirime për një periudhë të caktuar nga të gjitha detyrimet e tatimit në të ardhura të korporatave për ndërmarrjet e reja të cilat investojnë kapitalin e tyre në Kosovë nëse ato fitimin e tyre e ri investojnë në investime kapitale që do të kishin synim hapjen e kapaciteteve të reja prodhuese apo aplikimit të teknologjisë më të avancuar dhe inovuese e cila do të mundësonte ofrimin e shërbimeve dhe produkteve më cilësore dhe të cilat do të ishin konkurruese. Edhe kjo është një masë e cila do të mund të aplikohet veçanërisht me investimet e huaja direkte ngase në mungesë të kapitalit vendor e një rëndësi të madhe është tërheqja e investitorëve të huaj. Edhe kjo masë do të duhej të aplikohet me kujdes dhe për investime në prodhimtari që nuk ka në Kosovë dhe nuk do të shkaktonte favorizim të një investitori ndaj prodhuesve të tjerë.
- Me qëllim të rritjes së punësimit të bëhet rimbursimi i pjesës së pagesës së kontributeve shoqërore për të punësuarit e rinj dhe të cilët brenda një periudhe të

caktuar dy apo tri vjeçare kanë qenë të lajmëruar në qendrat e punësimit por nuk kanë arritur të gjejnë punë. Kjo masë ndikon edhe në futjen në rrjedha të rregullta punësimit pasi që bizneset paguajnë deri më tani vetëm pjesën e kontributeve shoqërore dhe kjo ka bërë që disa nga to të mos lajmërojnë punëtorët e angazhuar tek ata dhe rimbursimi i kësaj pjese të kontributeve shoqërore do të stimulonte punësimet e reja dhe lajmërimin e punëtorëve të cilët punojnë por janë të lajmëruara në qendrat e punësimit si të papunë. Dobia për qeverinë është se disa nga këta punëtor duke pasur parasysh se konsiderohen si të papunë marrin ndihma nga skemat sociale që aplikohen në Kosovë edhe pse janë të punësuar por të pa regjistruar dhe të cilët për të ardhurat e tyre nuk paguajnë asnjë lloj tatimi dhe kontributi shoqëror për shtetin.

- Përshkallëzim i tvsh-së në më shumë norma tatimore ku të ardhurat të cilat do të humbeshin nga tatimi për shkak të zvogëlimit të normave të tvsh-së të kompensoheshin me rritjen e normave të tvsh-së për produkte që konsiderohen si luks apo të cilat dëmtojnë shëndetin e popullatës (kjo masë mund të ndikoj në tentim për rritjen e evazionit fiskal tek produktet të cilave iu rritet tvsh – ja por duhet synuar që të ndërmerren masa mbrojtëse ndaj këtij fenomeni që mund të paraqitet). Deri në vitin 2015 është aplikuar vetëm norma standarde e tvsh-së prej 16% dhe 0 për eksporte apo e përjashtuar për disa produkte por pa të drejtë të zbritjes së tvsh – së në blerje. Nga shtatori i vitit 2015 tvsh – ja është përshkallëzuar në normën standarde prej 18 %, normën e ulët prej 8 % si dhe mallrat për të cilat nuk aplikohet tvsh-ja si në eksporte apo shitje Kforit, Bankës Botërore dhe OJQ – ve dhe Organizatave Qeveritare që angazhohen në projekte bamirësie në Kosovë.

- Implementimi i ligjit për investime strategjike ku mundë të ofrohen kushte preferenciale fiskale dhe të tjera për ndërmarrjet me interes për ekonominë e vendit një gjë e tillë aplikohet edhe në vendet e ndryshme të BE edhe pse ato e kanë të ndaluar një gjë të tillë me qëllim që kompanitë shumë milionëshe të investojnë kapitalin e tyre në vendet e tyre ato u japin atyre lehtësira të ndryshme që shpesh nuk i bëjnë publike. Ky ligj është aprovuar në parlamentin e Kosovës por ende nuk ka filluar implementimi i tij prandaj duhet të fillohet që me qëllim të tërheqjes së investorëve strategjik për projekte të caktuara dhe të rëndësisë së veçantë sa më shpejt të fillohet implementimi i tij.
- Ndarja e një fondi për subvencionimin e ndërmarrjeve të caktuara që kanë rëndësi strategjike për Kosovën ku me ligj përcaktohet se cilat veprimtari dhe cilat ndërmarrje dhe cilat kushte duhet të plotësojnë këto ndërmarrje që të mund të karakterizohen për një gjë të tillë e gjithë kjo të përcaktohet në mënyrë të qartë në mënyrë që të eliminohen aferat abuzive që mund të ndodhin nga institucionet të cilat do të merreshin me zbatimin e këtyre stimuljeve për veprimtari të caktuara (Një përvojë e tillë ekziston tek shteti kroat ku ata nga pjesa dërmuese e subvencioneve rreth 37 % i ndajnë për industrinë e ndërtimit të anijeve ngase kjo industri ka një rëndësi për ta se siguron mjete financiare nga eksporti dhe punëson një numër të madh të punëtorësh).
- Subvencionimi i bujqësisë me kritere të qarta ku me qëllim të eliminimit të aferave korruptive të krijoheshin rezerva shtetërore për farë për mbjellje të kualitetit të lartë, plehra artificiale dhe lëndë djegëse të cilat fermerët do ti merrnin me çmime

më të ultë dhe pagesën do të mund ta bënin ose më produkte të tyre si kompensim ose në para të gatshme.

- Me qëllim të krijimit të mundësive më të mira për eksportuesit të cilët do të kishin efekt shumë të madh në zvogëlimin e bilancit tejet të pafavorshëm tregtar shteti duhet të ndaj një fond të veçantë për subvencionimin e eksportit të prodhimeve vendore dhe të shërbimeve në të cilat përcaktohen qartë kriteret se kush mund të jetë përfitues i këtij fondi ku nuk duhet të përfshihen veprimtarit që nuk ndikojnë në rritjen e punësimit ku sot eksportet e Kosovës karakterizohen kryesisht me shitjen e metaleve jo të përpunuara.

BIBLIOGRAFIA

- Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (2006), Bilanci i Pagesave i Kosovës 2004 – 2005, Prishtinë, Kosovë
- Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës(2007), CBAK Bulletin, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2007), Doracak mbi tatimet, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2009), Raporti i punës 2008, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2010), Raporti i punës 2009, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2011), Raporti i punës 2010, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2011), Strategjia e përmbushjes 2012 - 2015, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2012), Raporti i punës 2011, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2013), Raporti i punës 2012, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2013), Buletini Informativ, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2014), Raporti i punës 2013, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2015), Raporti i punës 2014, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2016), Raporti i punës 2015, Prishtinë, Kosovë
- Atk (2017), Raporti i punës 2016, Prishtinë, Kosovë
- Agell, J., Ohlsson., H. and P. Skogmann Thoursie (2006), Growth effects of government expenditure and taxation in rich counties: a comment, *European Economic Review*, 50(1), 211-218
- Alesina, A. and Ardagana, S. (1998): "Tales of Fiscal Contractions: Fiscal Adjustments: Why Can They Be Expansionary", *Economic Policy*, 27, f. 489 -543
- Alesina, A. and Drazen, A. (1991): " Why Are Stabilizations Delayed? *American Economic Review*, 82 (5), f.79-1188.
- Alesina, A. and Peroti, R. (1995): " Fiscal Expansion and Fiscal Adjustments in OECD Countries ", *Economic Policy* 21, f.205-248.
- Alesina, A. and Peroti, R. (1996): " Budget Defits and Budget Institutions", NBER Working Papers, 5556.
- Alesina, A. and S. Ardagna, 2010, "Large Changes in Fiscal Policy: Taxes versus Spending," in *Tax Policy and the Economy*, Jeffrey R. Brown (ed.), vol. 24, Chicago: University of Chicago Press, pp. 35-68. Adjustments", *Brookings Papers on Economic Activity*, f, 197-248.
- Alesina, A. and Rodrik, D. (1994): "Distributive Politics and Economic Growth", *Journal of Economics*, 109 (2),f.465-490.
- Alesina, A. and Roubini, N. (1992): " Political Cycles: Evidence from OECD Economies" *Review of Economic Studies*, 59, f. 63-668.
- Alloza, M. (2016), *The impact of Taxes on Income Mobility*, London, University College, London
- Arnold, J. (2008), *Do Tax Structure Affect Aggregate Economic Growth? Empirical Evidence from a Panel of OECD Countries*.
- Atkinson, B. and Stiglitz.J. (1980), *Lectures on Public Economics*, New York, Mc Graw – Hill
- Atkinson, B. (1983), *The economics of the quality*, Oxford University Press
- Avila, R. And Strauch, R. (2003), *Public finances and long – term growth in Europe – evidence from panel data analysis*, Working Paper N. 246, European Central Bank,
- Buser, W. (2011) *The impact of fiscal decentralization on economics performance in high income OECD nations: an institutional approach*. *Public Choice* 149: 31–48.

- Barro, R. J. and X. Sala-i-Martin (1992), Public finance in models of economic growth, *Review of Economic Studies*, 59(4), 645-661,
- Barro, R. (1979): "On the Determination of Public Debt", *Journal of Political Economy*, 98 (1), f. 103-117.
- Buchanan, J. (1960): *Fiscal Theory and Political Economy*, Chapel Hill, North Carolina: University of North Carolina Press.
- Buchanan, J. and Wagner, R. E. (1976) "Revenue Structure, Fiscal Illusion and Budgetary Choice", *Public Choice*, 25,f. 45-61.
- Bleaney, M, Gemmell, N. and R. Kneller (2001), Testing the endogenous growth model: publik expenditure, taxation, and growth over the long run, *Canadian Journal of Economics*, 34(1) 36-57
- Banka Qendrore e Kosovës (2009) " Raporti vjetor 2008, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2010) " Raporti vjetor 2009, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2010) "Raporti i Stabilitetit Financiar" Numër 1 Dhjetor 2010, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2011) " Raporti i Stabilitetit Financiar" Numër 2 Dhjetor 2011, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2011) " Raporti vjetor 2010, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2012) " Raporti i Stabilitetit Financiar" Numër 03 Dhjetor 2012, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2012) " Raporti i Bilancit të pagesave 2012, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2012) " Raporti vjetor 2011, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2013) " Raporti vjetor 2012, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2014) " Raporti vjetor 2013, Prishtinë, Kosovë
- Banka Qendrore e Kosovës (2015) " Raporti i zhvillimeve makroekonomike, Prishtinë, Kosovë
- Baldacci, E., Clements, B. & Gupta S. (2003), "Using Fiscal Policy to spur Growth Finance & Development"
- Banka Botërore (2014), *Country Snapshot*, Washington, USA
- Banka Botërore (2014), *Doing Business*, Washington, USA
- Benos.N (2004), "Fiscal policy and economic growth: Empirical evidence from OECD countries, University of Cyprus "
- Bleaney, M, Gemmell, N. and R. Kneller (2001), Testing the endogenous Growth model: publik expenditure, taxation and growth over the long run, *Canadian Journal of Economics*, 34(1),36-57
- Bruce, D. and Mohsin, M. (2006) Tax policy and entrepreneurship: new time series evidence. *Small Business Economics* 16: 409-25.
- Bundo, Sh.(2004), *Financë, Botimi i parë*, Tiranë
- Bundo, Sh.(2007), *Financë, Botimi i Tretë*, Tiranë
- Calame. P (2011). *Ekonomia në shekullin XXI*, Papirus,
- Charles I. (1992). "The search for growth" *Proceedings*, Federal Reserve Bank of Kansas City, f. 57-92.
- Cashin, P. (1995) Government spending, taxes and economic growth. *IMF Staff Papers* 42(2): 237-69
- Civici, A. (2009), "Globalizimi ...ante portas", UET, Tiranë, Shqipëri
- Civici, A. (2010), "Krizë Financiare 2007-2010: Tronditja dhe pikëpytja mbi efektivitetin e kapitalizmit" *Revista Economicus* (Nr.5)
- Civici, A. (2010), "Krizë Financiare ..apo globale?", UET, Tiranë, Shqipëri

- Civici, A. (2011), “ Iluzionet monetare-mashtuesit e mëdhenj”, OMBRA GVG. Tiranë
- Colombier, C. & Pickhardt, M. (2005), A note on public input specifications, *International Advances In Economic Research*, 11(1) 13 - 18
- Colombier, C. (2009), Growth Effects of Fiscal Policies. *Applied Economics*, Volume 41 Issue 7, March 2009, page 899 - 912
- Cvetkovic, Arsic, Milicevic (2013), Improving Global Competitiveness of small and medium enterprises in Serbia.
- Damiani, M. and Pompei, F. (2010) Labour protection and productivity in EU economies: 1995–2005. *European Journal of Comparative Economics* 7(2): 373–411.
- Doganat e Kosovës (2009) Raporti vjetor 2008, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2010) Raporti vjetor 2009, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2011) Raporti vjetor 2010, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2012) Raporti vjetor 2011, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2013) Raporti vjetor 2012, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2014) Raporti vjetor 2013, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2015) Raporti vjetor 2014, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2016) Raporti vjetor 2015, Prishtinë, Kosovë
- Doganat e Kosovës (2017) Raporti vjetor 2016, Prishtinë, Kosovë
- Dennis. H. (2008) “Historia e mendimit ekonomik”, Presses University de France, Paris, Francë
- Dollar D and A Kraay. (2002). Growth is Good for the Poor, *Journal of Economics Growth* Vol. 7. <http://dx.doi.org/10.1023/A:1020139631000>
- Enti i Statistikave të Kosovës (2011), Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës. Prishtinë, Kosovë
- ESK (2014), Statistikat ekonomike, Llogarit Qeveritare të Kosovës 2008 – 2013, Prishtinë, Kosovë.
- Edwards S. (1998). Openness, productivity and Growth: What do We really know? *The Economic Journal*, Vol.108, N.447. <http://dx.doi.org/10.1111/1468-297.00293>
- Feldstein, M. (1982), “Inflation, tax rules, and investments: Some econometric evidence”, *Econometrica* 50, p. 233-46
- Feldstein, M. (1985), “Debt and taxes in Theory of Public Finance”, *Journal of Public Economics* 28, 233-46
- FMN, (2013), Fiscal Monitoring – Taxing Times, Washington, USA
- FMN, (2015), The western Balkans 15 years of economic transition, Washington, USA
- Friedman, M. (1998), Let’s Revamp the Tax code- But How? *Wall Street Journal*, p.22
- Fölster, St. & Henrekson, M. (2001), Growth effects of government expenditure and taxation in rich countries, *European Economic Review*, 45(8), 1501-1520.
- Hayek, P. (1931), F. A. Prices and Production.
- Heath, A. (2012), The Single Income Tax. London: 2020 Tax Commission, The TaxPayers Alliance and the Institute of Directors.
- Kadriu, S. (2012), Financa Publike, Prishtinë
- Komoni, S. (2008). “Financa Publike”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë
- Kneller, R., Bleaney, M. and Gemmell, N. (1999) Fiscal policy and growth, evidence from OECD countries, *Journal of Public Economics*, 74(2) 171 - 90
- Krugman, P. (1994), Competitiveness: A dangerous obsession, *Foreign Affairs*, page. 28-44.
- Krugman, P. (2008), The Return of Depression Economics and the Crisis of 2008, W.W.Norton.
- Kosova Budget System (2003) “Policies and Sustainability”, Riinvest Institut June 12,

2003

- Keynes, J.M.(2006). Teoria e përgjithshme e punësimit, interesit dhe parasë. Plejad,2006
- Kuvendi i Kosovës, (2011), Ligji për akcizën në produktet e duhanit, Prishtinë, Kosovë
- Kuvendi i Kosovës, (2013) Ligji mbi buxhetin, Prishtinë, Kosovë
- KPMG(2014), Investment in Kosovo, Prishtinë, Kosovë
- Konkurrenca në Shqipëri (2011), Broshurë informuese, Autoriteti i konkurrencës, Tiranë
- Levine, R. And D.Renelt (1992), A sensitivity analysis to cross- country growth regressions, American Economic Review, 82(4),642-963.
- Lall, S. (2001), Competitiveness Indices and Developing Countries: An Economic Evaluation of the Global Competitiveness Report, World Development, Vol. 29, No. 9, pp. 1501-1525.
- UNDP (2012) Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2012, Sektori Privat dhe Punësimi, Prishtinë, 2013
- Federalni Zavod za programiranje razvoja (2016), Konkurentnost 2015 – 2016 Bosne i Hercegovine, Sarajevo, Bosna i Hercegovina
- National Competitiveness Council of Croatia (2004), ''55 Preporuka za Povecanje konkurentnosti hrvatske''Zagreb, Croatia
- Mayo, B.H. (2012), Bazat e Financës, Hyrje në institucionet financiare, investime dhe drejtim'', UET, Tiranë, Shqipëri
- Meakin, R. (2012) Make it simple. Taxation169(4358): 6–8.
- Minford, L. (2015) The macroeconomic effects of UK tax, regulation and R&D subsidies: testing endogenous growth hypotheses in an open economy DSGE model. PhD thesis, Cardiff University.
- Musgrave, R. (1959), The Theory of Public Finance, New York, McGraw- Hill
- Musgrave, R. (1980), Theories of Fiscal Crises: An Essay in Fiscal Sociology''In the Economics of Taxation, Washington DC, Brookings Institution
- Musgrave, R. (1985) ''A Brief History of Fiscal Doctrine''In Handbook of Public Economics, Vol.1, Amsterdam: North-Holland
- Myles, G. (2000) " Taxation and economic growth", Fiscal Studies, 21 (1), f.141-168.
- MFE, (2013) Raporti vjetor financiar, 2007 – 2013, Prishtinë, Kosovë
- MFE, (2015) Raporti vjetor financiar, 2014 – 2015, Prishtinë, Kosovë
- MFE, (2017) Raporti vjetor financiar, 2015 – 2016, Prishtinë, Kosovë
- MTI, (2009) Politikat tregëtare të Kosovës, Prishtinë, Kosovë
- MTI, (2011) Shkëmbimet tregëtare të Kosovës, Prishtinë, Kosovë
- MTI, (2013) Raportet vjetore 2009 deri 2013, Prishtinë, Kosovë
- MTI, (2014) Raporti vjetor i zhvillimit industrial, Prishtinë, Kosovë
- Nijkamp, P. and Poot, J. (2004) Meta –analysis of the effect of fiscal policies on long run, growth, European Journal of Political Economy,20,91-124
- OECD(2013), Zhvillimi i sektorit privat, Vlerësimi i sistemit inovativ të Kosovës, Prishtinë, Kosovë
- OECD (2010), Tax Policy Reform and Economic Growth. OECD Tax Policy Studies no. 20. Paris: OECD Publishing.
- Pack, H. (1994) Endogenous Growth Theory: Intellectual appeal and empirical Shortcomings, Journal of Economic Perspectives,8(1),55 – 72
- Pere, E, (2011), ''Tax systems in West Balkans Countries – Between Simplicity and Efficiency'', <https://www.researchgate.net/publication/227487391>
- Porter, M, E., (1990), The Competitive Advantage of Nations, Harvard Business Review, March-April 1990, page. 74-91.
- Rosen, S.H.(2010), Financat Publike, UET Press, Tiranë, Shqipëri

- Samuelson, P. & Nordhaus, W. *Ekonomija*, Mate Zagreb, 2000
- Samuelson, P.(1955) "The Pure Theory of Public Expenditure", *Review of Economics and Statistics*
- Smit, A., *Istraživanje prirode i uzroka bogatstva naroda*, Kultura, Beograd,1970
- Suat, B & Mirza. T (2016), The Concept of tax harmonization and tax competition in EU member countries,UDK, 336.227.8(4-672EY)
- Schuller, B. Lindbom, M. (2009), Competitiveness of Nations in the Global Economy. Is Europe Internationally Competitive? *Economics and Management* , 14(1): 934-941.
- Stiglitz, J. (1973): Taxation, Corporate Financial Policy, and the Cost of Capital" *Journal of Public Economics* 2,pp 1-34,
- Stiglitz, J. (1978), Notes on Estate Taxes, redistribution and the Concept of Balanced Growth Path Incidence" *Journal of Political Economy*, 86. Pp 137 - 150
- Stiglitz, J (1982), "Information and Capital Markets," in William F. Sharpe and Cathryn Cootner (eds.), *Financial Economics: Essays in Honor of Paul Cootner*, Prentice Hall, New Jersey, pp. 118 -158
- Stiglitz, J (1984), "Alternative Theories of Wage Determination and Unemployment in L.D.C.'s: The Labor Turnover Model, " *Quarterly Journal of Economics*, 88(2): 194-227
- Stiglitz, J. (1987): Pareto efficient and optimal taxation and the new welfare economics, in *Handbook of Public Economics*, vol. II, edited by A. J. Auerbach and M. Feldstein, North-Holland, Amsterdam.
- Stiglitz, J. (2011), " Re thinking Macroeconomics: What Failed and How to Repair It," *Journal of the European Economic Association*", 9(4): 591-645
- Stiglitz, J. (2013), "Stable Growth in an Era of Crises: Learning from Economic Theory and History" *Ekonomi - tek*, 2(1): 1-38.
- Stiglitz, J & Guzman, M., (2014), "Pseudo-wealth and Consumption Fluctuations", Columbia University Working Paper, presented at the World Congress of the IEA, June, 2014.
- Stiglitz, J. (2014), *Reforming Taxation to Promote Growth and Equity*, Roosevelt Institute,
- Schumpeter, J. A. (1935). "The Analysis of Economic Change." *The Review of Economic Statistics* 17(4): 2-10.
- Schumpeter, J. A. (1936) *The Theory of Economic Development. An Inquiry into Profits, Capital, Credit, Interest, and the Business Cycle*. Cambridge, MA, Harvard
- Schumpeter, J. A. (1947). "The Creative Response in Economic History." *Journal of Economic History* 7(2): 149-159. University Press.
- Schumpeter, J.A. (1975), *Povjest ekonomske analize*, Zagreb, Informator, sv.II str. 632.
- Schumpeter, J.(1975) *Istorija ekonomske analize*, Informator, Zagreb,
- Schumpeter, J.A. (1996), *History of Economic Analysis: With a New Introduction*, Oxford University Press.
- Temple, J. (1999), The new growth evidence, *Journal of Economic Literature*, 27(1), 112-156.
- UNDP (2014) *Raporti i konkurrueshmërisë, grupet natyrore*, Prishtinë, Kosovë
- UNDP (2015) *Tregjet potenciale për eksport*, Prishtinë, Kosovë
- World Bank, (2005) "Public Investment and Fiscal Policy - Lessons from the Pilot Country Studies," Washington, USA.
- WEF, (2012), *The Global Competitiveness Report 2012-2013*, Ed. Schwab, K, World Economic Forum
- Xhafa, H. & Ciceri, B. (2001), *Drejtimi Financiar*, Toena, Tiranë

Zagler, M and Durnecker, G. (2003), "Fiscal policy and economic growth "Journal of Economic Surveys", 17, f. 397-418

ANEKSE

Pyetësi për Shoqëritë tregtare

Pyetësor lidhur me politikat fiskale të aplikuara në Kosovë, konkurrueshmërin dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë nga pas lufta deri më 2013

E/ I nderuar zonje/zotëri

Unë jam Skender Hasani – Doktorant pran Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës Ky është një pyetësor që do të përdoret për informacione për punim doktrate dhe çdo informacion i marrë është i besueshëm dhe do të përdoret vetëm për qëllime të këtij punimi prandaj me mirëbesim ju lutem të plotësoni këtë pyetësor

Pozita e të intervistuarit në kompani: _____

PJESA I: INFORMATA BAZË PËR SHOQËRINË - BIZNESIN

1. Viti i themelimit të shoqërisë - biznesit?
2. Lloji i pronësisë së biznesit?
 - a. biznes individual
 - b. korporatë
 - c. tjetër
3. Veprimtaria juaj nga fillimi ka qenë?
 - a. njëjtë
 - b. ka ndryshuar
4. Veprimtaria juaj është?
 - a. Tregtare
 - b. Prodhuese
 - c. Shërbime
 - d. tjetër, specifiko
5. Mjetet financiare i keni siguruar nga?
 - a. Kapitali aksionar – vetjak _____ %
 - b. Kreditimi _____ %
 - c. Familja & miqtë _____ %
 - d. Tjetër _____

PJESA E II: INFORMATA MBI POLITIKËN FISKALE

1. Çfarë mendoni për politikat fiskale të aplikuara pas luftës në Kosovë, kanë qenë?

- a. të favorshme
- b. të pafavorshme

2. Cilat lloje të taksave paguani po ose jo?

- a) Tatim në fitim
- b) Tvsh
- c) Tatim për biznese të vogla
- d) Tatime për të punësuarit
- f) Tjetër specifiko _____

3. Sa është shuma totale e tatimeve të paguara brenda viteve duke përfshirë edhe taksat doganore?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

4. A mendoni se duhet të ketë ndryshime në politikat fiskale?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

5. A mendoni se duhet rritur disiplina fiskale në Kosove?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

6. A mendoni se ka biznese të privilegjuara në aspektin fiskal?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

7. Vlerëso lartësinë e normave tatimore prej 1 deri 5. Ku, 1 = normë e ulët, 5 shumë e lartë, nëse janë të aplikueshme tek biznesi juaj:

Lloji i tatimit	1	2	3	4	5	E pa aplikueshme
Tatimi në paga						
Tvsh						
Taksat doganore						
Akciza						
Tatimi në fitim						

8. A jeni deklarues dhe pagues i TVSH-së?

- a. po
- b. jo

8 .a Nëse po, kur keni filluar të deklaroni dhe të paguani TVSH? Viti_____

9. Si e vlerësoni pragun e hyrjes në TVSH?

- a. të ulët
- b. mesatar
- c. të lartë

10. Pas hyrjes në TVSH, si e ndjeni aftësinë e biznesit tuaj në treg në krahasim me periudhën para hyrjes në TVSH?

- a) E përmirësuar;
- b) E njëjtë
- c) E dobësuar;

11. A mund të përshkruani shkurt se çfarë mendoni se duhet ndryshuar në politikat fiskale për krijimin e një ambienti të favorshëm bizneseve në Kosovë?

VETËM PËR BIZNESET PRODHUESE

12. Nëse merreni me prodhim a paguani për lëndë të parë doganë , tvsh dhe taksa tjera gjatë importimit?

- a. po
- b. jo

13. Nëse po sa është përqindja që paguani për?

- a) Taksë doganore =
- b) Tvsh ne import =
- c) Akcize =
- d) Takse tjetër =

14. A paguani doganë, Tvsh për makineri të importuara apo ato të blera brenda vendit?

- a. po
- b. jo

15. Nëse po sa është përqindja që paguani për?

- a) Taksë doganore
- b) Tvsh në import

PJESA E III : KONKURUESHMËRIA

1. A mendoni se ka klimë të favorshme bizneseve në Kosovë?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

2. A keni pengesa nga konkurenca jo lojale ?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

3. A mendoni se prodhimet, mallrat ose shërbimet tuaja janë të njohura sa duhet në tregun kosovar?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

4. A mendoni se prodhimet, mallrat ose shërbimet tuaja konsumohen – shfrytëzohen sa duhet në Kosovë ?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

5. A mendoni se prodhimet, mallrat ose shërbimet tuaja janë të njohura në tregun e jashtëm?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

6. Nëse jo çfarë mendoni se ndikon në këtë?

- a. çmimi
- b. kualiteti
- c. marketingu i dobët
- d. nuk e di

7. Si e vlerësoni afarizmin tuaj për vitet: (vlerëso me numra: 1= mirë; 2 = mesatarisht; 3 = jo mirë)

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

8. Renditni sipas mendimit tuaj faktorët të cilët përbëjnë pengesë për afarizmin tuaj:

1= pengesë shumë e madhe; 2 = pengesë e madhe; 3 = është pengesë; 4 = pengesë e vogël;

5 = nuk është pengesë), shëno numrat në vazhdim të fjalisë:

Emërtimi	1	2	3	4	5
Tatimet e larta					
Puna e administratës tatimore					
Ligjet në fuqi jo adekuate dhe të pa mjaftueshme					
Konkurenca e ashpër/fortë					
Korrupsioni					
Evazioni fiskal					
Ekonomia joformale/ e zezë					
Krimi, vjedhjet					
Qasja në kredi					
Aftësitë tuaja drejtuese					
Lejet dhe licencimet për biznese					
Niveli joadekuat i aftësive të punësuarave					
Furnizimi me energji elektrike					
Furnizimi me material, makineri dhe pajisje					
Vonimi i pagesave dhe arkëtimi i borxheve					
Diçka tjetër (specifiko)_____					

9. Sa është vlera e investimeve kapitale në vite ?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =

- e. 2012 =
- f. 2013 =

10. Cila është vlera e mjeteve totale të biznesit, sipas viteve ?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

VETËM PËR BIZNESET PRODHUESE:

11. Sa është vlera e lëndës së parë të blerë – materialeve prodhuese në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

12. Sa përqind zë lënda e parë në koston totale?

13. Prodhimet e tuaja a i eksportoni?

- a. Po
- b. Jo

14. Nëse po, sa është % vlerës së eksportit në shitjet e përgjithshme?

15. Sa shfrytëzohen kapacitetet tuaja në dispozicion?

_____ %

16. A mendoni se prodhimet tuaja janë kualitative sa ato të konkurrencës?

- a. po

- b. jo
- c. nuk di

17. Çmimet e prodhimeve tuaja a janë konkurruese me ato të mallrave të ngjashëm?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

18. Konkurencë tuaja janë kompanitë prodhuese?

- a. vendore
- b. të jashtme

19. A mendoni se shteti duhet të subvencionoj prodhimet vendore?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

20. A keni marrë ndonjë subvencion – grand ?

- a. po
- b. jo

21. Nëse po prej kujt i keni marrë?

22. Cila ka qenë vlera e subvencionit?

23. A mendoni se shteti duhet te vendosë masa mbrojtëse për të mbrojtur bizneset vendore?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

24. A shihni perspektivë me prodhimet tuaja në tregun vendor dhe të jashtëm?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

25. A mendoni të zgjeroni gamën e prodhimeve tuaja?

- a. po
- b. jo
- c. nuk e di

PJESA E IV : INFORMATA MBI TË PUNËSUARIT

1. Cili ka qenë numri i punëtorëve tuaj në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

2. Nga të gjithë të punësuarit cila është struktura kualifikuese e tyre?

- a. ulët =
- b. mesme =
- c. lartë =

3. Sa ka qenë paga mesatare për të punësuarit në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

4. Sa kanë qenë pagat totale të paguara në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

5. Sa përqind zë fuqia punëtore në koston totale ?

PJESA V : TREGUESIT FINANCIAR

1. Sa ka qenë qarkullimi juaj në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

2. Sa ka qenë marzhi bruto i fitimit të prodhimeve, mallrave ose shërbimeve tuaja në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

3. Sa ka qenë fitimi/humbja në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

4. Sa janë shpenzimet operative në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

5. Sa janë shpenzimet fikse në vite?

- a. 2008 =
- b. 2009 =
- c. 2010 =
- d. 2011 =
- e. 2012 =
- f. 2013 =

Pyetësi për institucione qeveritare dhe OJQ

Pyetësor lidhur me politikat fiskale të aplikuara në Kosovë, konkurueshmërin dhe zhvillimin e bizneseve në Kosovë pas luftës deri në vitin 2013.

E/ I nderuar zonjë/zotëri

Unë jam Skender Hasani – Doktorant pranë Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës Ky është një pyetësor që do të përdoret për informacione për punim doktrate dhe çdo informacion i marrë është i besueshëm dhe do të përdoret vetëm për qëllime të këtij punimi prandaj me mirëbesim ju lutem të plotësoni këtë pyetësor

Pozita e të intervistuarit në institucion : _____

Rendit sipas mendimit tuaj faktorët të cilët ndikojnë në aktivitetet e shoqërive tregtare që veprojnë në Kosovë dhe kanë të bëjnë me politika fiskale dhe politika të tjera ekonomike dhe lidhen me institucionet qendrore dhe lokale: 1= pengesë shumë e madhe, 2 = pengesë e madhe; 3 = është pengesë; 4 = pengesë e vogël; 5= nuk është pengesë),

tek numrat 1 deri 5 shëno përgjigjen tuaj:

Emërtimi	1	2	3	4	5
Tatimet e larta					
Puna e administratës tatimore (Burokracia)					
Ligjet në fuqi jo adekuate dhe të pa mjaftueshme					

Konkurrenca e ashpër/fortë					
Korrupsioni					
Evazioni fiskal					
Ekonomia joformale/ e zezë					
Vonesat për Leje dhe licenca për biznese					
Qasja në kredi					
Mos subvencionimi nga shteti i veprimtarive prodhuese					
Vonimi i pagesave nga institucionet qendrore dhe lokale					
Niveli joadekuat i aftësive të punësuarave në shoqëri tregtare					
Furnizimi me energji elektrike					
Krimi, vjedhjet					
Diçka tjetër specifik)_____					